



Republika e Maqedonisë së Veriut
Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional

PROGRAMI
PËR DHËNIE TË PROVIMIT
PËR AGJENTË

Shkup, nëntor 2022

Përmbajtje

HYRJE.....	6
1. STRUKTURA E SISTEMIT TË REFORMUAR TRESHTYLLËSH PENSIONAL	8
2. SHKAQET PËR REFORMËN E SISTEMIT PENSIONAL	9
3. QËLLIMET E REFORMËS SË SISTEMIT PENSIONAL DHE PËRFITIMET E PRITURA.....	13
4. INFRASTRUKTURA INSTITUCIONALE.....	16
4.1. SHOQËRITË PENSIONALE.....	17
4.1.1. Themelimi i shoqërive për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale, shoqërive për menaxhim me fondet vullnetare pensionale dhe shoqërive për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale, lëshim të lejes për themelimin e shoqërisë dhe lëshim të lejes për menaxhim me fondin e detyrueshëm pensional dhe lejes për menaxhim me fondin vullnetar pensional	19
4.1.2. Kryegjësja themelore e shoqërive pensionale.....	23
4.1.3. Kushtet për themelues të shoqërive pensionale	24
4.1.4. Përgjegjësia e shoqërive pensionale para anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondit të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional	26
4.1.5. Detyra fiduciare e personave përgjegjës	26
4.1.6. Menaxhimi korporativ i shoqërive pensionale	27
4.1.7. Menaxhimi me rreziqe i fondeve të detyrueshme dhe/ose vullnetare pensionale	28
4.1.8. Sigurimi i harmonizimit të punës me rregullativën.....	28
4.1.9. Aktuar i autorizuar	28
4.1.10. Revizioni i punës së shoqërive pensionale.....	29
4.1.11. Dokumentacioni dhe evidenca e shoqërisë pensionale	29
4.2. <i>FONDI I DETYRUESHËM DHE VULLNETAR PENSIONAL</i>	30
4.2.1. Vlerësimi i mjeteve të fondeve pensionale	31
4.3. <i>RUAJTËSI I PRONËS SË FONDEVE PENSIONALE</i>	32
4.4. <i>AGJENCIA PËR MBIKËQYRJE TË FINANCIMIT KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL (MAPAS)</i>	34
5. ANËTARËSIMI NË FONDET E DETYRUESHME PENSIONALE DHE PAGESA E KONTRIBUTEVE.....	38
5.1. <i>ANËTARËSIMI NË FONDET E DETYRUESHME PENSIONALE</i>	38
5.1.1. Marrëveshja për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional.....	47
5.1.2. Prishja e marrëveshjes për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional.....	47
5.1.3. Transferimi nga një fond të detyrueshëm pensional në fond tjetër	48
5.1.4. Shpërndarja e të siguruarve në fondet e detyrueshme pensionale nga FSPIM	48

5.1.5.	Anulimi i regjistrimit të anëtarit në Regjistrin e anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar në Regjistrin e anëtarëve të pensionuar të fondeve të detyrueshme pensionale	49
5.1.6.	Mënyra e evidencës së anëtarëve të fondit të detyrueshëm pensional	50
5.1.7.	Përditësimi i të dhënave në Regjistrin e anëtarëve dhe korrigjimi i marrëveshjes për anëtarësim 50	
5.2.	<i>DATA, MËNYRA DHE PROCEDURA E ANËTARËSIMIT NË FONDIN E DETYRUESHËM PENSIONAL</i>	51
5.2.1.	<i>Për anëtarët për të cilët janë të vlefshme kriteret për anëtarësim në shtyllën e dytë nga 1.1.2019</i>	51
5.2.2.	<i>Për anëtarët për të cilat janë të vlefshme kriteret për anëtarësim në shtyllën e dytë para 31.12.2018</i>	52
5.4.	<i>PAGESA E KONTRIBUTEVE NË FONDIN E DETYRUESHËM PENSIONAL</i>	52
5.5.	<i>KATEGORITË E TË SIGURUARVE PËR TË CILAT ËSHTË PËRCAKTUAR PËRJASHTIMI NGA PAGESA E KONTRIBUTEVE NGA SIGURIMI I DETYRUESHËM SOCIAL</i>	54
5.5.1.	Kategoria e parë e të siguruarve për të cilat është përcaktuar përjashtim	54
5.5.2.	Kategoria e dytë e të siguruarve për të cilat është përcaktuar përjashtimi	55
6.	SKEMAT PENSIONALE PROFESIONALE	56
6.1.	<i>Praktika e zakonshme në shumë vende evropiane është ekzistimi i skemave pensionale profesionale në Republikën e Maqedonisë së Veriut</i>	56
6.2.	<i>Anëtarësimi tejkufitar</i>	58
7.	ANËTARËSIMI NË FONDE VULLNETARE PENSIONALE DHE PAGESA E KONTRIBUTEVE VULLNETARE	58
7.1.	<i>ANËTARËSIMI NË FONDET VULLNETARE PENSIONALE</i>	58
7.2.	<i>MËNYRA DHE PROCEDURA PËR ANËTARËSIM NË FONDIN VULLNETAR PENSIONAL</i>	59
7.2.2.	Mënyra e anëtarësimin në fondin vullnetar pensional me pjesëmarrje në skemën pensionale profesionale.....	61
7.2.3.	Procedura për transferim nga një në tjetër fond vullnetar pensional të anëtarit i cili ka lidhur marrëveshje për anëtarësim.....	61
7.2.4.	Procedura e transferimit të anëtarit i cili është pjesëmarrës në skemën pensionale profesionale	62
7.2.5.	Mënyra e evidentimit të anëtarëve të fondit vullnetar pensional	63
7.2.6.	Përditësimi i të dhënave në Regjistrin e anëtarëve dhe korrigjimi i marrëveshjes për anëtarësim ...	64
7.3.	<i>PAGESA E KONTRIBUTEVE VULLNETARE</i>	65
7.3.1.	Pagesa e kontributit vullnetar nga anëtarit ose personi fizik në llogarinë individuale vullnetare	65
7.3.2.	Pagesa e kontributit vullnetar nga siguroesi në llogari profesionale.....	66
8.	MARKETINGU DHE AGJENTËT E SHOQËRIVE PENSIONALE	66
8.1.	<i>MARKETINGU I FONDEVE PENSIONALE</i>	66
8.1.1.	Mënyra dhe procedura e marketingut të fondit të detyrueshëm dhe vullnetar pensional.....	67

8.1.2. Reklamimi dhe informimi për kompensimet dhe të ardhurat e fondit të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional	70
8.1.3. Raporte dorëzuar anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondit të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional	71
8.1.4. Tabela e njoftimeve.....	72
8.1.5. Prospekti informativ.....	73
8.2. <i>AGJENTË TË SHOQËRIVE PENSIONALE</i>	74
8.2.1. Provim për agjentë	75
8.2.2. Mënyra dhe procedura e regjistrimit në Regjistrin e agjentëve	75
8.2.3. Fshirja e personit nga regjistri i agjentëve	76
9. KOMPENSIME	77
9.1. <i>KOMPENSIME QË I ARKËTOJNË SHOQËRITË QË MENAXHOJNË ME FONDE TË DETYRUESHME PENSIONALE</i>	77
9.2. <i>NDRYSHIME NË KOMPENSIMET QË I ARKËTOJNË SHOQËRITË QË MENAXHOJNË ME FONDET E DETYRUESHME PENSIONALE</i>	79
9.3. <i>NDRYSHIMET NË KOMPENSIMET QË I ARKËTOJNË SHOQËRITË QË MENAXHOJNË ME FONDET VULLNETARE PENSIONALE</i>	80
9.4. <i>NDRYSHIME NË KOMPENSIMET QË I PAGUAJNË SHOQËRITË QË MENAXHOJNË ME FONDE VULLNETARE PENSIONALE</i>	81
9.5. <i>KOMPENSIME TË CILAT I PAGUAJNË SHOQËRITË PENSIONALE</i>	82
10. TREGU FINANCIAR DHE TREGU I KAPITALIT	82
10.1. <i>SISTEMI FINANCIAR</i>	82
10.2. <i>TREGJET FINANCIARE</i>	83
10.3. <i>NDËRMJETËSUESIT FINANCIARË</i>	84
11. INVESTIMI I MJETEVE TË FONDEVE PENSIONALE	87
12. PENSIONE DHE KOMPENSIME PENSIONALE	92
12.1. <i>PARIMET E FINANCIMIT DHE PËRLLLOGARITJA E PENSIONEVE</i>	92
13.3. <i>KUSHTET PËR FITIMIN DHE REALIZIMIN E TË DREJTËS SË PENSIONIT TË PLEQËRISË DHE KOMPENSIMIT PENSIONAL</i>	95
13.3.1. Pensioni i pleqërisë nga shtylla e parë	96
12.3.2. Pensioni i pleqërisë nga shtylla e dytë	98
12.3.2.1. <i>Llojet dhe mënyra e pagesës së pensionit nga shtylla e dytë</i>	98
12.3.2.2. <i>Anuitetet në shtyllën e dytë</i>	99
12.3.2.3. <i>Tërheqje të programuara në shtyllën e dytë</i>	100
12.3.2.5. <i>Koordinimi ndërmjet MAPAS dhe AMS për harmonizim të standardeve dhe rregullave për përlllogaritje të pensioneve që i kryejnë shoqëritë pensionale dhe shoqëritë e sigurimit</i>	102
12.3.2.7. <i>Mënyra dhe procedura e realizimit të pensionit të pleqërisë nga shtylla e dytë</i>	103

12.3.3. Kompensimi pensional nga shtylla e tretë	109
12.3.3.1. Llojet dhe mënyra e pagesës së kompensimit pensional nga shtylla e tretë	109
112.3.3.2. Anuiteti në shtyllën e tretë.....	110
12.3.3.3. Tërheqjet e programuara në shtyllën e tretë.....	112
12.3.3.4. Pagesa të njehershme dhe të shumëhershme në shtyllën e tretë	112
12.3.3.5. Koordinimi ndërmjet MAPAS dhe AMS për shkak të harmonizimit të standardeve dhe rregullave për përlllogaritje të kompensimeve pensionale që i kryejnë shoqëritë pensionale dhe shoqëritë e sigurimit.	113
12.4. KUSHTET PËR FITIMIN DHE REALIZIMIN E TË DREJTËS SË PENSIONIT INVALIDOR DHE KOMPENSIMIT PENSIONAL NË RAST TË INVALIDITETIT	118
12.4.1. Pensioni invalidor nga shtylla e parë	118
12.4.2. Pensioni invalidor nga shtylla e dytë	119
12.5. REALIZIMI I TË DREJTËS SË PENSIONIT FAMILJAR.....	120
12.5.1. Pensioni familjar nga shtylla e parë	120
12.5.2. Pensioni familjar nga shtylla e dytë	120
12.6. E DREJTA E TRASHËGIMISË.....	121
12.8. E DREJTA E SHUMËS MË TË ULËT TË PENSIONIT	122
13. GARANCITË	123
14. DISPOZITA NDËSHKIMORE DHE PËR KUNDËRVAJTJE	124
15. SHTOJCA	126
<i>Shtojca 1 – Lista me ligje, rregullore dhe literaturë tjetër të shfrytëzuar</i>	<i>126</i>
<i>Shtojca 2 (link) - Rregullore për mënyrën dhe procedurën e marketingut të fondeve pensionale (Gazeta zyrtare e RM-së. 143/2013, 182/2014, 221/2015, 166/2016, 9/2019 dhe 41/2019 dhe Gazeta zyrtare RMV-së. 235/2019, 244/2019, 116/2020 dhe 253/2021)).....</i>	<i>128</i>
<i>Shtojca 3 (link) - Rregullore për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional</i>	<i>128</i>
<i>(Gazeta zyrtare e RM-së nr. 247/2018, 9/2019 dhe Gazeta zyrtare e RMV-së nr. 235/2019 dhe 212/2021)</i>	<i>128</i>
<i>Shtojca 4 (link) - Rregullore për mënyrën e anëtarësimit në fondin vullnetar pensional (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 138/2008, 74/2010, 134/2010, 26/2011, 155/2013, 134/2014, 110 2016, 188/2017 dhe Gazeta zyrtare e RMV-së nr. 212/2021).....</i>	<i>128</i>
<i>Shtojca 5 (link) - Rregullore për mënyrën e pagesës së kontributeve në fondin vullnetar pensional (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 138/2008 dhe Gazeta zyrtare e RMV-së nr. 27/2022).....</i>	<i>128</i>
<i>Shtojca 6 (link) - Rregullore për shumën maksimale dhe mënyrën e pagesës së kompensimit monetar për transferim të anëtarit nga një fond në fond tjetër pensional (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 93/2008 dhe Gazeta zyrtare e RMV-së nr. 47/2014).....</i>	<i>128</i>
Shtojca 7 – FLUKSI MONETAR (Pasqyra skematike)	129

HYRJE

Ky program është dedikuar për përgatitje të provimit për personat që do të kryejnë marketing të fondeve pensionale përkatësisht agjentët me qëllim trajnimin e tyre për kryerje të punëve të marketingut për sigurim të detyrueshëm dhe vullnetar pensional me financim kapital. Gjegjësisht, në pajtim me Ligjin për sigurim të detyrueshëm të pensional me financim kapital agjentët japin provim që përfshin tema nga sigurimi i detyrueshëm, vullnetar pensional me financim kapital, si dhe nga sfera e pagesës së pensioneve dhe kompensimeve pensionale të sigurimit të detyrueshëm pensional me financim kapital.

Punët e marketingut janë të gjitha aktivitetet që kanë për qëllim reklamimin e shoqërive pensionale dhe fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale dhe informim dhe lidhje të marrëveshjeve për anëtarësim në fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale dhe për pagesë të mjeteve nga fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale. Këto aktivitete përfshijnë: reklamim të punës së shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale me të cilat ato menaxhojnë; informim për karakteristikat e sigurimit të detyrueshëm dhe vullnetar pensional me financim kapital, informim për kompensimet dhe provizionet transaksionale; informim për të ardhurat e fondeve të detyrueshme dhe fondeve vullnetare pensionale; fondeve të detyrueshme dhe fondeve vullnetare pensionale; informim të portofolit investues të fondeve të detyrueshme dhe fondeve vullnetare pensionale; informim për llogaritë individuale, llogaritë individuale vullnetare dhe llogaritë profesionale; anëtarësim dhe transferim të anëtarëve nga njëri fond në tjetrin fond të detyrueshëm pensional; lidhje të marrëveshjeve për tërheqje të programuara, marrëveshjeve për pagesë të njëhershme dhe marrëveshjeve për pagesë të shumëhershme dhe aktivitete tjera për reklamim dhe sigurim të informacioneve lidhur me punën e shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale. Shoqëria pensionale mund të kryejë punë të marketingut të fondit pensional në ambientet e tyre, në ambientet e bashkëpunëtorëve të tyre afaristë për marketing ose jashtë tyre, drejtpërdrejt ose përmes llojit të tyre përkatës (telefon, faks, internet). Ambientet për marketing doemos duhet të përmbushin kushte të caktuara të përcaktuara ligjore.

Anëtarët potencialë të sigurimit pensional me financim kapital takimin e parë të drejtpërdrejtë me këtë sigurim dhe shoqëri e kanë përmes personave që kryejnë marketing, përkatësisht agjentët. Për shkak të mbrojtjes së interesave të anëtarëve potencialë dhe të ardhshëm dhe anëtarëve të pensionuar të sigurimit pensional me financim kapital dhe për shkak të sigurimit të informimit të drejtë dhe objektiv të publikut, marketingu bëhet në mjedis të rregulluar të përcaktuar me ligj dhe akte nënligjore. Për këtë shkak me rëndësi esenciale është që të kenë njohuri për mënyrën e kryerjes së marketingut, për procedurat që guxojnë dhe nuk guxojnë t'i aplikojnë, dhe gjithsesi me rëndësi të veçantë materien për të cilën bisedojnë me anëtarët potencialë përkatësisht anëtarët e pensionuar.

Së pari, me rëndësi të veçantë është që agjentët të kenë njohuri nga sistemi i përgjithshëm pensional, me theks të veçantë në sigurimin pensional me financim kapital (shtylla e dytë dhe e tretë). Ato doemos duhet t'i dinë shkaqet dhe qëllimet e reformës së sistemit pensional dhe rolet dhe mënyrën e funksionimit të institucioneve të përfshira në sistemin e reformuar pensional. Agjentët duhet ta njohin shkëlqyeshëm shtyllën e dytë dhe të tretë, duhet t'i dinë karakteristikat e

tyre themelore, mënyrën e funksionimit dhe përfitimet e anëtarëve. Shtylla e dytë dhe e tretë kanë numër të madh të karakteristikave të ngjashme, por ekzistojnë edhe dallime të dukshme ndërmjet të dyja shtyllave, për të cilat agjenti doemos duhet të ketë njohuri të mira dhe t'ua përcjellë dhe sqarojë në mënyrë të drejtë personave të cilëve u bëjnë marketing.

Meqë agjentët janë personat e vetëm me të cilat anëtarët potencialë mund të lidhin marrëveshje për anëtarësim, agjentët doemos duhet të kenë veçanërisht njohuri të madhe për mënyrën dhe procedurën për anëtarësim në fondet pensionale, përkatësisht për kategoritë e të siguruarve që mund të bëhen anëtarë dhe afatet në të cilat ato kanë të drejtë të zgjedhin fond pensional dhe të anëtarësohen në të, për mënyrën e lidhjes dhe plotësimin të marrëveshjes, mënyrën e pagesës së kontributeve, etj. Duke e pasur parasysh se transparenca është një prej karakteristikave themelore të sistemit të reformuar pensional, anëtarët duhet të informohen saktësisht për të gjitha të drejtat e tyre, veçanërisht për mënyrat e informimit të tyre, mundësitë për parashtrim të ankesave, mundësitë për prishje të marrëveshjes për anëtarësim ose për transferim në fond tjetër pensional, etj. Në shtyllën e tretë ekziston mundësi për themelimin dhe financimin të skemave pensionale profesionale për të cilën agjentët gjithashtu duhet të kenë njohuri.

Gjithashtu, me rëndësi të veçantë është që anëtarët të informohen në mënyrë të drejtë për mënyrën dhe llojet e pagesës së mjeteve të sigurimit pensional me financim kapital, si pensioni, kompensimi pensional ose llojet tjera specifike të pagesave. Meqë bëhet fjalë për risi të mëdha në sistemin dhe për vendime të rëndësishme që duhet t'i sjellë çdo pensionist i ardhshëm, është me rëndësi të jashtëzakonshme njohuria e mirë e materies nga ana e agjentëve dhe informimi i drejtë i pensionistëve të ardhshëm. Së këndejmi, agjentët duhet doemos të kenë njohuri për të gjitha llojet dhe kombinimet e pagesës së pensioneve dhe kompensimeve pensionale nga shtylla e dytë dhe e tretë, institucionet e autorizuar t'i paguajnë, Qendra për sistem elektronik për kuotim të krijuar për transparencë më të madhe të procesit për zgjedhje, lidhshmëria me shtyllën e parë dhe mënyra e realizimit të pensionit përkatësisht kompensimeve pensionale nga të tre shtyllat, lidhshmëria dhe rolet e të gjitha institucioneve në garantimin e pagesës minimale të pensionit, etj. Gjithsesi, theks të veçantë për agjentët e shoqërive pensionale është njohuria e tërheqjeve të programuara të cilat do të paguhen nga shoqëritë pensionale.

Programi për dhënie të provimit për agjentë përditësohet rregullisht në pajtim me ndryshimet në ligjet dhe aktet nënligjore relevante, si dhe me qëllim inkorporimin e evenimenteve më të rëndësishme nga sfera e sigurimit pensional me financim kapital në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

1. STRUKTURA E SISTEMIT TË REFORMUAR TRESHTYLLËSH PENSIONAL

Sistemi i reformuar pensional përbëhet nga sigurimi pensional dhe invalidor në bazë të solidaritetit të gjeneratës dhe sigurimit pensional me financim kapital, me çka qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut u mundësohet sigurim material dhe sigurim social.

Struktura e sistemit pensional shumëshresor bazohet në tre lloje (shtylla) të sigurimit dhe atë:

- 1) Sigurimi i detyrueshëm pensional dhe invalidor në bazë të solidaritetit të gjeneratës (shtylla e parë),
- 2) Sigurimi i detyrueshëm pensional me financim kapital (shtylla e dytë),
- 3) Sigurimi pensional vullnetar me financim kapital (shtylla e tretë).

Sigurimi i detyrueshëm pensional dhe invalidor në bazë të solidaritetit të gjeneratës (shtylla e parë) është sigurim i organizuar, sipas parimit të financimit rrjedhës (pay-as-you-go), që do të thotë se të siguruarit aktual paguajnë për pensionistët aktualë. Kjo shtyllë siguron pensione të definuara sipas formulës së paracaktuar, e pjesa tjetër e pensionit sigurohet nga sigurimi pensional me financim kapital. Përmes kësaj shtylle sigurohet realizimi i të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor në rast të pleqërisë, invaliditetit dhe vdekjes, që do të thotë se paguhet një pjesë e pensionit të pleqërisë, pensionit invalidor, pensionit familjar, si dhe shuma më e ulët e pensionit.


Sigurimi i detyrueshëm pensional me financim kapital (shtylla e dytë) është sigurim në bazë të kapitalizmit të mjeteve, sipas parimit të kontributeve të definuara, me ç'rast ekziston lidhshmëri e ngushtë dhe varësi ndërmjet vëllimit të mjeteve – kontributeve të investuara dhe kompensimeve të ardhshme pensionale që i realizon çdo person të bazuar në ligjshmëritë e tregut. Gjegjesisht, kjo mënyrë e sigurimit është e bazuar në parimin e mbledhjes së mjeteve përmes pagesës së kontributeve në llogari individuale mjetet e të cilave e më tutje investohen dhe fitimi i zvogëluar për shpenzimet e punës në sistemin shtohet (akumulohet) në mjetet në llogaritë individuale. Përmes kësaj shtylle sigurohet realizim i të drejtës së sigurimit pensional në rast të pleqërisë, përkatësisht paguhet pension i pleqërisë (mënyrë shtesë e pensionit nga shtylla e parë).

Sigurimi vullnetar pensional me financim kapital (shtylla e tretë) është gjithashtu sigurim në bazë të kapitalizmit të mjeteve, sipas parimit të kontributeve të definuara, por në bazë vullnetare. E rëndësishme për këtë është që në të mund të përfshihen të gjithë personat që dëshirojnë të sigurojnë vëllim më të lartë të sigurisë materiale krahas sigurimit të detyrueshëm, si dhe të gjithë personat që nuk janë të përfshirë me sigurimin e detyrueshëm (në shtyllën e parë dhe të dytë). Krahas kësaj, me shtyllën e tretë mundësohet edhe themelimi dhe financimi i skemave pensionale profesionale.

2. SHKAQET PËR REFORMËN E SISTEMIT PENSIONAL


Sistemi pensional i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka zhvillim të gjatë historik. Ai ka ekzistim shumëvjeçar në këto ambiente të shoqëruar me zhvillim dhe përplotësim të vazhdueshëm ndër vite. Ndaj ndryshimeve socioekonomike në vitet e kaluara (në fillim të viteve 90-ta) nuk ishte imun as sistemi pensional i cili u përball me vështirësi të mëdha në funksionimin e tij normal. Lëvizjet e pavalitshme në ekonomi nga fillimi i transicionit drejt ekonomisë së tregut shkaktuan rritje të numrit të ndërmarrjeve që punojnë me humbje, shpallje të tepricave teknologjike të fuqisë punëtore dhe hapje të procedurave të shumta të falimentimit. Ato ishin shkaqet kryesore që ndikuan në uljen e numrit të të siguarve aktivë nga njëra anë dhe rritje të numrit të pensionistëve nga ana tjetër që shpuri në uljen e raportit ndërmjet të siguarve dhe pensionistëve.

Gjithashtu, ndikimi i faktorit demografik në sistemin pensional është gjithnjë më i shprehur. Gjegjesisht, analizat e ndryshimit të strukturës së popullatës në korniza botërore në periudhë të gjatë kohor treguan trend të përgjithshëm të plakjes së popullsisë.



Ky trend demografik nuk e anashkalon as Maqedoninë e Veriut, sepse sipas projeksioneve demografike pritet rritje e jetëgjatësisë për afro 5 vjet në 40 vitet e ardhshme.

Një pasqyrë e plakjes së popullsisë është përmes të a.q. piramida të popullsisë. Piramidat e popullsisë të paraqitur në grafikun më poshtë e ilustrojnë ndryshimin e strukturës së popullsisë sipas grupeve të moshës nga viti 2020 deri në vitin 2050 (projeksione). Nga projeksionet e paraqitur mund të vërehet se popullsia e re në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2050 do të zvogëlohet në krahasim me vitin 2020, ndërsa popullsia e vjetër në periudhën e njëjtë shënon rritje. Kjo do të thotë se trendi i plakjes së popullsisë vazhdon edhe në disa dekadat e ardhshme.




Burimi: Kombet e bashkuara (Unitet Nations, Department of Economic and Social Affairs, Population Division. World Population Prospects: The 2015 Revision)

Struktura e pleqërisë së popullsisë paraqet faktor të rëndësishëm demografik për formimin e fuqisë punëtore. Projeksionet e lëvizjes së popullsisë së aftë për punë (në moshë nga 18 deri 64 vjet), popullsia e vjetër (në moshë mbi 65 vjet) dhe raporti i pleqve me popullsinë e aftë për punë

është paraqitur në grafikun në vijim. Ky raport është indikator për plakjen e popullsisë.

Raporti popullsia 65+/popullsia 18-64




Burimi: *Raporti për sistemin pensional në Republikën e Maqedonisë me projeksione aktuale, dhjetor 2015 (Fondi i SPIM).*

Mund të vërehet se pritet rritje e vogël e popullsisë së aftë për punë deri në vitin 2020 dhe pastaj bie për shkak të shkallës së ulët të fertilitetit (procedura e fertilitetit duhet të jetë më e madhe se 2,1 që të bëhet rritja e popullsisë). Nga ana tjetër, rritja e jetëgjatësisë së njerëzve për shkak të kushteve më të mira për jetesë, shërbimeve më të mira shëndetësore, është shkak për rritjen e vazhdueshme të numrit të popullsisë në moshë mbi 65 vjet. Raporti i këtyre dy grupeve të popullsisë pritet të rritet nga 19,45% në 49,74% në vitin 2060 dhe të bjerë deri në 42,28% në vitin 2080. Kjo do të thotë se në të ardhmen afro një e gjysma e popullsisë mbi 18 vjet do të jetë popullsi e vjetër. Lëvizja demografike e analizuar paraprakisht e popullsisë, përkatësisht plakja e popullsisë, ndikon në numrin e pensionistëve. Numri më i madh i personave të vjetër në popullsinë e përgjithshme do të thotë edhe numër i rritur i pensionistëve, ndërsa zgjatja e pritur e rritur e jetës shkakton shfrytëzim më afatgjatë të pensionit. Nga ana tjetër, kushtet e pavolitshme ekonomike, veçanërisht papunësia e madhe, e shoqëruar me ulje të shkallës së fertilitetit, ndikojnë në uljen e numrit të të siguarve në afat të gjatë. Për sistemin me financim rrjedhës (PAYG) është shumë i rëndësishëm raporti ndërmjet të siguarve dhe pensionistëve, sepse me kontributet nga të siguarit ekzistues paguhen pensionet për pensionistët ekzistues.

Projeksionet e lëvizjes së ardhshme të numrit të të siguarve dhe pensionistëve, si dhe raporti i tyre, janë paraqitur në grafikun në vijim.

Numri i të siguarve dhe pensionistëve dhe raporti i tyre



Burimi: *Raporti për sistemin pensional në Republikën e Maqedonisë me projeksione aktuale, dhjetor 2015 (Fondi i SPIM).*

Nga trafikoni mund të vërejmë se në periudhën fillestare të projeksioneve numri i të siguarve rritet, si rezultat i uljes së shkallës së papunësisë dhe rritjes ekonomike. Megjithatë, pas vitit 2030 numri i të siguarve fillon të bjerë për shkak të lëvizjeve demografike dhe stabilizimit të rritjes ekonomike. Numri i pensionistëve rritet në vazhdimësi në 50 vitet e ardhshme, e pastaj ulet. Raporti ndërmjet të siguarve dhe pensionistëve, nga 1,8 të siguarit aktualë për një pensionist në afat të gjatë ulet në 1,4 të siguar për 1 pensionist. Ky trend i raportit do të thotë se gjithnjë më pak të siguar do të paguajnë për numër më të madh të pensionistëve.

Ndikimi i të gjithë këtyre faktorëve mbi solvencën afatgjate të Fondit të SPIM është më i madh dhe projeksionet aktuale tregojnë se pa reforma sistemi do të funksionojë me deficit i cili do të rritet shpejt dhe dukshëm.

Me qëllim të tejtransferimit të këtyre gjendjeve të pritura u imponua nevoja për reformë themelore të sigurimit pensional dhe invalidor në shtetin tonë.

Sistemi mund ta ruajë bilancin fiskal përmes rritjes së shkallës së kontributit, përmes uljes së pensioneve ose përmes rritjes së tatimeve. Këto zgjidhje do të mund ta kthejnë sistemin në balancë në periudhë të shkurtër, por në afat të gjatë sistemi nuk do të jetë efikas dhe solvent. Shkallët e larta të kontributit do ta pengojnë rritjen ekonomike dhe do të t'i stimulojnë të obliguarit që t'i shmangin detyrimet ndaj sistemit, përkatësisht do të ketë paraqitje të evazionit të

kontributeve që janë burim themelor i financimit të sistemit. Nga ana tjetër, ulja e nivelit të pensioneve ndoshta nuk do të sigurojë të ardhura të mjaftueshme për pensionistët në pleqëri.

Për ato shkaqe u dizajnuar edhe u implementua reformë themelore e sistemit pensional me çka u vendos sistemi pensional treshtyllësh në Republikën e Maqedonisë.

Me paraqitjen e sistemit të ri pensional pritet balancim të të ardhurave dhe shpenzimeve të Fondit të SPIM në afat të gjatë, sepse me paraqitjen e sigurimit pensional me financim kapital zvogëlohen detyrimet e sigurimit në bazë të solidaritetit të gjeneratës.

Sigurimi me financim kapital dallohet në mënyrë radikale dallohet nga financimi aktual ekzistues në lidhje me trajtimin dhe regjistrimin e kontributeve të paguara. Gjegjësisht, çdo anëtar i shtyllës së dytë dhe/ose shtyllës së tretë ka llogari individuale në emër të tij në të cilën regjistrohen kontributet e paguara në emër të tij dhe të ardhurat nga investimet.

Për këtë sigurim është karakteristike që pensionet janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë aktuale me kontributet. Pensioni i ardhshëm varet nga mjetet e akumuluar në llogarinë individuale dhe nga kohëzgjatja e pritur e jetës gjatë pensionimit, përkatësisht periudha e pritur e shfrytëzimit të pensionit. Lartësia e mjeteve të akumuluar në llogarinë individuale varet nga kontributet e paguara, shkalla e të ardhurave nga investimet, vitet e pagesës së kontributeve dhe kompensimeve të arkëtuara nga kontributet përkatësisht nga mjetet e fondit pensional.

Karakteristikë e rëndësishme në shtyllën e dytë dhe të tretë është që ato menaxhohen në mënyrë private dhe konkurrense, kështu që kontributet e paguara investohen nga shoqëri të specializuara dhe të licencuara për menaxhim me mjetet e fondeve pensionale. Në këtë mënyrë sigurohet që qëllimet ekonomike ta caktojnë strategjinë investuese, duke krijuar mundësi për maksimizim të të ardhurave të përgjithshme. Kjo sigurohet me diversifikim të rreziqeve të investimeve (përfshirë edhe diversifikim ndërkombëtar) që është një nga karakteristikat e domosdoshme të këtij sistemi.

3. QËLLIMET E REFORMËS SË SISTEMIT PENSIONAL DHE PËRFITIMET E PRITURA

Me reformën e sistemit pensional dhe vendosjen dhe ekzistimin e sistemit e sistemit pensional treshtyllësh si sistem i kombinuar nga sigurimi i financuar aktual publik pensional dhe sigurimi pensional me financim kapital në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pritet të sigurohet stabiliteti afatgjatë i sistemit i cili është element i rëndësishëm i sigurimit social. Shikuar në mënyrë sistemore, ekzistimi i tre shtyllave në sistemin pensional është mundësi për sigurim të mjeteve për pleqëri nga tre burime dhe diversifikim të njëkohshëm të rrezikut, që është veçanërisht i rëndësishëm duke pasur parasysh se sigurimi pensional dhe invalidor zhvillohet një periudhë e gjatë kohore. Në atë periudhë të gjatë kohore janë të mundshme lëvizje të paparashikueshme (edhe të volitshme edhe të pavolitshme) si te popullsia ashtu edhe në ekonominë, kështu që sistemi i diversifikuar do të sigurojë mbrojtje për personat e vjetër në afat të gjatë dhe funksionim të njëkohshëm solvent afatgjatë të sistemit pensional në tërësi.

Dizajni i reformës nis, para së gjithash, nga ruajtja e parimeve të sistemit të pareformuar pensional: detyrim në sigurimin pensional dhe invalidor, varësi të të drejtave nga gjatësia dhe

vëllimi i investimit të mjeteve, drejtësia sociale dhe respektimi i konventave dhe rekomandimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Sigurimi pensional me financim kapital bazohet në parimet e sigurimit të mjeteve për siguri materiale të personave në bazë të kapitalizmit të mjeteve dhe sigurimit të pensioneve në bazë të kontributeve të definuara, investimi i mjeteve në bazë të sigurisë, diversifikimit të rrezikut dhe likuidimit dhe transparencës. Gjithashtu sistemi i reformuar është në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas të cilit qytetarët kanë të drejtën e sigurisë sociale dhe sigurimit social mbi parimet e drejtësisë sociale. Kjo do të thotë ruajtja e parimit të sigurisë nga të gjitha rreziqet (pleqëria, vdekja dhe invaliditeti).

Qëllimet themelore gjatë dizajnit të reformës ishin:

- Siguria në realizimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor,
- Sigurimi i solvencës afatshkurtër dhe afatgjatë të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë së Veriut,
- Siguri maksimale dhe rrezik minimal,
- Garantim të drejtësisë së pensioneve për të gjitha gjeneratat,
- Forcimi i besimit të publikut në sistemin pensional përmes arritjes së qëllimeve tjera.

Më tutje, qëllimi primar i sigurimit pensional vullnetar me financim kapital në Republikën e Maqedonisë së Veriut është:

- Sigurimi i të ardhurave më të larta pas pensionimit për të siguruarit të cilët janë tashmë të siguruar në sistemin njëshpyllësh ose dyshtyllësh (sigurim i detyrueshëm pensional dhe invalidor), e që dëshirojnë dhe kanë mundësi të ndajnë mjete plotësuese për shkak të sigurisë më të madhe materiale ose ruajtjes së standardit më të lartë të jetesës pas pensionimit;
- Sigurimi i pensionit për personat që nuk janë të përfshirë me sigurimin e detyrueshëm pensional personalisht për vete ose nga persona tjetër. Këtu bëjnë pjesë në afat të gjatë të papunët, të punësuarit e projekteve ose në misione të huaja, bashkëshortët që nuk janë të punësuar, dhe personat tjerë pa marrë parasysh nëse janë në marrëdhënie pune ose janë të papunë;
- Sigurimi i parakushteve për vendosje të skemave pensionale profesionale në procesin e harmonizimit të sistemit të sigurimit social në Maqedoninë e Veriut me sistemin e Bashkimit Evropian.

Përmbushja e qëllimeve të lartpërmendura do të rezultojë në përfitime për individët që marrin pjesë në sistemin pensional, për vetë sistemin pensional, si dhe efekte plotësuese mbi ekonominë.

Efektet e pritura për individin	Efektet e pritura për sistemin
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Siguri më të madhe ▪ Diversifikim të rreziqeve ▪ Transparencë në punë ▪ Kursim vullnetar dhe plotësuese 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Sistem pensional solvent ▪ Rritje të kursimeve nacionale ▪ Përforcim të fuqisë së investimit ▪ Rritje të ekonomisë

- | | |
|--|---|
| | <ul style="list-style-type: none">▪ Rritje të efikasitetit të tregut maqedonas të punës |
|--|---|

Efektet e pritura për sistemin

Me reformën në sistemin pensional pritet sigurim i sigurisë dhe stabilitetit afatgjatë të sistemit për sigurim pensional dhe invalidor për të gjithë gjeneratat e të siguruarve, gjë që është qëllimi i çdo shteti gjatë krijimit të politikës sociale. Solvenca afatgjate e sistemit do të sigurojë të ardhura të sigurta për ditët e pensionit.

Gjithashtu, funksionimi i shtyllës së dytë dhe të tretë, të cilat janë me financim kapital në sistemin pensional prodhon efekte plotësuese makroekonomike nga reforma në sistemin pensional. Këto efekte plotësuese kanë të bëjnë me rritjen e kursimeve nacionale, akumulimin e kapitalit dhe përforcimin e fuqisë së investimit, përshpejtimin e rritjes ekonomike, si dhe rritjen e efikasitetit të tregut të punës. Vendosija e fondeve pensionale do të ketë ndikim në rritjen e kursimit të popullsisë dhe atë në afat të gjatë, e kjo do të thotë se do të përforcohet fuqia e investimit dhe rritja e ekonomisë në vend. Me futjen e shtyllës së dytë dhe të tretë, një pjesë e madhe e mjeteve të paguara në këto shtylla do të mund të investohen në ekonominë e Maqedonisë. Megjithëse në periudhën fillestare ato mjete do të përdoren pjesërisht për blerje të letrave shtetërore afatgjate me vlerë që të financohet deficitit tranzicional, megjithatë më vonë ato do të investohen në ekonominë e Maqedonisë. Investimi i këtyre mjeteve në formë të depozitave bankare ose letrave të llojlojshme me vlerë, do të ndikojë në drejtim të uljes së shkallëve të larta aktive ekzistuese dhe do të paraqesë burim i rëndësishëm i financimit të projekteve profitabile në ekonominë maqedonase. Kjo do të rezultojë me përshpejtimin e rritjes ekonomike të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Njëkohësisht, roli më i madh i shtyllës së dytë dhe të tretë do të ndikojë në drejtim të zhvillimit të përshpejtuar të tregut vendor të kapitalit. Gjegjësisht, rezultatet nga investimet pensionale varen nga zhvillimi i tregut të kapitalit, e nëse ai është në shkallë të ulët të zhvillimit, investimi i mjeteve të fondeve mund të ndikojë në rritjen e nivelit të tregut të kapitalit. Njëkohësisht prezenca e shoqërive pensionale do të shkaktojë paraqitje të shërbimeve të reja financiare, instrumenteve të reja financiare dhe institucioneve të reja financiare. Mund të pritet që reforma të kontribuojë edhe për efikasitet më të madh të tregut maqedonas të punës, përkatësisht për rritje të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore, që do të thotë ulje të papunësisë, si dhe ndikim mbi transferimin e punëtorëve nga sektori joformal në sektorin formal të ekonomisë.


Me sigurimin pensional vullnetar vendoset edhe korniza ligjore për organizim të skemave pensionale profesionale dhe harmonizim me rrjedhat evropiane. Me atë pranohen edhe shkaqet e direktivës së Parlamentit Evropian nga kjo sferë në të cilën ceket se, meqë sistemet për sigurim social janë në presion, i cili rritet vazhdimisht, pensionet profesionale në të ardhmen do të kenë rol gjithnjë më të madh në plotësimin e të ardhurave pas pensionimit për shkak që duhet të zhvillohen skemat pensionale profesionale pa u parashtruara pyetje për rëndësinë e sistemeve pensionale për sigurim social në kuptim të sigurimit të sigurt, të përhershëm edhe efikas social, që duhet të

garantojë standard të denjë jetësore në pleqësi dhe prandaj duhet të jetë në esencën e qëllimit për përforcimin e modelit social evropian.

4. INFRASTRUKTURA INSTITUCIONALE

Institucionet themelore që e përbëjnë sistemin e reformuar pensional janë:

1. *Ministria e Punës dhe Politikës Sociale* – kompetente për krijimin dhe udhëheqjen e politikës së sigurimit pensional dhe invalidor dhe kryerjen e mbikëqyrjes në zbatimin e ligjeve nga ky sigurim.
2. *Tre llojet e shoqërive pensionale:*
 - 2.1. Shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale – shoqëria aksionare themelues të të cilave janë institucionet financiare me kapital dhe përvojë të madhe, veprimtaria e vetme e së cilës është menaxhimi me mjete të fondeve të detyrueshme pensionale.
 - 2.2. Shoqëria për menaxhim me fondet pensionale vullnetare – shoqëria aksionare themelues shumicë të të cilave janë institucionet financiare me kapital dhe përvojë të madhe, veprimtaria e vetme e së cilës është menaxhimi me mjetet e fondeve pensionale vullnetare.
 - 2.3. Shoqëria për Menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale – shoqëria aksionare e themeluar nga institucionet financiare me kapital dhe përvojë të madhe, veprimtaria e vetme e së cilës është menaxhimi me mjetet e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale.
3. *Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (MAPAS)* – institucioni rregullat dhe mbikëqyrës që i mbron interesat e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale dhe e nxit zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital, e për punën e saj përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
4. *Ruajtësi i pronës së fondeve pensionale* – bankë afariste e cila i përmbush kushtet e caktuara ligjore dhe i ruan në mënyrë të sigurt mjetet e fondit pensional të ndara nga mjetet e shoqërive pensionale që menaxhojnë me to. Në disa vitet fillestare si zgjidhje transferimtare ruajtës i pronës për fondet e detyrueshme pensionale ishte Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Tani edhe për fondet e detyrueshme edhe për fondet vullnetare pensionale funksionin ruajtës të pronës e kryejnë bankat afariste.
5. *Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë së Veriut (FSPIM) dhe Drejtoria e të Ardhurave Publike (DAP)* – DAP kryen arkëtim të centralizuar të kontributeve, ndërsa FSPIM-ja kryen bartjen dhe shpërndarjen e kontributeve të detyrueshme dhe të dhënave përkatëse për anëtarët në fondet e zgjedhura të detyrueshme pensionale. Për fondet vullnetare pensionale nuk ka arkëtim të centralizuar të kontributeve.



4.1. SHOQËRITË PENSIONALE

Në fillim, është me rëndësi të sqarohet se në sigurimin pensional me financim kapital ka tre lloje të shoqërive pensionale:

- Shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale
- Shoqëria për menaxhim me fondet vullnetare pensionale
- Shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale

Shoqëritë për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale themelohen dhe punojnë në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare dhe Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital, ndërsa shoqëritë për menaxhim me fondet vullnetare pensionale dhe shoqëritë për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale themelohen dhe punojnë në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare dhe Ligjin për sigurim vullnetar pensional me financim kapital. Ekzistojnë ngjashmëri më të mëdha në procedurën për themelimin të tre llojeve të shoqërisë, por ekzistojnë dallime në kushtet për themelimin të shoqërive, në kuptim të asaj se për shoqëritë për menaxhim me fondet pensionale vullnetare kushtet janë më liberale.

Fondi i detyrueshëm pensional mund të themelohet dhe menaxhohet nga shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale ose shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale. Fondi vullnetar pensional mund të themelohet dhe

menaxhohet nga shoqëria për menaxhim me fondet vullnetare pensionale ose shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale.

Shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale themelohet në bazë të lejes nga Agjencia dhe menaxhon me fondin e detyrueshëm pensional në bazë të lejes për menaxhim me fondin e detyrueshëm pensional. Shoqëria për menaxhim me fondet pensionale vullnetare themelohet në bazë të lejes së lëshuar nga Agjencia, e pas themelimit, nga Agjencia merr leje për menaxhim me fondin vullnetar pensional. Shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale themelohet në bazë të lejes së lëshuar nga Agjencia, e pas themelimit, Agjencia merr leje për menaxhim me fondin e detyrueshëm pensional. Me rëndësi esenciale për sigurinë e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale është që shoqëria pensionale të jetë e fuqishme financiarisht, e sigurt dhe me menaxhment të mirë. Me qëllim të shmangies së konfuzionit është e domosdoshme që emri i shoqërisë pensionale ta shprehë qartë detyrën e saj. Prandaj emërtimi i shoqërisë pensionale doemos duhet t'i përmbajë fjalët “shoqëri për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale” ose shoqëri për menaxhim me fondet vullnetare pensionale” ose “shoqëri për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale” varësisht nga ajo se për cilin lloj të shoqërisë pensionale bëhet fjalë.

Veprimtaria e vetme e shoqërisë për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale është menaxhimi me fondet e detyrueshme pensionale, prezantimi i tyre para personave të tretë, si dhe veprimtaritë tjerë lidhur me menaxhimin me fondet e detyrueshme pensionale. Veprimtaria e vetme e shoqërisë për menaxhim me fondet vullnetare pensionale është menaxhimi me fondet vullnetare pensionale, prezantimi i tyre para personave të tretë, si dhe veprimtaritë tjera lidhur me menaxhimin me fondet vullnetare pensionale. Veprimtaria e vetme e shoqërisë për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale është menaxhimi me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale, prezantimi i tyre para personave të tretë, si dhe veprimtaritë tjera lidhur me menaxhimin me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale. Andaj shoqëria nuk mund të kryejë veprimtari tjera të parapara në klasifikimin nacional të veprimtarive.

Në periudhën fillestare shoqëri për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale dhe shoqëri për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale mund të themelojë dhe të menaxhojë vetëm me një fond të detyrueshëm pensional. Gjithashtu, në periudhën fillestare lejohet që shoqëria për menaxhim me fondet vullnetare pensionale dhe shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale të mund të themelojë dhe të menaxhojë vetëm me një fond vullnetar pensional. Në fazën fillestare nga paraqitja e sistemit të reformuar pensional parashihet ekzistim vetëm nga një fond i detyrueshëm pensional për çdo shoqëri dhe vetëm nga një fond vullnetar pensional për çdo shoqëri, e në fazat më të vonshme, varësisht nga kushtet dhe shkalla e zhvillimit të sigurimit të detyrueshëm dhe vullnetar pensional me financim kapital, do të mundësohet menaxhim me numër më të madh të fondeve të detyrueshme përkatësisht vullnetare pensionale nga një shoqëri pensionale.

Shoqëritë pensionale të themeluara në pajtim me Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital dhe Ligjin për sigurim vullnetar pensional me financim kapital mund të ofrojnë pagesë të pensioneve dhe kompensimeve të pensioneve përmes tërheqjeve të programuara.

4.1.1. Themelimi i shoqërive për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale, shoqërive për menaxhim me fondet vullnetare pensionale dhe shoqërive për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale, lëshim të lejes për themelim të shoqërisë dhe lëshim të lejes për menaxhim me fondin e detyrueshëm pensional dhe leje për menaxhim me fondin vullnetar pensional

Meqë bëhet fjalë për sigurim pensional të bazuar në kapitalizim të kontributeve dhe sigurim të mjeteve për pleqëri, zakonisht të gjitha sistemet pensionale në rregullat ligjore përfshijnë kriteret të larta për hyrje në sistemin, me ç'rast do t'u lejojnë hyrje vetëm atyre shoqërive që i përmbushin kushtet (kufizimet) e përcaktuara ligjore. Këto kushte ligjore janë të arsyetuara sepse për veprimtarinë pensionale, përkatësisht për menaxhim me mjetet e anëtarëve të fondeve pensionale, ato do të sigurojnë përvojë më të madhe, shkathtësi dhe solvencë, që do të thotë pjesëmarrje më të vogël të shtetit në sigurimin e shpenzimeve për garancitë dhe njëkohësisht do të forcohet besimi në sigurinë dhe stabilitetin e sistemit pensional.

Për shkak të madhësisë së tregut financiar dhe madhësisë së numrit të anëtarëve në sistemin e ri pensional, për Republikën e Maqedonisë ishte e rëndësishme që në fillim të kufizohet numri i pjesëmarrësve në tregun pensional. Andaj në fillim të sigurimit të detyrueshëm pensional me financim kapital, Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional lëshoi leje për themelim të shoqërive në bazë të tenderit publik. Tenderi publik u realizua në dy faza. Faza e parë përbënte parakualifikim të ofertuesve, e në fazën e dytë u bë zgjedhje e dy ofertave në bazë të kompensimeve të ofruara që do t'i arkëtojnë shoqëritë nga kontributet e paguara.

Pas përfundimit të tenderit më 4.4.2005 u ndanë leje dy shoqërive për menaxhim me fondet pensionale, në vijim:

1. Shoqëria aksionare për menaxhim me fondet pensionale Fondi i ri pensional Shkup që menaxhon me – Fondin e ri pensional – Fondi i hapur i detyrueshëm pensional dhe
2. KB Shoqëria e parë për menaxhim me fonde pensionale SHA Shkup që menaxhon me - KB Fondin e parë të detyrueshëm pensional – Shkup.

Dy shoqërive ekzistuese të cilëve u janë lëshuar leje për menaxhim me fondet pensionale me kohëzgjatje prej dhjetë vitesh, në nëntor 2008 u lëshohen leje për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale me kohëzgjatje të pakufizuar, pa procedurë plotësuese. Gjatë vitit 2009 Agjencia, këtyre dy shoqërive për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale, u lëshoi leje për kryerje të veprimtarisë menaxhim me fondin vullnetar pensional dhe leje për menaxhim me fondin vullnetar pensional (përkatësisht Shoqërisë aksionare për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale “NLB Fondi i ri pensional” Shkup leje për menaxhim me Fondin e hapur vullnetar pensional “NLB Penzija plus” – Shkup dhe KB Shoqërinë e parë për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale SHA Shkup leje për menaxhim me KB Fondin e parë të hapur pensional – Shkup).

Gjatë vitit 2017 dhe gjysmë vjetorit të parë të vitit 2018 u realizua një proces i shitjes së Shoqërisë aksionare për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale “NLB Fondi i ri pensional” Shkup. Në shkurt 2018 në bazë të kërkesës së dorëzuar nga NLB Fondi i ri pensional SHA Shkup, Agjencia dha pëlqim për transferim 100% të aksioneve të lëshuara nga NLB Fondi i ri pensional SHA Shkup te Pozavarovallnica Sava d.d. Procesi i transferimit të

pronësisë së aksioneve mbaroi në mars 2018. Pastaj në qershor 2018, Agjencia dha leje për ndryshimin e emërimit të shoqërisë Shoqëri aksionare për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale “NLB Fondi i ri pensional” Shkup në Shoqëri për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale Shoqëria pensionale Sava sh.a. Shkup, dha leje për ndryshim të emërimit të fondit pensional Fondi i hapur i detyrueshëm pensional – “NLB Fondi pensional” Shkup në Fond të hapur të detyrueshëm pensional Fondi pensional Sava dhe dha leje për ndryshim të emërimit të fondit pensional Fondi i hapur vullnetar pensional – “NLB Penzija plus” Shkup në Fondin e hapur vullnetar pensional Sava penzija plus.

Duke pasur parasysh se sistemin pensional shihet në afat të gjatë, në Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital është paraparë të ndiqet zhvillimi i tregut të kapitalit në korrelacion me sektorin pensional dhe në bazë të atyre ligjshmërive ekonomike të caktohet politika e mëtutjeshme nëse janë krijuar kushtet për hapje të mundësisë për hyrje të shoqërive të reja për menaxhim me fondet pensionale. Duke pasur parasysh se njoftimi për paraqitje të shtyllës së tretë tregoi interes të personave të interesuar për pjesëmarrje edhe në shtyllën e dytë dhe të tretë, me ligj u hap mundësi për shoqëri të reja edhe në shtyllën e dytë, gjë që mund të ndikojë mbi rritjen e konkurrencës në tregun pensional. Kjo e mundëson edhe gjenden reale të numrit më të madhe të anëtarëve dhe më shumë mjeteve në shtyllën e dytë nga ato të paraparat në fillim. Krahas kësaj, me krijimin e mundësisë që shoqëri tjera të marrin leje, krahas themeluesve vendorë, nxitet edhe hyrja e investuesve të huaj si themelues të shoqërive të reja që do të menaxhojnë me fondet pensionale.

Kështu, në shkurt 2019, Zavarovallnivca Trigllav DD Lubjanë, nga Republika e Sllovenisë dorëzoi Kërkesë për themelim të shoqërisë për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale. Në pajtim me procesin e përcaktuar për themelim të shoqërisë së re pensionale, Agjencia në fund të muajit mars 2019 lëshoi leje për themelim të shoqërisë për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale të Zavarovallnica Trigllav DD Lubjanë, Republika e Sllovenisë dhe leje për menaxhim me fondin e detyrueshëm pensional dhe leje për menaxhim me fondin vullnetar pensional.

Pastaj , në vitin 2022 filloi me punë edhe shoqëria e parë që menaxhon vetëm me fond vullnetar pensional. Gjegjesisht, në mars 2022 Shoqëria për menaxhim me fondet e hapura dhe të mbyllura investuese VFP FOND MENAXHMENT SHA SHKUP dorëzoi Kërkesë për themelim të shoqërisë për menaxhim me fonde vullnetare pensionale. Në pajtim me procesin e përcaktuar për themelim të shoqërisë së re pensionale, Agjencia në fund të muajit maj 2022 lëshoi leje për themelim të shoqërisë për menaxhim me fonde vullnetare pensionale të Shoqërisë për menaxhim me fonde të hapura dhe të mbyllura investuese FVP FOND MENAXHMENT SHA SHKUP dhe leje për menaxhim me fond vullnetar pensional.

Së këndejmi, momentalisht në Republikën e Maqedonisë së Veriut ekzistojnë katër shoqëri pensionale nga të cilat tre shoqëri pensionale menaxhojnë me nga një fond të detyrueshëm dhe me nga një fond vullnetar pensional, ndërsa një shoqëri pensionale menaxhon vetëm me një fond vullnetar pensional, dhe atë:

1. Shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale Shoqëria pensionale SAVA sh.a. Shkup, që menaxhon me:

- Fondin e hapur të detyrueshëm pensional Fondi pensional Sava
- Fondin e hapur vullnetar pensional Plus penzija Sava

Aksioner¹ i Shoqërisë për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale Shoqëria pensionale Sava sh.a. Shkup është Pozavarovaqllnica Sava d.d, Republika e Sllovenisë që merr pjesë me 100% në kryegjënë e shoqërisë. Kryegjëja themelore e shoqërisë është 2,1 milionë euro.

2. KB Shoqëria e parë për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale SHA Shkup, që menaxhon me:

- KB Fondin e parë të hapur të detyrueshëm pensional – Shkup
- KB Fond e parë të hapur vullnetar pensional – Shkup

Aksionarët e KB Shoqërisë së parë për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale SHA Shkup janë Skupina Holldingu i parë i zavarovallnicës DD Lubjanë, Republika e Sllovenisë, e cila në kryegjënë e shoqërisë merr pjesë me 51% dhe Banka Komerciale, SHA, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, që merr pjesë me 49% në kryegjënë e shoqërisë. Kryegjëja themelore e shoqërisë është 1,8 milionë euro.

3. Shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale SHOQËRIA PENSIONALE TRIGLLAV SHA Shkup, që menaxhon me

- Fondin e parë të hapur të detyrueshëm pensional Trigllav – Shkup
- Fondin e hapur vullnetar pensional Trigllav – Shkup

Aksionar i Shoqërisë për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale SHOQËRIA PENSIONALE TRIGLLAV SHA Shkup është Zavarovallnica Trigllav DD Lubjanë, Republika e Sllovenisë që merr pjesë me 100% në kryegjënë e shoqërisë. Kryegjëja themelore e shoqërisë është 5,4 milionë euro.

4. Shoqëria për menaxhim me fondet pensionale vullnetare VFP SHOQËRIA PENSIONALE SHA Shkup, që menaxhon me

- VFP fondin e hapur vullnetar pensional – Shkup
- Aksionari i Shoqërisë për menaxhim me fondet pensionale vullnetare VFP SHOQËRIA PENSIONALE SHA Shkup është Shoqëri për menaxhim me fondet e hapura dhe të mbyllura investuese VFP FOND MENAXHMENT SHA SHKUP, Republika e Maqedonisë së Veriut

¹ Aksionarë të Shoqërisë aksionare për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale “NLB Fond i ri pensional” Shkup ishin Banka e re e Lubjanës, DD, Lubjana, Republika e Sllovenisë që mori pjesë me 51% në kryegjënë e shoqërisë dhe NLB banka, SHA Shkup, Republika e Maqedonisë që mori pjesë me 49% në kryegjënë e shoqërisë.

që merr pjesë me 100% në kryegjënë e shoqërisë. Kryegjëja themelore e shoqërisë është 0,5 milionë euro.

Mënyra e lëshimit të lejeve për shoqëritë e reja që do të menaxhojnë me fondet e detyrueshme pensionale rregullohet me Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital. Ndërkaq parashihet që kushtet për themeluesit dhe për themelim të shoqërive të reja të jenë të njëjta me kushtet e parapara për të dyja shoqëritë të cilëve u janë lëshuar lejet për themelim të shoqërive në bazë të tenderit publik.

Në Ligjin për sigurim vullnetar pensional me financim kapital rregullohet mënyra e lëshimit të lejeve për shoqëritë për menaxhim me fondet vullnetare pensionale dhe shoqëritë për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale. Kriteret për themelues janë më liberale për shoqëritë për menaxhim me fondet vullnetare sesa për shoqëritë për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale, sepse bëhet fjalë për sigurim vullnetar, ku zakonisht ka vëllim më të vogël të mjeteve, si dhe me qëllim për të mundësuar përfshirje të pjesëmarrësve të rinj në tregun pensional dhe rritje të konkurrencës. Nga ana tjetër, meqë shoqëritë për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare kanë përgjegjësi dhe vëllim të rritur të mjeteve me të cilën menaxhojnë, për to propozohet të përmbushin kritere të njëjta si shoqëritë për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale.

Agjencia nuk e rregullon vetëm dhënien fillestare të lejes, por të gjitha ndryshimet e aksionarëve, anëtarëve të këshillit drejtues dhe mbikëqyrës dhe personave që propozohet të jenë përgjegjës për vendimet investuese, menaxhim me rreziqe, revizion të brendshëm, llogari individuale, marketing, kontroll të agjentëve dhe përlllogaritje të tërheqjeve të programuara ose ndryshime dhe plotësime të dokumenteve dhe të dhënave, i nënshtrohen lejes së saj, përveç nëse ndryshimet janë jashtë kontrollit të shoqërisë, e kjo i ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për parandalim të atyre ndryshimeve.

Agjencia mund të tërheqë ose anulojë leje për menaxhim me fondin e detyrueshëm dhe/ose vullnetar për shkak të mosruajtjes së kushteve ligjore për themelues të shoqërive dhe për punën e vetë shoqërisë, punës në kundërshtim me interesat e anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale, nëse shoqëria nuk kryen rritje të kryegjësë themelore, kryegjësë, mjeteve personale ose mjeteve likuide në pajtim me kërkesat ligjore, nëse shoqëria nuk i mënjanon parregullsitë e konstatuara nga Agjencia gjatë kryerjes së kontrollit, në rast të pagesës së mjeteve në fondin e detyrueshëm pensional nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në rastet e rregulluara me ligj, nëse shoqëria nuk i përmbush detyrimet nga marrëveshja me ruajtësin e pronës, për shkak të keqpërdorimit të të dhënave për të siguruarit, anëtarët ose anëtarët e pensionuar të sistemuar përkohësisht dhe në raste tjera të shkeljes së ashpër të dispozitave të Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital dhe Ligjit për sigurim vullnetar pensional me financim kapital dhe të Ligjit për parandalim të pastrimit të parave dhe të ardhurave tjera nga vepra ndëshkimore dhe financimit të terrorizmit ose me kërkesë të shoqërisë. Para se ta tërheqë ose anulojë lejen për menaxhim me fondin pensional, Agjencia do ta thërret shoqërinë dhe do t'i japë mundësi t'i mënjanojë paligjshmëritë dhe parregullsitë në punën, përveç nëse konsiderohet se mundësia e tillë do të jetë në kundërshtim me interesat e anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar të fondit pensional ose me interesin publik. Agjencia menjëherë do ta njoftojë shoqërinë për vendim për tërheqje

ose anulim të lejes për menaxhim me fondin pensional. Kundër vendimit të Agjencisë shoqëria ka të drejtë të parashtrijë padi për ngritje të kontestit administrativ në gjykatën kompetente. Padia nuk e anulon ekzekutimin e vendimit. Pas anulimit të lejes për menaxhim me fondin pensional, në shoqërinë që ka menaxhuar me atë fond pensional zbatohen në mënyrë adekuate dispozitat për likuidim të shoqërisë nga Ligji për shoqëritë tregtare ose dispozitat e Ligjit për falimentim.

Për shkak të mbrojtjes së interesave të anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondit pensional, shoqëria të cilës i është tërhequr leja për menaxhim me fondin e detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional, vazhdon të punojë nën mbikëqyrje të përforcuar të Agjencisë, në procedurë të përcaktuar nga Agjencia. Nëse shoqërisë të cilës i është hequr leja për menaxhim me fondin e detyrueshëm dhe/ose fondin vullnetar pensional, për shkak të mbrojtjes së interesave të anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar, Agjencia e ndërmori menaxhimin dhe udhëheqjen me fondin e detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional. Kur vendimi për anulim të lejes për menaxhim me fondin e detyrueshëm pensional do të bëhet final dhe nëse ka së paku dy shoqëri, Agjencia i sistemon anëtarët dhe anëtarët e pensionuar të atij fondi të detyrueshëm pensional në fondet e detyrueshme pensionale ekzistuese të menaxhuara nga shoqëritë tjera, në pajtim me ponderin e definuar për sistemim të të siguruarve të sapopunësuar. Ndërsa, kur vendimi për anulim të lejes për menaxhim me fondin vullnetar pensional do të bëhet final, Agjencia i sistemon anëtarët dhe anëtarët e pensionuar në fondet vullnetare pensionale ekzistuese sipas zgjedhjes së rastit, në pajtim me ponderin i cili caktohet sipas të ardhurave të fondit vullnetar pensional dhe lartësisë së kompensimit nga kontributet e paguara, që e arkëton shoqëria. Nëse nuk ka asnjë fond vullnetar pensional, Agjencia menaxhon me fondin vullnetar pensional me të cilin ka menaxhuar shoqëria të cilës i është hequr leja për menaxhim me fondin vullnetar pensional deri te themelimi i shoqërisë së re.

4.1.2. Kryegjëja themelore e shoqërive pensionale

Është shumë e rëndësishme që sistemi dhe anëtarët e shoqërive pensionale të jenë institucione të fuqishme dhe stabile dhe të kenë kryegjë themelore adekuate.

Shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale duhet të ketë kryegjë themelore në lartësi prej së paku 1,5 milionë euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Shoqëria për menaxhim me fondet vullnetare pensionale duhet të ketë kryegjë themelore në lartësi prej së paku 500.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale duhet të ketë kryegjë themelore në lartësi prej së paku 1,8 milionë euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe/ose fondit vullnetar pensional me të cilin menaxhon shoqëria pensionale, shoqëria është e detyruar që ta rrisë kryegjënë në pajtim me dispozitat ligjore.

Kryegjëja themelore e shoqërisë pensionale paguhet vetëm me mjete në para. Me qëllim të rritjes së fuqisë financiare të shoqërive pensionale, nuk lejohet kryegjëja themelore të rrjedhë nga hua dhe kredi dhe nuk mund të jetë i ngarkuar në çfarëdo mënyre. Kryegjëja themelore e shoqërisë doemos duhet të rrjedhë nga burimet ligjore dhe të tatimohet në pajtim me rregullat e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe rregullat e vendit në të cilin çdo aksionar i huaj është themeluar si person juridik.

Shoqëria është e detyruar që në çdo kohë ta ruajë shumën e kryegjësë, por jo më pak se një e gjysma e shumës së kryegjësë themelore. Shoqëria është e detyruar që në çdo kohë të ruajë mjete personale në shumë jo më të vogël se një e gjysma e shumës së kryegjësë themelore. Shoqëria është e detyruar që në çdo kohë të ruajë shumën e mjeteve likuide si përqindje e kryegjësë themelore përkatësisht kryegjësë. Përqindjen minimale e mjeteve likuide e përcakton Agjencia.

4.1.3. Kushtet për themelues të shoqërive pensionale

Qëllimi themelor i dispozitave me të cilat janë përcaktuar kushtet për themeluesit e shoqërive për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale, shoqërive për menaxhim me fondet vullnetare pensionale dhe shoqërive për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale është sigurimi i stabilitetit të shoqërive dhe menaxhmentit të mirë që do të udhëheqë me to.

Shoqëri pensionale mund të themelojnë personat juridikë vendorë dhe të huaj, ndërsa personi fizikë nuk mund të jenë themelues.

Për themeluesit e shoqërive që menaxhojnë me fonde të detyrueshme pensionale, e këtu bëjnë pjesë shoqëritë për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale dhe shoqëritë për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe fondet vullnetare pensionale janë paraparë kërkesa më të rrepta ligjore sepse bëhet fjalë për sigurim të detyrueshëm pensional, përgjegjësi të rritur dhe vëllim më të madh të mjeteve me të cilat menaxhojnë. Nga ana tjetër, kërkesat për themeluesit e shoqërive për menaxhim me fonde vullnetare pensionale janë më liberale sesa kriteret për shoqëritë për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale, sepse bëhet fjalë për sigurim vullnetar, ku zakonisht ka vëllim më të madh të mjeteve.

Kërkesat themelore për themelues të shoqërive për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale ose të shoqërive për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale janë në vijim:

- Themeluesit të cilët mund të posedojnë 51% të kryegjësë themelore janë bankat, shoqëritë e sigurimit, shoqëritë për menaxhim me fondet investuese, shoqëritë e huaja për menaxhim me fondet pensionale dhe institucionet tjera financiare, si dhe personat tjerë juridikë të cilët drejtpërdrejt ose tërthorazi, posedojnë më shumë se 50% të aksioneve me të drejtë të menaxhimit të institucioneve financiare. Nëse ka themelues ose themelues që posedojnë 51% të kryegjësë themelore të shoqërisë, atëherë të gjithë themeluesit duhet ta përmbushin këtë kusht.

- Themeluesi është person juridik i cili i përmbush kushtet në vijim:
 - a) të ketë kapital së paku në shumë prej 20.000.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e paraqitjes për leje;
 - b) të ketë së paku tre vjet ekzistim;
 - c) të jetë në vazhdimësi solvent në punën e tij në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose jashtë vendit;
 - d) të ketë ekip të vazhdueshëm menaxheria nga personat kompetentë, profesionalë dhe me përvojë.

Nëse si themelues paraqitet institucioni i huaj financiar krahas kushteve të cekura paraprakisht, doemos duhet të ketë rejting të rekomandueshëm për investim sipas agjencive ndërkombëtare të kredisë me renome, së paku për periudhë prej një viti para se të paraqitet si themelues.

Kërkesat themelore për themelues të shoqërive për menaxhim me fondet vullnetare pensionale janë në vijim:

➤ Themelues të shoqërisë për menaxhim me fondet vullnetare pensionale që posedojnë 51% ose më shumë se kryegjëja themelore e shoqërisë, mund të jenë institucione financiare që i përmbushin kushtet në vijim:

a) të kenë:

1) mjete personale së paku në shumë prej 9.000.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e paraqitjes për leje, nëse është bankë;

2) kryegjë së paku në shumë prej 3.000.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e paraqitjes për leje, nëse është shoqëri e sigurimit;

3) kryegjëja së paku në shumë prej 500.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e paraqitjes për leje, nëse është shoqëri për menaxhim me fondet investuese;

4) kryegjë së paku në shumë prej 1.000.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e paraqitjes për leje, nëse është shoqëri e huaj për menaxhim me fondet pensionale; dhe

5) kryegjëja së paku në shumë prej 5.000.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e paraqitjes për leje, për institucionet tjera financiare.

b) të jenë të regjistruara dhe të kenë punuar së paku tre vite;

c) të janë në vazhdimësi solvent në punën e tyre në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose jashtë vendit; dhe

ç) të kenë ekip menaxheria të formuar nga persona kompetentë, profesionalë dhe me përvojë.

Themelues të shoqërisë për menaxhim me fonde vullnetare pensionale që posedon së paku 51% të kryegjësë themelore të shoqërisë mund të jetë person juridik i cili i përmbush të gjitha kushtet e lartpërmendur, përveç kushtit për mjetet personale ose kryegjënë. Nëse nuk ka themelues ose themelues që posedojnë 51% të kryegjësë themelore të shoqërisë për menaxhim me fondet vullnetare pensionale, atëherë të gjithë themeluesit i përmbushin kushtet që vlejné për themelues që posedojnë 51% ose më shumë se kryegjëja themelore e shoqërisë.

Me këto kërkesa sigurohet që shoqëritë që menaxhojnë me fonde pensionale të jenë së paku të ndjeshëm ndaj dështimit të aksionarëve.

Me qëllim të shmangies së konfliktit të interesave dhe të sigurimit të konkurrencës, personi i njëjtë juridik nuk mund të jetë aksionar në më shumë shoqëri të llojit të njëjtë ose shoqëri që janë të lidhura njëra me tjetrën përmes posedimit të ndërsjellë të aksioneve. Nëse për shkak të ndryshimeve organizative ose statusore, ndryshimeve në pronësinë ose pozitën juridike të personave juridikë, vjen deri të shkelja e rregullave ligjore për aksionarët e shoqërive pensionale, personat juridike duhet të bëjnë harmonizim në afat prej gjashtë muaj.

Është e lejuar ligjërisht që shoqëritë pensionale ta zgjerojnë veprimtarinë e tyre, përkatësisht të reregjistrohen, pas plotësimit të kushteve ligjore dhe marrjes së lejes nga Agjencia. Gjegjësisht, shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale mund të menaxhojë edhe me fondet vullnetare pensionale pas marrjes së lejes për kryerje të veprimtarisë – menaxhim me fonde vullnetare pensionale dhe pas marrjes së lejes për menaxhim me fond vullnetar pensional.

Dhe anasjelltas, shoqëria për menaxhim me fondet vullnetare pensionale mund të menaxhojë edhe me fondet e detyrueshme pensionale pas marrjes së lejes për kryerje të veprimtarisë – menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale dhe lejes për menaxhim me fond të detyrueshëm pensional.

Më tutje, lejohet edhe bashkim i shoqërive pensionale të llojit të njëjtë. Me përjashtim, për shkak të ruajtjes së konkurrencës ndërmjet shoqërive që menaxhojnë me fondet e detyrueshme pensionale (shoqëritë për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale ose shoqëritë për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale), nëse ekzistojnë vetëm dy shoqëri që menaxhojnë me fonde të detyrueshme pensionale, njëra shoqëri nuk guxon të blejë aksione nga shoqëri tjetër dhe ato nuk guxojnë të bashkohen, ndahen ose në mënyrë tjetër të riorganizohen.

Agjencia doemos duhet të japë leje për të gjitha ndryshimet e aksionarëve me qëllim të sigurimit se të gjitha aksionarët e rinj i përmbushin kriteret e nevojshme. Çdo fitim ose transferim të aksioneve të shoqërisë që nuk ka pëlqim paraprak nga Agjencia konsiderohet si i pavlefshëm.

4.1.4. Përgjegjësia e shoqërive pensionale para anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondit të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional

Shoqëria është përgjegjëse para anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale me të cilat menaxhon për dëmet që janë rezultat i moskryerjes, kryerjes së parregullt ose të pandërgjegjshme të detyrave dhe detyrimeve të përcaktuara në lidhje me menaxhimin dhe prezantimin e fondit të caktuar pensional, përveç nëse rezultatet e dobëta ose joadekuate janë si rezultat i rrethanave në të cilat shoqëria pensionale nuk ka mundur të ndikojë dhe të cilat nuk kanë mundur të ndryshohen nga shoqëria pensionale dhe në rast të shkallës më të lartë të ndërgjegjes. Dëmet e krijuara për shkak të moskryerjes, kryerjes së parregullt ose të pandërgjegjshme të detyrave dhe detyrimeve, nuk guxojnë të mbulohen nga mjetet e fondeve pensionale. Nëse detyrime të caktuara të shoqërisë pensionale janë bartur për kryerje te personi i tretë, kjo nuk e përjashton shoqërinë pensionale nga përgjegjësia.

4.1.5. Detyra fiduciare e personave përgjegjës

Për shkak të vendosjes së anëtarëve në fokus kryesor të punës së shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale dhe ngritjes së nivelit të mbrojtjes së interesave të anëtarëve me ligj futet detyra fiduciare në shoqëritë pensionale. Detyra fiduciare parasheh detyrim të një personi të cilit ia beson dikush tjetër besimin e tij për të menaxhuar dhe mbrojtur pronën ose paratë e tij.

Kjo do të thotë se çdo anëtar i këshillit drejtues, këshillit mbikëqyrës, person përgjegjës për: vendime investuese, menaxhim me rreziqe, revizion të brendshëm, llogari individuale, marketing, kontroll të agjentëve dhe përlllogaritje të tërheqjeve të programuara dhe organi i shoqërisë ka detyrë fiduciare për të punuar në dobi të interesave të anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondit pensional.

Detyrën duhet ta realizojë duke zbatuar standarde të larta të etikës dhe integritetit dhe pa konflikt të interesave dhe të sigurojë ndryshim të tyre nga çdo i punësuar dhe i angazhuar me punë në shoqërinë. Gjithashtu, anëtari i këshillit drejtues, i këshillit mbikëqyrës dhe personi përgjegjës për: vendime investuese, menaxhim me rreziqe, revizion të brendshëm, llogari individuale, marketing, kontroll të agjentëve dhe përlllogaritje të tërheqjeve të programuara duhet të ketë kompetencë adekuate dhe operative për kryerje të detyrave të cilat i janë ndarë dhe gjithmonë të informohet për çështje që kanë të bëjnë me fushëveprimin e tyre të punës.

4.1.6. Menaxhimi korporativ i shoqërive pensionale

Shoqëritë pensionale janë të detyruar që të zbatojnë praktikë të menaxhimit të mirë korporativ në mënyrë të përcaktuara nga Agjencia dhe të sjellin Kod për menaxhim të mirë korporativ, në pajtim me rregullat e miratuara nga Agjencia.

Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtues i shoqërisë pensionale janë përgjegjës për vendosjen e strukturës së menaxhimit korporativ të shoqërisë pensionale dhe për miratimin e kodit për menaxhim të mirë korporativ. Menaxhimi korporativ i shoqërisë pensionale paraqet përmbledhje rregullash me të cilat rregullohen mënyra, procedurat dhe proceset përmes të cilave organet mbikëqyrëse dhe drejtuese, personat me autorizime dhe përgjegjësi të veçanta dhe personat udhëheqës në shoqërinë pensionale miratojnë vendime në lidhje me menaxhimin e shoqërisë dhe fondit pensional dhe mënyrën si ndiqet implementimi i atyre vendimeve. Qëllimi i menaxhimit të mirë korporativ të shoqërisë pensionale është sigurimi i përgjegjësisë dhe transparencës në punën e shoqërisë pensionale, krijimi i besimit ndërmjet organeve mbikëqyrëse dhe drejtuese dhe subjekteve të interesuara veçanërisht anëtarëve të fondit pensional dhe përmirësimi i efikasitetit të punës së shoqërisë pensionale dhe fondit pensional.

Në pajtim me rregullat e menaxhimit korporativ anëtarët e këshillit mbikëqyrës dhe drejtues, duhet të posedojnë kualifikime dhe njohuri adekuate, reputacion të mirë, ndershmëri, kompetencë dhe integritet personal, si dhe ta kuptojnë rolin e tyre në menaxhimin korporativ me shoqërinë pensionale, e përcaktojnë dhe e ndjekin përmbushjen e standardeve profesionale dhe vlerave korporatave të shoqërisë pensionale dhe me to i njoftojnë të gjitha të punësuarit. Më tutje, në kuadër të këshillit mbikëqyrës dhe drejtues duhet të ekzistojë ndarje e qartë e autorizimeve dhe përgjegjësisive dhe të ekzistojnë vija të njoftimit ndërmjet të gjithë të punësuarve. Personat me autorizime dhe përgjegjësi të veçanta dhe personat udhëheqës duhet të posedojnë kualifikime dhe njohuri përkatëse dhe ta kuptojnë rolin e tyre korporativ, Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtues duhet të sigurojë proces efikas të kontrollit të brendshëm dhe kryerje efikase të revizionit të brendshëm dhe të jashtëm, Këshilli Mbikëqyrës duhet të miratojë dhe zbatojë politikë transparente, konkurrense, të drejtë dhe përgjegjëse për ndjekje të performansave dhe shpërblim të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe drejtues, personave me autorizime dhe përgjegjësi të veçanta, personat udhëheqës dhe të punësuarit në shoqërinë pensionale, Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtues janë përgjegjës për publikim transparent, në kohë dhe të saktë të informacioneve që kanë të bëjnë me punën e shoqërisë pensionale dhe fondit pensional, Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtues duhet të sigurojë investim të fondit pensional që të jetë në pajtim me parimet dhe qëllimet e përcaktuara me ligj dhe vetëm në interes të anëtarëve të fondit pensional, Këshilli Drejtues duhet të vendosë sistem efikas për ankesa nga anëtarët e fondit pensional deri në shoqërinë pensionale, Këshilli

Mbikëqyrës dhe Drejtues duhet të vendosin sistem për kontroll të harmonizimit të punës së shoqërisë pensionale dhe fondit pensional me rregullat, Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtues duhet të sigurojnë sistem efikas të identifikimit, matjes dhe menaxhimit me rreziqe në punën e shoqërisë pensionale dhe fondit pensional.

4.1.7. Menaxhimi me rreziqe i fondeve të detyrueshme dhe/ose vullnetare pensionale

Shoqëria pensionale është e detyruar që të vendosë aktivitete për menaxhim me rreziqe të fondit të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional.

Ndërkaq, shoqëria pensionale është e detyruar që të caktojë person përgjegjës për menaxhim me rreziqe që duhet të ketë kualifikime përkatëse për kryerje të aktiviteteve lidhur me menaxhimin me rreziqe dhe të mos ketë konflikt interesi. Personi është i detyruar që të sigurojë analizë objektive të rreziqeve dhe ta këshillojë në mënyrë të drejtë këshillin drejtues gjatë miratimit të vendimeve, duke i pasur parasysh të gjitha rreziqet relevante.

Gjithashtu, shoqëria është e detyruar që të vendosë edhe mekanizma efikase kontrolluese të cilat janë dokumentuar në aktet e tij interne me qëllim të zbutjes së të gjitha rreziqeve që ndikojnë në interesat e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondit të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional.

4.1.8. Sigurimi i harmonizimit të punës me rregullativën

Shoqëria pensionale është e detyruar që të vendosë procedurë dhe të caktojë person për ndjekje dhe sigurim të harmonizimit të punës me ligj, akte nënligjore dhe akte interne të shoqërisë.

4.1.9. Aktuar i autorizuar

Shoqëria pensionale është e detyruar që të caktojë person përgjegjës për përlllogaritje të tërheqjeve të programuara, përkatësisht aktuar të autorizuar i cili për punën e tij përgjigjet para këshillit administrativ të shoqërisë pensionale. Aktuari i autorizuar është person fizik i cili ka leje për punë si aktuar i autorizuar nga Agjencia për Mbikëqyrje të Sigurimit. Aktuari i autorizuar nuk guxon të jetë person i lidhur me shoqërinë pensionale.

Aktuari i autorizuar është i detyruar që të japë udhëzime për përlllogaritje të tërheqjeve të programuara dhe të kontrollojë nëse përlllogaritje të bëra dhe tabelat e përdorura të vdekshmërisë dhe shkallët e kamatës janë në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore të përcaktuara nga Agjencia. Gjithashtu aktuari i autorizuar është i detyruar që të kontrollojë likuiditetin e fondit pensional. Në lidhje me veprimet e ndërmarra të lartpërmendura aktuari i autorizuar i shoqërisë pensionale përgatit vërtetim me mendim për çdo tremujor nga viti rrjedhës, për çdo fond pensional në veçanti. Këtë vërtetim aktuari i autorizuar e parashtron në këshillin drejtues të shoqërisë pensionale dhe në Agjencinë.

Gjithashtu aktuari i autorizuar përgatit raport për punën e tij për vitin paraprak dhe e dorëzon për miratim në këshillin mbikëqyrës të shoqërisë. Shoqëria pensionale dorëzon raport vjetor për punën e aktuarit të autorizuar në Agjencinë.

4.1.10. Revizioni i punës së shoqërive pensionale

Shoqëria pensionale është e detyruar që të ketë njësi të veçantë organizative për revizion të brendshëm të udhëhequr nga revizori i brendshëm i cili për punën e tij përgjigjet para këshillit mbikëqyrës të shoqërisë. Kjo njësi kryen kontroll të vazhdueshëm dhe të plotë të ligjshmërisë dhe saktësisë së punës së shoqërisë, veçanërisht në menaxhimin me mjetet e fondit pensional.

Shoqëria pensionale duhet të ketë edhe revizor të autorizuar të jashtëm i cili nuk guxon të jetë person i lidhur me shoqërinë ose me aksionarët e shoqërisë, menaxheri i huaj i mjeteve ose ruajtësi i pronës dhe të cilit tre vitet e fundit nuk i janë shqiptuar masa nga Instituti i revizorit të autorizuar. Shoqëria pensionale është e detyruar që të publikojë ekstrakt nga raporti i rishikuar financiar me mendim nga revizori i autorizuar në së paku një gazetë ditore dhe në ueb faqen e tij.

4.1.11. Dokumentacioni dhe evidenca e shoqërisë pensionale

Shoqëria pensionale është e detyruar që të mbajë evidencë të plotë, të saktë dhe azhurne për llogaritë individuale, vullnetare individuale dhe profesionale për çdo anëtar dhe anëtar të pensionuar të fondit të detyrueshëm dhe/ose vullnetar me të cilin menaxhon për kontributet e tij të paguara përkatësisht mjetet e paguara dhe të transferuara, numrin e njësive kontabël dhe vlerën e llogarisë, si dhe të dhënat tjera të përcaktuara me ligj.

Shoqëria pensionale është e detyruar që t'i arkivojë dhe ruajë të gjitha dokumentet dhe evidencë tjetër në lidhje me fondin e detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional me të cilin menaxhon, e veçanërisht:

- a) të dhënat për anëtarët dhe për anëtarët e pensionuar dhe për anëtarët paraprakë dhe për anëtarët e pensionuar përfshirë emrin, mbiemrin dhe adresën, numrin e vetëm të amzës dhe shumën në llogarinë individuale në momentin e largimit nga fondi pensional;
- b) të dhënat për të gjitha mjetet e blera dhe të shitura për fondin pensional me të cilin menaxhon, data e transaksioneve e palës tjetër kontraktuese dhe çmimi i realizuar.

Shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare është e detyruar që të mbajë evidencë të veçantë për fondin e detyrueshëm dhe vullnetar pensional me të cilat menaxhon, si dhe për sigurimin e masave të nevojshme për ndarje financiare të fondit të detyrueshëm nga fondi vullnetar pensional.

Shoqëria është e detyruar që të japë, mbajë, evidentojë, arkivojë, dorëzojë, publikojë njoftime, të dhëna dhe informacione të sakta dhe të përditësuara.

Shoqëria pensionale është e detyruar që të sigurojë mbrojtje të të dhënave personale të anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale, në pajtim me Ligjin për mbrojtje të të dhënave personale.

Personi përgjegjës për llogari individuale është përgjegjës për mbajtje të drejtë dhe në kohë, arkivim dhe ruajtje të evidencës për llogaritë individuale, vullnetare individuale dhe profesionale të çdo anëtarit dhe të anëtarit të pensionuar të fondit të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional.

4.2. FONDI I DETYRUESHËM DHE VULLNETAR PENSIONAL

Dispozitat ligjore në lidhje me përkufizimin dhe strukturën e fondit pensional në masë të madhe janë të njëjtë edhe për fondin e detyrueshëm edhe për fondin vullnetar pensional. Gjegjësisht, fondi pensional (i detyrueshëm ose vullnetar) paraqet fond të hapur investuese, që themelohet dhe punon në pajtim me Ligjin për fondet investuese nëse me Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital ose Ligjin për sigurim vullnetar pensional me financim kapital nuk është rregulluar më ndryshe.

Fondi i detyrueshëm pensional është themeluar dhe menaxhuar nga shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale ose shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare që e paraqet dhe përfaqëson fondin e detyrueshëm pensional para personave të tretë. Fondi vullnetar pensional është themeluar dhe menaxhuar nga shoqëria për menaxhim me fondet vullnetare pensionale ose shoqëritë për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale që e paraqet dhe përfaqëson fondin vullnetar pensional para personave të tretë. Agjencia e shënon fondin e detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional në regjistrin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare dhe u cakton numër identifikimi, pa plotfuqishmërisë së lejes për menaxhim me fondin e detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional. Regjistrimi në regjistrin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale ka veprim juridik ndaj personave të tretë ditën e nesërme nga dita e regjistrimit.

Selia e fondit pensional gjendet në selinë e shoqërisë që menaxhon me atë fond pensional. Emërtimi i çdo fondi të detyrueshëm pensional i përmban detyrimisht fjalët “Maqedonia” as shkurtesë as fjalë tjetër të nxjerrë prej asaj fjale për shmangie të konfuzioneve dhe hutimeve. Emërtimi i çdo fondi vullnetar pensional i përmban fjalët “Fond vullnetar pensional”.

Fondi pensional përbëhet nga kontributet e paguara në emër dhe për llogari të anëtarëve, mjetet e anëtarëve, mjetet e anëtarëve të pensionuar dhe të ardhurat nga kontributet dhe mjetet e investuara, të zvogëluara për kompensimet që arkëtohen nga fondi pensional. Pronarë të fondit pensional janë anëtarët e tij dhe anëtarët e pensionuar, dhe të drejtat e tyre individuale të pronësisë përcaktohen nga shuma e mjeteve në llogaritë e tyre.

Mjetet e fondit pensional janë tërësisht të ndara nga mjetet e shoqërisë që menaxhon me atë fond dhe ruhen në bankë ruajtëse. Ky segregim i mjeteve është tejet i rëndësishëm për të arritur nivel të lartë të sigurisë së mjeteve.

Mjetet e fondit pensional nuk mund të jenë objekt të kërkesave dhe mbi ato mjete as që mund të kryhet përmbarrim nga ose në emër të kreditorëve të shoqërisë pensionale që e menaxhon atë fond pensional. Këto masa janë të domosdoshme për të garantuar sigurinë e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale.

Çdo fond pensional ka statut, për të cilin Agjencia jep pëlqimin e saj. Për të siguruar transparencë të madhe, statuti duhet të përmbajë informacion të qartë për funksionimin e fondit pensional. Përkatësisht, statuti i fondit pensional duhet të përmbajë parime themelore dhe kufizime të veçanta për investimet, mënyrën e llogaritjes së provizioneve dhe kompensimeve transaksionale të shoqërisë, mënyrën e mbajtjes së kontabilitetit të fondit pensional, mënyrën e informimit të

anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondit pensional dhe gazetën ditore në të cilën do të publikohet prospekti informativ i fondit pensional, të dhënat për mënyrën e llogaritjes dhe pagesës së pensioneve përmes tërheqjeve të programuara dhe kompensimeve pensionale përmes tërheqjeve të programuara, pagesave të njëhershme dhe të shumëhershme, dhe të dhëna tjera me rëndësi për fondin pensional.

Kontabiliteti i fondeve dhe shoqërive pensionale kryhet në përputhje me ligjet dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

4.2.1. Vlerësimi i mjeteve të fondeve pensionale

Sigurimi pensional me financim kapital (edhe i detyrueshëm edhe vullnetar) funksionon mbi parimin e kontributeve të përcaktuara, ku pensioni i ardhshëm i anëtarit të fondit pensional varet nga shuma që do të grumbullohet në llogarinë e tij. Me vlerësimin e mjeteve do të arrihet vlera reale e mjeteve si rezultat i kontributeve të paguara dhe investimeve të bëra. Prandaj, është me rëndësi jetike vendosja e e sistemit të vlerësimit që do të ofrojë informacione relevante, në kohë për Agjencinë dhe për secilin anëtar dhe anëtar të pensionuar të fondit pensional. Mënyra e vlerësimit të mjeteve është i njëjtë edhe për fondet e detyrueshme edhe për ato vullnetare pensionale.

Kontributet e anëtarëve, mjetet e transferuara, kompensimet për transferimin jo në kohë të kontributeve (në rastin e fondeve të detyrueshme pensionale) dhe të gjitha të ardhurat nga investimi i tyre do të shpërndahen në llogari individuale, vullnetare individuale ose profesionale që janë në emër të anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale. Njësitë e kontabilitetit do të përdoren për evidentimin e llogarive individuale, vullnetare individuale dhe profesionale dhe mjetet e fondit pensional. Të gjitha kontributet, mjetet e transferuara, kompensimet për transferimin jo në kohë të kontributeve dhe të ardhurat nga investimi i mjeteve të fondit pensional shndërrohet në njësi të kontabilitetit. Njësitë e kontabilitetit shërbejnë për qëllime vlerësimi ku një njësi kontabiliteti përbën pjesë proporcionale në totalin e mjeteve neto të atij fondi pensional. Të gjitha pagesat e reja në bazë të kontributit të anëtarit dhe transferimi i mjeteve te anëtari i pensionuar konvertohen në njësi kontabiliteti në mënyrë të tillë që shuma e paguar (të zvogëluar për kompensimin nga kontributi) pjesëtohet me vlerën e njësisë së kontabilitetit në datën e pagesës. Ndërsa shumat në bazë të kompensimit për transferim jo në kohë të kontributeve do të konvertohen në njësi kontabiliteti në bazë të vlerës së njësisë së kontabilitetit të fondit të detyrueshëm pensional në datën e vonesës së përcaktuar.

P.sh. nëse pagesa e kontributit të anëtarit në fondin pensional, e reduktuar për tarifën e kontributit, është 1000 denarë, ndërsa vlera e njësisë së kontabilitetit në datën e pagesës është 100 denarë, atëherë pagesa do të konvertohet në 10 (1000/100) njësi të reja kontabiliteti. Përkatësisht, anëtari fiton 10 njësi kontabiliteti dhe me atë shumë do të rritet numri i njësive të anëtarit dhe numri i përgjithshëm i njësive të fondit.

Vlera e njësisë së kontabilitetit të fondit fitohet duke pjesëtuar vlerën totale të mjeteve neto të fondit të të gjitha njësive të kontabilitetit të të gjithë anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondit. Kjo vlerë llogaritet çdo ditë dhe varet nga lëvizjet e çmimeve të instrumenteve në të cilat janë investuar mjetet e fondit. Kjo mënyrë llogaritjeje lejon që vlera e njësisë të shprehë vetëm lëvizjen e çmimeve të instrumenteve në të cilat janë investuar mjetet e fondit.

Anëtarët dhe anëtarët e pensionuar të fondit mund të krahasojnë rezultatet e fondeve në bazë të të ardhurave të realizuara të fondeve, të cilat do të llogariten në bazë të ndryshimit të vlerës së njësisë së kontabilitetit. Të ardhurat llogariten në shumën nominale dhe reale. Llogaritja do të bëhet në fund të qershorit dhe dhjetorit të çdo viti për periudhë 7-vjeçare, përkatësisht 84 muaj dhe në atë rast periudha e llogaritjes është 84 muaj. Nëse fondi ekziston për më pak se 84 muaj, por më shumë se 12 muaj, të ardhurat llogariten në fund të qershorit ose dhjetorit, për periudhën nga 1 qershori ose dhjetori pas krijimit të fondit deri në fund të qershorit ose dhjetorit kur bëhet llogaritja. Në atë rast, periudha e llogaritjes është 78, 72, 66, 60, 54, 48, 42, 36, 30, 24, 18 ose 12 muaj. Të ardhurat shprehen si përqindje me dy shifra decimale.

Të ardhurat e fondit pensional në shumë nominale paraqesin ndryshim në vlerën e njësisë kontabël në datën e fundit të vlerësimit në periudhën e kontabilitetit, në raport me vlerën e njësisë së kontabilitetit në ditën e fundit të muajit para muajit të parë në periudhën e kontabilitetit, i konvertuar në shkallën vjetore ekuivalente në shumën nominale. P.sh. rritja e vlerës së njësisë së kontabilitetit nga 100 denarë në 145 denarë për periudhë shtatë vjeçare nënkupton se të ardhurat e fondit në shumën

nominale të reduktuar në nivel vjetor është

$$5,45\% \left(\left(\frac{145}{100} \right)^{\frac{1}{7}} - 1 \right)$$

Të ardhurat e fondit pensional në shumë reale përlllogariten në bazë të të ardhurave të fondit pensional në shumë nominale dhe niveli i shpenzimeve të jetës në periudhën e njëjtë për të cilën përlllogariten të ardhurat, të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikës së Republikës së Maqedonisë së Veriut. P.sh., të ardhurat e fondit pensional në shumë nominale të reduktuar në nivel vjetor për periudhë shtatë vjeçare është 5,45% dhe ndryshimi i nivelit të shpenzimeve të jetës për periudhën e njëjtë prej shtatë vitesh të reduktuar në nivel vjetor është 3,00% do të thotë të ardhurat e fondit në shumë reale të reduktuar në nivel vjetor janë 2,38%

$$\frac{1 + 5,45\%}{1 + 3,00\%} - 1$$

4.3. RUAJTËSI I PRONËS SË FONDEVE PENSIONALE

Ruajtësi i pronës është institucioni të cilit i është besuar përgjegjësia për ruajtjen e mjeteve të fondit pensional, ndërsa funksionet e tij në lidhje me ruajtjen e mjeteve për fondin e detyrueshëm pensional janë përcaktuar në Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital, përkatësisht Ligjin për sigurim pensional vullnetar me financim kapital në rast të ruajtjes së mjeteve të fondit pensional vullnetar.

Të gjitha instrumentet në të cilat janë investuar mjetet e fondit pensional duhet të ruhen doemos nga një ruajtës. Shoqëria është e detyruar të zgjedhë një ruajtës të vetëm të pronës, të cilit ia beson përgjegjësinë për ruajtjen e mjeteve të fondit pensional dhe me të cilin lidh kontratë për ruajtjen e pronës. Në rast të shoqërisë për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale, ajo mund të ketë ruajtësin e njëjtë për të dy fondet që i menaxhon, si dhe mund të ketë dy ruajtës të veçantë për çdo fond pensional. Kontrata për ruajtjen e pronës është objekt i pëlqimit paraprak të Agjencisë.

Ruajtësi i pronës së mjeteve të fondeve pensionale është bankë komerciale e cila ka licencë nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe që i plotëson kushtet në vijim:

a) të ketë një minimum të caktuar të mjeteve vetjake të përcaktuara me ligj.

b) të mos jetë aksioner në shoqërinë që menaxhon me fondin pensional pronën e të cilit e ruan, as aksionar në ndonjë person të lidhur me shoqërinë dhe të mos ketë asnjë lidhje kapitale ndërmjet këtyre personave.

c) anëtarët e organeve të ruajtësit të pronës dhe të punësuarit tjerë të në ruajtësin e pronës të mos jenë anëtarë të këshillit drejtues ose të këshillit mbikëqyrës, drejtor i përgjithshëm, drejtor ose të punësuar tjerë të shoqërisë, mjetet e të cilit i ruan, dhe të mos jenë në marrëdhënie të tillë të njëjta me persona tjerë që janë persona të lidhur me shoqërinë

Në lidhje me pikën a) ekziston dallim varësisht nga llojit i fondit pensional dhe minimumi i mjeteve vetjake është 20.000.000 euro sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për fondet e detyrueshme pensionale dhe 9.000.000 euro sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për fondet vullnetare pensionale.

Banka që kryen punë të ruajtjes së pronës duhet të ketë njësi të veçantë organizative për kryerjen e këtyre punëve.

Nëse banka pushon së përmbushuri ndonjë prej kushteve gjatë periudhës përderisa është ruajtëse e mjeteve të fondit pensional, ajo është e detyruar të njoftojë menjëherë shoqërinë dhe Agjencinë dhe të ndërmarrë veprime për harmonizim në periudhë jo më të gjatë se tre muaj nga dita kur ka pushuar së përmbushuri ndonjë nga kushtet.

Në periudhën fillestare, ruajtësi i mjeteve të fondeve të detyrueshme pensionale ishte Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (si zgjidhje kalimtare). Me hyrjen në fuqi të zgjidhjes sistematike të ligjit, gjatë muajve tetor dhe nëntor 2009, dy shoqëritë që menaxhojnë fondet e detyrueshme pensionale përfunduan me sukses procesin e transferimit të funksionit të ruajtësit të pronës së fondeve të detyrueshme pensionale të cilat i menaxhon Banka Popullore në Republikën e Maqedonisë në bankat e përzgjedhura afariste.

Nëse fondi pensional ka mjete jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ruajtësi i mjeteve zgjedh gjithashtu një nën-ruajtës të mjeteve për t'i ruajtur ato mjete. Mund të jetë një bankë ose një institucion i specializuar depozitues që ka leje pune të lëshuar nga autoriteti kompetent në një vend jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe është i autorizuar për një veprimtari të tillë në përputhje me ligjet e vendit ku do të kryejë ruajtjen e mjeteve të fondit pensional. Nën-ruajtësi i zgjedhur i pasuritë duhet të ketë rejting të rekomandueshëm për investim sipas agjencive të rejtingut kreditor me renome ndërkombëtare.

Funksionet kryesore që i kryen ruajtësi i mjeteve të fondeve pensionale janë si në vijim:

- i ruan në mënyrë të sigurt të gjitha letrat me vlerë që përfaqësojnë mjetet e fondit pensional;

- letrat me vlerë që i përfaqësojnë mjetet e një fondi pensional si bono elektronike i mban në llogari të veçantë në Depozituesin Qendror të Letrave me Vlerë;

- i ruan dokumentet për barazim në lidhje me arkëtimet dhe pagesat e mjeteve nga llogaria bankare e fondit pensional;

- punon si ndërmjetës për sbarazimin e transaksioneve me letra me vlerë në bazë të urdhëresave nga shoqëria dhe mbledh dhe arkëton të ardhura nga dividendët, kamatat dhe të gjitha të ardhurat e tjera që rrjedhin nga investimet e mjeteve të fondit pensional;

- siguron që marrëveshjet në lidhje me blerjen, investimin dhe transferimin e mjeteve të fondit pensional të jenë në përputhje me ligjin, statutin e fondit pensional dhe urdhëresat që rrjedhin nga transaksionet e shoqërisë dhe se ato urdhëresa janë në pajtim me ligjin. ;

- kryen kontrole të mjeteve neto edhe të njësisë së kontabilitetit të fondit pensional, i kontrollon dhe konfirmon llogaritjet e bëra nga shoqëria dhe është përgjegjës për saktësinë e përlllogaritjeve;

- kryen kontroll të harmonizimit të portofolit të fondit pensional me kufizimet investuese;

- bashkëpunon dhe mbikëqyr nënruajtësin e pronës;

- përlllogarit dhe arkëton tatimet lidhur me investimet dhe dorëzon kërkesa për kthim dhe përjashtim nga tatimi; dhe

- njofton për mbledhjet vjetore të aksionarëve dhe për të drejtat lidhur me pronësinë dhe i zbaton urdhëresat lidhur me realizimin e të drejtave të pronësisë.

Ruajtësi i pronës është i detyruar që menjëherë, fillimisht me gojë, e pastaj edhe me shkrim, ta njoftojë Agjencinë në rast të dyshimit ose për mosrespektimin e marrëveshjes për ruajtje të pronës në të cilën ai është palë kontraktuese, të ligjit ose për probleme ose veprime të caktuara në kundërshtim me interesat e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondit pensional.

Në çdo datë të vlerësimit të ruajtësit të pronës bëhet vlerësim i mjeteve dhe njësisë së kontabilitetit dhe e njofton Agjencinë për vlerën e mjeteve neto dhe njësisë së kontabilitetit të fondit pensional bashkë me konfirmimin për harmonizimin e vlerësimit me shoqërinë pensionale. Nëse ekziston mosharmonizimi i përlllogaritjeve të mjeteve neto dhe njësisë së kontabilitetit të fondit pensional të bëra nga shoqëria dhe nga ruajtësi i pronës, shoqëria është e detyruar që të harmonizohet me përlllogaritjet e bëra nga ruajtësi i pronës, me ç'rast ruajtësi i pronës e njofton Agjencinë për mënyrën e zgjidhjes së mosharmonizimit. Gjithashtu, nëse ruajtësi i pronës konstaton mosharmonizim të portofolit të fondit pensional ta njoftojë menjëherë Agjencinë.

Ruajtësi i pronës përgjigjet për dëmet e shkaktuara për shkak të moskryerjes, kryerjes së parregullt ose të pandërgjegjshme të detyrave dhe ato nuk mund të mbulohen nga mjetet e fondit pensional.

4.4. AGJENCIA PËR MBIKËQYRJE TË FINANCIMIT KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL (MAPAS)

Sistemi i reformuar pensional të Maqedonisë së Veriut përmban komponentë të sigurimit të detyrueshëm dhe vullnetar pensional me financim kapital, si risi në sistemin pensional që njëkohësisht imponon nevojë për vendosje të institucionit të specializuar për mbikëqyrje që do të punojë në mënyrë të pavarur, efikase dhe transparente, duke siguruar sukses të reformës dhe sigurimit afatgjatë të qëndrueshëm pensional me financim kapital, si pjesë integrale e sistemit të përgjithshëm pensional.

Mbikëqyrja nevojitet për të siguruar respektim, përkatësisht pra zbatimin e ligjit dhe rregulloreve, ndërtimin e besimit në sistemin e pensioneve, monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve dhe mundësinë e inicimit ose propozimit të ndryshimeve dhe shtesave në akte dhe rregullore nëse është e nevojshme.

Fushat dhe proceset kritike që duhet të jenë nën mbikëqyrje janë: funksionimi i shoqërive dhe menaxhimi i fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, investimi i mjeteve të fondeve pensionale, mënyra e anëtarësimit dhe transferimi nga një fond pensional në fond tjetër pensional, llogaritë individuale, aktivitetet e marketingut, pagesa e mjeteve, etj. Gjithashtu do të bëhet mbikëqyrja edhe e punës së ruajtësve të pronës edhe të Qendrës për Sistem Elektronik për Kuotim (në tekstin e mëtejshëm: Qendra për Kuotim).

Për periudhën fillestare të sistemit të ri të pensioneve, përvojat në shumicën e vendeve tregojnë se është e nevojshme që mbikëqyrja të jetë parandaluese (proaktive). Megjithatë, modelet e mbikëqyrjes nuk janë statike, ato evoluojnë me transferimin e kohës pas ndryshimit të kushteve të tregut.

Në pajtim me përvojat dhe standardet e lartpërmendura, Agjencisë për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (MAPAS) i është besuar mbikëqyrja e punës së tre llojeve të shoqërive pensionale që menaxhojnë fondet pensionale (shoqëri për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale, shoqëritë për menaxhim me fondet vullnetare pensionale dhe shoqëritë për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale) dhe me shoqëritë e detyrueshme dhe vullnetare pensionale me qëllim për të arritur funksionim të mirë të sigurimit pensional me financim kapital, duke i dhënë Agjencisë fuqinë dhe detyrimin për të mbrojtur interesat e anëtarëve dhe anëtarëve në sistemin. Njëkohësisht, një nga qëllimet e themelimit të Agjencisë është nxitja e zhvillimit të sigurimit pensional me financim kapital.

Agjencia është përgjegjëse për punën e saj para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Revizion të punës së Agjencisë kryen revizori i autorizuar i jashtëm. Agjencia, në kuadër të kompetencave të saj, bashkëpunon me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale me qëllim të zhvillimit dhe përmirësimit të sigurimit pensional me financim kapital.

Agjencia kryen detyrat në vijim:

- a) kryen aktivitete për mbledhjen e kërkesave për themelimin e shoqërive pensionale, lëshon, tërheq dhe heq lejet për themelimin e shoqërive pensionale, lëshon leje për kryerjen e veprimtarisë - menaxhim me fondet vullnetare pensionale, leje për kryerjen e veprimtarisë - menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale, dhe lëshon, tërheq ose heq leje për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe/ose vullnetare pensionale;
- b) kryen mbikëqyrje të punës së shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale me të cilat ato menaxhojnë, e veçanërisht e kontrollon punën e ligjshme të tyre;
- c) kryen mbikëqyrje të punës së personave juridikë që janë ruajtës të mjeteve të fondeve të detyrueshme dhe/ose vullnetare pensionale menaxherëve të huaj të mjeteve të fondit të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional në lidhje me punën me ato mjete;
- ç) e promovon, organizon dhe nxit zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale;
- d) e rrit vetëdijen e publikut për qëllimet dhe parimet e shoqërive pensionale dhe fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, për përfitimet e anëtarësimit në fondin e detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional, duke përfshirë qëllimet, parimet dhe përfitimet e pjesëmarrjes në skemë pensionale profesionale për të drejtat e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondeve të

detyrueshme dhe vullnetare pensionale dhe për çështje të tjera që lidhen me sigurimin pensional me financim kapital;

dh) jep propozim për ngritjen e procedurave për kundërvajtje dhe penale pranë organit kompetent kundër shoqërive pensionale, ruajtësve të pronës të fondeve të detyrueshme dhe/ose vullnetare pensionale, menaxherëve të huaj të mjeteve dhe personave të tjerë në rast të shkeljes së dispozitave të Ligjit për sigurimit pensional me financim kapital, Ligjit për sigurimin pensional vullnetar me financim kapital dhe ligjeve tjera;

e) monitoron dhe shqyrton raportet financiare të fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale dhe shoqërive pensionale;

ë) mban regjistrin e agjentëve, regjistrin e anëtarëve dhe regjistrin e anëtarëve të pensionuar të fondeve të detyrueshme pensionale dhe regjistrin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale;

f) për të siguruar mbikëqyrje dhe rregullim efikas të sigurimit pensional me financim kapital dhe sektorit financiar, bashkëpunon me Ministrinë e Financave, Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Komisionin për Letrat me Vlerë të Republikës Maqedonisë së Veriut dhe me organe dhe institucione tjera brenda dhe jashtë vendit. Vëllimin, përmbajtjen dhe formën e bashkëpunimit e rregullon në mënyrë të ndërsjellë më hollësisht Agjencia me organet dhe institucionet kompetente;

g) bashkëpunon me Fondin për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë së Veriut në fushën e kompetencave që i janë besuar atij fondi me Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital;

gj) përpunon të dhënat personale në përputhje me rregulloret që rregullojnë mbrojtjen e të dhënave personale;

h) kërkon dhe siguron të dhëna personale për përdorim në përputhje me rregulloret që rregullojnë mbrojtjen e të dhënave personale;

i) miraton akte në pajtim me Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital dhe në pajtim me ligjin për sigurim vullnetar pensional me financim kapital;

j) miraton udhëzime të brendshme për punën e tij dhe përgatit udhëzime profesionale, manuale etj., në lidhje me sigurimin pensional me financim kapital;

k) inicion miratimin e rregullave dhe akteve tjera në lidhje me shoqëritë pensionale dhe fondet pensionale të cilat i menaxhojnë;

l) anëtarësohet dhe merr pjesë në organizata vendore dhe ndërkombëtare, kur kjo pjesëmarrje është në interes të sistemit pensional të Maqedonisë, dhe

ll) kryen punë të tjera në përputhje me Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital dhe në përputhje me Ligjin për sigurim pensional vullnetar me financim kapital.

Agjencia kontrollon gjithashtu funksionimin e Qendrës për Kuotim.

Me qëllim të kryerjes efikase të detyrave të saj kontrolluese, Agjencia është e autorizuar:


a) t'i kontrollojë të gjitha dokumentet e shoqërive pensionale dhe të dhënat elektronike që lidhen me funksionimin e tyre dhe funksionimin e fondeve pensionale që ato drejtojnë;

- b) t'i kontrollojë të gjitha dokumentet dhe të dhënat elektronike nga pika a) të këtij paragrafi nga ruajtësi i pronës dhe nga menaxheri i huaj i fondeve të detyrueshme dhe/ose vullnetare pensionale;
- c) t'i kontrollojë të gjitha dokumentet dhe evidencën elektronike nga siguruesi për mënyrën e organizimit dhe financimit të skemës pensionale profesionale;
- ç) t'i kontrollojë inspektojë të gjitha dokumentet dhe të dhënat elektronike të Qendrës për Kuotim, si dhe informacionet nga menaxhuesi i tij në lidhje me aktivitetet e Qendrës për Kuotim; etj.

Nëse Agjencia, gjatë kryerjes së kontrollit në punën e shoqërisë pensionale dhe menaxhimin me fondet e detyrueshme dhe/ose vullnetare pensionale, konstaton se ekzistojnë punë ose vepra të cilat janë të ndëshkueshme sipas ligjit, Kryetari i Këshillit të Ekspertëve ose personi i autorizuar nga ai parashtron kallëzim për ngritje të procedurës para organit kompetent. Për parregullsi të caktuara ligjore të cilat janë kryer për herë të parë Agjencia organizon dhe realizon edukim të personit ose subjektit ku është përcaktuar parregullsia.

Agjencia ndërmerr masa dhe cakton afate për realizimin e tyre nëse shoqëria pensionale, ruajtësi i pronës, organi drejtues ose mbikëqyrës ose personi përgjegjës i shoqërisë pensionale nuk i respekton rregullat dhe/ose aktet e brendshme me të cilat është rregulluar puna e shoqërisë pensionale dhe menaxhimi i tyre me mjetet e fondeve pensionale.

Masat të cilat i ndërmerr Agjencia janë ndarë në tre grupe:



a) dëmi potencial dhe gjasa e ndodhjes së paligjshmërisë dhe/ose parregullsisë, përkatësisht rreziku nga ndodhja e tyre shfaqjes së tyre, si dhe ndikimi i tyre mbi stabilitetin dhe sigurinë e shoqërive pensionale, fondeve pensionale dhe sistemit pensional në tërësi.

b) ndikimi ose ndikimin potencial i masës së shoqërisë pensionale ose fondit pensional në drejtim të parandalimit të përkeqësimit të mëtejshëm të gjendjes në shoqërinë pensionale ose në fondin pensional.

c) nëse paligjshmëria apo parregullsia ka qenë e qëllimshme dhe nëse përsëritet

d) gatishmëria e organeve të shoqërisë pensionale për mënjanimin e paligjshmërive dhe/ose parregullsive

Anëtarët e fondeve të detyrueshëm dhe/ose vullnetare pensionale ose ish anëtarët dhe anëtarët e pensionuar, nëse janë të pakënaqur, mund të paraqesin ankesë në Agjencinë kundër shoqërisë pensionale, për veprime dhe aktivitete të ndërmarra nga ajo shoqëri që nuk janë në përputhje me ligjin dhe aktet e asaj shoqërie. Në Agjenci mund të parashtrahet ankesë nga anëtar dhe anëtar i pensionuar i fondit të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional kundër personave të tjerë me të cilët fondi pensional dhe shoqëria pensionale kanë pasur marrëdhënie biznesi ose kontraktuale, në rast se anëtari ose anëtari i pensionuar beson se interesat e tij janë dëmtuar si rezultat i shkeljes së ligjit nga ai person në aspekt të marrëdhënieve afariste ose kontraktuale. Procesi i tillë mund ta ndihmojë Agjencinë në funksionet e saj mbikëqyrëse sepse shpeshherë anëtarët, anëtarët e pensionuar, ish-anëtarët dhe persona tjerë që kanë pasur komunikim me shoqëritë janë të parët që ndërsgjegjësohen për probleme të tilla.

5. ANËTARËSIMI NË FONDET E DETYRUESHME PENSIONALE DHE PAGESA E KONTRIBUTEVE

5.1. ANËTARËSIMI NË FONDET E DETYRUESHME PENSIONALE

Anëtar i fondit të detyrueshëm pensional është personi fizik i cili ka lidhur marrëveshje për anëtarësim në fondin e detyrueshëm ose në emër të të cilit është hapur llogari në fondin e detyrueshëm pensional në rastet e përcaktuara në Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital.

I siguruari mund të anëtarësohet në fond të detyrueshëm pensional në dy mënyra:

1) me nënshkrim të marrëveshjes për anëtarësim në fond të detyrueshëm pensional dhe me regjistrim në Regjistrin e anëtarëve që e mban Agjencia.

2) me shpërndarje në fondin e detyrueshëm pensional me përzgjedhje të rastësishme nga FSPIM në rast kur i siguruari i cili është i detyruar që të bëhet anëtar i fondit të detyrueshëm pensional nuk ka nënshkruar marrëveshje anëtarësimi gjatë periudhës për zgjedhjen e fondit të detyrueshëm pensional dhe me regjistrim në Regjistrin e anëtarëve të cilin e mban Agjencia.

Një person i siguruar mund të jetë anëtar vetëm në një fond të detyrueshëm pensional dhe në atë fond pensional mund të ketë vetëm një llogari.

Shoqëria pensionale nuk mund të refuzojë anëtarësim të të siguarit në fondin e detyrueshëm pensional të cilin e menaxhon, përveç në rastin kur ai i siguruar nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor. Shoqëria pensionale është e detyruar, me kërkesë të personit, ta njoftojë

nëse është anëtar i fondit të detyrueshëm pensional të cilin e menaxhon, si dhe për të drejtat që rrjedhin nga anëtarësimi.

Kriteret për anëtarësim në shtyllën e dytë të vlefshme nga 1.1.2019

Në pajtim me ndryshimet e Ligjit për sigurim pensional me financim kapital nga 28.12.2018 dhe ndryshimet e Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor nga 28.12.2018, u ndryshua kriteri për anëtarësim në shtyllën e dytë, përkatësisht:

➤ Të siguruarit të cilët për herë të parë anëtarësohen në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor pas 1 janarit 2019 dhe në datën e anëtarësimit janë më të rinj se mosha 40 vjeçare, janë të detyruar që të anëtarësohen dhe të paguajnë kontribute në fondin e detyrueshëm pensional sipas zgjedhjes personale dhe se kanë cilësi të të siguruarit në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor. Këto të siguruar janë të detyruar që të anëtarësohen në fondin e detyrueshëm pensional në afat prej tre muajsh llogaritur nga data e anëtarësimit në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor (përkatësisht data e punësimit të parë).

Të siguruarve që janë anëtarësuar në shtyllën e dytë para miratimit të këtyre ndryshimeve të ligjit (që kanë qenë të përfshirë në mënyrë të detyrueshme ose vullnetare në shtyllën e dytë) dhe të cilat kanë lindur pas 1 janarit 1967, u vazhdon anëtarësimi në sigurimin pensional me financim kapital.

Pastaj, në pajtim me këto ndryshime të Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital përcaktohen edhe kriteret për ndërprerjen e kategorive të caktuara të anëtarëve. Gjegjësisht:

- Anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale të cilat detyrimisht u përfshinë në shtyllën e dytë (të punësuarit për herë të parë pas 1 janarit 2003) dhe kanë lindur më 1 janar 1967, u ndërpritet anëtarësimi në fondin e detyrueshëm pensional më 1 janar 2019. Shoqëria pensionale e transferon shumën e përgjithshme të mjeteve nga llogaritë e këtyre anëtarëve në FSPIM dhe këto të siguruar mbeten të siguruar vetëm në sigurimin pensional që financohet vazhdimisht të bazuar në solidaritetin e gjeneratës.
- Anëtarët e fondeve të detyrueshme pensionale të cilët u përfshinë vullnetarisht në shtyllën e dytë që janë anëtarësuar në sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital sipas zgjedhjes së rastit (të punësuar për herë të parë para 01.01.2003) dhe që kanë lindur para 1 janarit 1967 kanë të drejtë të zgjedhin ta ndërprerin ose vazhdojnë anëtarësimin në shtyllën e dytë pensionale me deklaratë me shkrim për ndërprerje ose vazhdim të anëtarësisë në fondin e detyrueshëm pensional drejtuar MAPAS, përmes personit të autorizuar nga MAPAS ose nga shoqëria me të cilën ka lidhur marrëveshje për anëtarësim, më së voni deri më 30 shtator 2019. Nëse anëtari, gjatë kohëzgjatjes së këtij afati nuk jep deklaratë për vazhdimin e anëtarësisë në fondin e detyrueshëm pensional, pas skadimit të afatit i ndërpritet anëtarësia në fondin e detyrueshëm pensional. Anëtarit i cili jep deklaratë për ndërprerje të anëtarësisë në fondin e detyrueshëm pensional para datës 30 shtator 2019, anëtarësia i ndërpritet në datën e dhënies së deklaratës. Shoqëria pensionale e transferon shumën e përgjithshme të mjeteve nga llogaritë e anëtarëve të cilëve u ndërpritet anëtarësia, në FSPIM dhe këto të siguruar mbeten të siguruar gjatë sigurimit të financuar pensional të bazuar në solidaritetin e gjeneratës.
- Anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale të cilëve deri në ditën e fillimit të zbatimit të ndryshimeve të Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital (1 janar 2019), gjatë sigurimit kanë fituar cilësi të të siguruarit në pajtim me nenin 11 pika 9 dhe 15 të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor (me cilësi të të siguruarit si bujk individual ose si

kryerës të veprimtarisë së pavarur për tregti me pakicë në tezga dhe tregje) ose gjatë sigurimit kanë pasur stazh të sigurimit që llogaritet me kohëzgjatje të zmadhuar, u ndërpritet anëtarësia në sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital më 1 janar 2019. Shoqëria pensionale e transferon shumën e përgjithshme të mjeteve nga llogaria e këtyre anëtarëve në FSPIM dhe këto të siguruar mbeten të siguruar vetëm me sigurimin pensional me financim të vazhdueshëm të bazuar në solidaritetin e gjeneratës.

Në shtator 2019 u miratuan ndryshime të reja të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor dhe Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital në pajtim me të cilat u definua më qartë se kur u ndërpritet anëtarësia në fondin e detyrueshëm pensional anëtarëve të cilët janë në vende pune me stazh të sigurimit me kohëzgjatje të zmadhuar.

Gjegjësisht, në pajtim me ndryshimet e Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor nga data 2.9.2019, të siguruarit të cilëve stazhi i sigurimit u llogaritet me kohëzgjatje të zmadhuar dhe të siguruarit nga Kapitulli VII – Fitimi dhe realizimi i të drejtave të kategorive të caktuara të të siguruarve me kushte të veçanta, nuk përfshihen në shtyllën e dytë pensionale, nëse kanë stazh të mbushur të sigurimit me kohëzgjatje të zmadhuar që mundëson zvogëlim të kufirit të pleqërisë për realizim të të drejtës së pensionit të pleqërisë për së paku një vjet.

Megjithatë, anëtarët e fondit të detyrueshëm pensional që kanë mbushur stazhin e sigurimit me kohëzgjatje të zmadhuar që mundëson zvogëlim të kufirit të pleqërisë për realizim të të drejtës së pensionit të pleqërisë për së paku një vjet në pajtim me nenin 118 paragrafi (3) të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, mund të zgjedhin ta vazhdojnë anëtarësinë në shtyllën e dytë pensionale me deklaratë me shkrim për vazhdimin e anëtarësisë në fondin e detyrueshëm pensional në afat prej tre muajsh nga mbushja e stazhit të sigurimit. Nëse, gjatë kohëzgjatjes së këtij afati këto anëtarë nuk japin deklaratë me shkrim për vazhdim të anëtarësisë në fondin e detyrueshëm pensional, u ndërpritet anëtarësia në fondin e detyrueshëm pensional pas skadimit të këtij afati. Pas ndërprerjes së anëtarësisë, shoqëria pensionale e transferon shumën e përgjithshme të mjeteve nga llogaritë e këtyre anëtarëve në FSPIM dhe këto të siguruar mbeten të siguruar vetëm me sigurimin pensional me financim të vazhdueshëm të bazuar në solidaritetin e gjeneratës.

Pastaj, anëtarët e fondit të detyrueshëm pensional, të cilët deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë mbushur stazhin e sigurimit me kohëzgjatje të zmadhuar që mundëson zvogëlim të kufirit të pleqërisë për realizim të të drejtës së pensionit të pleqërisë për së paku një vit në pajtim me nenin 118 paragrafi (3) të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, mund të zgjedhin ta vazhdojnë anëtarësimin në shtyllën e dytë pensionale me deklaratë me shkrim për vazhdimin e anëtarësisë në fondin e detyrueshëm pensional, më së voni deri më 30 nëntor 2019. Nëse, gjatë kohëzgjatjes së këtij afati, këto anëtarë nuk japin deklaratë me shkrim për vazhdimin e anëtarësisë në fondin e detyrueshëm pensional, u ndërpritet anëtarësia në fondin e detyrueshëm pensional pas skadimit të këtij afati. Pas ndërprerjes së anëtarësisë, shoqëria pensionale e transferon shumën e përgjithshme të mjeteve nga llogaritë e këtyre anëtarëve, në FSPIM dhe këto të siguruarit mbeten të siguruar vetëm në sigurimin pensional me financim të vazhdueshëm të bazuar në solidaritetin e gjeneratës.


Gjithashtu, edhe të siguruarit të cilët gjatë sigurimit do të fitojnë bazë të sigurimit sipas nenit 11 paragrafi (1) pika 9) dhe 15) të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor (cilësi të të siguruarit si bujk individual ose kryerës i veprimtarisë së pavarur për tregti me pakicë dhe tregje) pushojnë të jenë anëtarë në shtyllën e dytë pensionale.

Më poshtë është dhënë pasqyrë me shembuj të personave nga disa kategori të ndryshme të anëtarëve.

Anëtarë të detyrueshëm


Të punësuar për herë të parë pas datës 1 janar 2019 dhe më të rinj se 40 vjeçar në datën e punësimit

- Duhet të nënshkruajnë marrëveshje për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional në afat prej 3 muajsh pas datës së punësimit
- Nëse nuk nënshkruajnë marrëveshje për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional deri në skadimin e muajit të tretë pas datës së punësimit, do të shpërndahen në njërin prej fondeve të detyrueshme pensionale sipas zgjedhjes së rastit.



Shembull:


- *Aleksandri është punësuar për së pari herë më 1 mars 2019*
- *Aleksandri më 1 mars 2019 ka moshë 25 vjeçare*
- *Aleksandri është anëtar i detyrueshëm i shtyllës së dytë pensionale*
- *Aleksandri mund të zgjedhë se në cilin fond të detyrueshëm pensional do t'i paguajë kontributet e tij*
- *Zgjedhjen e tij, Aleksandri duhet ta bëjë në afat prej 3 muajsh pas datës së punësimit (deri më 1 qershor 2019)*
- *Aleksandri duhet të nënshkruajë marrëveshje për anëtarësim në fondin e zgjedhur pensional*
- *Nëse Aleksandri nuk nënshkruan marrëveshje për anëtarësim në fondin pensional deri në skadimin e muajit të tretë pas datës së punësimit, Aleksandri do të shpërndahet në njërin prej fondeve të detyrueshme pensionale sipas zgjedhjes së rastit*



Anëtarët vullnetarë të lindur para datës 1 janar 1967 të cilët kanë të drejtë të zgjedhjes


Të punësuar së pari herë para datës 1 janar 2003

- Zgjedhjen për vazhdim ose ndërprerje të anëtarësisë në fondin e detyrueshëm pensional mund ta bëjnë në periudhën nga 1 janar 2019 deri më 30 shtator 2019
- Zgjedhja vërtetohet me nënshkrim të deklaratës për ndërprerje ose vazhdim të anëtarësisë në fondin e detyrueshëm pensional



Shembull:

- Gorani është punësuar për së pari herë më 1 mars 2000 dhe ka lindur më 1 janar 1966
- Gorani ka pasur mundësi të zgjedhë nëse do të anëtarësohet në sistemin dyshtyllësh
- Zgjedhjen e tij, Gorani e ka bërë në periudhën nga 20 shtator 2005 deri më 31 dhjetor 2005 dhe ka nënshkruar marrëveshje për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional që e ka zgjedhur
- Gorani ka mundësi të zgjedhë nëse do të ndërpresë ose vazhdojë anëtarësinë në fondin e zgjedhur të detyrueshëm pensional, në periudhën nga 1 janar 2019 deri 30 shtator 2019 duke dhënë deklaratë me shkrim në MAPAS, përmes personit të autorizuar nga MAPAS ose nga shoqëria me të cilën ka lidhur marrëveshje për anëtarësim
- Gorani duhet të japë deklaratë me shkrim për vazhdim ose ndërprerje të anëtarësisë në fondin e detyrueshëm pensional
- Nëse Gorani jep deklaratë për vazhdim i vazhdon anëtarësia në fondin e detyrueshëm pensional
- Nëse Gorani jep deklaratë për ndërprerje ose nuk jep kurrfarë deklarate deri më 30 shtator 2019, i ndërpritet anëtarësia në fondin e detyrueshëm pensional dhe Gorani bëhet i siguruar vetëm në shtyllën e parë.



Kriteret për anëtarësim në shtyllën e dytë para datës 31.12.2018

Përfundimisht më datë 31.12.2018, ekzistojnë dy kategori globale të të siguruarve për anëtarësim në shtyllën e dytë, dhe atë anëtarë të detyrueshëm dhe vullnetarë:

- Të siguruarit të cilët për herë të parë pas datës 1 janar 2003 janë anëtarësuar në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor (përkatësisht janë punësuar), ishin të detyruar që të anëtarësohen dhe të paguajnë kontribute në fondin e detyrueshëm pensional sipas zgjedhjes vetjake derisa kanë cilësi të të siguruarit në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor. Të siguruarit ishin të detyruar që të anëtarësohen në fondin e detyrueshëm pensional në afat prej tre muajsh llogaritur nga data e anëtarësimit në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor (përkatësisht data e punësimit të parë).
- Të siguruarit që janë përfshirë në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor (përkatësisht janë punësuar) para datës 1 janar 2003 mund të anëtarësohen dhe të paguajnë kontribute në fondin e detyrueshëm pensional sipas zgjedhjes vetjake dhe zgjedhjen duhej ta bënin më së voni deri më 31 dhjetor 2005. Me përjashtim, këto persona nëse nuk kanë qenë të punësuar në periudhën e anëtarësimit kishin të drejtë të zgjedhin fond të detyrueshëm pensional sipas punësimit të tyre në afat të përgjithshëm për zgjedhje prej tre muajsh.

Gjithashtu, përfundimisht me datë 31.12.2018, në pajtim me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor të siguruarit që kanë bërë pjesë në kapitullin VII të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor (të siguruarit nën kushte më të volitshme) janë përjashtuar nga anëtarësimi në shtyllën e dytë. Gjegjësisht, meqë ato janë pensionuar nën kushte më të volitshme dhe zakonisht punojnë më shkurt, nuk ka kohë të mjaftueshme për kapitalizim të mjeteve të tyre në shtyllën e dytë, me ç'rast u vlerësua se është më mirë që ato të mbeten në sistemin njëshpyllësh. Gjithashtu, edhe bujqit individualë u përjashtuan nga anëtarësimi në shtyllën e dytë.

Megjithatë, po ta ndryshonin personat e lartpërmendur cilësinë e përkatësisë së kapitullit VII të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor ose të bujqve individualë, mund sipas zgjedhjes personale të vendosin ta ndërpresin anëtarësimin në fondin e detyrueshëm pensional dhe të kthehen në sistemin pensional njëshpyllësh, në afat prej një viti nga ndryshimi i cilësisë. Në atë rast të gjitha kontributet e paguara për të në shtyllën e dytë janë transferuar në FSPIM prej ku personi gjatë pensionimit do ta marrë pensionin e plotë.

Fillimi i anëtarësimit në shtyllën e dytë filloi më 20 shtator 2005, ndërsa pagesën e kontributit për sigurim pensional me financim kapital filloi pas datës së fillimit të pagesës së kontributeve të përcaktuara nga Qeveria e RM-së, përkatësisht pas datës 1 janar 2006 me pagesë të rrogës së janarit.

Më poshtë është dhënë pasqyrë me shembuj të personave nga disa kategori të ndryshme të anëtarëve.

Anëtarë vullnetarë


Të punësuar për së pari herë para datës 1 janar 2003

- Zgjedhjen e fondit të detyrueshëm pensional mund ta bënin në periudhën nga 20 shtator 2005 deri më 31 dhjetor 2005
- Zgjedhja u vërtetua me nënshkrim formal të marrëveshjes për anëtarësim në fondin zgjedhor



Shembull:


- Gorani është punësuar për së pari herë më 1 mars 2000
- Gorani kishte mundësi për të zgjedhur nëse do të anëtarësohet në sistemin dyshtyllësh
- Zgjedhjen e tij, Gorani mund ta bëjë në periudhë nga 20 shtator 2005 deri 31 dhjetor 2005
- Gorani duhej të nënshkruajë marrëveshje për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional pas zgjedhjes së tij dhe me atë formalisht të bëhet anëtar



Anëtarë vullnetarë

Të punësuar për së pari herë para datës 1 janar 2003, por me ndërprerje në sigurimin në periudhën nga 20 shtator 2005 deri më 31 dhjetor 2005

- Zgjedhjen e fondit të detyrueshëm pensional mund ta bënin pas punësimit sërishmi në afatin e përgjithshëm prej tre muajsh.
- Zgjedhja u vërtetua me nënshkrimin formal të marrëveshjes për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional



Shembull:


- Marija është punësuar për së pari herë më 1 mars 2002, por ka ndërprerë me punë më 31 mars 2005 dhe përsëri është punësuar nga 1 janar 2010
- Marija kishte mundësi të zgjedhë nëse do të anëtarësohet në sistemin dyshtyllësh
- Zgjedhjen e saj, Marija mund ta bëjë në periudhë prej 3 muajsh nga data e punësimit sërishmi (deri 1 prill 2010)
- Marija duhej të nënshkruante marrëveshje për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional pas zgjedhjes së saj dhe me atë formalisht të bëhet anëtar



Anëtarë të detyrueshëm


Të punësuar për së pari herë pas datës 1 janar 2003

- Duhej të nënshkruajnë marrëveshje për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional në afat prej 3 muajsh pas datës së punësimit
- Po të mos shkruanin marrëveshje për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional deri në skadimin e muajit të tretë pas datës së punësimit, u shpërndanë në njërin prej fondeve të detyrueshme pensionale sipas zgjedhjes së rastit



Shembull:


- Aleksandri është punësuar për së pari herë më 1 gusht 2012
- Aleksandri është anëtar i detyrueshëm i sistemit dyshtyllësh
- Aleksandri mund të zgjedhë në cilin fond të detyrueshëm do t'i paguajë kontributet e tij
- Zgjedhjen e tij, Aleksandri duhej ta bëjë në agat prej 3 muajsh pas datës së punësimit (deri më 1 janar 2012)
- Aleksandri duhej të nënshkruante marrëveshje për anëtarësim në fondin e zgjedhur pensional
- Nëse Aleksandri nuk ka nënshkruar marrëveshje për anëtarësim në fondin pensional deri në skadimin e muajit të tretë pas datës së punësimit, Aleksandri është shpërndarë në njërin prej fondeve të detyrueshme pensionale sipas zgjedhjes së rastit.



Anëtarët e detyrueshëm

Të punësuarit për së pari herë pas datës 1 janar 2003, por me ndërprerje në sigurimin në periudhën nga 20 shtator 2005 deri në 31 dhjetor 2005

- Duhet të nënshkruajnë marrëveshje për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional në afat prej 3 muajsh pas datës së punësimit sërishmi
- Nëse nuk nënshkruajnë marrëveshje për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional deri në skadimin e muajit të tretë pas datës së punësimit sërishmi, do të shpërndahen në njërin prej fondeve të detyrueshme pensionale sipas zgjedhjes së rastit.



Shembull:

- Vesna është punësuar për së pari herë më 1 mars 2004, por ka ndërprerë me punë më 31 gusht 2005 dhe përsëri është punësuar nga 1 prill 2008.

- *Vesna është anëtare e detyrueshme e sistemit dyshtyllësh*
- *Vesna mund të zgjedhë në cilin fond të detyrueshëm pensional do t'i paguajë kontributet e saj*
- *Zgjedhjen e saj, Vesna duhet ta bëjë në afat prej 3 muajsh pas datës së punësimit sërishmi (deri më 1 korrik 2008)*
- *Vesna duhet të nënshkruajë marrëveshje për anëtarësim në fondin e zgjedhur pensional*
- *Nëse Vesna nuk nënshkruan marrëveshje për anëtarësim në fondin pensional deri në skadimin e muajit të tretë pas datës së punësimit, Vesna do të shpërndahet në njërin prej fondeve të detyrueshme pensionale sipas zgjedhjes së rastit*

5.1.1. Marrëveshja për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional

Marrëveshja për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional duhet të plotësohet dhe nënshkruhet në formën e standardizuar (të dhënë në shtojcë të këtij Programi, si pjesë përbërëse e Rregullores për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional), në të kundërtën do të jetë e pavlefshme. Shoqëria cakton numër të vetëm të marrëveshjes për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional, që përbëhet prej dhjetë shifrave. Për çdo fond të detyrueshëm pensional Agjencia i cakton dy shifrat e para, me të cilat identifikohet fondi i detyrueshëm pensional dhe ato detyrimisht janë pjesë përbërëse nga çdo numër të ndarë nga shoqëria.

Marrëveshja për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional duhet të nënshkruhet personalisht i siguruari i cili ka të drejtë të bëhet anëtar i fondit të detyrueshëm pensional dhe agjenti në emër të shoqërisë. Gjatë lidhjes së marrëveshjes për anëtarësim, shoqërinë e përfaqëson vetëm agjenci i cili është regjistruar në Regjistrin e agjentëve. Agjenti duhet ta kontrollojë identitetin e personit i cili lidh marrëveshje për anëtarësim në bazë të dokumentit për identifikim personal.

Marrëveshja për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional duhet t'i përmbajë datën dhe kohën (ora dhe minuta) kur është nënshkruar nga të dyja palët, si dhe të dhënat tjera të detyrueshme. Marrëveshja për anëtarësim nënshkruhet në dy ekzemplarë origjinalë dhe agjenti pas nënshkrimit të marrëveshjes menjëherë duhet t'i dorëzojë një ekzemplar shoqërisë dhe një ekzemplar anëtarit i cili e ka nënshkruar marrëveshjen për anëtarësi.

Shoqëria mund t'i mundësojë të siguarit të lidhë marrëveshje për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional dhe përmes platformës elektronike për komunikim dykahësh me shfrytëzim të autentifikimit të dyfishtë. Procesi për lidhje digjitale të marrëveshjes për anëtarësi në fondin e detyrueshëm pensional është dhënë në shtojcë të këtij Programi, si pjesë përbërëse e Rregullores për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional. Procedurën për lidhje digjitale të marrëveshjes për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional, shoqëria e zbaton në pajtim me procedurën dhe rregullat për mbrojtje të të dhënave personale.

Shoqëria pensionale është e detyruar, që t'i mundësojë kontroll të prospekteve informative, statuteve dhe raporteve financiare të fondit të detyrueshëm pensional me të cilin menaxhon çdo personi i cili do të paraqitet për anëtarësim para nënshkrimit të marrëveshjes për anëtarësim dhe çdo anëtar i me kërkesë të tij.

5.1.2. Prishja e marrëveshjes për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional

Në rast kur i siguruari për së pari herë ka nënshkruar marrëveshje për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional dhe deri atëherë nuk ka qenë anëtar i asnjë fondi të detyrueshëm pensional, ka të drejtë të prishjes së njëanshme të marrëveshjes me parashtrim me shkrim të dorëzuar shoqërisë në afat prej tetë ditë pune nga data e nënshkrimit të marrëveshjes për anëtarësim. Shoqëria është e detyruar që bashkë me marrëveshjen për anëtarësim të siguarit t'i dorëzojë parashtrësë për prishje të marrëveshjes. Parashtrësja për prishje të marrëveshjes për anëtarësim duhet të plotësohet dhe nënshkruhet në formë të standardizuar (të dhënë në shtojcë të këtij programi), në të kundërtën do të jetë e pavlefshme. Parashtrësja nënshkruhet në dy ekzemplarë, të cilat agjenti menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes ia dorëzon të siguarit bashkë me marrëveshjen për anëtarësim. Parashtrësën e nënshkruar për prishje të marrëveshjes për anëtarësim të të siguarit mund ta dorëzojë personalisht në shoqërinë, përmes personit tjetër ose përmes postës me dërgesë të rekomanduar.

Shoqëria duhet t'i ruajë të dhënat për të siguarit të cilat e kanë prishur marrëveshjen për anëtarësim dhe të njëjtët duhet të jenë të disponueshëm për Agjencinë me kërkesë të saj.

5.1.3. Transferimi nga një fond të detyrueshëm pensional në fond tjetër

Anëtari i fondit të detyrueshëm pensional ka të drejtë të kalojë dhe të anëtarësohet në fond tjetër të detyrueshëm pensional. Anëtari i cili ka llogari individuale në fondin e detyrueshëm pensional (fond i detyrueshëm pensional ekzistues) mund të bëhet anëtar i fondit të detyrueshëm pensional të menaxhuar nga shoqëri tjetër (fond i ardhshëm i detyrueshëm pensional), me nënshkrim të marrëveshjes për transferim me shoqërinë që menaxhon me fondin e ardhshëm të detyrueshëm pensional, nënshkrim të deklaratës për pëlqim për transferim dhe pagesë të kompensimit për transferim nëse numri i muajve nga muaji i parë për të cilin anëtari ka fituar të drejtën e kontributit në fondin e detyrueshëm pensional ekzistues deri në muajin e transferimit në fondin e ardhshëm të detyrueshëm pensional është më i vogël se 24 muaj. Nëse numri i muajve nga muaji i parë për të cilin anëtari ka fituar të drejtën e kontributit në fondin e detyrueshëm pensional deri në muajin e transferimit në fondin e ardhshëm të detyrueshëm pensional është më i madh se 24 muaj, kompensimi për transferim nuk paguhet.

Shoqëria e cila menaxhon me fondin e ardhshëm të detyrueshëm është e detyruar që të kontrollojë nëse janë përmbushur kushtet për transferim dhe ta regjistrojë anëtarin në Regjistrin e anëtarëve. Anëtarësia në fondin e ardhshëm të detyrueshëm pensional fillon në datën e parë të ardhshme për transferim të mjeteve.

Përmbajtjen e marrëveshjes për transferim në fondin e detyrueshëm pensional dhe deklaratën për pëlqim për transferim e përcakton Agjencia.

Në rast të transferimit të anëtarit nga njëri në tjetrin fond të detyrueshëm pensional, mjetet e atij anëtari transferohen nga fondi ekzistues në fondin e ardhshëm të detyrueshëm pensional në datën e parë të ardhshme për transferim të mjeteve të përcaktuara nga Agjencia. Transferimi i mjeteve paraqet transferim të mjeteve nga llogaria e anëtarit që është e hapur në një fond të detyrueshëm pensional në tjetër fond të detyrueshëm pensional me të cilin menaxhon tjetër shoqëri. Shoqëria e cila menaxhon me fondin e detyrueshëm pensional e njofton shoqërinë e cila menaxhon me fondin e ardhshëm të detyrueshëm pensional për kontributet e anëtarit të paguar në fondin e detyrueshëm pensional ekzistues, për mjetet e transferuara për atë anëtar dhe për kontributet e atij anëtari që i ka paguar në fondet pensionale në të cilat ka qenë anëtar në të kaluarën.

5.1.4. Shpërndarja e të siguarve në fondet e detyrueshme pensionale nga FSPIM

Nga momenti i punësimit, të siguarit që hynë detyrimisht në shtyllën e dytë, shpërndahen përkohësisht në fondet e detyrueshme pensionale dhe kontributet e tyre ruhen në nënlllogari individuale në fondet e detyrueshme pensionale. Shpërndarja e përkohshme bëhet sipas zgjedhjes së rastit me ç'rast numri

i të siguruarve i cili shpërndahet në çdo fond të detyrueshëm pensional caktohet sipas të ardhurave të atij fondi të detyrueshëm pensional dhe lartësisë së kompensimit nga kontributet që e paguan shoqëria që menaxhon me atë fond të detyrueshëm pensional në pajtim me nenin 98 paragrafi (1) pika a) të Ligjit.

Kjo bëhet me qëllim për të siguruar menjëherë investim të mjeteve të këtyre të siguruarve, por ato të siguruar ende nuk janë anëtarë të fondeve të detyrueshme pensionale në të cilat janë shpërndarë përkohësisht. Agjencia në formë elektronike i informon shoqëritë për të siguruarit e shpërndarë përkohësisht, duke cekur numrin e tyre unik amëz, emrin, mbiemrin dhe numrin unik tatimor të personit juridik ku janë punësuar, me qëllim shoqëria të mund të hapë nënlllogari dhe të ketë evidencë për të siguruarit e shpërndarë përkohësisht. Agjencia e njofton çdo të siguruar të shpërndarë përkohësisht për fondin e detyrueshëm pensional në të cilin është shpërndarë përkohësisht si dhe për të drejtat që dalin nga anëtarësimi.

Të siguruarit e shpërndarë përkohësisht kanë afat prej tre muajsh për të zgjedhur në cilin fond të detyrueshëm pensional do të marrin pjesë, çfarë do të thotë mundet sipas zgjedhjes personale të anëtarësohen në fondin e detyrueshëm pensional në të cilin kanë qenë të shpërndarë përkohësisht ose të zgjedhin të anëtarësohen në fond të detyrueshëm pensional.

Nëse i siguruari i shpërndarë përkohësisht nënshkruan marrëveshje për anëtarësim në cilindo prej fondeve të detyrueshme pensionale në afatin për zgjedhje, ai bëhet anëtar i fondit të menaxhuar nga ajo shoqëria.

Por, nëse deri në ditën e njëmbëdhjetë të punës nga skadimi i periudhës për zgjedhje të fondit të detyrueshëm pensional, i siguruari i shpërndarë përkohësisht nuk ka nënshkruar marrëveshje për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional e cila është bërë e plotfuqishme, ai bëhet anëtar i fondit të detyrueshëm pensional në të cilin është shpërndarë përkohësisht paraprakisht nga FSPIM dhe regjistrohet në Regjistrin e anëtarëve.

Agjencia, në ditën e regjistrimit e njofton shoqërinë në formë elektronike për personat që janë shpërndarë. Në bazë të të dhënave dhe njoftimit nga Agjencia, shoqëria menjëherë vendos llogari individuale në emër të anëtarit të cilit ia transferon mjetet e akumuluar nga nënllogaria e hapur për të siguruarin e shpërndarë përkohësisht.

5.1.5. Anulimi i regjistrimit të anëtarit në Regjistrin e anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar në Regjistrin e anëtarëve të pensionuar të fondeve të detyrueshme pensionale

Agjencia mund të anulojë regjistrim të anëtarit në regjistrin e anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale krahas rasteve kur personi ka nënshkruar më shumë se një marrëveshje për anëtarësimin ose prishin në mënyrë të drejtë marrëveshje e cila është nënshkruar paraprakisht, dhe nëse:

- a) Regjistrimi është bazuar në të dhëna të pasakta;
- b) Në bazë të vendimit gjyqësor ose
- c) Në raste tjera të cilat nuk janë në pajtim me ligjin.

Agjencia mund të anulojë regjistrim të anëtarit të pensionuar të fondit të detyrueshëm pensional në regjistrin e anëtarëve të pensionuar nëse:

- a) Regjistrimi është bazuar në të dhëna të pastaj;
- b) Në bazë të vendimit gjyqësor ose
- c) Në raste tjera që nuk janë në pajtim me rregullat që e rregullojnë sigurimin pensional dhe invalidor dhe sigurimin pensional me financim kapital.

Pas anulimit të regjistrimit, Agjencia menjëherë i njofton shoqërinë dhe FSPIM në formë elektronike. Pas anulimit të regjistrimit nga Agjencia, shoqëria i dorëzon njoftim me shkrim anëtarit ose anëtarit të pensionuar me arsyetim për regjistrimin e anuluar.

5.1.6. Mënyra e evidencës së anëtarëve të fondit të detyrueshëm pensional

Shoqëritë që menaxhojnë me fonde të detyrueshme pensionale mbajnë evidencë për llogari individuale të çdo anëtari dhe anëtari të pensionuar të fondit të detyrueshëm pensional.

Shoqëria hap llogari individuale për çdo anëtar të fondit të detyrueshëm pensional me të cilin menaxhon, në datën në të cilën i siguruari bëhet anëtar i fondit të detyrueshëm pensional.

Shoqëria e hap llogarinë individuale të anëtarit ose anëtarit të pensionuar në rast të:

- a) Blerjes së anuitetit të pensionuar i cili paguhet deri në fund të jetës së shoqërisë për sigurim të autorizuar për këtë qëllim;
- b) Tërheqjeve të programuara të siguruara nga shoqëri tjetër me të cilën anëtari ka lidhur marrëveshje për tërheqje të programuara pas pensionimit;
- c) Pagesës së të gjitha mjeteve nga llogaria individuale për shkak të kombinimit të tërheqjeve të programuara të përkohshme me anuitet të prolonguar të përjetshëm;
- ç) Transferimit të anëtarit dhe anëtarit të pensionuar nga njëri fond i detyrueshëm pensional në fondin tjetër;
- d) Transferimit të mjeteve nga llogaria individuale në Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë së Veriut kur një anëtar do të fitojë të drejtën e pensionit invalidor;
- dh) Transferimit të mjeteve nga llogaria individuale në FSPIM në rast të vdekjes së anëtarit anëtarët e familjes të të cilit kanë të drejtë të pensionit familjar;
- e) Pagesës së mjeteve nga llogaria individuale të trashëgimtarit/trashëgimtarëve në pajtim me Ligjin për trashëgimi në rast të vdekjes së anëtarit ose anëtarit të pensionuar;
- ë) Pagesës së njëhershme të shumës së përgjithshme në llogarinë individuale në bazë të nenit 92 paragrafi (2) të Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital dhe
- f) Rasteve tjera të tërheqjes ose transferimit të mjeteve në pajtim me Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital.

5.1.7. Përditësimi i të dhënave në Regjistrin e anëtarëve dhe korrigjimi i marrëveshjes për anëtarësim

Shoqëria mund të korrigjojë të dhëna personale të anëtarit në marrëveshje origjinale për anëtarësim me kërkesë të anëtarit. Ndërkaq, shoqëria kryen kontroll të drejtpërdrejtë të letërnjoftimit/dokumentit për identifikim të anëtarit përmes personit të autorizuar nga organi kompetent të shoqërisë ose agjentit dhe me nënshkrim e verifikon kontrollin. Ndërkaq, data e lidhjes së marrëveshjes origjinale për anëtarësim korrigjohet vetëm nëse është shkruar në mënyrë të paqartë, në bazë të deklaratës së anëtarit dhe agjentit që e kanë nënshkruar marrëveshjen.

Shoqëria mund të azhurnojë ose të korrigjojë të dhëna personale të anëtarit në Regjistrin e anëtarëve në bazë të kërkesës së anëtarit. Forma e kërkesës është e përcaktuar në rregullativën nënligjore. Ndërkaq për shkak të identifikimit personal të parashtruesit të kërkesës, shoqëria kryen kontroll të drejtpërdrejtë në letërnjoftimin/dokumentin për identifikim personal të anëtarit përmes personit të autorizuar nga organi

kompetent i shoqërisë ose agjentit ose telefonit për kontakt me anëtarin, me ç'rast siguron incizim nga biseda.

Shoqëria mund të azhurnojë ose të korrigjojë të dhëna për adresën e jetesës dhe/ose adresën për korrespondim të anëtarit, në Regjistrin e anëtarëve, nëse anëtari përmes telefonit lajmërohet në shoqërinë. Shoqëria e identifikon anëtarin me ç'rast siguron incizim nga biseda.

Gjithashtu shoqëria duhet t'i mundësojë anëtarit të fondit të detyrueshëm pensional t'i përditësojë të dhënat personale në Regjistrin e anëtarëve përmes sistemit të tij elektronik në faqen e internetit. Ndërkaq anëtari mund t'i përditësojë të dhënat personale në vijim: emrin, mbiemrin, adresën e jetesës, vendin e jetesës, kodin postar, adresën për korrespondim, vendin për korrespondim, kodin postar për korrespondim, telefonin dhe postën elektronike. Ndërkaq, për shkak të sigurimit të sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale, gjatë përditësimit, shoqëria duhet të sigurojë identifikim dhe kontroll të autorizimit të personit që dëshiron të kryejë përditësim të të dhënave.

Procedurat për përditësim të të dhënave, shoqëria i zbaton në pajtim me procedurat dhe rregullat për mbrojtje të të dhënave personale.

5.2. DATA, MËNYRA DHE PROCEDURA E ANËTARËSIMIT NË FONDIN E DETYRUESHËM PENSIONAL

5.2.1. Për anëtarët për të cilët janë të vlefshme kriteret për anëtarësim në shtyllën e dytë nga 1.1.2019

I siguruari anëtarësohet në fond të detyrueshëm pensional duke nënshkruar marrëveshjen e anëtarësimit dhe duke u regjistruar në Regjistrin e anëtarëve të cilin e mban Agjencia ose me shpërndarjen në fond të detyrueshëm pensional nga FSPIM në rast se i siguruari është i detyruar të bëhet anëtar pa nënshkruar marrëveshjen e anëtarësimit gjatë periudhës së zgjedhjes së fondit të detyrueshëm pensional dhe me regjistrim në Regjistrin e anëtarëve të cilin e mban Agjencia.

Të drejtat dhe detyrimet nga anëtarësimi nga anëtarësimi për të siguarit e punësuar për herë të parë pas datës 1 janar 2019 dhe të cilët në datën e antarësimit janë më të rinj se 40 vjet, fitohen nga data kur për herë të parë janë anëtarësuar në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor.

Në ditën e tretë të punës pas skadimit të afatit prej tetë ditë pune për prishjen e marrëveshjes, shoqëria i fut të dhënat nga marrëveshja për anëtarësim në sistemin informativ të Agjencisë, në rast kur i siguruari për herë të parë ka nënshkruar marrëveshje për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional dhe paraprakisht nuk ka qenë anëtar i asnjë fondi të detyrueshëm pensional. Shoqëria e kontrollon saktësinë e të dhënave para se t'i fusë ato në sistemin informativ të Agjencisë. Nëse të dhënat e futura nuk përkojnë me të dhënat e cekura në marrëveshjen për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional, atëherë të vlefshme konsiderohen të dhënat nga marrëveshja për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional. Pas zbulimit të dallimeve në të dhënat, shoqëria dorëzon kërkesë për korrigjim të të dhënave në Agjencinë.

Pas futjes së të dhënave nga marrëveshja Agjencia përmes sistemit të saj informativ e kontrollon plotësinë, saktësinë e të dhënave dhe përbushjen e kushteve për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional. Në bazë të të këtij kontrolli Agjencia e regjistron të siguarin si anëtar i fondit të detyrueshëm pensional në Regjistrin e anëtarëve nëse të gjitha të dhënat në marrëveshjen për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional janë futur në kohë në sistemin informativ të Agjencisë, ato janë të plota dhe të sakta dhe nëse janë përbushur kushtet për anëtarësim në atë fond të detyrueshëm pensional. Nëse nuk është përbushur ndonjë prej kushteve të lartpërmendura, Agjencia nuk mund ta regjistrojë të siguarin si anëtar i fondit të detyrueshëm pensional.

Nëse Agjencia pranon të dhëna nga shoqëria për të siguruarin i cili ka nënshkruar marrëveshje për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional, e në evidencën e FSPIM nuk ka të dhëna për atë të siguruar, Agjencia përmes sistemit informativ e njofton FSPIM dhe e prolongon regjistrimin e anëtarit. Agjencia përmes sistemit informativ e njofton shoqërinë se regjistrimi i anëtarit ka status të pritjes. Nëse Agjencia në afatin e përcaktuar konstaton se i siguruari është regjistruar në evidencën e FSPIM, të gjitha të dhënat e dorëzuara nga shoqëria janë të sakta dhe janë përmbushur kushtet për anëtarësim e regjistron të siguruarin në Regjistrin e anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale. Data e regjistrimit konsiderohet si datë e anëtarësimit. Por, nëse pas skadimit të atij afati Agjencia konstaton se i siguruari nuk është regjistruar në evidencën e FSPIM përmes sistemit informativ e njofton shoqërinë se regjistrimi është refuzuar. Shoqëria hap llogari individuale për çdo anëtar të fondit të detyrueshëm pensional në datën në të cilën i siguruari bëhet anëtar i fondit të detyrueshëm pensional. Data në të cilën i siguruari bëhet anëtar në fondin e detyrueshëm pensional është data e regjistrimit të tij në Regjistrin e anëtarëve.

Nëse i siguruari ka nënshkruar marrëveshje për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional janë më shumë se një shoqëri dhe nuk ka prishur asnjë prej marrëveshjeve në fondin e detyrueshëm pensional në afatin për prishje të marrëveshjes për anëtarësim, e vlefshme konsiderohet ajo marrëveshje për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional i cili ka nënshkruar i pari. Agjencia e anulon regjistrimin e anëtarit në bazë të marrëveshjes për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional që është nënshkruar në bazë të marrëveshjes për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional që është nënshkruar më vonë, e që ka arritur i pari në Agjencinë. Agjencinë për atë menjëherë e njofton shoqëria përmes sistemit informativ.

5.2.2. Për anëtarët për të cilat janë të vlefshme kriteret për anëtarësim në shtyllën e dytë para 31.12.2018

Të drejtat dhe detyrimet nga anëtarësimi për të siguruarit e punësuar për herë të parë para datës 1 janar 2003 fitohen nga data e nënshkrimit të marrëveshjes për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional, ndërsa për të siguruarit janë punësuar për herë të parë pas datës 1 janar 2003 fitohen nga data kur për herë të parë janë përfshirë në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor. Me përjashtim, për të siguruarit të cilat për herë të parë janë përfshirë në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor para datës 1 janar 2006, të drejtat dhe detyrimet nga anëtarësimi fitohen nga 1 janar 2006 nëse i siguruari nuk ka pasur ndërprerje në sigurimin pensional në periudhën nga 20 shtator 2005 deri më 31 dhjetor 2005, ndërsa nëse i siguruari ka pasur ndërprerje në këtë periudhë, të drejtat dhe detyrimet nga anëtarësia fitohen nga data e parë e sigurimit pas datës 1 janar 2006.

5.4. PAGESA E KONTRIBUTEVE NË FONDIN E DETYRUESHËM PENSIONAL

Pagesa e kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor bëhet në pajtim me Ligjin për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm pensional. Drejtoria për të Ardhurat Publike (nga 1 janar 2009) kryen arkëtim të kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social (kontributi për sigurim pensional dhe invalidor në rast të papunësisë) dhe tatimit personal mbi të ardhurat.

Për të siguruarit që do të mbeten në sistemin me një shtyllë, kontributi i përgjithshëm për sigurim pensional dhe invalidor mbeten në FSPIM (për vitin 2020 dhe është 18,8% nga bruto rroga), e për të siguruarit që do të përfshihen në sistemin me dy shtylla, FSPIM kryen shpërndarje dhe transferim të një pjese në fondet e detyrueshme pensionale. Lartësia e kontributit që transferohet në fondin e detyrueshëm

pensional sipas zgjedhjes së anëtarit është 6% nga baza për pagesë të kontributit është përcaktuar me ligj. Lartësia e kontributit që mbetet në FSPIM fitohet si dallim ndërmjet kontributit të përgjithshëm për sigurimin pensional dhe kontributit për sigurim pensional dhe invalidor dhe kontributit të paguar në fondin e detyrueshëm pensional (nga viti 2020 është 12,8% nga rroga bruto (12,8% = 18,8% - 6%). FSPIM i transferon kontributet e anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale në llogari individuale të fondeve të detyrueshme të zgjedhura pensionale, menjëherë e më së voni në afat prej pesë ditë puna nga dira e pranimit të kontributeve, me kusht që në afatin e njëjtë të jenë aplikuar edhe të dhëna përkatëse në pajtim me ligjin, të cilat i mundësojnë FSPIM ta kryejë atë obligim. Nëse FSPIM nuk i transferon kontributet e anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale në llogaritë e fondeve të detyrueshme pensionale menjëherë, e më së voni në afat prej pesë ditë pune nga dita e pranimit të kontributeve për shkak të mungesës së të dhënave përkatëse, FSPIM është i detyruar që në afat jo më të gjatë se tre muaj nga dita e pranimit të kontributeve të sigurojë të dhëna përkatëse dhe të kryejë transferim të kontributeve të anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale në llogaritë e fondeve të detyrueshme të zgjedhur pensionale të ruajtësi i pronës. Pastaj, FSPIM dorëzon të dhëna në shoqërinë dhe Agjencinë në lidhje me transferimin e kryer të kontributeve. Për t'i realizuar këto funksione, FSPIM, në bazë të të dhënave nga Agjencia, mban bazë të të dhënave për të siguruarit e përfshirë në shtyllën e dytë dhe për fondin e detyrueshëm të zgjedhur pensional.

Ndryshimet në Ligjin për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital nga data 28.12.2018 parashikojnë detyrimin e FSPIM-së për pagim të kompensimit për transferim të jo në kohë të kontributeve në rastet në vijim:


- Nëse FSPIM nuk i bart kontributet e anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale pas skadimit të tre muajve nga dita e pranimit të kontributeve, FSPIM është i detyruar që gjatë transferimit të kontributeve, të paguajë edhe kompensim për transferim jo në kohë të kontributeve.

- Nëse FSPIM nuk i shpërndan personat e siguruar që janë anëtarë të detyrueshëm të shtyllës së dytë në përputhje me kriteret e reja për anëtarësim, në fondet e detyrueshëm pensional menjëherë, por jo më vonë se tre muaj pas anëtarësimit të tyre në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor, FSPIM është i detyruar që gjatë shpërndarjes së të siguruarve në fondet e detyrueshme pensionale dhe transferimit të kontributeve të paguajë kompensim për transferim jo në kohë të kontributeve.

- Për personat e siguruar që janë anëtarë të detyrueshëm të shtyllës së dytë sipas kriterëve para miratimit të ndryshimeve në ligj (të siguruarit që janë punësuar për herë të parë pas datës 1 janar 2003), por të cilët deri në ditën e fillimit të zbatimit të ligjit FSPIM nuk i ka shpërndarë në fondet e detyrueshme pensionale, FSPIM është i detyruar që gjatë shpërndarjes së tyre në fondet e detyrueshëm pensionale, përveç transferimit të kontributeve për ata persona të siguruar për periudhën nga data e pagesës së kontributit në sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital deri në ditën e shpërndarjes së tyre, të paguajë kompensim për transferim jo në kohë të kontributeve.

Mjetet për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital, të realizuara në bazë të pagesës së jo në kohë dhe të paplotë të kontributit, transferohen në llogarinë individuale të anëtarit të fondit të detyrueshëm pensional.

Pasqyrë skematike të arkëtimit dhe shpërndarja e kontributeve:



5.5. KATEGORITË E TË SIGURUARVE PËR TË CILAT ËSHTË PËRCAKTUAR PËRJASHTIMI NGA PAGESA E KONTRIBUTEVE NGA SIGURIMI I DETYRUESHËM SOCIAL

5.5.1. Kategoria e parë e të siguarve për të cilat është përcaktuar përjashtim

Në pajtim me ndryshimet e Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 44 nga 05.03.2014) të siguarit deri në moshën 29 vjeçare të cilat janë në marrëdhënie pune ose të vetëpunësuar me orar të plotë dhe për të cilat është përcaktuar përjashtim nga pagesa e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social në periudhë deri në 12 muaj në pajtim me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë, nuk janë anëtarë të detyrueshëm në shtyllën e dytë për atë periudhë. Pas skadimit të periudhës së përjashtimit nga pagesa e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm dhe social këto të siguar bëhen anëtarë të detyrueshëm në shtyllën e dytë.

Koha të cilën të siguarit deri në moshën 29 vjeçare e kanë kaluar në marrëdhënie pune ose janë vetëpunësuar me orar të plotë pune, për të cilat është përcaktuar përjashtim nga pagesa e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social në periudhë deri në 12 muaj në pajtim me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë, llogaritet në stazhin e sigurimit.

Këto ndryshime të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor zbatohen dy vjet nga dita e hyrjes në fuqi.

5.5.2. Kategoria e dytë e të siguarve për të cilat është përcaktuar përjashtimi

Në pajtim me ndryshimet e Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 61 nga 17.04.2015), kategoritë e caktuara të të siguarve për të cilat është përcaktuar përjashtim nga pagesa e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social në pajtim me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë në periudha të caktuara përkatëse, nuk janë anëtarë të detyrueshme në shtyllën e dytë për periudhën e caktuar përkatëse. Pas skadimit të periudhës së përjashtimit nga pagesa e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm dhe social këto të siguaruar bëhen anëtar të detyrueshëm në shtyllën e dytë.

Periudhat e përjashtimit të përcaktuar dhe kategoritë e të siguarve janë në vijim:

- deri në 36 muaj, nëse i siguaruari është në moshë deri 35 vjet;
- deri 60 muaj, nëse i siguaruari është në moshë nga 35 vjet deri në 50 vjet;
- deri 60 muaj, nëse i siguaruari është në moshë mbi 50 vjet;
- deri në 60 muaj për të siguaruarit të cilët janë prindër të tre ose më shumë fëmijëve, prin i vetëm dhe anëtar i familjes me një prind, marrës të ndihmës sociale në para, fëmijë pa prindër dhe kujdes prindëror, viktima të dhunës familjare, person me invaliditet me invaliditet të përcaktuar në pajtim me Ligjin për punësim të personave me invaliditet dhe personave me aftësi të zvogëluar të përcaktuar të punës ose pa aftësi profesionale për punë për 50% në pajtim me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor, ushtarë profesionalë të cilëve u është ndërprerë marrëdhënie pune në pajtim me Ligjin për shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë dhe prindërve të fëmijëve me pengesa në zhvillim shfrytëzues të shtesës së veçantë dhe
- deri në përmbushjen e kushteve për pension të pleqërisë të përcaktuara me ligj, nëse i siguaruari është në moshë mbi 58 vjet.

Koha të cilën këto kategori të të siguarve e kanë kaluar në marrëdhënie pune ose kanë qenë të vetëpunësuar me orar të plotë pune, për të cilat është përcaktuar përjashtimi i periudhës së caktuar përkatëse, llogaritet në stazhin e sigurimit.

Këto ndryshime të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor zbatohen për periudhën për të cilën është përcaktuar përjashtim nga pagesa e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social në pajtim me Ligjin për plotësim të Ligjit për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 56/15).

5.5.3. Kategoria e tretë e të siguarve për të cilat është përcaktuar përjashtimi

Në pajtim me ndryshimet e Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 154 nga 04.09.2015), personi i cili do të punësohet si zëvendës për punëtorin i cili përdor pushim të lindjes dhe për të cilin person është përcaktuar përjashtim nga pagesa e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social në pajtim me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë për periudhën derisa zgjat pushimi i lindjes, nuk është anëtar i

detyrueshëm në shtyllën e dytë për periudhën përderisa zgjat pushimi i lindjes. Pas skadimit të periudhës së përjashtimit nga pagesa e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm dhe social ky i siguruar bëhet anëtar i detyrueshëm në shtyllën e dytë.

Koha të cilën e ka kaluar ky i siguruar në marrëdhënie pune ose ka qenë i vetëpunësuar si zëvendësim për punëtorin i cili përdor pushim të lindjes nga puna për periudhën derisa zgjat pushimi i lindjes, për të cilën është përcaktuar përjashtim nga pagesa e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social, llogaritet në stazhin e sigurimit.

6. SKEMAT PENSIONALE PROFESIONALE

Zakonisht praktika në shumë vende evropiane është ekzistimi i skemave pensionale profesionale, përmes të cilave punëdhënësit ose shoqatat e qytetarëve organizojnë dhe financojnë sigurim plotësues pensional për të gjitha të punësuarit përkatësisht anëtarët. Kjo është në pajtim me rrjedhat dhe direktivat evropiane. Gjegjësisht, meqë sistemet evropiane për sigurim social janë nën presion, i cili vazhdimisht rritet, pensionet profesionale në të ardhmen gjithnjë e më shumë do të kenë rol të plotësimit të të ardhurave pas pensionimit. Prandaj duhet të zhvillohen pensionet profesionale, sigurimi social plotësues me qëllim të sigurimit të sigurt, të përherëshëm dhe efikas, i cili duhet të garantojë standard të denjë jetësor në pleqëri.

Me sigurimin pensional vullnetar në Republikën e Maqedonisë së Veriut vendoset korniza ligjore për organizim të skemave pensionale profesionale.

6.1. Praktika e zakonshme në shumë vende evropiane është ekzistimi i skemave pensionale profesionale në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Duke pasur se investimi i mjeteve të fondeve pensionale është në fazë të hershme të praktikimit, si dhe për shkak të sigurimit të vëllimit më të madh të mjeteve në një fond, parashihet në fazën fillestare të ekzistimit të sigurimit vullnetar pensional me financim kapital, organizimin e skemave profesionale punëdhënësit ta realizojnë përmes shoqërive të specializuara për menaxhim me fonde pensionale.

Punëdhënësi ose shoqata e qytetarëve (përkatësisht siguruasi) mund të organizojë dhe financojë vetëm një skemë pensionale profesionale, dhe atë vetëm për të punësuarit ose anëtarët e tyre. Më shumë punëdhënës ose më shumë shoqata të qytetarëve mund të organizojnë dhe financojnë bashkërisht skema pensionale profesionale. Siguruasi nënshkruan marrëveshje me shoqërinë të cilën e ka zgjedhur të menaxhojnë me fondin pensional vullnetar në të cilin do të përfshihet skema pensionale profesionale. Ndërkaq, siguruasi është i detyruar që zgjedhjen e fondit vullnetar pensional ta bëjë në interes më të mirë të të punësuarve dhe anëtarëve të tij. Siguruasi miraton edhe rregulla për skemën pensionale profesionale. Siguruasi mund ta anulojë skemën pensionale profesionale, t'i ndryshojë rregullat e skemës pensionale profesionale ose ta ndryshojë fondin vullnetar pensional ku është përfshirë skema pensionale profesionale.

Siguruasi mund të caktojë se cilat të punësuar ose anëtar mund të marrin pjesë në skemën pensionale profesionale të cilën ai e organizon dhe e financon dhe ka të drejtë ta caktojë lirisht lartësinë e shumës së paguar dhe frekuencës së pagesës për çdo pjesëmarrës në veçanti. Siguruasi i paguan të gjitha kontributet për çdo pjesëmarrës në skemën pensionale profesionale të cilën ai e

organizon dhe e financon. Gjithashtu, siguruesi është i detyruar që t'i paguajë nga mjetet personale kompensimet nga kontributet dhe kompensimet për transferim për anëtarët e fondit pensional të cilët marrin pjesë në skemën e tij pensionale profesionale.

Çdo pjesëmarrës në skemën pensionale profesionale nënshkruan deklaratë për pëlqim për pjesëmarrje në skemën pensionale profesionale dhe ia dorëzon siguruesit. Personat që bëhen anëtarë të fondit vullnetar pensional në bazë të skemës pensionale profesionale marrin vërtetim për anëtarësim nga shoqëria në afat prej 30 ditësh nga anëtarësimi dhe nuk lidhin marrëveshje me shoqërinë që menaxhon me fondin vullnetar pensional. Agjencia e përcakton formën e standardizuar të deklaratës për pëlqim për pjesëmarrje në skemën pensionale profesionale dhe vërtetimit për anëtarësi. Anëtari në fondin vullnetar pensional në bazë të marrëveshjes për anëtarësi të lidhur me shoqërinë, përveç të drejtës për të paguar kontribut.

Ndryshimi i lartësisë dhe frekuencës së pagesës së kontributeve nga ana e siguruesit nuk ndikon në të drejtën e anëtarësisë në fondin.

Pjesëmarrja në skemën pensionale profesionale ndërpritet me:

- a) Ndërprerjen e marrëdhënies së punës ose anëtarësimin në shoqatën e qytetarëve dhe transferimin e mjeteve nga llogaria profesionale ekzistuese në llogari tjetër profesionale ose llogari tjetër individuale vullnetare, në pajtim me ligjin;
- b) Ndërprerjen e marrëdhënies së punës ose anëtarësisë në shoqatën e qytetarëve dhe vdekjen e anëtarit;
- c) Anulimin e skemës pensionale profesionale dhe transferimin e mjeteve nga llogaria profesionale ekzistuese në llogari tjetër profesionale ose llogari vullnetare individuale në pajtim me ligjin;
- ç) Anulimin e skemës pensionale profesionale dhe arritjen e pensionit të pleqërisë ose invalidor;
- d) Anulimin e skemës pensionale profesionale dhe vdekjen e anëtarit.

Ndërkaq, veçanërisht është e rëndësishme të theksohet e drejta e pronësisë dhe transferimit të mjeteve të anëtarëve të skemës pensionale profesionale. Gjegjësisht, mjetet e pjesëmarrësit të skemës pensionale profesionale, të cilit i është ndërprerë marrëdhënia e punës te punëdhënësi ose anëtarësia në shoqatën e qytetarëve (përkatësisht siguruesi) transferohen nga llogaria profesionale ekzistuese në llogarinë e re profesionale nga skema pensionale profesionale të organizuar nga sigurues tjetër ku personi bëhet pjesëmarrës. Nëse pas skadimit të 90 ditëve nga ndërprerja e marrëdhënies së punës ose anëtarësisë në shoqatën e qytetarëve, personi nuk bëhet pjesëmarrës i skemës pensionale profesionale te sigurues tjetër, mjetet nga llogaria e tij profesionale ekzistuese transferohen në llogarinë e tij vullnetare individuale në fondin vullnetar pensional (nëse personi ka). Nëse personi nuk ka llogari vullnetare individuale, shoqëria pensionale e cila e mban llogarinë profesionale ekzistuese do të kërkojë informatë nga Agjencia nëse anëtari ka llogari vullnetare individuale në fond tjetër vullnetar pensional dhe nëse ka i transferon mjetet nga llogaria profesionale ekzistuese në atë llogari vullnetare individuale. Nëse shoqëria pensionale merr informatë nga Agjencia se anëtari nuk ka llogari vullnetare individuale kjo i hap llogari vullnetare individuale në fondin vullnetar pensional me të cilin menaxhon dhe i transferon mjetet nga llogaria profesionale ekzistuese në llogarinë vullnetare individuale. Njëkohësisht shoqëria pensionale i dorëzon vërtetim për anëtarësim. Rregullat e njëjta për transferim të mjeteve të pjesëmarrësit të skemës pensionale profesionale vlejnë nëse siguruesi anulon skemën pensionale profesionale.

6.2. Anëtarësimi tejkuftitar

Me Ligjin për sigurim pensional me financim kapital mundësohet edhe anëtarësimi tejkuftitar me çka do të mundësohet zbatimi i parimit të qarkullimit të lirë të punëtorëve dhe kapitalit në kuadër të vendeve të BE-së. Kjo është në pajtim me direktivat e Bashkimit Evropian, duke pasur parasysh aspiratat e Republikës së Maqedonisë së Veriut për anëtarësim të plotfuqishëm në BE. Këto dispozita të ligjit do të fillojë të zbatohen nga dita e anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian.

Gjegjësisht, ligji jep mundësi që siguruesi me selinë në vendin anëtar të BE-së të organizojë dhe financojë skemë pensionale profesionale në fondet vullnetare pensionale në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Shoqëria që menaxhon me fondin vullnetar pensional në të cilin është përfshirë skema do ta njoftojë Agjencinë, në pajtim me procedurën e caktuar se dëshiron të pranojë dhe organizojë skemë pensionale profesionale për sigurues me seli në BE. Agjencia do të hyjë në kontakt me autoritetet përkatëse të vendit anëtar të BE-së ku është regjistruar siguruesi dhe prej ku propozohet themelimi dhe organizimi i skemës pensionale profesionale.

Njëkohësisht, jepet mundësi edhe për siguruesin me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut të organizojë dhe financojë skemë pensionale profesionale e cila do të menaxhohet nga shoqëria e autorizuar për menaxhim me skema pensionale në vende anëtare të BE-së.

7. ANËTARËSIMI NË FONDE VULLNETARE PENSIONALE DHE PAGESA E KONTRIBUTEVE VULLNETARE

7.1. ANËTARËSIMI NË FONDET VULLNETARE PENSIONALE

Anëtar i fondit vullnetar pensional mund të jetë çdo person i cili ka mbushur 15 vjet dhe është edhe pronar i llogarisë individuale vullnetare ose çdo person i cili është pjesëmarrës në skemën pensionale profesionale dhe është pronar i llogarisë profesionale. Anëtari mund të paguajë kontribut vullnetar vetë për vete, ose në emër të tij për llogarinë e tij të paguajë kontribut vullnetar personi i tretë (a.q. pagues) ose për të të paguajë siguruesi përkatësisht financuesi i skemës pensionale profesionale.

Personi bëhet anëtar i fondit pensional vullnetar:

- me nënshkrimin e marrëveshjes për anëtarësim në fondin vullnetar pensional ndërmjet personit dhe shoqërisë dhe me hapjen e llogarisë individuale vullnetare
- me nënshkrimin e marrëveshjes për anëtarësim në fondin pensional vullnetar ndërmjet personit, paguesit dhe shoqërisë dhe me hapjen e llogarisë individuale vullnetare ose
- me pjesëmarrjen e skemës pensionale profesionale dhe hapjen e llogarisë profesionale.

Shoqëria hap llogari individuale vullnetare ose llogari profesionale të anëtarit, menjëherë pas pagesës së parë të kontributit.

Një person mund të ketë vetëm një llogari individuale vullnetare dhe një llogari profesionale. Këto llogari të jenë në fond të njëjtë ose të ndryshëm vullnetar pensional.

Shoqëria nuk mund të refuzojë anëtarësim të të siguarit në fondin vullnetar pensional me të cilin menaxhon, përveç në rast kur ai person ka më pak se 15 vite ose më shumë se 70 vite.

Shembull 1

- *Petari ka 30 vjet dhe është i punësuar për herë të parë më 1 mars 2012*
- *Petari ka mundësi të zgjedhë nëse do të anëtarësohet në sigurimin vullnetar pensional me financim kapital dhe në të cilin fond pensional vullnetar do t'i paguajë kontributet e tij vullnetare.*
- *Zgjedhjen e tij, Petari mund ta bëjë në periudhën e pakufizuar pas datës së fillimit të marketingut për sigurimin pensional vullnetar me financim kapital*
- *Petari duhet të nënshkruajë marrëveshje për anëtarësim në fondin vullnetar pensional të cilin e ka zgjedhur, të paguajë kontribut vullnetar, me ç'rast do t'i hapet llogari individuale vullnetare dhe me atë Petari formalisht bëhet anëtar.*

Shembulli 2

- *Ana ka 28 vjet. Ajo është bashkëshortja e Petarit dhe nuk është e punësuar*
- *Ana ka mundësi të zgjedhë nëse do të anëtarësohet në sigurimin pensional vullnetar me financim kapital dhe në të cilin fond vullnetar pensional do t'i marrë pagesat e kontributeve vullnetare*
- *Zgjedhjen e saj, Ana mund ta bëjë në periudhën e pakufizuar pas datës në fillim të marketingut për sigurim pensional vullnetar me financim kapital*
- *Ana dhe Petari duhet të nënshkruajnë marrëveshje për anëtarësim në fondin pensional vullnetar të cilin e kanë zgjedhur, ku Ana do të jetë anëtare, ndërsa Petari pagues. Petari duhet të paguajë kontribut vullnetar, me ç'rast do t'i hapet llogari individuale vullnetare Anës dhe me atë formalisht bëhet anëtare.*

Shembulli 3

- *Petari është i punësuar për herë të parë më 1 mars 2012*
- *Punëdhënësi i tij zgjidh të organizojë skemë pensionale profesionale në të cilën e përfshin edhe Petarin.*
- *Petari merr vërtetim për anëtarësim nga shoqëria. Punëdhënësi i tij duhet të paguajë kontribut vullnetar, me ç'rast do t'i hapet llogari profesionale Petarit dhe me atë Petari formalisht bëhet anëtar.*

7.2. MËNYRA DHE PROCEDURA PËR ANËTARËSIM NË FONDIN VULLNETAR PENSIONAL

7.2.1. Mënyra e anëtarësimit në fondin pensional vullnetar me nënshkrimin e marrëveshjes për anëtarësim në fondin pensional vullnetar

Një prej mënyrave për anëtarësim në fondin pensional vullnetar është me nënshkrimin marrëveshjes për anëtarësim në fondin pensional vullnetar dhe pagesën e kontributit vullnetar.

Marrëveshja për anëtarësim në fondin pensional vullnetar duhet të plotësohet dhe nënshkruhet në formë të përcaktuar nga Agjencia. Shoqëria cakton numër të vetëm të marrëveshjes për anëtarësim, i cili përbëhet nga dhjetë shifra. Për çdo fond pensional, Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional i cakton dy shifrat e para, me të cilat identifikohet fondi pensional dhe ato detyrimisht

janë pjesë përbërëse e çdo numri të ndarë nga shoqëria. Marrëveshja për anëtarësim mund të ndryshohet me aneks vetëm nëse ndodh përfshirje, ndryshim ose përjashtim të personit fizik – pagues të marrëveshjes.

Gjatë lidhjes së marrëveshjes për anëtarësim, shoqërinë e përfaqëson agjent i cili është regjistruar në Regjistrin e agjentëve. Agjenti duhet ta kontrollojë identitetin e personave që e lidhin marrëveshjen për anëtarësim në bazë të dokumentit për identifikim personal. Marrëveshja për anëtarësim duhet të nënshkruhet personalisht nga anëtari dhe agjenti në emër të shoqërisë, e nëse paguesi paguan kontribut në emër dhe për llogari të anëtarit atëherë marrëveshja për anëtarësim duhet të nënshkruhet edhe nga paguesi. Marrëveshja për anëtarësim duhet ta përmbajë datën dhe kohën (ora dhe minuta) kur është nënshkruar nga të dyja përkatësisht nga të tre palët. Marrëveshja për anëtarësim nënshkruhet në tre ekzemplarë origjinalë dhe agjenti pas nënshkrimit të marrëveshjes menjëherë duhet t'i sigurojë një ekzemplar shoqërisë dhe një ekzemplar anëtarit i cili e ka nënshkruar marrëveshjen për anëtarësim, e në rast se paguesi paguan kontribut atëherë marrëveshja nënshkruhet edhe nga ana e atij personi dhe agjenti pas nënshkrimit të marrëveshjes menjëherë duhet të sigurojë një ekzemplar edhe për paguesin. Para nënshkrimit të marrëveshjes për anëtarësim, shoqëria i siguron anëtarit qasje në prospektin informativ dhe statutin e fondit pensional vullnetar.

Në rast se një person lidh marrëveshje për anëtarësim me dy ose më shumë shoqëri për menaxhim me fonde vullnetare pensionale ose me dy ose më shumë shoqëri për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale, e vlefshme do të llogaritet marrëveshja për anëtarësim në bazë të së cilës është kryer pagesa e parë e kontributit.

Anëtari ose paguesi mund të vendosë në mënyrë të njëanshme që paguesi të ndërpresë së paguari mjete në llogarinë individuale vullnetare. Në atë rast shoqëria dhe anëtari nënshkruajnë aneks të marrëveshjes për anëtarësim, me ç'rast anëtari do të mund të vazhdojë vetë dhe/ose personi tjetër të paguajë kontribut vullnetar në llogarinë e njëjtë individuale vullnetare.

Anëtari ose paguesi të lidhë marrëveshje për anëtarësim me dy ose më shumë shoqëri për menaxhim me fonde pensionale vullnetare ose me dy ose më shumë shoqëri për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale, e vlefshme do të llogaritet marrëveshja për anëtarësim në bazë të së cilës është kryer pagesa e kontributit.

Anëtari ose paguesi mund të vendosë në mënyrë të njëanshme që paguesi të ndërpresë të paguajë mjete në llogarinë individuale vullnetare. Në atë rast shoqëria dhe anëtari nënshkruajnë aneks të marrëveshjes për anëtarësim, me ç'rast anëtari do të mund të vazhdojë vetë ose/dhe person tjetër të paguajë kontribut vullnetar në llogarinë e njëjtë individuale vullnetare.

Shoqëria mund t'i mundësojë të siguarit që të lidhë marrëveshje për anëtarësim në fondin pensional vullnetar edhe përmes platformës elektronike për komunikim dykahësh me përdorimin e autentifikimit të dyfishtë. Procesi për lidhje digjitale të marrëveshjes për anëtarësim në fondin vullnetar pensional është dhënë në shtojcë të këtij Programi, si pjesë përbërëse e Rregullores për anëtarësim në fondin vullnetar pensional. Procedura për anëtarësim në fondin pensional vullnetar. Procedurën për lidhje digjitale të marrëveshjes për anëtarësim në fondin vullnetar pensional, shoqëria e zbaton në pajtim me procedurat dhe rregullat për mbrojtje të të dhënave personale.

Agjenti duhet të ketë parasysh se me Ligjin për parandalim të larjes së parave dhe të ardhurave tjera nga vepra ndëshkimore dhe financimit të terrorizmit përcaktohen masat dhe veprimet për zbulim dhe parandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit të parapara me këtë ligj përfshihen edhe institucionet financiare dhe personat zyrtarë dhe përgjegjës në to. Në pajtim me të lartpërmendurën, agjenti është i detyruar që ta informojë shoqërinë nëse anëtari ka refuzuar të identifikohet ose ka dhënë të

dhëna të rrejshme, nëse ndonjë person dëshiron të lidhë marrëveshje për anëtarësim në emër të personit tjetër, nëse anëtari sillet në mënyrë të pazakonshme dhe refuzon të identifikohet gjatë lidhjes së marrëveshjes; nëse personi i tretë lidh marrëveshje për anëtarësim me më shumë persona përnjëherë me qëllim të paguajë në emër të tyre dhe gjatë lidhjes së marrëveshjes me person fizik nga jashtë vendi.

7.2.2. Mënyra e anëtarësimit në fondin vullnetar pensional me pjesëmarrje në skemën pensionale profesionale

Krahas të lartpërmendurës, mënyrë tjetër e anëtarësimit në fondin vullnetar pensional është përmes pjesëmarrjes në skemën pensionale profesionale.

Punëdhënësi ose shoqata e qytetarëve (përkatësisht, siguruesi) mund të organizojë dhe financojë skemë pensionale profesionale dhe të paguajë kontribut në fondin vullnetar pensional për të punësuarit dhe anëtarët e tij. Siguruesi ka të drejtë ta caktojë lirisht lartësinë e shumës së paguar dhe frekuencën e pagesës për çdo pjesëmarrës në veçanti, ndërsa ndryshimi i lartësisë dhe frekuenca e pagesës nuk ndikojnë në të drejtën e anëtarësisë në fondin. Çdo pjesëmarrës në skemën pensionale profesionale nënshkruan deklaratë për pëlqim për pjesëmarrje në skemën pensionale profesionale në formë të përcaktuar nga Agjencia dhe ia dorëzon siguruesit. Siguruesi nënshkruan marrëveshje me nënshkruarësin e autorizuar të shoqërisë që menaxhon me fonde vullnetare pensionale në të cilin të përfshihet skema, në shtojcë të së cilës jep listë të pjesëmarrësve në skemën.

Pjesëmarrësit në skemën pensionale profesionale nuk nënshkruajnë marrëveshje për anëtarësim por nga shoqëria marrin vërtetim për anëtarësim në formë të përcaktuar nga Agjencia. Shoqëria cakton numër të vetëm të vërtetimit për anëtarësim në fondin vullnetar pensional, që përbëhet nga dhjetë shifra. Për çdo fond pensional Agjencia i cakton dy shifrat e para, me të cilat identifikohet fondi pensional dhe ato detyrimisht janë pjesë përbërëse të çdo numri të ndarë nga shoqëria.

Nëse anëtari i fondit pensional është pjesëmarrës në dy skema profesionale pensionale, shoqëritë që menaxhojnë me fonde pensionale në të cilat janë përfshirë skema pensionale profesionale në afat prej 30 ditësh nga njoftimi i Agjencisë e njoftojnë anëtarin, se duhet të zgjedhë një prej skemave pensionale profesionale. Pasi anëtari të bëjë zgjedhje të fondit pensional në të cilin do të jetë anëtar, i ndërpritet anëtarësia në fondin pensional të cilin anëtari nuk e ka zgjedhur. Nëse anëtari në afat prej 90 ditësh nga njoftimi i Agjencisë nuk zgjedh fond pensional në të cilin do të jetë anëtar, e vlefshme do të konsiderohet anëtarësia ku është bërë pagesa e parë e kontributit.

7.2.3. Procedura për transferim nga një në tjetër fond vullnetar pensional të anëtarit i cili ka lidhur marrëveshje për anëtarësim

Anëtar i fondit vullnetar pensional mund të kalojë nga fondi ekzistues vullnetar pensional në fond tjetër vullnetar pensional, duke lidhur marrëveshje të re anëtarësimi me shoqërinë e ardhshme, duke nënshkruar formular pëlqimi për transferim dhe duke i transferuar mjetet nga llogaria individuale vullnetare e shoqërisë ekzistuese në llogarinë individuale vullnetare të shoqërisë së ardhshme.

Shoqëria që menaxhon fondin e ardhshëm vullnetar pensional ia dorëzon shoqërisë ekzistuese formularin e pëlqimit për transferim të përcaktuar nga Agjencia, brenda tetë ditëve pune pas nënshkrimit të marrëveshjes.

Shoqëria ekzistuese mund të refuzojë të bëjë transfer të shumës në llogarinë e anëtarit në fondin e ardhshëm vullnetar pensional në rast kur:

- personi për të cilin kërkohet transferim në fondin e ardhshëm pensional nuk është anëtar i fondit ekzistues pensional dhe
- nëse në shoqërinë ekzistuese kanë arritur më shumë se një kërkesë për transferim nga i njëjti person.

Shoqëria ekzistuese, pas marrjes së formularit për pëlqim për transferim, i dërgon njoftim me shkrim shoqërisë së ardhshme me informacion nëse transferimi pranohet apo refuzohet me arsyetim si dhe informacion mbi shumën e kompensimit për transferim. Këtë njoftim shoqëria ekzistuese e dërgon në datën 18 të muajit për të gjitha marrëveshjet e arritura për transferim në periudhën nga data 16 e muajit paraprak deri në datën 15 të muajit aktual. Pas marrjes së këtij njoftimi, shoqëria e ardhshme njofton menjëherë anëtarin për detyrimin për të paguar kompensimin e transferimit.

Brenda tetë ditëve nga marrja e njoftimit, anëtari është i detyruar të paguajë kompensimin e transferimit të përcaktuar nga shoqëria ekzistuese dhe shoqërisë ekzistuese i dorëzon dëshmi për kompensim të paguar me çka vërteton se pajtohet për të kaluar në fondin e ardhshëm pensional. Shoqëria që menaxhon me fondin ekzistues vullnetar pensional transferon shumën e llogarisë së anëtarit dhe të dhënat përkatëse në fondin e ardhshëm vullnetar pensional në datën e ardhshme të transferimit.

Anëtarësimi në fondin e ardhshëm vullnetar pensional fillon nga data e transferimit të mjeteve në llogarinë e anëtarit në fondin e ardhshëm pensional.

7.2.4. Procedura e transferimit të anëtarit i cili është pjesëmarrës në skemën pensionale profesionale

Nëse një pjesëmarrës në skemë pensionale profesionale punësohet te tjetër punëdhënës ose anëtarësohet në shoqatë tjetër, përkatësisht kalon te sigurues tjetër dhe organizon skemë pensionale profesionale dhe bëhet pjesëmarrës në atë skemë, atëherë mjetet nga llogaria ekzistuese profesionale do të transferohen në llogarinë profesionale në skemën pensionale profesionale të organizuar nga siguruesi tjetër. Pjesëmarrësi në skemën pensionale profesionale mund të bëhet anëtar i skemës tjetër pensionale profesionale kur siguruesi i ri do të kryejë pagesë të kontributit vullnetar në llogarinë profesionale.

Nëse një pjesëmarrës në skemën pensionale profesionale i ndërpritet marrëdhënie e punës te punëdhënësi ose anëtarësimi në shoqatën e qytetarëve, që organizon skemë pensionale profesionale, mjetet nga llogaria e tij profesionale transferohen në llogarinë e tij individuale vullnetare kur:

- anëtari punësohet nga punëdhënës ose anëtarësohet në shoqatën qytetare që nuk organizon skemë pensionale profesionale,
- punësohet te punëdhënësi ose anëtarësohet në shoqatë qytetarësh që organizon skemë pensionale profesionale, por nuk është pjesëmarrës në skemë ose
- nuk punësohet ose anëtarësohet në shoqatë qytetarësh.

Ky transferim i mjeteve nga llogaria profesionale në llogari individuale vullnetare kryhet pas 90 ditësh nga përfundimi i marrëdhënies së punës ose anëtarësimit në shoqatë. Nëse anëtari ka llogari individuale vullnetare në të njëjtin fond pensional, mjetet transferohen në atë llogari. Nëse pjesëmarrësi nuk ka llogari individuale vullnetare në të njëjtin fond pensional, shoqëria pensionale që menaxhon llogarinë profesionale do të kërkojë informacion nga Agjencia nëse anëtari ka llogari individuale vullnetare në fond tjetër pensional vullnetar dhe, nëse po, i transferon mjetet nga llogaria profesionale në atë llogari individuale vullnetare. Nëse shoqëria merr informacion nga Agjencia se anëtari nuk ka llogari individuale vullnetare në asnjë fond vullnetar pensional, atëherë shoqëria hap llogari individuale vullnetare për anëtarin në fondin që e menaxhon, i transferon mjetet në atë llogari dhe i dorëzon vërtetim për anëtarësim në fond pensional vullnetar në formën e përcaktuar nga Agjencia. Në rast se pjesëmarrësi është anëtar i pensionuar, shoqëria i ruan mjetet në llogarinë profesionale.

Kur siguruesi do të anulohet skemë pensionale profesionale, mjetet nga llogaria profesionale e një anëtari dhe pjesëmarrësi në skemë transferohen në llogarinë e tij profesionale të ardhshme nga një skemë pensionale profesionale e organizuar nga i njëjti ose një sigurues tjetër. Nëse, pas skadimit të 90 ditëve nga dita e përfundimit të skemës pensionale profesionale, pjesëmarrësi ekzistues nuk bëhet pjesëmarrës i një skeme tjetër pensionale profesionale, mjetet nga llogaria e tij profesionale kalojnë në llogarinë e tij individuale vullnetare nëse ekziston në fondine njëjtë. Nëse pjesëmarrësi nuk ka llogari individuale vullnetare në të njëjtin fond pensional, shoqëria pensionale që menaxhon llogarinë profesionale do të kërkojë informacion nga Agjencia nëse anëtari ka llogari individuale vullnetare në një fond tjetër vullnetar pensional dhe, nëse po, mjetet nga llogaria profesionale i transferon në llogarinë individuale vullnetare. Nëse shoqëria merr informacion nga Agjencia se anëtari nuk ka llogari individuale vullnetare në asnjë fond vullnetar pensional, ajo hap llogari individuale vullnetare për të në fondin vullnetar pensional që e menaxhon, i transferon mjetet nga llogaria profesionale në llogarinë individuale vullnetare dhe i dorëzon vërtetim për anëtarësinë në fondin vullnetar pensional në formën e përcaktuar nga Agjencia. Në rast se pjesëmarrësi është anëtar i pensionuar, shoqëria i ruan mjetet llogarinë profesionale.

7.2.5. Mënyra e evidentimit të anëtarëve të fondit vullnetar pensional

Shoqëritë që menaxhojnë me fondet vullnetare pensionale mbajnë evidencë për marrëveshjet e lidhura për anëtarësi, vërtetimet e lëshuara për anëtarësim dhe evidencën e anëtarëve që janë pronarë të llogarive individuale vullnetare dhe llogarive profesionale.

Shoqëria hap llogari individuale vullnetare pas pagesës së parë të kontributit vullnetar për çdo person që ka nënshkruar marrëveshje anëtarësimi në fondin pensional vullnetar. Shoqëria hap llogari profesionale pas pagesës së parë të kontributit vullnetar për çdo person që ka nënshkruar deklaratë për pëlqim për pjesëmarrje në skemë pensionale profesionale të organizuar dhe financuar nga punëdhënës ose shoqatë qytetare, shoqëria hap llogari vullnetare dhe/ose profesionale në rast të transferimit të anëtarit nga një fond vullnetar pensional në tjetrin pas transferimit të mjeteve nga fondi vullnetar pensional ekzistues në atë të ardhshëm.

Shoqëria e mbyll llogarinë individuale vullnetare të anëtarit dhe anëtarit të pensionuar në rast të:

- a) pagesës së shumës totale në llogarinë e tij, një herë ose disa herë;
- b) blerjes së anuitetit pensional që paguhet deri në fund të jetës nga shoqëri sigurimi e autorizuar për këtë qëllim;
- c) tërheqjet e programuara të siguruara nga shoqëri tjetër me të cilën anëtari ka lidhur një marrëveshje për tërheqje të programuara pas pensionimit;
- ç) pagesës së të gjitha mjeteve nga llogaria individuale vullnetare nëpërmjet tërheqjeve të programuara ose nëpërmjet pagesave të shumëhershme;
- d) pagesës së të gjitha mjeteve nga llogaria individuale vullnetare për shkak të kombinimit të opsioneve të përcaktuara në pikat a), b), c) ose ç);
- dh) transferimi i anëtarit dhe anëtarit të pensionuar nga një fond në fond tjetër vullnetar pensional;
- e) pagesës së njëhershme të të gjitha mjeteve në rast të paaftësisë së përgjithshme të konstatuar nga Komisioni për Vlerësimin e Aftësisë për Punë i Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut;
- ë) pagesës së njëhershme të të gjitha mjeteve nga llogaria individuale vullnetare për trashëgimtarin/trashëgimtarët në pajtim me Ligjin për trashëgimi në rast të vdekjes së anëtarit ose anëtarit të pensionuar dhe

f) kthimit të mjeteve të paguara anëtarit ose personit që paguan mjete në emër dhe për llogari të anëtarit në rast të zgjidhjes së kontratës sipas Rregullores për mënyrën e anëtarësimit në fond pensional vullnetar.

Shoqëria e mbyll llogarinë profesionale në rast të:

- a) pagesës së shumës totale në llogarinë e tij, në mënyrë të njehershme ose të shumëhershme;
- b) blerjes së anuitetit pensional që do të paguhet deri në fund të jetës nga shoqëria e sigurimit të autorizuar për këtë qëllim;
- c) tërheqjes së programuara të siguruar nga shoqëri tjetër me të cilën anëtari ka lidhur një marrëveshje për tërheqje të programuara pas daljes në pension;
- ç) pagesës së të gjitha mjeteve nga llogaria profesionale nëpërmjet tërheqjeve të programuara;
- d) pagesë së të gjitha mjeteve nga llogaria profesionale për shkak të kombinimit të opsioneve të cekura në pikat a), b) c) ose ç)
- dh) transferimit të anëtarit dhe anëtarit të pensionuar në fond tjetër vullnetar pensional;
- e) pagesë së njehershme të të gjitha mjeteve në rast të konstatimit të paaftësisë së përgjithshme për punë nga Komisioni për Vlerësimin e Aftësisë për Punë i Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut dhe
- ë) pagesës së njehershme të të gjitha mjeteve nga llogaria individuale vullnetare për trashëgimtarin/trashëgimtarët në pajtim me Ligjin për trashëgimi në rast vdekjeje të anëtarit ose anëtarit të pensionuar.

Më së voni deri në datën e tretë të muajit, shoqëritë dorëzojnë në Agjenci listë me të dhënat për ndryshime në anëtarësinë për muajin paraparak. Nëse tre ditët e para të muajit janë ditë jopune, shoqëritë e dorëzojnë listën në ditën e parë të punës gjatë muajit. Nëse gjatë kontrollit të këtyre të dhënave, Agjencia konstaton se ka mospërputhje të të dhënave, do t'i detyrojë shoqëritë që në afat prej dy ditësh , por jo më vonë se data e pestë e muajit, të bëjë korrigjim dhe t'i dorëzojë të dhënat e korrigjuara.

Shoqëria e kontrollon saktësinë e të dhënave të anëtarëve përpara se t'i vendosë ato në evidencën e saj. Shoqëria është e detyruar të sigurojë fshehtësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale të anëtarëve në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

7.2.6. Përditësimi i të dhënave në Regjistrin e anëtarëve dhe korrigjimi i marrëveshjes për anëtarësim

Shoqëria mund të korrigjojë të dhëna personale të një anëtari në marrëveshjen origjinale të anëtarësimit me kërkesë të anëtarit. Ndërkaq, shoqëria kryen kontroll të drejtpërdrejtë të letërnjoftimit/dokumentit për identifikim personal të anëtarit përmes personit të autorizuar nga organi kompetent i shoqërisë ose agjentit dhe e verifikon kontrollin me nënshkrim. Gjithashtu, data e lidhjes së marrëveshjes origjinale të anëtarësimit korrigjohet vetëm nëse ajo është e shkruar në mënyrë të palexueshme, bazuar në deklaratën e anëtarit dhe agjentit që ka nënshkruar marrëveshjen.

Kompania mund të përditësojë ose korrigjojë të dhënat personale të anëtarit në evidencën e anëtarëve që janë pronarë të llogarive individuale vullnetare dhe/ose llogarive profesionale bazuar në kërkesën e anëtarit. Forma e kërkesës është përcaktuar në rregullativën nënligjore. Për shkak të identifikimit personal të parashtruesit të kërkesës shoqëria kryen kontroll të drejtpërdrejtë të letërnjoftimit/dokumentit për identifikim personal të anëtarit përmes personit të autorizuar nga organi kompetent i shoqërisë ose agjentit ose kontaktit telefonik me anëtarin, me ç'rast sigurohet incizim nga biseda.

Shoqëria mund të përditësojë ose korrigjojë të dhëna për adresën e banimit dhe/ose adresën për korrespondencës të anëtarit, në evidencën e anëtarëve që janë pronarë të llogarive individuale vullnetare

dhe llogarive profesionale, nëse anëtari telefonon shoqërinë. Shoqëria e identifikon anëtarin me ç'rast siguron incizim nga biseda.

Gjithashtu, shoqëria duhet t'i mundësojë anëtarit të fondit vullnetar që t'i përditësojë të dhënat e tij personale në evidencën e anëtarëve që e mban shoqëria nëpërmjet sistemit të saj elektronik në faqen e internetit. Ndërkaq, anëtari mund të përditësojë të dhënat personale në vijim: emrin, mbiemrin, adresën e banimit, vendbanimin, kodin postar, adresën e korrespondencës, vendin e korrespondencës, kodin postar për korrespondencën, telefonin dhe postën elektronike. Gjithashtu, për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale, gjatë përditësimit, kompania duhet të sigurojë identifikimin elektronik dhe verifikimin e autorizimit të personit që dëshiron të përditësojë të dhënat.

Kompania zbaton procedurat për përditësimin e të dhënave në përputhje me procedurat dhe rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.

7.3. PAGESA E KONTRIBUTEVE VULLNETARE

Pagesa e kontributit vullnetar mund të bëhet vetëm për personin i cili i plotëson kushtet për anëtarësim në fondin pensional vullnetar në përputhje me Ligjin për sigurim pensional vullnetar me financim kapital. Kontribut vullnetar paguhet në bazë të:

- marrëveshjes së lidhur për anëtarësim ndërmjet shoqërisë dhe anëtarit.
- marrëveshjes për anëtarësim ndërmjet shoqërisë, anëtarit dhe personit fizik që paguan kontribut vullnetar për anëtarin (në tekstin e mëtejme: pagues).
- marrëveshje e lidhur ndërmjet shoqërisë dhe siguruesit dhe në bazë të marrëveshjes për organizim dhe financim të skemës pensionale profesionale, të lidhur ndërmjet punëdhënësit dhe shoqatës qytetare (në tekstin e mëtejme: siguruesi) dhe përfaqësuesit të të punësuarve ose anëtarëve të saj.

Kontributi vullnetar paguhet në llogari të veçantë në para të fondit të pensional vullnetar, që mbahet te ruajtësi i pronës. Kontributi vullnetar shpërndahet në llogarinë individuale vullnetare ose në llogarinë profesionale të anëtarit në varësi të mënyrës së anëtarësimit dhe pas plotësimit të kushteve për anëtarësim.

Anëtari, paguesi dhe siguruesi kanë të drejtë ta caktojnë lirisht lartësinë e shumës së paguar të kontributit vullnetar dhe dinamikën e pagesës, ndërsa ndryshimi i lartësisë së pagesës ose ndërprerja e pagesës nuk ndikojnë në të drejtën e anëtarësimit në fondin, përkatësisht nuk nënkuptojnë ndërprerjen e anëtarësimit.

Shoqëritë që menaxhojnë fondet vullnetare pensionale janë të detyruara të ndërmarrin masa dhe aktivitete në përputhje me Ligjin për parandalim të larjes së parave dhe të ardhurave tjera nga vepra ndëshkimore dhe financimit të terrorizmit. Agjencia kryen mbikëqyrje të sistemeve për parandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

7.3.1. Pagesa e kontributit vullnetar nga anëtari ose personi fizik në llogarinë individuale vullnetare

Pagesat e kontributeve vullnetare në emër dhe për llogari të anëtarit që ka llogari individuale vullnetare mund të bëhen nga anëtari dhe/ose paguesi. Pagesa bëhet nga llogaria e transaksionit e anëtarit dhe/ose paguesit. ose nëpërmjet transaksionit të lidhur me llogarinë e transaksionit të anëtarit dhe/ose të paguesit. Personi që ka lidhur marrëveshjen e anëtarësimit ose paguesi ka të drejtë të paguajë kontributin e

parë vullnetar pas skadimit të pesë ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes së anëtarësimit. Shoqëria, nëpërmjet agjentit që lidh marrëveshjen e anëtarësimit, duhet të informojë personin që ka lidhur marrëveshjen ose paguesin për mënyrën dhe afatin e pagesës së kontributit të parë vullnetar. Nëse personi që ka lidhur kontratën ose paguesi paguan kontributin e parë përpara skadimit të afatit të mësipërm, shoqëria duhet t'i kthejë mjetet e paguara në llogarinë e transaksionit të personit që ka lidhur kontratën ose paguesit, ditën tjetër të punës pas datës së pagesës së mjeteve. Megjithatë, me përjashtim, nëse në ditën e marrjes së mjeteve shoqëria ka evidentuar marrëveshje anëtarësimi me personin të cilit i referohet pagesa, shoqëria nuk i kthen mjetet e paguara. Nëse, nga ana tjetër, kontributi vullnetar i paguhet një personi që nuk ka lidhur marrëveshje anëtarësimi, shoqëria është e detyruar t'i kthejë mjetet e paguara në llogarinë e transaksionit të personit që ka bërë pagesën ditën tjetër të punës pas datës së pagesës së mjeteve.

Shoqëria nuk mund ta pranojë pagesën e kontributit vullnetar për personin i cili ka mbushur moshën 70 vjeçare ose ka realizuar të drejtën e pensionit në pajtim me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor, i cili tërheq mjete në pajtim me Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital ose që realizuar kompensim pensional në pajtim me Ligjin për sigurim pensional vullnetar me financim kapital

7.3.2. Pagesa e kontributit vullnetar nga siguruesi në llogari profesionale

Pagesat vullnetare të kontributeve në emër dhe për llogari të anëtarit që ka llogari profesionale mund t'i bëjë vetëm siguruesi që organizon dhe financon skemën profesionale të pensioneve në të cilën është përfshirë anëtari, pas lidhjes së marrëveshjes ndërmjet shoqërisë dhe siguruesit dhe marrëveshjes për organizimin dhe financimin e skemës pensionale profesionale të lidhur ndërmjet siguruesit dhe përfaqësuesit të të punësuarve ose anëtarëve të tij. Pagesa bëhet nga llogaria transaksionale e siguruesit ose nëpërmjet transaksionit të lidhur me llogarinë transaksionale të siguruesit. Nëse siguruesi paguan kontribut vullnetar për person që nuk është i përfshirë në skemën pensionale profesionale, shoqëria është e detyruar që t'i kthejë mjetet e paguara në shumën nominale në llogarinë transaksionale të siguruesit ditën tjetër punës pas datës së pagesës së mjeteve.

Pagesa e kontributit vullnetar për një person mund të bëhet vetëm nëpërmjet skemës pensionale profesionale. Nëse një person është pjesëmarrës në dy ose më shumë skema pensionale profesionale, ai duhet të japë deklaratë për zgjedhjen e skemës pensionale profesionale në të cilën do të marrë pjesë.

Shuma e kontributeve vullnetare përcaktohet nga siguruesi për të gjithë pjesëmarrësit në skemën pensionale profesionale të cilën ai e organizon dhe e financon. Shumat e kontributeve vullnetare përcaktohen nga siguruesi si përqindje e rrogës së anëtarit që përfshihet në skemën pensionale profesionale ose si shumë fikse.

Nëse një anëtar me llogari individuale vullnetare lë të drejtën e kompensimit pensional në pajtim me Ligjin për sigurim pensional vullnetar të me financim kapital, siguruesi mund të paguajë kontribute në llogarinë e tij profesionale

8. MARKETINGU DHE AGJENTËT E SHOQËRIVE PENSIONALE

8.1. MARKETINGU I FONDEVE PENSIONALE

Aktivitetet e marketingut janë të gjitha aktivitetet që synojnë reklamimin e një shoqërie pensionesh dhe një fondi pensioni të detyrueshëm dhe vullnetar dhe informimin dhe lidhjen e marrëveshjeve për

anëtarësim në një fond pensioni të detyrueshëm ose vullnetar dhe marrëveshjet për pagesën e fondeve nga një fond pensioni i detyrueshëm ose vullnetar, që përfshin:

- reklamim të veprimtarisë së shoqërisë pensionale dhe fondit pensional me të cilin menaxhon;
- informim për karakteristikat e sigurimit të detyrueshëm dhe vullnetar pensional me financim kapital;
- informacion për kompensimet dhe provizionet transaksionale;
- informim për të ardhurat e fondit të detyrueshëm dhe/ose vullnetar;
- informacion për portofolin investues të fondit detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional;
- informim për llogaritë individuale, vullnetare individuale dhe llogaritë profesionale;
- anëtarësim dhe transferim të anëtarëve nga një fond të detyrueshëm pensional në tjetër fond të detyrueshëm pensional;
- anëtarësim dhe transferim të anëtarëve nga një fond vullnetar pensional në fond tjetër vullnetar pensional;
- lidhje të marrëveshjeve për tërheqje të programuara, marrëveshje për pagesë të njëhershme dhe marrëveshje për pagesë të shumëhershme dhe
- aktivitete tjera për qëllime reklamimi dhe sigurimi të informacioneve lidhur me funksionimin e shoqërisë pensionale dhe fondin pensional.

Askush, përveç shoqërisë pensionale të themeluar në përputhje me Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital ose Ligjin për sigurim pensional vullnetar me financim kapital, nuk mund të kryejë punë marketingu ose të ofrojë fond të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional, skemë pensionale ose aranzhman të ngjashëm pensionale, as t'i përdorë fjalët "Shoqëri për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale", "Shoqëri për menaxhim me fondet vullnetare pensionale", "shoqëri për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale", "Fondi i detyrueshëm pensional", "Fondi vullnetar pensional", "Skema pensionale" ose fjalë të ngjashme në të emërtimin e tyre.

Shoqëritë pensionale mund të fillojnë me marketingun dhe hulumtimin e opinionit publik pas datës së përcaktuar nga Agjencia dhe marrjes së licencës për themelim dhe miratim për menaxhim me fondin e detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional, regjistrimit të agjentëve të tyre në regjistrin e agjentëve.

Shoqëria pensionale është e detyruar t'i dorëzojë Agjencisë, në fotokopje ose në medie të jashtme të përshtatshme, materialin e publikuar të marketingut brenda në afat prej tre ditësh pas publikimit të tij. Të gjitha materialet reklamuese, promovuese ose informative në lidhje me fondin pensional ose shoqërinë pensionale konsiderohen si material marketingu. Në rast se Agjencia konsideron se ndonjë reklamë ose material tjetër i shkruar mund të shkaktojë konfuzion, ajo me vendim mund të ndalojë publikimin ose shpërndarjen e mëtejshme dhe të urdhërojë publikimin e ndryshimit të atij materiali brenda në një afat që do ta caktojë vetë.

Personi përgjegjës për marketingun është përgjegjës për reklamimin e punës së shoqërisë pensionale, fondit të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional të cilën e menaxhon dhe informacionin në lidhje me sigurimin e detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional me financim kapital, në pajtime me ligjin.

Personi përgjegjës për kontrollin e agjentëve është i detyruar të kontrollojë aktivitetet e agjentëve në lidhje me anëtarësimin dhe transferimin e anëtarëve nga njëri fond në tjetrin fond të detyrueshëm ose vullnetar pensional dhe lidhjen e marrëveshjeve për pagesën e tërheqjeve të programuara nga shtylla e dytë dhe/ose marrëveshjeve për pagesën e kompensimeve pensionale.

8.1.1. Mënyra dhe procedura e marketingut të fondit të detyrueshëm dhe vullnetar pensional

Gjatë kryerjes së marketingut, është e rëndësishme që të mos jepen deklaratat gabuara ose mashtruese për publikun dhe për anëtarët e mundshëm dhe ekzistues dhe anëtarët në pension të fondeve pensionale. Për këtë qëllim, rregullohet ligjërisht që shoqëritë pensionale, fondet pensionale, agjentët, punonjësit, personat e angazhuar me kontratë dhe personat e lidhur nuk guxojnë të japin informacione të gabuara dhe të pasaktë për fond pensional ose për shoqëri pensionale që e menaxhon atë fond ose informacion të cilët mund t'i mashtrojnë anëtarët dhe anëtarët e pensionuar të fondit pensional, personat që kanë të drejtë të bëhen anëtarë të fondit pensional dhe personat të cilët në të ardhmen do të kishin të drejtë të bëhen anëtarë dhe anëtarë të pensionuar të fondit pensional, si dhe sigurues dhe sigurues potencial, qoftë edhe me deklarata gojore, materiale me shkrim, nëpërmjet reklamës dhe çdo materiali tjetër reklamues. Shoqëria pensionale ka për detyrë të sigurojë saktësi dhe besueshmëri të të dhënave edhe kur organizimi dhe përgatitja e punës kryhen nga persona të tretë.

Në funksin të kryerjes së punëve të marketingut, askush nuk mund të:

- t'i ofrojë çfarëdo dhurate një personi tjetër me qëllim që ta shtyjë atë të anëtarësohet, të lidhë marrëveshje për tërheqjeje të programuar, marrëveshje për shumën e përgjithshme ose marrëveshje për pagesë të shumëfishtë në fond pensional ose të mbetet anëtar ose pensionist i fondit pensional, si dhe të marrë pjesë në skemë pensionale profesionale ose të qëndrojë në skemën pensionale profesionale, ose ta detyrojë të marrë pjesë ose të qëndrojë në vende ku kryhet marketingu i fondeve pensionale

- t'i ofrojë çfarëdo dhurate siguruesit ose personave të lidhur me të, me qëllim që ta nxisë ose shpërblejë të bëhet ose të mbetet organizator i skemës pensionale profesionale ose t'u urdhërojë të punësuarve ose anëtarëve të tij të marrin pjesë në skemë pensionale profesionale.

- t'i ofrojë çfarëdo dhurate punëdhënësit ose personave të lidhur me të, sindikatës ose organizatës tjetër, organit kolektiv ose personave të lidhur me atë organizatë ose organ, me qëllim për ta nxitur ose shpërblyer nëse i detyron ose i urdhëron të punësuarit e tij, për t'u anëtarësuar në ndonjë fond pensional.

Dhuratë nënkupton, por nuk kufizohet në shpërblime në para, pagesa e kompensimit në para për ndërprerjen e parakohshme të anëtarësimit ose prishjen e marrëveshjes për tërheqje të programuara nga një fond tjetër të detyrueshëm ose vullnetar pensional ose ndërprerjen e marrëveshjes për pagesa të shumëhershme nga një fond tjetër vullnetar pensional, dhuratë të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, vepra të artit, organizim të ekspozitave ose shfaqjeve, ose kompensime tjera që zakonisht paguhet, përveç atyre pagesave që rrjedhin drejtpërdrejt nga të drejtat e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondit pensional.

Punëdhënësit nuk guxojnë të ndikojnë te të punësuarit e tyre të anëtarësohen në fond të caktuar pensional, ku personi përgjegjës ose person me kompetenca dhe përgjegjësi të veçanta nuk mund t'i reklamojë të punësuarit fond pensional, përveç në rast kur punëdhënësi ka organizuar skemë pensionale profesionale për të punësuarit e tij.

Në rast se shoqëria që menaxhon me fond të detyrueshëm pensional përmes të punësuarit të tij, përfaqësuesit, agjentit ose personit të lidhur me atë kompani ose personit të lidhur me atë shoqëri ushtron ndikim mbi një person mashkull më të vjetër se 50 vjeç ose një person femër më të vjetër se 45 vjeç për t'u anëtarësuar në fond të detyrueshëm pensional, shoqëria duhet të jetë në gjendje të dëshmojë se në momentin e lidhjes së marrëveshjes së anëtarësimit, nuk ka pasur mundësi të supozohet në mënyrë të arsyeshme se anëtarësimi i atij personi në atë fond të detyrueshëm pensional është në kundërshtim me interesat e ai person.

Nëse i punësuarit, përfaqësues, agjent ose personi i lidhur i shoqërisë pensionale ushtron ndikim te një anëtar ose një anëtar të pensionuar për të prishur kontratën me një shoqëri tjetër dhe për të lidhur një kontratë me shoqërinë që ai e përfaqëson, ai duhet t'u japë përparësi interesave të atij anëtari kundrejt interesave personale ose të shoqërisë. Kontakt personal nënkupton takim personal, bisedë telefonike ose

korrespondencë të adresuar personalisht ndërmjet personit të punësuar, përfaqësuesit ose agjentit të shoqërisë dhe personit në fjalë ose një personi tjetër të lidhur me të.

Ndalohet zbatimi i procedurave të marketingut të fondit pensional që janë në kundërshtim me moralin publik dhe që mund ta dëmtojnë sigurimin pensional me financim kapital. Kjo është e nevojshme për të shmangur cenimin e reputacionit të sigurimit pensional me financim kapitali, që është pjesë e sistemit të integruar pensional.

Gjatë kryerjes së aktiviteteve të marketingut, shoqëritë pensionale dhe agjentët duhet të punojnë edhe në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, i cili rregullon mbrojtjen e të dhënave personale si liritë dhe të drejtat themelore të qytetarëve, dhe veçanërisht të drejtat për privatësi në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.

Nocioni "Të dhëna personale" nënkupton çdo informacion që i referohet një personi fizik të identifikuar ose një personi fizik që mund të identifikohet, ndërsa personi që mund të identifikohet është personi, identiteti i të cilit mund të përcaktohet drejtpërdrejt ose tërthorazi, veçanërisht në bazë të numrit unik të identifikimit të qytetarit ose në bazë të një ose më shumë karakteristikave specifike për identitetin e tij fizik, mendor, ekonomik, kulturor ose social. Çdo person që ka qasje në të dhënat personale është i detyruar të sigurojë fshehtësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Përpunimi i të dhënave personale, përkatësisht çdo operacion i kryer mbi të dhënat personale në mënyrë automatike ose në mënyrë tjetër, siç është: grumbullimi, evidentimi, organizimi, ruajtja, përdorimi etj., duhet të kryhet në përputhje me këtë ligj. Ligji parashikon edhe gjopa për veprime në kundërshtim me ligjin. Me qëllim mbikëqyrjen e ligjshmërisë së aktiviteteve të ndërmarra gjatë përpunimit të të dhënave personale dhe mbrojtjen e tyre, në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, u themelua Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Shoqëria pensionale mund të kryejë punë të marketingut të fondit pensional në ambientet e saj dhe në ambientet e bashkëpunëtorëve të saj afarist për marketing, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes llojit përkatës të komunikimit (telefon, faks, internet).

Ambienti duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- të ketë të paktën një agjent, i cili mund të punësohet te bashkëpunëtori afarist;
- të ketë person përgjegjës që do të punojë në marketingun e shoqërisë pensionale, që mund të punësohet nga bashkëpunëtori afarist;
- nëse në ambientin e bashkëpunëtorit afarist për marketing ka vetëm një agjent i cili është i punësuar nga bashkëpunëtori afarist, i njëjti person mund të jetë personi përgjegjës për kryerjen e punëve të marketingut të shoqërisë pensionale në atë ambient dhe
- të sigurojë ambient adekuat për aktivitetet e marketingut të shoqërisë pensionale.

Shoqëria pensionale është e detyruar të lidhë marrëveshje me bashkëpunëtorin afarist, i cili mund të jetë bankë ose shoqëri sigurimesh, për kryerjen e veprimtarive të marketingut në ambientet e saj. Në marrëveshjen, mes tjerash, ceken: adresat e ambienteve të bashkëpunëtorit afarist për marketing të cilat shoqëria private i përdor për të kryer punë marketingu; mënyra dhe shuma e pagesës dhe mënyra e kontrollit të bashkëpunëtorit afarist nga shoqëria pensionale.

Shoqëria pensionale është përgjegjëse për marketingun e fondit pensional në ambientet në të cilat kryhen punë marketingu, nga agjentët dhe bashkëpunëtorët e biznesit për marketing.

Shoqëria pensionale nuk mund të japë vlerësime për një shoqëri tjetër pensionale në reklamat e saj dhe as të bëjë krahasime me shoqëritë e tjera pensionale dhe fondet e detyrueshme pensionale dhe/ose vullnetare, përveç në lidhje me të ardhurat e kaluara nga investimet, politikën e kaluar të investimeve dhe kompensimet e arkëtuara nga anëtarët e fondeve pensionale. Gjatë krahasimit të të ardhurave të kaluara nga investimet, shoqëria pensionale detyrimisht e paraqet edhe kompensimin nga kontributet ashtu edhe kompensimin mujor nga mjetet neto të fondit pensional, të paguara nga anëtarët e fondit pensional me të cilin menaxhon, për të njëjtën periudhë të cilës i referohet krahasimi i të ardhurave.

Shoqëria pensionale për reklamimin e saj nuk mund të përdorë shprehje apo slogane që nuk mund të vërtetohen si: “shërbim më i mirë”, “shoqëria më e mirë”, “mbështetja më e mirë” etj.

Në reklamimin, promovimi ose të dhënat për kompensimet, të ardhurat e fondit pensional, anëtarësimin në fondin pensional dhe të dhënat tjera në të cilat përdoren format statistikore, shoqëria pensionale e cek qartë burimin e informacioneve. Agjencia është burimi i vetëm i të dhënave për kompensime dhe të ardhurat e fondit pensional. Nëse pasqyrat grafike të publikuara nga Agjencia përdoren për reklamim, promovim ose informim, shoqëria pensionale është e detyruar ta shfaqë të gjithë pasqyrën grafike, jo vetëm pjesët e zgjedhura të pasqyrës. Gjatë përdorimit të të dhënave ose pjesëve të të dhëna nga raportet statistikore të Agjencisë, citimi i të dhënave ose ekstrakteve nga raportet bëhet në përputhje me rregullat për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të ngjashme.

Materialet e marketingut të publikuara nga shoqëria pensionale në letër dhe në formë elektronike, përveç materialeve audio, duhet të përmbajnë edhe këto të dhëna: “Mbikëqyrës i financimi kapital të sigurimit pensional e Agjencia për Mbikëqyrjen e Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (MAPAS) www.mapas.mk tel . 02 3224 229.

Shoqëria pensionale në reklamimin e saj nuk duhet të përfshijë projeksione të ardhshme për të ardhurat e fondit pensional të cilin e menaxhon, për kompensimet dhe për gjendjen e të gjitha llojeve të llogarive individuale, përveç gjatë bërjes së përlllogaritjeve për shumën e akumuluar nga llogaria vullnetare individuale dhe profesionale. Përlllogaritjet për shumën e ardhshme të akumuluar bëhen në bazë të elementeve në vijim: shuma dhe perioda e pagesave, lartësia e të ardhurave dhe lartësia e kompensimeve. Për lartësinë e të ardhurave përdoren supozime racionale që janë të harmonizuara me të ardhurat e realizuara reale dhe të ardhurat nga strategjia investuese, në së paku tre skenarë (racional-bazik, pesimistik dhe optimistik). Për lartësinë e kompensimeve përdoret lartësia e kompensimeve të cilët arkëtohen në mënyrë të vazhdueshme. Supozimet e përdorura dhe rezultatet e fituara shoqëria pensional i cek qartë në deklaratat dhe parashikimet.

Nëse cilado prej të dhënave të përfshira në reklamimin ndryshohet, shoqëria pensionale mund t'i shfaqë të dhënat paraprake edhe për 15 ditë nga ndryshimi i materialit për marketing në formë letre, përkatësisht, pesë ditë nga ndryshimi i materialit për marketing në formë elektronike. Kjo veçanërisht u referohet të dhënave për: të ardhurat dhe numrin e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondit të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional, kompensimet dhe provizionet transaksionale, ambientet për kryerje të punëve të marketingut dhe të dhëna të tjera.

8.1.2. Reklamimi dhe informimi për kompensimet dhe të ardhurat e fondit të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional

Shoqëria pensionale, gjatë publikimit të informacioneve për kompensimet, duhet t'i cekë veçmas informacionet në vijim: kompensimet nga kontributet, kompensimi mujor nga vlera e mjeteve neto të fondit pensional, kompensimi për transferim, zvogëlimi i kompensimit për anëtarësim të vazhdueshëm dhe provizione transaksionale. Të dhënat e publikuara duhet të korrespondojnë me vlerat e vlefshme në datën në të cilën është bërë publikimi. Gjatë informimit për rritjen e kompensimeve shoqëria pensionale e cek datën nga e cila paraqitet rritja, duke u dhënë hapësirë të njëjtë të dhënave për kompensimin rrjedhës dhe të rritur.

Shoqëria pensionale në reklamimin e saj i përdor vetëm të ardhurat e fondit pensional që është publikuar nga Agjencia dhe e cek burimin e informacioneve nga Agjencia. Në reklamën ceket edhe perioda për të cilën janë përlllogaritur të ardhurat. Të dhënat e publikuara nga shoqëria pensionale për të ardhurat e fondit pensional me të cilin menaxhon duhet të jenë të barabarta me të dhënat për të ardhurat për periudhën

e njëjtë që më së afërmi deri në datën e raportit është publikuar nga Agjencia. Gjatë shpalljes së të ardhurave nga fondi pensional, shoqëria pensionale detyrimisht e tregon edhe kompensimin nga kontributet dhe kompensimin mujor nga mjetet neto të fondit pensional, të arkëtuara nga anëtarët e atij fondi pensional, për të njëjtën periudhë për të cilën është bërë publikimi.

Çdo publikim i kompensimit dhe/ose të ardhurave detyrimisht e përmban fjalinë përfundimtare në vijim:

a) për fondin e detyrueshëm pensional: "Të ardhurat në llogarinë tuaj individuale janë të ndryshueshme dhe varen nga të ardhurat e fondit tuaj të detyrueshëm pensional dhe nga kompensimet e arkëtuara nga shoqëria juaj që menaxhon me fondin e detyrueshëm pensional".

b) për fond vullnetar pensional: "Të ardhurat në llogarinë tuaj individuale vullnetare dhe/ose llogarinë profesionale janë të ndryshueshme dhe varen nga të ardhurat e fondit tuaj vullnetar pensional dhe nga kompensimet e arkëtuara nga shoqëria juaj që menaxhon me fondin vullnetar pensional".

8.1.3. Raporte dorëzuar anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondit të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional

Shoqëria pensionale është e detyruar që rregullisht dhe të paktën një herë në vit të informojë me shkrim anëtarët e fondit pensional të cilin e menaxhon për gjendjen e fondeve në llogaritë e tyre individuale, në llogaritë individuale vullnetare ose në llogaritë profesionale, për datat e pagesës së kontributeve dhe transferimin e mjeteve për anëtarin e atij fondi gjatë periudhës përkatëse dhe për shndërrimin e kontributeve dhe mjeteve të transferuara në njësi kontabiliteti. Raportet për anëtarët e fondit pensional i referohen periudhës nga raporti i fundit deri në datën e fundit të vlerësimit përfundimisht më 31 dhjetor. Me përjashtim të vitit të parë në të cilin janë paguar kontributet, raporti i referohet periudhës nga data e parë e vlerësimit deri në datën e fundit të vlerësimit përfundimisht më 31 dhjetor të vitit aktual. Shoqëria pensionale i dorëzon këto të dhëna deri më 31 mars vitin e ardhshëm për të gjithë personat që kanë qenë anëtarë të fondit pensional me të cilin menaxhon gjatë asaj periudhe raportuese. Forma e këtyre raporteve jepet në formularët që janë pjesë përbërëse e rregulloreve që rregullojnë tregtimin e shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale. Shoqëritë pensionale i dorëzojnë raportet në zarf të gjelbër dhe mund të përdoren ngjyra të ndryshme për tekstin dhe sfondin e formularëve. Këto raporte u dorëzohen anëtarëve pa pagesë. Njoftimi për anëtarët e fondeve pensionale, pas pëlqimit paraprak të anëtarit, mund të dërgohet në formë elektronike në vend të formës së shkruar. Me kërkesën e anëtarit të fondit pensional, shoqëria është e detyruar në çdo kohë, brenda tetë ditë pune nga marrja e kësaj kërkesë, t'i dorëzojë anëtarit njoftim shtesë për vlerën e mjeteve në llogarinë e tij individuale, vullnetare individuale ose profesionale. Shoqëria Kompania mund të paguajë kompensim për këtë njoftim, por vetëm deri në shumën e shpenzimeve për printim dhe shpenzime të postës. Gjithashtu, me kërkesë të anëtarit, shoqëria pensionale është e detyruar t'i sigurojë atij qasje elektronike në raportin e detajuar në formën e dhënë të formularëve që janë pjesë përbërëse e rregullores me të cilin rregullohet marketingu i shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale.

Kur anëtari kalon nga një fond pensional ekzistues në fond të ardhshëm të detyrueshëm pensional, ose nga një fond ekzistues në fond të ardhshëm vullnetar pensional, me kërkesë të anëtarit, shoqëria pensionale që menaxhon me fondin e ardhshëm pensional i dorëzon anëtarit raport për anëtarësimin e plotë, duke përfshirë anëtarësimin në fondin e detyrueshëm ose vullnetar pensional.

Së paku një herë në vit, shoqëria pensionale është e detyruar t'i dorëzojë çdo anëtari të çdo fondi pensional me të cilin menaxhon, raport me të dhënat për vlerën dhe pjesëmarrjen e mjeteve të fondit pensional të investuara në lloj të veçantë të mjeteve, përfshirë të dhëna për emetuesin e letrës përkatëse me vlerë, në datën e fundit të vlerësimit përfundimisht më 31 dhjetor çdo viti. Me përjashtim të vitit të parë ku

kontributet janë paguar, raporti i referohet periudhës nga data e parë e vlerësimit deri në datën e fundit të vlerësimit përfundimisht më 31 dhjetor të vitit aktual. Shoqëria pensionale i dorëzon këto të dhëna deri më 31 mars të vitit vijues për të gjithë personat që kanë qenë anëtarë të fondit pensional me të cilin menaxhon gjatë asaj periudhe raportuese. Obligimi për dhënie të të dhënave për emetuesit e letrave me vlerë u referohet investimeve në letra me vlerë që paraqesin të paktën 1% të vlerës së mjeteve të fondit pensional. Forma e këtij raporti është e rregulluar në rregulloren që rregullon marketingun e kompanive pensionale dhe fondeve pensionale. Shoqëria pensionale ofron edhe pasqyrë grafike (piti) të strukturës së portofolit sipas grupit të instrumenteve dhe sipas shteteve. Gjithashtu, shoqëria pensionale paraqet pasqyrë grafike të njësisë së kontabilitetit për një periudhë shtatëvjeçare. Shoqëritë pensionale i dorëzojnë këto të dhëna në një zarf të gjelbër. Këto të dhëna do t'u dërgohen anëtarëve të fondeve pensionale pa pagesë. Ky njoftim mund të dërgohet në formë elektronike në vend të formës së shkruar, pas pëlqimit paraprak me shkrim të anëtarit.

Gjithashtu, shoqëritë pensionale publikojnë në faqet e tyre të internetit të dhëna të detajuara për investimet e fondeve pensionale me të cilat menaxhojnë. Të dhënat e detajuara përfshijnë të paktën të dhëna për instrumentet sipas afatit, përqindjes së shkallës së kamatës dhe datës së maturimit veçmas për secilin instrument varësisht nga lloji i instrumentit.

Së bashku me të dhënat e mësipërme, shoqëria pensionale u dorëzon anëtarëve të fondit pensional me të cilin menaxhon të dhëna për kompensimet të cilat i arkëton dhe për të ardhurat e fondit pensional me të cilin menaxhon. Të dhënat për kompensimet duhet të jenë për periudhën nga raporti i fundit deri në datën e fundit të vlerësimit, me gjendje më 31 dhjetor. Si përjashtim, për vitin e parë në të cilin janë paguar kontributet, të dhënat i referohen periudhës nga data e parë e vlerësimit deri në datën e fundit të vlerësimit përfundimisht më 31 dhjetor të vitit aktual. Të dhënat për të ardhurat duhet të jenë të barabarta me të dhënat për të ardhurat të publikuara nga Agjencia, me gjendje më 31 dhjetor të vitit aktual. Këto të dhëna duhet të dorëzohen deri më 31 mars të vitit aktual për të gjithë ata që kanë qenë anëtarë të fondit të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional gjatë periudhës raportuese.

Gjithashtu, shoqëria pensionale është e detyruar të paraqesë të dhëna për shumën totale të provizioneve transaksionale që i kanë paguar shoqëria pensionale dhe menaxherët e tyre të huaj të mjeteve të fondit pensional, në periudhën që nga raporti i fundit, si dhe për shumën mesatare të këtyre shpenzimeve për një njësi kontabiliteti të atij fondi.

Njoftimet e mësipërme dërgohen në mënyrë përkatëse edhe te anëtarët e pensionuar.

Për anëtarët e fondeve të detyrueshme pensionale, anëtarësimi i të cilëve u është ndërprerë, në përputhje me ndryshimet në Ligjin për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital nga dhjetori 2018, shoqëritë pensionale kanë për obligim t'i dorëzojnë njoftimet e mësipërme më së voni deri më 28.02.2019.

Përveç të gjitha njoftimeve të sipërpërmendura, shoqëria pensionale ka për obligim që çdo anëtar i ri të shpërndarë t'i dorëzojë njoftim në afat prej 15 ditësh nga data e pranimi të të dhënave të kontaktit për anëtarin, të dorëzuara nga Agjencia. Njoftimi përmban të paktën të dhëna për të drejtat dhe obligimet e tij që rrjedhin nga anëtarësimi në fondin e detyrueshëm pensional.

8.1.4. Tabela e njoftimeve

Në të gjitha ambientet e shoqërisë pensionale ose bashkëpunëtori i tij afarist për marketing, të dedikuara për pritjen e palëve, duhet të ketë të paktën një tabelë njoftimi, të vendosur në vend të dukshëm, me informacione të shkurtra për të dhënat kryesore në lidhje me fondin e detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional dhe shoqërinë pensionale. Në tabelën e njoftimeve fillimisht shënohet emri i shoqërisë pensionale dhe për çdo fond pensional që menaxhohet nga shoqëria shënohet:

emri i fondit pensional, struktura e kompensimeve, lartësia dhe data e aplikimit të tyre (në rast të kompensimeve të ardhshme), reduktimi i kompensimit për anëtarësinë e përhershme, të dhënat për të ardhurat e fondit pensional dhe të dhënat për mbikëqyrësin e sigurimit pensional me financim kapital. Të dhënat përditësohen në afat prej pesë ditësh nga ndryshimi i krijuar.

Në të gjitha ambientet e shoqërisë pensionale ose të bashkëpunëtorit të saj për marketing, të dedikuara për pranim të palëve duhet të ketë:

a) listë të përditësuar me emrat, mbiemrat, adresat dhe numrat e telefonit të personit përgjegjës të ambientit dhe të personave përgjegjës të shoqërisë pensionale, të theksuara në vend të dukshëm;

b) kopje të raporteve të rishikuara financiare të shoqërisë pensionale dhe fondit të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional, përfundimisht më 31 dhjetor të vitit paraparak, që publikohen në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore;

c) kopje të statutit dhe prospektit informativ të fondit të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional.

Shoqëria pensionale në selinë e saj në vend të dukshëm duhet të ketë listë të përditësuar me emra, mbiemra, adresa dhe numra telefoni të personave përgjegjës për të gjitha ambientet për kryerje të marketingut dhe listë të përditësuar të agjentëve sipas qyteteve. Shoqëria pensionale publikon edhe listën e agjentëve sipas qyteteve në faqen e saj të internetit.

8.1.5. Prospekti informativ

Shoqëria pensionale është e detyruar, më së voni deri 31 mars çdo vit aktual, të publikojë prospekt informues për fondet pensionale me të cilat menaxhon me të dhëna të plota, të sakta dhe objektive me gjendjen më 31 dhjetor të vitit paraparak. Shoqëria për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale përgatit prospekte të veçanta informative për fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale me të cilat menaxhon.

Prospekti informativ lëshohet dhe duhet të jetë i disponueshëm për publikun në të gjitha ambientet e shoqërisë pensionale ose bashkëpunëtorit të saj afarist për marketing, të dedikuara për pranimin e palëve të shoqërisë pensionale dhe në faqen e saj të internetit. Prospekti informativ publikohet në një nga gazetatat ditore me tirazh më të madh që shpërndahet në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Përmbajtja e prospektit informativ duhet të përgatitet në mënyrë të drejtpërdrejtë, të thjeshtë, të kuptueshëm lehtësisht në një mënyrë të dobishme për marrjen e vendimeve për lidhjen e marrëveshjes për anëtarësim në fond të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional dhe për anëtarin e pensionuar potencial të lidhë marrëveshje për pagesën e mjeteve nga fondi i detyrueshëm ose vullnetar pensional. Prospekti informativ nuk mund të përmbajë asnjë lloj reklame dhe në të mund të printohet vetëm emri i shoqërisë pensionale të cilën e ka publikuar, fondi pensional me të cilin menaxhon, logoja dhe slogani i shoqërisë pensionale.

Prospekti informativ përmban të dhëna të plota, të sakta dhe objektive për fondin pensional dhe shoqërinë që e menaxhon atë fond, të cilat janë të nevojshme që anëtari potencial të sjellë vendim për anëtarësim në fondin pensional dhe që anëtari i pensionuar potencial të lidhë marrëveshje për tërheqje të programuara ose marrëveshje për pagesa të shumëhershme, përkatësisht:

a) emrin dhe selinë e shoqërisë dhe fondit që e menaxhon;

b) emrat e anëtarëve të këshillit drejtues dhe të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë pensionale;

c) emrat dhe adresat e aksionarëve dhe pjesëmarrja e tyre në kryegjënë themelore të shoqërisë pensionale;

ç) emrin dhe selinë e ruajtësit të pronës dhe të dhënat për ndryshimet e mundshme të ruajtësit të pronës të bëra në vitin paraprak dhe arsyet e ndryshimeve të tilla;

d) të dhënat për revizorin e fondit pensional dhe shoqërisë;

dh) parimet bazë të investimit dhe vetëkufizimeve gjatë investimit, përveç atyre të parashikuara në ligj;

e) përgjegjësia gjatë marrjes së vendimeve për investime;

ë) kompensimet, provizionet dhe të gjitha shpenzimet tjera që arkëtohen nga anëtarët dhe nga anëtarët e pensionuar të fondit pensional;

f) mënyra e anëtarësimit, lidhjen e një marrëveshjeje për tërheqje të programuara, lidhjen e marrëveshjes për pagesë të njëhershme, lidhje të marrëveshjes për pagesë të shumëhershme dhe lidhje të marrëveshjes për transferim;

g) mënyra e njoftimit të anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar;

gj) e drejta e pensionit/përkatësisht kompensimi pensional;

h) portofoli i fondit pensional;

i) numri i anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondit pensional;

j) vlera neto e mjeteve të fondit pensional; dhe

k) të dhëna tjera për punën e shoqërisë dhe menaxhimin me fondin pensional që mund t'i përshkruajë Agjencia për sigurimin e transparencës.

Shoqëria pensionale është e detyruar t'i dorëzojë, me kërkesë të anëtarit dhe anëtarit të pensionuar të fondit pensional me të cilin menaxhon. Gjithashtu, shoqëria pensionale është e detyruar t'i ofrojë pasqyrë prospekteve informative dhe statuteve të fondeve pensionale me të cilat menaxhon për çdo person që do të paraqitet për anëtarësim, do të dëshirojë të lidhë marrëveshje për tërheqje të programuara, marrëveshje për pagesë të njëhershme dhe marrëveshje për pagesë të shumëhershme përpara nënshkrimit të marrëveshjes.

8.2. AGJENTË TË SHOQËRIVE PENSIONALE

Agjent mund të jetë personi i punësuar në shoqëri pensionale dhe person tjetër i kontraktuar nga një shoqëri pensioni. Agjenti mund të kryejë punë marketingu për fondet pensionale dhe/ose të lidhë marrëveshje për anëtarësim, marrëveshje për transferim, marrëveshje për tërheqje të programuara, marrëveshje për pagese të njëhershme dhe marrëveshje për pagesë të shumëhershme vetëm në fondet pensionale të menaxhuara nga shoqëria pensionale në të cilën ai është i punësuar ose i angazhuar me kontratë. Personi mund të kryejë punë marketingu vetëm pasi të jetë regjistruar në Regjistrin e agjentëve të cilin e udhëheq Agjencia.

Agjenti duhet të jetë i pranishëm gjatë lidhjes së marrëveshjes së për anëtarësim, marrëveshjes për transferim, marrëveshjes për tërheqje të programuara, marrëveshjes për pagesë të shumëhershme dhe është i detyruar ta nënshkruajë marrëveshjen e tillë. Agjenti është i detyruar të kryejë të gjitha kontaktet me anëtarin, me anëtarin e pensionuar ose me personat që kanë të drejtë të bëhen anëtarë ose anëtarë të pensionuar të fondit pensional personalisht dhe nuk mund të lidhë marrëveshje anëtarësimi, marrëveshje për tërheqje të programuar, marrëveshje për pagesë të njëhershme dhe marrëveshje për pagesë të shumëhershme përmes personit tjetër.

Shoqëria pensionale parashtron kërkesë në Agjencinë për personat që synon t'i punësojë ose angazhojë me kontratë si agjentë, për dhënie të provimit për agjentë dhe kërkesë për regjistrim në Regjistrin e agjentëve dhe paguan kompensimet për provim dhe regjistrim në Regjistrin e agjentëve.

Në Regjistrin e agjentëve mund të regjistrohet personi i cili i plotëson kushtet në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut ose, nëse është i huaj, të ketë statusin e rregulluar të të huajit në pajtim me ligjin;
- të mos i është shqiptuar sanksion kundërvajtës ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në fushën e ekonomisë, financës, sigurimit, veprimtarisë bankare dhe drejtësisë;
- të ketë të përfunduar së paku arsimin e mesëm;
- të ketë dhënë provim për agjentë në Agjencinë dhe
- të mos jetë i punësuar në Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut, në Fondin për Sigurim Shëndetësor të Maqedonisë së Veriut, në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Drejtorinë e të Ardhurave Publike dhe në agjencitë e punësimeve të përkohshme.

Agjencia përcakton mënyrën dhe procedurën e dhënies së provimit për marrjen e statusit të agjentit dhe mënyrën dhe procedurën e regjistrimit të personit në Regjistrin e agjentëve.

8.2.1. Provim për agjentë

Provimin për agjentë e organizohet Agjencia, ndërsa teknikisht e realizon personi juridik me të cilin Agjencia ka lidhur marrëveshje. Provimi jepet sipas programit për dhënien e provimit të përgatitur nga Agjencia. Provimi përbëhet nga dy pjesë: pjesa e parë (pjesa teorike) dhe pjesa e dytë (shembulli praktik). Provimi fillon me dhënien e pjesës së parë të provimit dhe pjesa e dytë e provimit jepet së paku pesë ditë pas dhënies me sukses të pjesës së parë të provimit. Pjesa e parë e provimit jepet me shkrim duke iu përgjigjur një numri të caktuar pyetjesh në formën e zgjidhjes së një testi elektronik në kompjuter, dhe e dyta gjithashtu jepet me shkrim duke studiuar një shembull praktik dhe duke iu përgjigjur një numri të caktuar pyetjesh që dalin nga shembulli praktik. Kandidati i cili nuk e ka kaluar pjesën e parë të provimit nuk mund ta japë pjesën e dytë. Nëse kandidati nuk e ka dhënë pjesën e dytë të provimit, do të konsiderohet se nuk e ka dhënë provimin. Kandidati ka dhënë pjesën e parë ose të dytë të provimit nëse ka fituar të paktën 70% të gjithsej 6 pikëve pozitive të parashikuara për pjesën e parë ose të dytë të provimit.

Shoqëritë pensionale mund të paraqesin kërkesë për dhënien e provimit për agjentë në Agjenci, jo më vonë se 45 ditë para organizimit të provimit. Provimi zhvillohet gjatë muajve maj dhe nëntor, sipas orarit të përcaktuar nga Agjencia, të cilin ua dorëzon shoqërive pensionale. Me përjashtim, Agjencia mund t'i mbajë provimet në afate më të shkurtra se afatet e përcaktuara sipas një plani të përcaktuar nga Agjencia. Hapësira dhe kushtet për mbajtjen e provimeve sigurohen nga personi juridik me të cilin Agjencia ka lidhur marrëveshje. Agjencia i njofton shoqëritë pensionale për rezultatet e provimit në afat prej 15 ditësh nga dita e dhënies së provimit.

Personat që kanë dhënë provimin (pjesa e parë dhe e dytë) marrin certifikatë për provimin e dhënë për agjent nga Agjencia. Një person mund t'i nënshtrohet provimit të agjentit maksimum tre herë, pavarësisht se cila shoqëri pensionale e ka paraqitur për dhënie të provimit.

Certifikata për provimin e dhënë përmban të dhëna për emrin dhe mbiemrin e plotë të personit, datën e provimit dhe emrin, selinë dhe adresën e shoqërisë pensionale që ka parashtruar kërkesë dhe të dhëna të tjera.

8.2.2. Mënyra dhe procedura e regjistrimit në Regjistrin e agjentëve

Shoqëria pensionale në Agjencinë parashtron kërkesë në emër të agjentit për regjistrimin e saj në Regjistrin e agjentëve, nëse personi i plotëson kushtet nga ligji.

Agjencia i regjistron në Regjistrin e agjentëve personat që e kanë dhënë provimin, nëse i përmbushin edhe kushtet tjera ligjore. Çdo person është regjistruar në Regjistrin e agjentëve merr certifikatë për fitimin e statusit të agjentit që përmban emrin dhe mbiemrin e plotë të personit, kodin e regjistrimit dhe të dhënat tjera. Shoqëria pensionale, çdo agjenti që është regjistruar në Regjistrin e agjentëve, i lëshon legjitimacion me logon dhe emrin e shoqërisë pensionale dhe me fotografinë, emrin, mbiemrin dhe kodin e regjistrimit të agjentit. Çdo agjent e përdor legjitimacionin kur kryen punë të marketingut, anëtarësimit ose transferimit të anëtarëve nga njëri në tjetrin fond të detyrueshëm ose nga njëri në tjetrin fond vullnetar pensional. Agjencia, menjëherë pas regjistrimit të personit në Regjistrin e agjentëve, e njofton shoqërinë pensionale përkatëse për kodin e regjistrimit të çdo agjenti. Kodi i regjistrimit ceket në të gjitha marrëveshjet për anëtarësim në fondin pensional, për të cilat ai agjent është përgjegjës. Shoqëria pensionale paguan kompensim për regjistrim të çdo agjenti. Shoqëria pensionale menjëherë i dorëzon në Regjistrin e agjentëve. Shoqëria pensionale menjëherë i dorëzon në Agjencinë ndryshimet e të dhënave për agjentët (emri, mbiemri dhe të dhënat tjera).

Riregjistrimi i agjentit në Regjistrin e agjentëve bëhet në çdo 12 muaj. Për shkak të riregjistrimit të agjentit në Regjistrin e agjentëve shoqëria pensionale duhet të dorëzojë në Agjencinë kërkesë për riregjistrim më së voni 15 ditë para datës nga e cila fillon të vlejë riregjistrimi. Data e cekur në kërkesën për riregjistrim nuk mund të jetë para datës së skadimit të vlefshmërisë së riregjistrimit të agjentit. Shoqëria pensionale paguan kompensim për riregjistrim të çdo personi në Regjistrin e agjentëve.

Personi i cili është regjistruar në Regjistrin e agjentëve ose nuk ka pasur riregjistrim për shoqëri tjetër pensionale, duhet përsëri ta japë provimin për agjentët.

Shoqëria pensionale është e detyruar që të dorëzojë kërkesë në Agjencinë për fshirje të agjentit nga Regjistri i agjentëve nëse nuk përmbush disa dispozita ligjore. Shoqëritë pensionale menjëherë e njoftojnë Agjencinë dhe i dorëzojnë të dhënat për personat të cilëve u është ndërprerë statusi i agjentit (emri, mbiemri dhe të dhënat tjera themelore personale) si dhe kodi i regjistrimit.

Shoqëria e njofton me shkrim Agjencinë nëse agjentët e tij veprojnë në kundërshtim me Ligjin. Njoftimet me shkrim duhet të bazohen në fakte objektive dhe të pakontestueshme.

8.2.3. Fshirja e personit nga regjistri i agjentëve

Agjencia zbaton procedurë për fshirje nga Regjistri i agjentëve të agjentit që nuk i respekton dispozitat e Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital dhe/ose Ligjit për sigurim pensional vullnetar me financim kapital. Kryetari i Këshillit të ekspertëve të Agjencisë sjell aktvendim për fshirjen e agjentit kundër të cilit agjenti ka të drejtë të ankesës në Këshillin Drejtues të Agjencisë. Ankesa nuk e prolongon kryerjen e aktvendimit. Me atë ky person nuk mund të kryejë më tutje punë të marketingut dhe marrëveshjet të cilat pastaj do t'i lidhë konsiderohen të pavlefshme. Personit të fshirë nga Regjistri i agjentëve për shkak të mosrespektimit të dispozitave të Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital dhe/ose Ligjit për sigurim vullnetar pensional me financim kapital ose akteve nënligjore, nuk do t'i lejohet riregjistrim në regjistrin, në afat prej tre vitesh nga dita e fshirjes.

Krahas kësaj, në ligjin është paraparë edhe gjobë në lartësi nga 200 deri në 250 euro në kundërvlerë me denarë për kundërvajtje për agjentin nëse nuk u përmbahet obligimeve dhe kufizimeve të parapara në ligjin. Me gjobë në lartësi nga 8000 deri në 9000 euro në kundërvlerë me denarë, varësisht nga kundërvajtja, do të dënohet shoqëria pensionale nëse zbaton procedura të marketingut në kundërshtim me Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital ose Ligjin për sigurim pensional vullnetar

me financim kapital. Gjobë deri në shumën e dyhershme do t'i shqiptohet shoqërisë pensionale nëse me kundërvajtje të lartpërmendur ka marrë dobi më të madhe pronësore ose ka shkaktuar dëm më të madh pronësor. Krahas kësaj, për kundërvajtjen e lartpërmendur gjobë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës për kundërvajtje në shoqërinë pensionale.

9. KOMPENSIME

9.1. KOMPENSIME QË I ARKËTOJNË SHOQËRITË QË MENAXHOJNË ME FONDE TË DETYRUESHME PENSIONALE

Shoqëria që menaxhon fondet e detyrueshme pensionale për punën e saj lidhur me menaxhimin e fondit të detyrueshëm pensional arkëton kompensime sipas kushteve dhe në mënyrë të përcaktuar me Ligjin për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital.

Shoqëria mund të arkëtojë vetëm kompensimet në vijim:

> kompensimin e kontributeve si përqindje e çdo kontributi të paguar në fond të detyrueshëm pensional, para shndërrimit të mjeteve në njësi kontabiliteti. Shuma e kompensimit përcaktohet nga shoqëria, por ajo nuk mund të kalojë 2% të çdo kontributi të paguar;

> kompensimin mujor nga vlera e mjeteve neto të fondit të detyrueshëm pensional, për mbulimin e shpenzimeve të shoqërisë, për menaxhim me fondin e detyrueshëm pensional. Shuma e tarifës përcaktohet nga shoqëria, por ajo nuk mund të kalojë 0.03% të vlerës së mjeteve neto të fondit të detyrueshëm pensional - kompensim për menaxhimin e mjeteve;

> kompensimi për transferim - në rast kur anëtari i fondit të detyrueshëm pensional kalon në një fond tjetër të detyrueshëm pensional.

Shuma maksimale e kompensimit nga kontributet në shumë prej 2% ka filluar të zbatohet nga viti 2020, e tutje, ndërsa shuma maksimale e kompensimit mujor për menaxhim të mjeteve nga 0.03% ka filluar të zbatohet nga viti 2019 e në vazhdim. Deri në arritjen e këtyre kufijve, ka pasur një ulje graduale të shumës maksimale të kompensimeve, sipas tabelës në vijim:

Viti	Kompensim nga kontributet	Kompensim mujor nga mjetet
2014	3,50%	0,045%
2015	3,25%	0,040%
2016	3,00%	0,040%
2017	2,75%	0,035%
2018	2,50%	0,035%
2019	2,25%	0,030%
2020	2,00%	0,030%

Shoqëria i përcakton shumat e kompensimit nga kontributet, kompensimit për menaxhimin e mjeteve dhe kompensimit për transferim, si dhe shumën e uljes së kompensimit nga kontributet e paguara në bazë të kohëzgjatjes së anëtarësimit në fondin e detyrueshëm pensional në statutin e fondit të detyrueshëm pensional me të cilin menaxhon dhe i shpjegon ato në prospektin informativ.

Nëse shoqëria nuk përcakton kompensim më të ulët se ai maksimal, atëherë shoqëria a arkëton kompensimin maksimal, të përcaktuar me ligj.

Kompensimi nga kontributet konsiderohet se është marrë kur kontributet pranohen nga ruajtësi i pasurisë së fondit të detyrueshëm pensional përkatës dhe miratohen nga Agjencia dhe arkëtohet çdo ditë pune. Kompensimi nga kontributet përlllogaritet duke shumëzuar përqindjen e kompensimit nga kontributet që arkëtohet me shumën e kontributeve të paguara në çdo llogari individuale ose nënlllogari individuale, varësisht nga rasti dhe arkëtohet me uljen e shumës së përlllogaritur nga kontributet e paguara, çdo ditë kur pranohen kontributet.

Kompensimi për menaxhim me mjetet konsiderohet se është marrë dhe përlllogaritet në çdo datë të vlerësimit, ndërsa arkëtohet në ditën e pestë të punës në muajin e vlerësimit.

Kompensimi për transferim parqet kompensim në para në rast se anëtari i fondit të detyrueshëm pensional (fondi të detyrueshëm ekzistues pensional) zgjedh të kalojë në një fond të detyrueshëm pensional të menaxhuar nga shoqëri tjetër për menaxhim me fondet pensionale (fondi i ardhshëm i detyrueshëm) me kusht që anëtari që kalon të ketë qenë anëtar i fondit detyrueshëm ekzistues pensional më shkurt se 24 muaj përpara se të kalojë në fondin e ardhshëm të detyrueshëm pensional. Ky kompensim paguhet nga anëtari i fondit të detyrueshëm pensional që i bashkohet fondit të detyrueshëm të ardhshëm pensional. Shoqëria që menaxhon me fondin e detyrueshëm pensional të cilit i bashkohet anëtari ose përfaqësuesi i asaj shoqërie, nuk mund ta paguajë këtë kompensim.

Shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale, përkatësisht shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale dhe vullnetare, e përcakton kompensimin për transferim nga fondi i detyrueshëm ekzistues pensional në fondin e ardhshëm, i cili nuk mund të jetë më i lartë se shumata e shënuara në tabelë, të cilat janë përcaktuar në bazë të numrit të ditëve nga data kur anëtari ka fituar statusin e anëtarit në fondin detyrueshëm ekzistues pensional deri në datën e transferimit të mjeteve në llogarinë individuale të anëtarit në fondin e ardhshëm të detyrueshëm pensional, përkatësisht:

Numri i ditëve	Kompensim për transferim
Numri i ditëve <720	15 euro
Numri i ditëve > 720	Nuk paguhet kompensim për transferim

Shuma e kompensimit përlllogaritet në kundërvlerë me denarë ekuivalent me euron sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës së mjeteve.

Si përjashtim, në rastin e anëtarësimit të parë në fondin e pensional, numri i ditëve përlllogaritet nga dita e parë e muajit për të cilin anëtari ka fituar të drejtën për të kontribuar në fondin e detyrueshëm pensional.

Kompensimi për transferim nuk paguhet në rastet në vijim:

- nëse shoqëria e cila duhet të bëjë transferimin e mjeteve nga njëri fond i detyrueshëm pensional në fondin tjetër të detyrueshëm pensional i ka rritur ose njoftuar për rritje të kompensimeve në periudhën prej gjashtë muajsh para datës së transferimit të mjeteve;

- nëse Agjencia dëshmon se personi i është bashkuar atij fondi të detyrueshëm pensional si rezultat i aktiviteteve të marketingut dhe reklamimit në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital;

- nëse është hapur procedura e falimentimit ndaj shoqërisë që menaxhon me atë fond të detyrueshëm pensional, ose miratimi për të menaxhuar atë fond të detyrueshëm pensional i është tërhequr ose anuluar;

- nëse anëtari nuk ka mjete në llogarinë individuale; ose

- në rast të bashkimit të shoqërisë që duhet të transferojë mjetet nga njëri në tjetrin fond të detyrueshëm pensional, në periudhën prej 180 ditësh nga bashkimi.

Është e rëndësishme që kompanitë të mos bëjnë diskriminim ndërmjet anëtarëve në aspekt të arkëtimit të kompensimeve. Për atë qëllim, të gjithë kompensimet shoqëria i arkëton në përqindjen e njëjtë nga të gjithë anëtarët e fondit të detyrueshëm pensional. Me përjashtim, kompensimi nga kontributet mund të ulet për anëtarët e fondit të detyrueshëm pensional të cilët kanë qenë vazhdimisht anëtarë të atij fondi të detyrueshëm pensional gjatë periudhave kohore të përcaktuara nga Agjencia dhe në shumat e përcaktuara nga shoqëria. Ulja e kompensimit nga kontributet do të bëhet në mënyrë të barabartë për të gjithë anëtarët që kanë qenë anëtarë të të njëjtit fond të detyrueshëm pensional në të njëjtën periudhë kohore.

Përveç kompensimeve të mësipërme, kompensimet e vetme që arkëtohen nga mjetet e fondit pensional janë provizionet transaksionale. Provizionet transaksionale janë kompensim për bursë të letrave me vlerë, kompensimi për depozituesin e letrave me vlerë dhe provizioni për personat juridikë që kryejnë shërbime me letra me vlerë të lidhura drejtpërdrejt me tregtimin e mjeteve të fondeve të detyrueshme pensionale.

9.2. NDRYSHIME NË KOMPENSIMET QË I ARKËTOJNË SHOQËRITË QË MENAXHOJNË ME FONDET E DETYRUESHME PENSIONALE

Shoqëria që menaxhon me fondin e detyrueshëm pensional është i detyruar t'i njoftojë me shkrim të gjithë anëtarët e fondit të detyrueshëm pensional për çdo propozim për rritjen e kompensimeve që i arkëton, së paku 6 muaj përpara prezantimit të tyre. Gjithashtu, shoqëria i dorëzon kopje të këtyre njoftimeve çdo personi që synon të nënshkruajë marrëveshje anëtarësimi në fondin e detyrueshëm pensional me atë shoqëri përpara nënshkrimit të marrëveshjes së anëtarësimi nga ai person. Nëse i siguruari lidh marrëveshje transferimi (përkatësisht marrëveshje anëtarësimi të përkohshëm deri më 1 janar 2014), detyrimisht i dorëzon për kontroll kopje e njoftimit që u është dërguar ose duhet t'u dërgohet anëtarëve të fondit të detyrueshëm pensional në lidhje me rritjen e kompensimeve.

Ky njoftim do të publikohet në ueb faqen e shoqërisë dhe të paktën në njërin prej gazetave ditore me më shumë tirazh në Republikën.

Në rast se shoqëria nuk e arkëton kompensimin maksimal nga kontributet e përcaktuara me ligj, shoqëria që menaxhon me fondet e detyrueshme pensionale është e detyruar t'i paraqesë Agjencisë kërkesë për miratimin e uljes ose rritjes së përqindjes së kompensimit nga kontributet. Ulja e përqindjes së kompensimit nga kontributet fillon të zbatohet nga data 1 e muajit që vijon më së shumti një muaj pas muajit në të cilin është shpallur ndryshimi. Agjencia përcakton afatin për fillimin e zbatimit të uljes së përqindjes së kompensimit nga kontributet. Rritja e përqindjes së kompensimit të kontributit fillon të zbatohet nga data 1 në muajin që vijon gjashtë muaj pas shpalljes së ndryshimit (p.sh., nëse rritja është publikuar në gazetë në cilëndo kohë gjatë muajit janarit 2006, kjo zbatohet nga data 1 gusht 2006).

Pasi shpallet, vendimi për uljen e përqindjes së kompensimit nga kontributet nuk mund të anulohet përpara datës së fillimit të zbatimit.

Shoqëria është e detyruar ta njoftojë Agjencinë nëse anulon rritjen e tarifës nga kontributet para datës së zbatimit dhe ta publikojë atë së paku në një nga gazetave ditore me më shumë tirazh në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në atë rast, shoqëria mund të rrisë sërish kompensimin nga kontributet, pas skadimit të së paku 2 muajve nga data e publikimit të anulimit.

9.3. NDRYSHIMET NË KOMPENSIMET QË I ARKËTOJNË SHOQËRITË QË MENAXHOJNË ME FONDET VULLNETARE PENSIONALE

Shoqëria e cila menaxhon me fondet pensionale vullnetare për punën e saj lidhur me menaxhimin e fondit pensional vullnetar arkëton kompensime nën kushte dhe mënyrë të përcaktuara në Ligjin për sigurim vullnetar pensional me financim kapital.

Shoqëria mund t'i arkëtojë vetëm kompensimet në vijim:

> kompensimin e kontributeve si përqindje e çdo kontributi të paguar në fondin vullnetar pensional, përpara shndërrimit të tyre në njësi kontabiliteti. Kompensimin nga kontributet e cakton shoqëria, por ai nuk mund të tejkalojë 7% të çdo kontributi të paguar;

> kompensimin mujor si përqindje e vlerës së mjeteve neto të fondit vullnetar pensional. Kompensimi mujor përcaktohet nga shoqëria, por nuk mund të kalojë 0.15% në muaj;

> kompensimin në rast transferimi të mjeteve në llogari individuale të anëtarit nga një fond vullnetar pensional në fond tjetër vullnetar pensional, me kusht që anëtari që kalon të ketë qenë anëtar i fondit vullnetar ekzistues pensional për më pak se një vit. Shuma maksimale e kompensimit në para për transferim përcaktohet nga Agjencia pas pëlqimit paraprak të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale.

Shoqëria përcakton shumat e kompensimit nga kontributet, kompensimin mujor nga aktivet neto dhe kompensimin e tranzicionit, si dhe masën e uljes së kompensimit nga kontributet ose kompensimin mujor nga aktivet neto në bazë të gjatësisë së anëtarësisë në fond vullnetar pensional në statutin e fondit vullnetar pensional që menaxhon dhe i shpjegon ato në prospektin informativ.

Kompensimi nga kontributet llogaritet dhe arkëtohet çdo ditë pune. Kompensimi nga kontributet llogaritet duke shumëzuar përqindjen e kompensimit së kontributit që arkëtohet me shumën e kontributeve të në çdo llogari individuale vullnetare ose llogari profesionale, varësisht nga rasti, dhe arkëtohet me uljen e shumës së përlllogaritur të kontributeve të paguara, çdo ditë kur pranohen kontributet.

Kompensimi mujor nga mjetet neto llogaritet në çdo datë vlerësimi, ndërsa arkëtohet njëherë në muaj.

Kompensimi për transferim është kompensim në para në rast se anëtari i fondit vullnetar pensional (fondi vullnetar ekzistues pensional) zgjedh të kalojë në fond vullnetar pensional të menaxhuar nga shoqëri tjetër për menaxhim me fondet pensionale (fondi i ardhshëm vullnetar pensional) me kusht që anëtari që kalon të ketë qenë anëtar në fondin vullnetar ekzistues pensional për më pak se 12 muaj përpara se të kalojë në fondin e ardhshëm vullnetar pensional. Ky kompensim paguhet nga anëtar i fondit vullnetar pensional gjatë transferimit të mjeteve nga një llogari individuale vullnetare në tjetrën kur anëtari kalon në fond tjetër vullnetar pensional, ndërsa gjatë transferimit të mjeteve nga një llogari profesionale në tjetrën, kur siguruesi kalon në fond tjetër vullnetar pensional, ky kompensim paguhet nga siguruesi. Kompensimi paguhet në xhiro llogarinë të shoqërisë që menaxhon me fondin vullnetar ekzistues pensional. Shoqëria ose përfaqësuesi i shoqërisë që menaxhon me fondin vullnetar pensional në të cilin qaset anëtari nuk lejohet ta paguajë këtë kompensim.

Shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale, përkatësisht shoqëria për menaxhim me fondet vullnetare pensionale, e përcakton kompensimin për transferimin nga një fond vullnetar ekzistues pensional në fond të ardhshëm, që nuk mund të jetë më e lartë se shumat e përcaktuara në tabelë e mëposhtme, të cilat përcaktohen në bazë të numrit të ditëve nga data kur anëtari ka fituar statusin e anëtarit në fondin vullnetar ekzistues pensional deri në datën e transferimit të mjeteve në llogarinë individuale vullnetare të anëtarit ose llogarinë profesionale të anëtarit të fondit të ardhshëm vullnetar pensional dhe atë:

Numri i ditëve	Kompensim për transferim
----------------	--------------------------

Numri i ditëve ≤360	10 euro
Numri i ditëve > 360	nuk paguhet kompensim për transferim

Shuma e kompensimit përlogaritet në kundërvlerë me denarë të euros sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës së mjeteve.

Kompensimi për transferim, nuk arkëtohet në rastet në vijim:

- nëse shoqëria e cila duhet të kryejë transferim të mjeteve nga njëri fond në tjetrin fond vullnetar pensional i ka rritur ose i ka njoftuar për rritje të kompensimeve, në periudhën prej 180 ditësh para datës së transferimit të tillë të mjeteve;
- nëse anëtari nuk ka mjete në llogarinë profesionale ose në llogarinë individuale vullnetare;
- nëse mjetet transferohen nga njëra llogari në tjetrën llogari profesionale dhe nga llogaria profesionale në atë vullnetare për shkak të ndryshimit të siguruesit ose për shkak të përjashtimit të nxënësit nga skema pensionale profesionale;
- nëse Agjencia dëshmon se personi është anëtarësuar në atë fond vullnetar pensional si pasojë e marketingut dhe aktiviteteve reklamuese në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për sigurim vullnetar pensional me financim kapital;
- nëse mbi shoqërinë që menaxhon me atë fond vullnetar pensional është hapur procedurë falimentimi ose leja për menaxhim me atë fond vullnetar pensional i është tërhequr ose anuluar; ose
- në rast të bashkimit të shoqërisë që duhet të kryejë transferim të mjeteve nga një fond në tjetrin fond pensional, në periudhë prej 180 ditësh pas bashkimit.

Është e rëndësishme që shoqëritë të bëjnë diskriminim ndërmjet anëtarëve në aspekt të arkëtimit të kompensimeve. Për atë qëllim të gjitha kompensimet shoqëria i arkëton në përqindjen e njëjtë nga të gjitha anëtarët e fondit pensional vullnetar, përveç në rast të anëtarëve që janë pjesëmarrës në skemën pensionale profesionale. Me përjashtim, kompensimi nga kontributet mund të zvogëlohet për të gjitha anëtarët e fondit vullnetar pensional të cilët vazhdimisht kanë qenë anëtarë të atij fondi pensional vullnetar në periudhat kohore të përcaktuara nga shoqëria. Zvogëlimi i kompensimit bëhet në mënyrë të barabartë për të gjitha anëtarët që kanë qenë anëtarë në fondin pensional vullnetar në periudhën e njëjtë kohore.

Krahas kompensimeve të lartpërmendura, kompensime të vetme tjera që arkëtohen nga mjetet e fondit pensional janë provizionet transaksionale. Provizionet transaksionale janë kompensimi për bursë të letrave me vlerë, kompensimi për depozituesin e letrave me vlerë dhe provizioni për personat juridikë që kryejnë shërbime me letra me vlerë drejtpërdrejt lidhur me tregtinë me mjete të fondeve pensionale vullnetare.

9.4. NDRYSHIME NË KOMPENSIMET QË I PAGUAJNË SHOQËRITË QË MENAXHOJNË ME FONDE VULLNETARE PENSIONALE

Shoqëria që menaxhon me fondin vullnetar pensional është e detyruar që t'i dorëzojë njoftim me shkrim çdo anëtari të fondit vullnetar pensional me të cilin menaxhon për çdo propozim për rritje të kompensimeve që i arkëton nga kontributet ose mjetet, së paku 180 ditë para futjes së tyre. Gjithashtu, shoqëria është e detyruar që t'i njoftojë edhe të gjitha anëtarët e pensionuar të fondit pensional për çdo propozim për rritje të kompensimit mujor për menaxhim me mjetet, së paku 180 ditë para futjes së tyre.

Ky njoftim i dorëzohet edhe Agjencisë. Për shkak të transparencës njoftimi i njëjtë publikohet në ueb faqen e shoqërisë dhe së paku në një gazetë ditore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Gjithashtu, kur anëtari kalon nga një fond në fondin tjetër pensional vullnetar shoqëria që menaxhon me fondin e ardhshëm vullnetar pensional i dorëzon për kontroll ekzemplar të këtyre njoftimeve.

9.5. KOMPENSIME TË CILAT I PAGUAJNË SHOQËRITË PENSIONALE

Shoqëritë pensionale nga mjetet personale paguajnë i kompensim ruajtësit të pronës për shërbimet që i kryen për ruajtjen e mjeteve të fondit pensional, kompensim për Agjencinë për kryerjen e funksioneve të saj për mbikëqyrjen dhe rregullimin e sigurimit pensional me financim kapital dhe kompensim të FSPIM për punët të cilat i kryen ky institucion në pajtim me Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital.

Shuma e kompensimit për ruajtësin e pronës do të përcaktohet në marrëveshjen e ruajtjes së pronës të lidhur ndërmjet shoqërisë dhe ruajtësit të pronës.

Shoqëria pensionale është gjithashtu përgjegjëse për kompensimin të cilin e arkëton Agjencia në baza mujore. Ky kompensim mujor do të llogaritet si përqindje e kontributeve të paguara në muajin paraprak në fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale të menaxhuara nga çdo shoqëri pensionale dhe do të paguhet nga mjetet e shoqërisë. Shuma maksimale e këtij kompensimi është 0.8% e çdo kontributi të paguar. Përveç kësaj, Agjencia arkëton kompensime tjera për shërbime dhe formularë të caktuar, trajnime, provime, regjistrim në regjistrin e agjentëve etj. Shuma e kompensimeve të arkëtuara nga Agjencia përcaktohet nga Këshilli i ekspertëve të Agjencisë, për të cilin pëlqim jep Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe do të publikohet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Gjithashtu, në pajtim me ndryshimet në Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital, nga 1 janari 2019 sërish² do të parashikohet detyrimi i çdo shoqëria që menaxhon fond të detyrueshëm pensional që t'i paguajë kompensim FSPIM. Përkatësisht, secila shoqëri nga mjetet e saj i paguan kompensim mujor FSPIM në shumën prej 0.1% të kontributit të paguar në muajin paraprak në fondin e detyrueshëm pensional me të cilin menaxhon.

10. TREGU FINANCIAR DHE TREGU I KAPITALIT

10.1. SISTEMI FINANCIAR

Gjithandej në botë sipërmarrësit janë në kërkim të mjeteve financiare dhe për atë qëllim shpesh i shfrytëzojnë shërbimet e sistemit financiar. Çdo sistem financiar përbëhet nga dy pjesë kryesore: tregje financiare dhe institucione financiare, të cilat mundësojnë kanalizim dhe koordinim të kursimit dhe investimeve në një ekonomi. Institucionet në sistemin financiar kanë për detyrë që t'i sjellin në lidhje njerëzit, duke i lëvizur mjetet nga ato që kanë tepriçë mjetesh te ato që kanë mungesë mjetesh. Kështu që, njerëzit që shpenzojnë më pak sesa që fitojnë quhen njësi ekonomike suficitare ose kursimtarë, ndërsa njerëzit që shpenzojnë më shumë sesa që fitojnë quhen njësi ekonomike deficitare.


Si zëvendësim për mjetet e huazuara, njësitë ekonomike suficitare vendosin kërkesa financiare ndaj njërive ekonomike deficitare, përkatësisht marrin instrumente financiare në zotërim të tyre. Prandaj, investimi është një mundësi për të rritur kapitalin që zotërohet. Investimet janë huamarrje nga tepricat financiare të cilat i bëjnë njësitë ekonomike suficitare, të cilat në kohën e duhur do të heqin dorë nga konsumi i të mirave reale.

² Ky obligim u shfuqizua nga 1 qershor 2013

Paratë e kursyera mund të vendosen në bankë, të blihen letra me vlerë ose të ruhen "nën jastëk". Por a do të rriten ato në rastin e fundit? Përgjigja është: JO! Prandaj investimi është një mundësi për ta rritur kapitalin që e zotërojmë

Për shembull, Aleksandri ka trashëguar një shumë të konsiderueshme parash. Në vend që t'i ruajë "nën jastëk", ai mund t'ia japë hua kompanisë së Elenës, e cila do të dijë si t'i rrisë ato para. Kjo do të arrijë efekte të shumëfishta: kompania e Elenës do ta përmirësojë situatën në të cilën ndodhet, ndërsa Aleksandri pas skadimit të periudhës së dakorduar do ta marrë shumën prapa bashkë me kamatën e dakorduar.

Mjetet nga kursimtarët te investitorët mund të lëvizin drejtpërdrejt (nëpërmjet tregjeve financiare) ose tërthorazi (nëpërmjet ndërmjetësve financiarë).



10.2. TREGJET FINANCIARE

Tregjet financiare mundësojnë transferim të drejtpërdrejtë të mjeteve nga kursimtarët ndaj investuesve. Ato mund të ndahen në mënyrën në vijim:

- Tregu primar, paraqet treg në të cilin për herë të parë tregtohet me ndonjë letër me vlerë;
- Tregu dytësor, e paraqet çdo blerje ose shitje të letrave me vlerë të lëshuara paraprakisht;

Tregjet dytësore më tutje mund të ndahen në:

- Bursë të letrave me vlerë e cila paraqet treg të organizuar dhe të rregulluar dytësor të letrave me vlerë. Ajo paraqet lokacion të centralizuar ku takohen blerësit dhe shitësit e letrave me vlerë dhe tregtojnë me ato. Bursa punon sipas rregullave të përcaktuara rreptësisht. Shërbimet e saj mund t'i shfrytëzojnë vetëm anëtarët e bursës – shoqëritë brokere, ndërsa mund të tregtohet vetëm me letra me vlerë që kuotojnë në bursë;
- Tregu përmes sportelit është treg jashtë burse, pa lokacion qendror. Atë e përbëjnë grup dilerësh që kanë leje për tregtim me letra me vlerë nga bursa. Në këtë treg tregtohet përmes vizitës ose telefonimit të ndonjë dileri, duke përdorur sistem kompjuterik që i lidh dilerët e sportelit;

Për funksionimin e tregjeve të letrave me vlerë, është me rëndësi ekzistimi i institucioneve në vijim:

- Komisioni për Letra me Vlerë që paraqet organ shtetëror i cili e rregullon punën e tregjeve me letra me vlerë;
- Depozituesi qendror për letra me vlerë është person juridik që mban regjistër të letrave me vlerë, jep ISIN të letrave me vlerë, kryen barazim të transaksioneve dhe jep shërbime tjera plotësuese të emetuesve dhe poseduesve të letrave me vlerë;

10.3. NDËRMJETËSUESIT FINANCIARË

Depozituesit financiarë janë institucione financiare që qëndrojnë ndërmjet kursimtarëve dhe investuesve. Ato i shërbejnë edhe njësitë ekonomike suficitare dhe deficitare në mënyrë të plotë dhe mundësojnë transferim të drejtpërdrejtë të mjeteve ndërmjet tyre, duke zvogëluar rreziqe dhe shpenzime të caktuara.

Mënyra në të cilën punojnë ndërmjetësuesit financiarë do të dukej kështu: Aleksandri dhe Elena kanë tepriçë të lartë dhe në vend që t'i ruajnë “nën jastëk” kanë vendosur t'i deponojnë te banka A (ndërmjetësuesi financiar). Do të thotë banka A i mobilizon mjetet nga njësitë ekonomike suficitare në formë të depozitave kursyese. Por, banka A këtë shumë nuk do ta ruajë te vetja, por do t'ia japë si hua ndonjë ndërmarrjeje që do ta shfrytëzojë për realizim të qëllimeve të tyre. Pas skadimit të afatit të dakorduar banka A do t'ua kthejë shumën e deponuar të Aleksandrit dhe Elenës të zmadhuar për kamatën e dakorduar.

1. Fondi investues është ndërmjetësues financiar i formuar me qëllim për t'i mbledhur mjetet e lira në para nga investuesit e vegjël. Shoqëria për menaxhim me fondet është personi juridik i cili e themelon fondin dhe menaxhon me mjetet e fondit dhe ka status të personit juridik. Për dallim nga shoqëria për menaxhim me fondet, fondi investues nuk është person juridik, por thjesht paraqet masë nga parash të disponueshme për investim.

Por pse njerëzit t'i përdorin fondet investuese si ndërmjetësues në tregtim? Kjo është për shkak të përparësive që i kanë ato:

- Denominimi;
- Diversifikimi i rrezikut;
- Menaxhmenti profesional;

Fondet investuese mund të jenë:

- Fondet e hapura investuese – që themelohet me mbledhjen e mjeteve përmes thirrjes publike për shitje të dokumenteve për pjesëmarrje;
 - Fondet e mbyllura investuese – që themelohet me mbledhjen e mjeteve në para përmes thirrjes publike për shitje të aksioneve;
2. Investuesit institucionalë janë ndërmjetësues financiarë të cilat i investojnë mjetet e investuesve tjerë ose mjeteve personale, me qëllim realizimin e leverdis. Investuesit institucionalë janë: bankat, fondet investues, fondet pensionale dhe shoqëritë e sigurimit.
 3. Shtëpia e brokerit është e personit juridik, që nga Komisioni për Letra me Vlerë ka marrë licencë për kryerje të punëve me letra me vlerë. Brokëri paraqet ndërmjetësues në tregtimin me letra me vlerë që paraqitet në emër të tij, e për llogari të klientëve. Detyra e tij është e thjeshtë për t'i blerë blerësit dhe shitësit.
 4. Dileri është ndërmjetësues financiar i cili për dallim nga brokëri blen dhe shet letra me vlerë në emër të tij dhe për llogari të tij. Kështu për shembull dileri do të blejë instrumente financiare nga shitësi, duke shpresuar se do të mund t'i shesë në të ardhmen me gjysmë çmimi.
 5. Këshilltari investues është personi i cili investuesve u jep këshilla në aspekt të investimit. Këshilltari investues doemos duhet të jetë person i autorizuar i cili ka dhënë provimin e veçantë profesional për kryerje të punëve të këshillimit investues.

10.4. INSTRUMENTET FINANCIARE

Instrumentet financiare paraqesin kërkesa të pronarëve të tyre (investues financiarë) ndaj të ardhurave dhe pronës së individit, firmës ose institucionit që i ka shitur ose emetuar ato instrumente. Njëkohësisht instrumentet financiare janë obligim për ato që i kanë shitur (emetuar) dhe premtimi i tyre se do t'ua kryejnë pagesat e dakorduara të blerësve të instrumenteve (investuesit financiarë).

Kështu për shembull, nëse ndonjë firmë për prodhimin e ushqimit dëshiron të ndërtojë uzinë një prej mënyrave për të mbledhur mjete për atë qëllim është të emetojë obligacione (lloj të instrumentit financiar). Njerëzit që do t'i blejnë obligacionet kanë kërkesë për kthim të mjeteve dhe kamatës në bazë të periudhës kohore, ndërsa fabrika për prodhim të ushqimit do të ketë obligim t'i kthejë ato mjete.

Instrumentet financiare janë të këmbyeshme dhe të zëvendësueshme lehtë. Ato shpesh paraqesin copë letrë ose informacion të ruajtur në kompjuter, kanë vlerë të vogël si mall, ndërsa shpenzimet për transportimin dhe ruajtjen e tyre janë shumë të ulëta.

Lloj i veçantë i letrave me vlerë janë instrumentet financiare. Letrat me vlerë paraqesin kontratë që atij që e posedon i jep të drejtë të caktuar, e cila mund të shfrytëzohet vetëm me kushtin e pronësisë ligjore të atyre letrave. Ato kanë vlerën e tyre dhe mund të tregtohen. Sipas legjislacionit maqedonas, letra me vlerë nënkupton aksion, obligacion, bono thesari, bono komerciale, bono shtetërore, certifikatë për depozitë dhe derivate financiare. Letrat me vlerë dallohen dhe identifikohen nga ISIN-i i tyre. ISIN-i është numër ndërkombëtar identifikimi për letrat me vlerë, i cili u caktohet letrave me vlerë në një emetim, ku të gjitha letrat me vlerë nga ai emetim kanë të drejta/kushte identike.

Në procesin e blerjes dhe shitjes, investitorët përpiqen të marrin një raport të favorshëm midis rrezikut dhe të ardhurave. Bazuar në këtë, ata formojnë portofolin e tyre, i cili përfaqëson shumën e të gjitha investimeve (aksione, obligacione dhe letra të tjera me vlerë).

Aksionet janë letra me vlerë të kapitalit. Janë letra me vlerë që vërtetojnë pronësinë e mjeteve të investuara në shoqërinë aksionare. Me blerjen e aksioneve bëhesh aksioner në shoqërinë aksionare. Aksioner është çdo person që zotëron aksione që i japin të drejtën për të marrë pjesë në fitimin e shoqërisë

aksionare (dividend) dhe të drejtën për të marrë pjesë në menaxhim nëpërmjet pjesëmarrjes në kuvendin e aksionarëve të shoqërisë dhe të drejta të tjera.

Ekzistojnë llojet e aksioneve në vijim:

- Sipas përmbajtjes së të drejtave: aksionet e zakonshme dhe aksionet prioritare;
- Sipas të drejtës së votës: aksionet e zakonshme me të drejtë vote, aksionet prioritare pa të drejtë vote dhe aksionet prioritare me të drejtë vote;
- Sipas radhitjes së emetimit: aksionet themeluese nga emisioni i parë dhe aksionet nga emisionet e ardhshëm;

Nëse Elena ka tepriçë mjeteve që dëshiron t'i investojë më së miri është që fillimisht të konsultohet me brokerin e tij. Kështu, për shembull, Elena mund t'i japë urdhëresë brokerit të tij dhe t'i blejë aksione të zakonshme me të drejtë vote nga kompania B. Pasi brokeri t'i blejë aksionet, me çmim më të mirë të cilin mund ta sigurojë në atë moment, Elena bëhet aksionare, njëri nga pronarët në shoqërinë aksionare. Me atë që Elena ka të drejtë të marrë një pjesë të fitimit të shoqërisë në formë të dividendit, e gjithashtu ka të drejtë edhe të votojë në kuvendin e aksionarëve i cili shpesh mbahet njëherë në vit.

Obligacionet janë letra debitore me vlerë me të ardhura fikse, në bazë të të cilave emetuesi obligohet që t'ia kthejë investuesit shumën e huazuar plus kamatën për periudhë të caktuar kohore. Për dallim nga aksionet, obligacionet kanë datë maturimi dhe nuk mbajnë të drejtën e pjesëmarrjes së shoqërisë aksionare. Ekzistojnë më shumë lloje obligacionesh:

- Sipas institucioneve që emetojnë: shtetërore, komunale dhe korporative;
- Sipas afatit të maturimit: afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë;
- Sipas mënyrës së sigurimit të të drejtave: të garantuara, të pagaruara dhe obligacione të siguruar me hipotekë;
- Sipas mënyrës së realizimit të të drejtës së kamatës: kuponë dhe pa kuponë;
- Sipas kamatës: pa kamatë, obligacione me kamatë fikse dhe obligacione me kamatë variabile;

Aleksandri ka vendosur që me tepriçën e mjeteve personale të blejë obligacion me afat maturimi 5 vjeçar nga kompania A. kompania A obligohet që Aleksandërit t'ia paguajë shumën e kamatës në periudhë të caktuar (gjysmë vjetor, vjetor), e në fund të periudhës edhe shumën bazë. Në atë mënyrë Aleksandri duhet të fitojë vlerë më të madhe sesa atë që e ka investuar fillimisht.

Lloj tjetër të instrumenteve financiare janë depozitat bankare. Ato përbëjnë kërkesa në para nga personi i cili i ka deponuar mjetet në bankën. Ekzistojnë disa depozita:

- Sipas arkëtimit mund të jenë: depozita të afatizuara (të arkëtueshme sipas afatit të caktuar) dhe depozita të paafatizuara (të arkëtueshme menjëherë);
- Sipas kamatës mund të jenë: depozita me kamatë dhe depozita pa kamatë;
- Sipas shkallës së kamatës mund të jenë: depozita me shkallë fikse ose shkallë variabile të kamatës;

Çdo tepriçë të mjeteve në para nuk është e domosdoshme që Elena ta përdorë për blerje të letrave me vlerë për të realizuar të ardhura. Ajo mund t'i vë paratë në bankë në formë të depozitës. Ndërkaq Elena duhet t'i shqyrtojë të gjitha mundësitë që ia ofrojnë bankat dhe ta zgjedhë atë mundësi që sipas saj është më e volitshme. Pasi do ta bëjë zgjedhjen e saj Elena duhet të lidhë marrëveshje për depozitë me bankën e zgjedhur. Në atë marrëveshje do të ceket shuma e deponuar, periudha kohore dhe kamata që duhet ta pranojë Elena pas skadimit/gjatë periudhës së caktuar kohore. Pas skadimit të periudhës Elenës do t'i kthehen mjetet e zmadhuara për vlerën e kamatës. Nëse ajo vendos që t'i marrë mjetet para skadimit të afatit të dakorduar, banka do t'i përlllogarisë kamatë ndëshkimore. Por çfarë bën banka me mjetet gjatë asaj kohe? Ajo mund t'i investojë në ndonjë kompani tjetër (në formë të huas ose përmes blerjes së letrave me vlerë), ndërsa

mund të blejë edhe letra me vlerë të cilat i lëshon shteti (që paraqesin plasman më të sigurt). Do të thotë edhe me këtë instrument financiar shkaktohen efekte të shumëfishta pozitive në ekonomi.

10.5. LLOJE TË RAPORTEVE FINANCIARE THEMELORE

Raportet financiare janë pjesë e rëndësishme e punës financiar. Të dhënat nga raportet financiare mund të përdoren për miratimin vendimeve të rëndësishme gjatë investimit. Ekzistojnë disa lloje themelore të raporteve financiare:

- a) Bilanci i gjendjes paraqet specifikim të burimeve të shoqërisë (mjete) bashkë me obligimet (borxhet) dhe kapitali pronësor i një dite të caktuar ose pasqyra kohore;
- b) Bilanci i suksesit i tregon rezultatet neto nga puna e shoqërisë së caktuar në periudhën e caktuar kohore (muaji, tremujor ose viti);
- c) Raporti për fluksin e parave të gatshme i paraqet lëvizjet kryesore të mjeteve të gatshme gjatë një viti;
- ç) Raporti për ndryshime të kapitalit i paraqet uljet dhe rritjet e kapitalit.

11. INVESTIMI I MJETEVE TË FONDEVE PENSIONALE

Shoqëria pensionale është e detyruar që të menaxhojë me mjetet e fondeve pensionale dhe nuk guxon ta bartë përgjegjësinë për atë te personat e tjerë. Si përjashtim e kësaj, shoqëria pensionale mund të menaxhojë me mjetet e fondeve pensionale jashtë vendit për t'ia besuar menaxherit ose menaxherit të mjeteve me seli jashtë vendit, nëse ato kanë autorizim ligjor për atë në pajtim me ligjet e shtetit amë.

Mjetet e fondeve të detyrueshme pensionale investohen në pajtim me Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital, ndërsa mjetet e fondeve pensionale vullnetare investohen në pajtim me Ligjin për sigurim vullnetar pensional me financim kapital dhe strategjinë investuese, me qëllim realizimin e të ardhurave më të larta vetëm në favor të anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale dhe përmes diversifikimit dhe analizës financiare të minimizohet rreziku nga humbjet:

- që kanë ndodhur për shkak të mospagesës së emetuesit ose palës tjetër kontraktuese;
- që dalin nga ndikimi i tregjeve vendore dhe të huaja financiare;
- në vlerën reale të mjeteve të fondit pensional për shkak të inflacionit; dhe
- që janë si pasojë e shitjes së mjeteve të fondit pensional për shkak të sigurimit të likuiditetit të fondit pensional.


Gjatë menaxhimit dhe kontrollit të investimit të mjeteve të fondit pensional anëtarët e këshillit drejtues, mbikëqyrës dhe personi përgjegjës për vendimet investuese në shoqërinë pensionale janë të detyruar që të zbatojnë shkallë të kujdesit, efektivitetit dhe shkathtësive që do t'i aplikojë një njeri racional gjatë investimit të mjeteve personale. Çdo anëtar i këshillit drejtues dhe mbikëqyrës duhet ta përmbushë obligimin e tij në pajtim me detyrat e tij fiduciare dhe duhet të sigurojë aplikim të tyre nga ana e të punësuarit dhe të jetë i angazhuar me punë në shoqëri. Çdo shoqëri pensionale duhet të ketë dokument për strategji investimi për çdo fond pensional me të cilin menaxhon dhe ta respektojë atë strategji. Strategjia e investimit është një dokument i shoqërisë pensionale për investimin e mjeteve në lloje të ndryshme instrumentesh financiare me qëllim të sigurimit të të ardhurave më të larta të fondit pensional me të cilin ajo menaxhon, duke marrë parasysh qëllimet, tolerancën ndaj rrezikut dhe horizontin e investimit, në interes të anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondit pensionale. Është një dokument afatgjatë që ka të bëjë së paku shtatë

vite dhe duhet të rishikohet të paktën një herë në tre vite ose sa herë që ka dëshmi se supozimet mbi të cilat bazohet strategjia e investimeve kanë ndryshuar. Strategjia e investimit duhet të përmbajë: korniza të përgjithshme të procedurave për menaxhimin e mjeteve të fondit pensional, qëllimet investuese të fondit pensional, alokimi strategjik i mjeteve të fondit pensional, risqet e investimeve dhe proceset e menaxhimit të riskut dhe monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të strategjisë së investimit. Korniza e përgjithshme e procedurave për menaxhimin e mjeteve të fondit pensional përfshin strukturën e përgjegjësive investuese dhe procesin e marrjes së vendimeve për investime, metodologjinë, dinamikën dhe periudhat e llogaritjes, vlerësimit, raportimit dhe publikimit të rezultateve të investimeve dhe faktorëve të marrë parasysh gjatë procesit të përgatitjes së strategjisë së investimit duke përfshirë analizën e rezultateve të kaluara, analizën e tregjeve dhe instrumenteve financiare dhe supozime të qarta dhe të justifikuara mbi të cilat bazohet strategjia. Strategjia e investimit duhet të përmbajë të ardhura të planifikuara nominale dhe reale për fondin pensional, qëllime të qarta dhe të matshme investimi përmes një standardi të përcaktuar qartë dhe mënyrës se si do të arrihen të ardhurat e planifikuara. Gjithashtu, duhet të theksohet shpërndarja strategjike e mjeteve të fondit pensional, përkatësisht alokimi afatgjatë i mjeteve sipas klasave të instrumenteve financiare në të cilat planifikohet të investohen mjetet e fondit pensional, kufizimi sipas llojeve të instrumenteve dhe kufijtë e devijimit nga kufizimi dhe kriteret për përzgjedhjen e instrumenteve në portofol. Strategjia e investimit duhet të përmbajë gjithashtu informacion në lidhje me rreziqet e investimit dhe proceset e menaxhimit të riskut, si dhe mënyrën e monitorimit, kontrollit dhe vlerësimit të zbatimit të strategjisë së investimit.

Gjithashtu, të paktën një herë në vit, për çdo fond pensional që e menaxhon, shoqëria përgatit dokument se si të zbatohet strategjia e investimit për 12 muajt e ardhshëm, duke përfshirë investimin strategjik të çdo klase të mjeteve, kufizimet e investimeve të brendshme dhe ekspozimin ndaj rreziqeve.

Për të realizuar parimet e sigurisë së investimeve pensionale dhe diversifikimin e tyre, është e nevojshme të vendoset kufi ku mund të investohen mjetet (në cilat lloje instrumentesh dhe në cilat vende) dhe të përcaktohen shumat maksimale të investimit të fondeve në lloje të caktuara instrumentesh, numrash, botuesish etj.

Duke pasur parasysh, mjetet e fondit të detyrueshëm pensional, përkatësisht fondit vullnetar, mund të investohen vetëm në llojet e instrumenteve të renditura në tabelën në vijim:

Lloji i instrumentit	Fondi i detyrueshëm pensional	Fondi vullnetar pensional
Depozita në banka që kanë leje të lëshuar nga BPRMV, nëse bartin kamatë	✓	✓
Obligacionet dhe letrat tjera me vlerë që i ka emetuar ose për të cilat garanton BPRMV	✓	✓
Certifikatat për depozitë, bono komerciale dhe obligacione të emetuara ose të garantuara nga bankat që kanë leje të emetuar nga BPRMV	 ✓	✓
Letra me vlerë në bazë të hipotekës së emetuar nga bankat që kanë leje të emetuar nga BPRMV	✓	✓
Obligacione dhe letra me vlerë që i emeton ose për të cilat garanton RMV në tregun vendor	✓	✓
Aksionet nga shoqëritë aksionare vendore të cilat nuk janë mbyllur fondet investuese, të emetuara në bazë të lejes nga KLV e RMV dhe që kotojnë në tregun zyrtar ose tregtohen në tregun e shoqërive aksionare me obligime të veçanta për njoftim në kuadër të tregut të rregullt të bursës së letrës me vlerë ose në tregun tjetër të organizuar të letrave me vlerë në RMV që e kontrollojnë KLV;	✓	✓
Obligacione të emetuara në bazë të lejes nga KLV e RMV dhe që kotojnë në tregun zyrtar të bursës së letrave afatgjate me vlerë ose në treg tjetër të organizuar të letrave me vlerë në RMV që e kontrollojnë KLV, të emetuara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe nga shoqëritë aksionare vendore që nuk janë banka	✓	✓
Bono komerciale të emetuara nga shoqëritë aksionare të klasës së parë në RMV që nuk janë banka	✓	✓
Dokumente për pjesëmarrje dhe aksione të fondeve investuese të regjistruara në KLV të RMV		
- Fonde të hapura investuese	✓	✓
- Fonde të mbyllura investuese	✓	
-fonde investuese private mjetet e të cilave investohen në aksione dhe pjesëmarrje të shoqërive mikro, vogla dhe të mesme në RMV, të përcaktuara me Ligjin për shoqëri tregtare	✓	
Obligacione dhe letra tjera me vlerë të emetuara nga qeveria e huaj dhe bankat qendrore të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian ose të OECD	✓	✓
Letra debitore me vlerë që kanë rejting të rekomadueshëm për investim sipas agjencive të rejtingut të kredisë, të emetuara nga	✓	✓

kompani ose banka joshitetërore, të huaja ose banka nga shtetet anëtare të BE-së ose OECD		
Letrat debitoare me vlerë që kanë rejting të rekomandueshëm për investim sipas agjencive ndërkombëtare të kredisë, të emetuara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale, nga vendet anëtare të BE-së dhe vendet anëtare të OECD-së		√
Letrat debitoare me vlerë të emetuara nga Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve dhe Banka Botërore		√
Aksionet e emetuara nga kompanitë ose bankat e huaja që kanë rejting të rekomandueshëm për investim sipas rejtingut kreditor ndërkombëtar, me të cilat tregtohet në bursat kryesore në shtetet anëtare të BE-së ose OECD-së.	√	√
Dokumentet për pjesëmarrje, aksione dhe instrumente tjera të emetuara nga fonde të autorizuara investuese me seli në shtetet anëtare të BE-së ose të OECD-së që kanë investuar kryesisht në instrumente që kotojnë në bursat në ato shtete dhe politika investuese e të cilave lejon shfrytëzim të instrumenteve derivate më së shumti deri në 20% nga mjetet e fondit investues, me qëllim të vetëm për mbrojtjen e mjeteve dhe detyrimeve të fondit investues ose për realizim efikas të qëllimeve të politikës së fondeve investuese që i ndjekin performansat e indeksit të caktuar	√	
Dokumente për pjesëmarrje, aksione dhe instrumente tjera të emetuara nga fonde të autorizuara investuese me seli në shtetin anëtar të BE-së ose OECD-së që kanë investuar kryesisht në instrumente që kotojnë në bursat në ato shtete.		√

Me qëllim sigurimin e diversifikimit të investimeve të fondeve pensionale, investimet në llojet e caktuara të instrumenteve u nënshtrohen kufizimeve në vijim:

Investime jashtë vendit (BE dhe OECD)*	50%
Letra me vlerë të garantuara nga RMV në tregun vendor ose BPRMV	80%
Depozitat bankare, certifikatat për depozitë, bonot komerciale, letrat me vlerë në bazë të hipotekës nga bankat vendore**	60%
Obligacionet e emetuara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe nga shoqëritë aksionare vendore që nuk janë banka dhe bono komerciale nga shoqëritë aksionare që nuk janë banka***	40%
Aksionet nga shoqëritë aksionare vendore	30%
Dokumentet për pjesëmarrje dhe aksione të fondeve investuese maqedonase****	5%

*Në kuadër të këtij kufizimi më së shumti 30% të vlerës së fondit të detyrueshëm pensional mund të investohet në letra me vlerë të emetuara nga kompanitë, bankat ose fondet investuese të huaja joshitetërore, ndërsa më së shumti 30% të vlerës së fondit vullnetar pensional mund të investohet në letra me vlerë të emetuara nga kompani, banka, fonde investuese të huaja joshitetërore ose nga njësitë e vetëqeverisjes lokale jashtë vendit.

*** Në kuadër të këtij kufizimi më së shumti 30% e vlerës së fondit të detyrueshëm pensional mund të investohet në depozita bankare.*

****Në kuadër të këtij kufizimi më së shumti 1,5% nga mjetet e fondit të detyrueshëm pensional mund të investohet në dokumente për pjesëmarrje të fondeve investuese private*

***** Në kuadër të këtij kufizimi më së shumti 1,5% e mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional mund të investohet në dokumente për pjesëmarrje të fondeve investuese private*

Për shkak të shmangies së përqendrimit të investimit në emetues ose instrument të caktuar, me ligj janë rregulluar edhe shumat më të larta të investimeve në letra me vlerë nga vlera të emetuara nga emetues i njëjtë dhe shumat më të larta të investimeve në letrën e veçantë të vlerës, në të cilat mund të investojnë mjetet e një fondi pensional. Gjithashtu, me ligj rregullohet edhe shumat më të larta të mjeteve të fondeve pensionale të investuara në depozita dhe certifikata për depozitë në një bankë dhe në bankat e lidhura reciprokisht. Mjetet e fondeve pensionale nuk guxojnë të investojnë në llojet e instrumenteve në vijim:

- aksionet, obligacionet dhe letrat tjera me vlerë që nuk kotojnë në tregun zyrtar ose me të cilat nuk tregtohet publikisht;
 - instrumentet me të cilat nuk mund të disponohet juridikisht;
 - të mirat materiale të cilat rrallë kotojnë në tregjet e organizuara dhe vlerësimi i të cilave është e pasigurt, për shembull antikitetet, veprat artistike dhe mjetet motorike;
 - prona e patundshme dhe çfarëdo pjesëmarrje në pronën e patundshme përveç letrave me vlerë të emetuara në bazë të hipotekës dhe investimit të drejtpërdrejtë përmes fondeve investuese;
 - aksione, obligacione dhe letra me vlerë të lëshuara nga:
 - aksionari i shoqërisë pensionale;
 - ruajtësi i pronës së fondit pensional dhe
 - personat e lidhur me subjektet e cekura
 - marrëveshje-fjuçers, marrëveshje opsionale, marrëveshje forvard dhe instrumente tjera derivative, përveç investimit përmes fondeve investuese në pajtim me kufizimet e rregulluara të fondet e detyrueshme pensionale dhe
 - depozitat bankare në bankat që janë aksionarë të shoqërive pensionale, dhe
 - instrumentet bankare në banka që janë aksionarë të shoqërisë pensionale, dhe
 - instrumente tjera të rregulluara nga Agjencia, në të cilat investimi do të jetë në kundërshtim me interesat e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale.
- Për shkak të mjeteve të fondeve pensionale dhe shmangies së konfliktit të interesave të shoqërisë pensionale nuk guxon:
- t'i shesë mjetet e fondit pensional jo vetëm vetvetiu, ruajtësi i pronës, menaxheri i huaj i mjeteve, si dhe siguruesit që kanë skema pensionale profesionale janë përfshirë në fondin pensional (në rast të fondit pensional vullnetar) dhe personat e lidhur me ndonjë prej këtyre personave, përveç përmes transaksionit të kryer përmes bursës së letrave me vlerë të autorizuar nga Komisioni i Letrave me Vlerë i Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht organi kompetent përkatës në rast të investimit të mjeteve jashtë vendit;
 - të blejë me mjetet e fondit pensional mjete nga vetvetja, ruajtësi i pronës, menaxheri i huaj i mjeteve, si dhe nga siguruesi që kanë skema pensionale profesionale të përfshira në fondin pensional (në rast të fondit pensional vullnetar) dhe personi i lidhur me ndonjë prej këtyre personave, përveç përmes transaksionit të kryer përmes bursës së letrave me vlerë të autorizuar nga Komisioni për Letra me Vlerë i Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht organi kompetent përkatës në rast të investimit të mjeteve jashtë vendit.

- T'i përdorë mjetet e fondit pensional për miratimin e huave dhe garancive, përveç garancive për huamarrje për përmirësim të likuiditetit të fondit.
Tregtimi me letra me vlerë i fondeve pensionale bëhet në tregje të rregulluara sekondare të kapitalit, në tregje përmes sportelit dhe në tregje primare të instrumenteve që i përmbushin kushtet e lartpërmendura ligjore.
Tregtimi sekondar me letra me vlerë në Republikën e Maqedonisë së Veriut bëhet përmes bursës dhe tregut përmes sportelit të organizuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pajtim me Ligjin për letra me vlerë.
Tregtimi sekondar me letra me vlerë jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut bëhet në tregje të rregulluara të instrumenteve financiare në pajtim me nenin 2 paragrafi (1) pika 13) e Ligjit për fonde investuese. Ndërkaq duhet të përmbushen kushtet në vijim:
 - a) Instrumentet financiare që tregtohen në sistemin e organizuar ose multilateral (Organized Trading Facility – OTF dhe Multilateral Trading Facility – MTF) duhet të jenë të kuotuar paraprakisht në bursë në vendin anëtar të BE-së ose OECD-së;
 - b) Marrëveshja për blerje të aksioneve ose pjesëmarrjeve në fondet investuese duhet të nënshkruhen me së paku një operator tregtar që siguron tregtim me çmime të cilat nuk dallohen dukshëm nga çmimi i bursës së aksioneve të fondeve investuese në të cilat investohet përkatësisht nga vlera neto e fondit investues dhe
 - c) Shtëpia e dilerit që kryen tregtim të tregjeve përmes sportelit duhet të ketë kapital më shumë se 500 milionë euro.

12. PENSIONE DHE KOMPENSIME PENSIONALE

12.1. *PARIMET E FINANCIMIT DHE PËRLLOGARITJA E PENSIONEVE*

Pensioni do të thotë sigurimi i të ardhurave në pleqëri. Sigurimi pensional zakonisht siguron mbrojtje nga rreziqet pleqëri, invaliditet dhe vdekje përmes serisë së pagesave periodike (shpesh çdo muaj) personit të siguruar deri në fund të jetës ose familjes së tij. Ekzistojnë mënyra dhe parime të ndryshme të financimit të pensioneve (faza e akumulimit të mjeteve për pensione) dhe mënyra të ndryshme të përllogaritjes dhe pagesës së tyre (faza e deakumulimit të mjeteve për pensione). Mënyrat e financimit dhe pagesës së pensioneve në një shtet varen nga struktura e sistemit pensional në atë shtet, i cili varet drejtpërdrejt nga gjendjet ekonomike dhe demografike në shtet. Gjithashtu, ndikim ka edhe kultura dhe shprehitë dhe perceptimet e tij të kursimit për pension, llojet e pensionit dhe për mënyrat e pagesës së pensionit.

Në përgjithësi ekzistojnë dy mënyra të financimit të pensioneve:

- **PAYG (*Pay As You Go*)** – mënyra tradicionale e financimit të pensioneve, të bazuar në solidaritetin e gjeneratës, ku kontributet e paguara nga të siguruarit aktualë shpenzohen menjëherë për pagesë të pensioneve të pensionistëve aktualë.
- ***Sigurimi pensional me financim kapital*** – kontributet e paguara për çdo të siguruar paguhen dhe evidentohen në llogarinë e tij individuale, investohen, akumulohen dhe në fund paguhen për pension personal të të siguruarit.

Në përgjithësi ekzistojnë dy parime të përllogaritjes së pensioneve:

- ***Parimet e pensioneve të definuara (DB – defined benefit)*** – pensioni është paracaktuar (si përqindje e bazës pensionale përkatësisht rrogave) dhe nuk është e lidhur drejtpërdrejt me

kontributet e paguara, por shkallën e kontributit në mënyrë plotësuese mund të përshtatet varësisht nga nevoja e financimit të pensionit të premtuar.

- **Parimet e kontributeve të definuara (DC – defined contributions)** – shkalla e kontributit është paracaktuar, ndërsa pensioni caktohet në momentin e pensionimit dhe varet drejtpërdrejt nga mjetet e akumuluar.

12.2. MËNYRA E PAGESËS SË PENSIONEVE DHE KOMPENSIMEVE PENSIONALE NGA SISTEMET PENSIONALE ME FINANCIM KAPITAL ME KONTRIBUTE TË DEFINUARA

Llojet themelore të pagesave të pensioneve nga sistemet me financim kapital me kontribute të definuara janë tërheqjet e programuara, anuitetet dhe kombinimi i tyre.

Tërheqja e programuar paraqet seri të pagesave fikse ose variabile me ç’rast pensionisti tërheq vazhdimisht një pjesë të mjeteve të akumuluar në llogari të tij, ndërsa pjesa tjetër mbetet në llogari edhe më tutje investohet. Do të thotë pensionisti edhe më tutje mbetet në fondin pensional me cilësi specifike të anëtarit të pensionuar. Këto tërheqje të programuara i paguan shoqëria pensionale nga llogaria e anëtarit të pensionuar në fondin pensional, çdo muaj, deri në fund të jetës së pensionistit ose derisa ka mjete në llogarinë e pensionistit.

Lartësia e tërheqjeve të programuara për herë të parë përllogaritet në momentin e realizimit të pensionit dhe përsëri përllogaritet në çdo 12 muaj nga shoqëria pensionale varësisht nga lartësia e mjeteve dhe kohëzgjatja e pritur e jetës së anëtarit të pensionuar. Pagesa e tërheqjeve të programuara ndërpritet me shfrytëzimin e mjeteve në llogari individuale. Nëse përdoruesi i pensionit vdes, mjetet tjera trashëgohen.

Anuitet është seria e pagesave të rregullta periodike që paguhen, në periudhën e paracaktuar (numër i paracaktuar i viteve) ose derisa përdoruesi është gjallë. Në kontekst të sistemeve pensionale zakonisht anuitetet janë të përvetshme. Anuitetet i paguan shoqëria për sigurim të jetës, çdo muaj, deri në fund të periudhës së paracaktuar ose deri në fund të jetës së pensionistit. Do të thotë, pensionisti pas pensionimit duhet të zgjedhë anuitet dhe shoqëri sigurimi të jetës, ku shoqëria e tij pensionale i transferon mjetet në shoqëri për sigurim të jetës, si premi, e pastaj ajo shoqëri për sigurim e kryen pagesën e anuiteteve.


Lartësia e anuitetit përllogaritet në momentin e realizimit të pensionit dhe asaj shume paguhet deri në fund të periudhës së paracaktuar ose deri në fund të jetës së pensionistit. Do të thotë se shoqëria e sigurimit të jetës kryen pagesa të anuitetit deri në fund të jetës së pensionistit, bile edhe në rast që ai të jetojë shumë gjatë. Nëse shfrytëzuesi i pensionit vdes përgjithësisht nuk ka trashëgim të mjeteve. Anuiteti mund të jetë me garanci plotësuese, për shembull: pas vdekjes së shfrytëzuesit të vazhdojë te bashkëshorti/bashkëshortja, mund të jenë të garantuar me periudhë të garantuar të pagesës, etj.

Anuitetet janë prodhim sigurimi dhe përmbajnë elemente të sigurimit, përkatësisht te ato ekziston garanci për lartësinë e pagesës dhe periudhën e kohëzgjatjes së pagesave, sepse rreziku transferohet te pala e tretë. Kjo është përparësia kryesore e anuiteteve. Nga ana tjetër, nëse personi vdes herët nuk ka trashëgim të mjeteve të tyre. Si prodhim ato janë më të shtrenjtë për shkak të rrezikut të ndërmarrë nga pala e tretë.

Anuitetet mund të jenë me karakteristikat në vijim:

- *të përvetshme* – paguhen deri në fund të jetës së shfrytëzuesit (pa dallim të jetëgjatësisë së shfrytëzuesit)
- *të përkohshme* – paguhen në numër të paracaktuar të viteve
- *të drejtpërdrejta* – pagesa fillon menjëherë pas pagesës së premisë
- *të prolonguara* – pagesa fillon pas numrit të paracaktuar të viteve

- *individuale* – i shfrytëzon vetëm një person dhe përlogaritja bëhet sipas tabelave të vdekshmërisë për një person (i paguhet vetëm shfrytëzuesit të pensionit)
- *në mënyrë të përbashkët* – i shfrytëzojnë më shumë personat e paracaktuar dhe përlogaritja bëhet sipas tabelave të bashkuara të vdekshmërisë për më shumë persona (fillimisht i paguhet shfrytëzuesit të pensionit, ndërsa pas vdekjes së tij shfrytëzuesit të caktuar)
- *me periudhë të garantuar të pagesës* – paguhet së paku derisa zgjat periudha e garantuara e paracaktuar e pagesës (pa marrë parasysh nëse shfrytëzuesi është gjallë ose jo) e shfrytëzuesit ose personit të paracaktuar në shumën e njëjtë, e pas periudhës së garancisë vetëm derisa është gjallë shfrytëzuesi.
- *pa periudhë të garantuar të pagesës* – paguhet vetëm përderisa është gjallë shfrytëzuesi
- *fiks* – shuma e anuitetit është fikse dhe nuk ndryshohet gjatë periudhës së pagesës
- *variabil* – shuma e anuitetit është e ndryshueshme dhe ndryshohet sipas lëvizjes së vlerës tregtare të mjeteve të fondit investues me të cilin është lidhur anuiteti. Anuiteti shprehet në njësi ose pjesëmarrje të fondit investues, ndërsa lartësia e anuitetit caktohet sipas numrit të njësisë (pjesëmarrjeve) dhe vlerës tregtare të njësisë (pjesëmarrjes).
- *me pjesëmarrje në fitimin* – shuma e anuitetit përbëhet nga dy pjesë: shuma e garantuar minimale plus teprica mbi shumën fikse që varet nga përqindja e pjesëmarrjes në fitim dhe lartësia e fitimit të realizuar të shoqërisë së sigurimit.



Nga përvoja ndërkombëtare me pagesë të pensioneve, përvojave më të rëndësishme me shfrytëzim të tërheqjeve të programuara ka në Amerikën Latine. Sistemet në vendet në Amerikën Latine janë mjaft të vjetra dhe në ato marrin pjesë numër i dukshëm i pensionistëve me të drejtë të pagesës së pensioneve. Pensionistët zakonisht kanë të drejtë të zgjedhin ndërmjet anuitetit të përjetshëm nga kompania e sigurimit dhe tërheqjeve të programuara nga fondi pensional, ose kombinimi, shpesh tërheqje të programuara me anuitet të prolonguar të përjetshëm.

Në Amerikën Veriore dhe Evropën Perëndimore, format tradicionale të pagesës së pensioneve nga planet pensionale me kontribute të definuara janë forma të anuiteteve të përjetshme, e diku anë të lejuara edhe pagesa të njëhershme të mjeteve. Në disa prej këtyre shteteve, veçanërisht në Evropën Perëndimore, forma e vetme e lejuar janë anuitetet e përjetshme, me mundësi për pagesë të njëhershme të një pjese realisht të vogël të mjeteve.

Rregullimi i mënyrave për pagesë të pensioneve si pagesa të përrjetshme e pasqyron rolin e vërtetë të pensioneve, e kjo është të zëvendësohen të ardhurat e punësimit para pensionimit me të ardhura të përrjetshme pas pensionimit, me çka personat në pleqëri do të kenë të ardhura të sigurta deri në fund të jetës së tyre.

Edhe sistemi pensional maqedonas, me tre shtyllat e tyre, i ndjek trendët botërore në mënyrat e financimit dhe pagesës së pensioneve. Në të ekziston kombinimi i mënyrave dhe parimeve të financimit të pensioneve, si dhe të llojeve të pagesave të pensioneve.

Në pajtim me parimet e cekura paraprakisht dhe mënyrat e financimit dhe pagesa e pensioneve, sistemi pensional në Maqedoninë e Veriut është përmbledhje e kombinimeve në tabelën:

	PAYG	Me financim kapital
Pensione të definuara	Shtylla I	
Kontribute të definuara		Shtylla II Shtylla III

Gjithsesi, pikënisje është mbrojtja e personit në pleqëri, dhe të ardhurat e rregullta pas pensionimit, për shkak që kërkohet pagesë e përrjetshme e pensioneve në nivel mujor. Pagesa e njëhershme nuk siguron mbrojtje nga rreziqet për pleqtë, për shkak që lejohet si opsion vetëm në sigurimin pensional vullnetar me financim kapital.

Gjithashtu, janë të përfshirë edhe tre rreziqet e zakonshme, karakteristike për sistemet pensionale. Gjegjesisht, në Maqedoninë e Veriut të tre shtyllat e sistemit pensional sigurojnë mbrojtje nga rreziqet pleqëri, invaliditet dhe vdekje. Nga shtylla e parë dhe e dytë të siguruarit përkatësisht anëtarët realizojnë pension, ndërsa nga shtylla e tretë anëtarët realizojnë kompensim pensional. Pensioni nga shtylla e parë përfshin pagesë të pensionit të pleqërisë, familjar dhe invalidor, si dhe pensioni minimal. Pensioni nga shtylla e dytë përfshin pagesë të pjesës së dytë të pensionit të pleqërisë. Kompensimi pensional nga shtylla e tretë përfshin pagesë të kompensimit pensional në rast të pleqërisë, invaliditetit dhe vdekjes.

Kushtet për fitimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë janë të njëjtë edhe për shtyllën e parë dhe të dytë të sistemit pensional, ndërsa afatet për tërheqje të mjeteve nga shtylla e tretë dhe mënyrat e tërheqjes së tyre janë më liberalë sesa në shtyllën e dytë. Megjithatë kihet parasysh fakti se bëhet fjalë për sigurimin pensional, përkatësisht kursimin e pleqërisë.

Pagesa e pensioneve nga shtylla e parë është rregulluar me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor, ndërsa për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve pensionale nga shtylla e dytë dhe e tretë dispozitat themelore janë rregulluar në Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital dhe Ligjin për sigurim vullnetar pensional me financim kapital, ndërsa shumë më hollësisht pagesa e këtyre pensioneve dhe kompensimeve pensionale është rregulluar me Ligjin për pagesë të pensioneve dhe kompensimeve pensionale nga sigurimi pensional me financim kapital.

13.3. KUSHTET PËR FITIMIN DHE REALIZIMIN E TË DREJTËS SË PENSIONIT TË PLEQËRISË DHE KOMPENSIMIT PENSIONAL

Kushti i vetëm për realizimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë nga shtylla e parë dhe e dytë është 64 vjet për meshkuj, përkatësisht 62 vjet për ferma dhe minimum 15 vjet stazh pune. Anëtari i shtyllës së tretë mund të realizojë të drejtë të kompensimit pensional më së hershmi 10 vjet para moshës për fitimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë nga sigurimi i detyrueshëm pensional dhe invalidor,

përkatësisht në pajtim me rregullativën ekzistuese mendore, kjo do të thotë më së hershmi në moshë 54 vjeçare për meshkujt, përkatësisht më së hershmi në moshë 52 vjeçare për femra. Njëkohësisht, për shtyllën e tretë 70 vjet është kufiri maksimal nga i cili anëtari i shtyllës së tretë doemos duhet të fillojë të tërheqë mjete për kompensimin pensional, për shkak të mbarimit të ciklit të kursimit dhe fillimit të pagesës.

Realizimi i të drejtës së pensionit të pleqërisë në shtyllën e parë dhe të dytë është e lidhur. Gjegjësisht, një i siguruar njëkohësisht i përmbush kushtet për pensionin e pleqërisë, ai realizon të drejtën e pensionit të pleqërisë nga shtylla e dytë. Ekziston mundësia që deri në 3 vite ta prolongojë realizimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë nga shtylla e dytë, nëse vlerëson se kushtet ekonomike për tërheqje të mjeteve nga fondi i detyrueshëm pensional dhe ofertat e fituara për pension nuk janë të pranueshme. Realizimi i kompensimit pensional nga shtylla e tretë është e pavarur nga realizimi i pensionit nga shtylla e parë dhe e dytë dhe anëtari i shtyllës së tretë mund të realizojë kompensim pensional nga shtylla e tretë më së hershmi pas mbarimit të kushteve të lartpërmendura ligjore për moshën si kusht i vetëm.

13.3.1. Pensioni i pleqërisë nga shtylla e parë

Shtylla e parë siguron pension të parimit të pensioneve të definuar. Pensioni i pleqërisë nga shtylla e parë përcaktohet nga mesatarja mujore e rrogave të valorizuara të cilat i siguruari i ka realizuar gjatë kohëzgjatjes së përgjithshme të sigurimit (baza pensionale), e më së hershmi nga 1 janar 1970, në përqindje të caktuara varësisht nga gjatësia e stazhit pensional.

Ekzistojnë dy kategori themelore të të siguruarve:

- të siguruarit e përfshirë në sistemin pensional dyshtyllësh, të cilat do të marrin dy pensione (edhe nga shtylla e parë edhe nga shtylla e dytë)
- të siguruarit e përfshirë në sistemin pensional njësthtyllësh, të cilat do të marrin një pension (vetëm nga shtylla e parë)

Meqë të siguruarit nga kategoria e parë do të marrin pensione nga dy burime, ato do të marrin pensione më të vogla nga shtylla e parë (për llogari të pensioneve që do t'i marrin nga shtylla e dytë), për dallim nga të siguruarit nga kategoria e dytë që do të marrin pension vetëm nga shtylla e parë. Për shkak të drejtësisë dhe të dy kategorive të siguruarit duhet të kenë përafërsisht pensione të njëjta të përgjithshme.

Të siguruarit nga kategoria e lartpërmendur e parë (të përfshirë në sistemin dyshtyllësh) mund të jenë në një prej dy grupeve vijuese:

- do ta kalojnë gjithë stazhin e tyre të punës në sistemin dyshtyllësh (nëse detyrimisht janë përfshirë në sistemin dyshtyllësh) ose
- do të kenë pjesë në sistemin njësthtyllësh, një pjesë në sistemin dyshtyllësh (nëse vullnetarisht janë përfshirë në sistemin dyshtyllësh).

Varësisht nga përkatësia e sistemit njësthtyllësh ose dyshtyllësh dhe periudhave të pjesëmarrjes në secilin prej sistemeve do të aplikohen përqindje të ndryshme adekuate për përlllogaritje të pensionit në pajtim me ligjin.

- Për të siguruarit të cilat detyrimisht i bashkohen sistemit dyshtyllësh kjo përqindje është 1,00% (meshkuj), përkatësisht 1,14% (femra), për çdo vit stazh pensioni. Këto përqindje përfundimisht me 31.12.2018 ishin 0,75% (meshkuj) dhe 0,86% (femra).

Shemb. 1. Përqindja për përllogaritje të pensionit nga shtylla e parë për të siguarin – mashkull i cili detyrimisht i është bashkuar sistemit dyshtyllësh nga fillimi i karrierës së tij, që do të thotë gjithë stazhin e tij të punës e kalon në sistemin dyshtyllësh dhe ka gjithsej 40 vite stazh, do të jetë 40%.

$$40\% = 40 * 1,00\%$$

- Për të siguarit të cilët vullnetarisht i janë bashkuar (deri më 1 janar 2003 tashmë janë punësuar) në sistemin dyshtyllësh, kjo përqindje dallohet për vitet para transferimit në sistemin pensional dyshtyllësh dhe për vitet pas transferimit në sistemin pensional dyshtyllësh, për shkak që në ato periudha ka edhe pagesa të ndryshme të kontributeve. Gjegjesisht, për çdo vit stazhi pensional i mbushur pas ditës së përfshirjes në sistemin e ri, përqindja është 1,00% (mashkull), përkatësisht 1,14% (grua) që është e njëjtë si dhe për kategorinë paraprake të të siguarve (këto përqindje përfundimisht me 31.12.2018 ishin 0,75% (meshkuj) dhe 0,86% (femra). Nga ana tjetër, për çdo vit të mbushur stazhi pensional deri në ditën e përfshirjes në sistemin dyshtyllësh përqindja është 2,33% (meshkuj), përkatësisht 2,60% (femra), por më së shumti 11,65% (meshkuj), përkatësisht 13,00% (femra) që përkon me maksimum 5 deri 7 vite stazh. Kjo dispozitë ishte tejet e rëndësishme të kihet parasysh për çdo të siguar që ka vendosur të kalojë në sistemin dyshtyllësh, për shkak që, për shkak të kufizimit të lartpërmendur maksimal, tërthorazi sugjerohet se sistemi i ri është më i volitshëm për të rinjtë ose personat që kanë më pak stazh pensional para transferimit, ndërsa për të tjerët, më e volitshme është të mbeten në sistemin pensional njëstyllësh. Kjo dispozitë gjithashtu është me rëndësi të madhe të kihet parasysh gjatë vendimmarrjes së çdo të siguari i cili është bashkuar vullnetarisht në sistemin dyshtyllësh, ka lindur para datës 1.1.1967 dhe ka të drejtë të zgjedhë nëse ta ndërpresë ose vazhdojë anëtarësinë në fondin e detyrueshëm pensional.

Shemb. 2. Përqindja për përllogaritje të pensionit nga shtylla e parë për të siguarin – femër e cila ka lindur pas datës 1.1.1967, dhe ka të drejtë të zgjedhë nëse ta ndërpresë ose vazhdojë anëtarësinë në fondin e detyrueshëm pensional.

Shemb. 2. Përqindja për përllogaritje të pensionit nga shtylla e parë për të siguarin – femër që ka lindur pas datës 1.1.1967 që i është bashkuar sistemit dyshtyllësh me 6 vite të kaluara paraprakisht në sistemin njëstyllësh, ndërsa 24 vitet tjera nga karriera e tij i kalon në sistemin dyshtyllësh do të jetë 40,36%.

$$40,36\% = 13,00\% + 24*1,14\% = 13\% + 27,36\%$$

Vërejtja: 13,00% është shkalla zëvendësuese maksimale, për shkak që në vend të $6*2,60=15,6\%$ të përllogaritura në përllogaritjen merren 13,00%.

Për të siguarit që janë pjesë e sistemit njëstyllësh dhe për të siguarit që do të vendosin ta ndërkrejnë anëtarësinë në sistemin dyshtyllësh dhe do të mbeten në sistemin njëstyllësh përqindja për përllogaritje të pensionit do të përllogaritet në mënyrën e njëjtë si para reformës (nëse kanë pasur minimum 15 vite stazh) ose me uljen graduale (nëse kanë pasur më pak se 15 vite stazh).

- Për të siguarit që janë përfshirë në sigurimin pensional invalidor deri më 1 shtator 2001 dhe nuk kanë zgjedhur të përfshihen në sistemin pensional dyshtyllësh dhe që kanë së paku 15 vite stazh pensional, kjo përqindje do të caktohet në mënyrën në të cilën edhe më parë është caktuar

(në pajtim me tabelën në nenin 228 të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor). Kjo do të thotë, për 15 vite stazh pensional për meshkuj përqindja është 35%, e për femra është 40% edhe më tutje me rritjen e viteve të stazhit rritet përqindja kështu që për stazh të plotë (40 vjet për meshkuj, përkatësisht 35 vite për femra) ai është 80% për çdo vit të mëtejme stazh pensional të mbushur pas 1 janarit 2013 deri më 31 dhjetor 2018, pensioni përlllogaritet në lartësinë prej 1,61% pastaj për çdo vit të mëtejme stazh pensional të mbushur pas 1 janarit 2019 deri më 31 dhjetor 2019, pensioni përlllogaritet në lartësi prej 1,54%, e për çdo vit stazh pensional të mbushur pas 1 janarit 2020 pensioni përlllogaritet në lartësi prej 1,47%.

- Për të siguruarit që janë përfshirë në sigurimin pensional dhe invalidor deri më 1 shtator 2001 dhe nuk kanë zgjedhur të përfshihen në sistemin pensional dy shtyllësh dhe që kanë më pak se 15 vite stazh pensional, kjo përqindje është, për çdo vit të mbushur të stazhit pensional deri më 1 shtator 2001, 2,33% (meshkuj), përkatësisht 2,60% (meshkuj). Për çdo vit të mëtejme të stazhit pensional të mbushur pas 1 shtatorit 2001, e deri më 31 dhjetor 2012, pensioni përlllogaritet në lartësi prej 1,80% (meshkuj) përkatësisht 2,05% (femra). Për çdo vit të mëtejme pensional të stazhit të mbushur pas 1 janarit 2013 deri në 31 dhjetor 2018, pensioni përlllogaritet në lartësi prej 1,161% (meshkuj), përkatësisht 1,84% (femra), pastaj për çdo vit të mëtejme të stazhit pensional të mbushur pas 1 janarit 2019 deri më 31 dhjetor 2019, pensioni përlllogaritet në lartësi prej 1,54%, e për çdo vit të stazhit pensional të mbushur pas 1 janarit 2020 pensioni përlllogaritet në lartësi prej 1,47%.

12.3.2. Pensioni i pleqërisë nga shtylla e dytë

12.3.2.1. Llojet dhe mënyra e pagesës së pensionit nga shtylla e dytë

Shtylla e dytë siguron pension të parimit të kontributeve të definuara. Kjo do të thotë se pensioni nga shtylla e dytë nuk është definuar paraprakisht por përlllogaritet gjatë pensionimit dhe varet drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga mjetet e akumuluar në llogarinë e anëtarit në ditën e pensionimit të tij, si dhe kohëzgjatja e pritur e jetës së anëtarit pas pensionimit.

Anëtarët e shtyllës së dytë mund sipas zgjedhjes personale ta realizojnë pensionin e shtyllës së dytë vetëm gjatë ditës nga llojet vijuese të pagesave:

- Anuitet i drejtpërdrejtë i përjetshëm;
- Tërheqje të programuara;
ose
- Tërheqje të programuara të përkohshme në kombinim me anuitetin e prolonguar të përjetshëm.

Meqë edhe shtylla e dytë është pjesë e sigurimit të detyrueshëm pensional të gjitha tre llojet e lejuara të pagesës së pensionit nënkupton pagesë të përjetshme të pensionit.

Anuitetet i sigurojnë shoqëritë e sigurimit që kanë leje nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimit (në tekstin e mëtejme: AMS) për kryerje të punëve të sigurimit në klasën e sigurimit të anuiteteve dhe pagesës së anuiteteve për shfrytëzuesit e pensionit.

Tërheqjet e programuara i paguajnë shoqëritë pensionale që kanë leje nga MAPAS.

Ndryshimi i llojit të pagesës së pensionit është i mundshëm vetëm në rast të tërheqjeve të programuara. Gjegjësisht, polica e anuitetit është marrëveshje që nuk priset dhe ajo nuk mund të ndërpritet dhe nuk guxon të ndërpritet ose blihet. Nga ana tjetër, përdoruesi i pensionit mund t'i zëvendësojë tërheqjet

e programuara të përzetshme të siguruara nga njëra shoqëri pensionale me përdorim të mjeteve tjera disponueshme nga llogaria individuale për blerje të tërheqjeve të programuara nga shoqëria tjetër pensionale, për blerje të anuitetit të përzetshëm nga shoqëria e sigurimit ose blerjes së tërheqjeve të programuara të përkohshme nga shoqëria e njëjtë ose tjetër pensionale të kombinuara me anuitet të prolonguar të përzetshëm nga shoqëria e njëjtë ose tjetër pensionale të kombinuara me anuitet të prolonguar të përzetshëm nga shoqëria e sigurimit. Në rast kur shfrytëzuesi i pensionit ka zgjedhur tërheqje të programuara të përkohshme në kombinim me anuitetin e prolonguar të përzetshëm mund që në çdo moment t'i zëvendësojë tërheqjet e programuara të përkohshme të siguruara nga njëra shoqëri pensionale duke shfrytëzuar mjetet tjera të disponueshme nga llogaria individuale për blerje të tërheqjeve të programuara të përkohshme nga tjetër shoqëri pensionale për periudhë tjetër. Edhe polica për anuitetin e prolonguar nuk mund të ndërpritet ose blihet.

12.3.2.2. Anuitetet në shtyllën e dytë

Në shtyllën dytë të sistemit pensional lejohen vetëm anuitete të përzetshme me qëllim pensionistëve t'u sigurohen të ardhura pensionale deri në fund të jetës së tyre.

Këto anuitete sipas lartësisë së shumës që paguhet mund të jenë fikse-të harmonizuara me shpenzimet ose me pjesëmarrje në fitimin. Sipas periudhës së pagesës këto anuitete mund të jenë të garantuara ose të paguarantuar.

Anuiteti i përzetshëm është lloj anuiteti me të cilin shoqëria e sigurimit i garanton shfrytëzuesit pagesë të përzetshme mujore të pensionit, pa dallim të jetëgjatësisë së tij reale.

Fiksen anuitet të harmonizuar me kostot e jetesës është lloji i anuitetit të harmonizuar me lëvizjen e shpenzimeve për jetë dhe paguhet çdo muaj në denarë ose në euro me kundërvlerë me denarë.

Nëse anuiteti është *fiks i harmonizuar me kostot e jetesës* shoqëria e sigurimit është e detyruar që të kryejë harmonizim periodik të lartësisë së pensionit të një prej mënyrave në vijim:

- Sipas rritjes së indeksit të kostos së jetesës në gjysmë vjetorin e parë në krahasim me gjysmë vjetorin që i paraprin në Republikën e Maqedonisë së Veriut, më 1 janar dhe 1 korrik të çdo viti ose
- Harmonizim nominal fiks, së paku më 1 janar dhe 1 korrik çdo vit.
Përqindja e harmonizimit nominal fiks caktohet në datën e blerjes së policës për anuitet dhe është i pandryshueshëm gjatë kohëzgjatjes së policës. Në fund të çdo viti, AMS pas pëlqimit paraprak të MAPAS, e cakton përqindjen minimale të harmonizimit minimal për anuitete fikse që do të shiten gjatë vitit të ardhshëm kalendarik. Përqindja minimale e harmonizimit nominal aplikohet për të gjitha policat për këtë lloj të anuiteteve që do të shiten gjatë vitit të ardhshëm, në nivel vjetor nuk mund të jetë më e vogël se 1% as më e madhe se 3%. Shoqëritë e sigurimit mund të ofrojnë përqindje më të lartë të harmonizimit nominal të caktuar nga AMS për çdo vit kalendarik.

Anuiteti fiks me pjesëmarrje në fitim është lloji i anuitetit të cilin shoqëria e sigurimit e paguan çdo muaj dhe që përfshin pagesë të garantuar minimale dhe përqindje nga fitimi i realizuar i shoqërisë së sigurimit. Fitimi është variabil dhe nuk mund të dihet saktësisht para kohe, për shkak se përllogaritje të lartësisë së pensionit përmes anuitetit fiks me pjesëmarrje në fitim, shoqëria është e detyruar që të përdorë simulacione dhe

projeksione me parametra dhe supozime të lejuara në disa skenarë: “bazike”, “optimiste” dhe “pesimiste”. Këto parametra dhe supozime i përcakton AMS pas pëlqimit paraprak të MAPAS.

Anuiteti me periudhë të garantuar është lloj i anuitetit që ka periudhë të përcaktuar paraprakisht të muajve në të cilat detyrimisht do të paguhet pa dallim nëse përdoruesi i pensionit është i gjallë.

Shumën e anuitetit e cakton shoqëria e sigurimit varësisht nga mjetet që akumulohen në llogari individuale të pensionistit dhe që transferohen si premi në shoqëri dhe nga faktorët tjerë (tabelat e vdekshmërisë, supozimet për shkallë kamate, shpenzimet për menaxhim dhe supozimet tjera që përdoren gjatë caktimit të lartësisë së pensionit të ofruar).

Policat e anuitetit për shtyllë të dytë i shesin shoqëritë e sigurimit përmes përfaqësuesit në sigurim, shoqëria e përfaqësimit në sigurim dhe shoqëria brokere e sigurimit që është themeluar dhe punon në pajtim me Ligjin për mbikëqyrje të sigurimit. Ndërkaq, ato gjatë shitjes së anuiteteve nuk guxojnë të ofrojnë lirime, kthime të mjeteve në para ose volitshmërive tjera të anëtarit të fondit pensional. Subjektet që kryejnë shitje të anuiteteve i arkëtojnë shërbimet e tyre në lloj të pagesës ose provizionit dhe nuk guxojnë t'i arkëtojnë nga shfrytëzuesi i pensionit ose anëtarit të fondit pensional.

Shoqëria e sigurimit nuk guxon që të arkëtojë kompensime gjatë pagesës së anuiteteve të shtyllës së dytë, përveç shpenzimeve transaksionale.

Në rast të falimentimit ose likuidimit të shoqërisë së sigurimit që siguron pension nga shtylla e dytë aplikohen dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje të sigurimit që kanë të bëjnë me falimentimin dhe likuidimin e shoqërisë së sigurimit. Kërkesat e shfrytëzuesve të pensionit nga shtylla e dytë dhe nga ato persona të caktuar kanë të drejtë të shlyerjes së parë në krahasim me kreditorët tjerë të shoqërisë së sigurimit.

12.3.2.3. Tërheqje të programuara në shtyllën e dytë

Tërheqjet e programuara është lloj i i pensionit të cilin e paguan çdo muaj shoqëria pensionale deri në fund të jetës së shfrytëzuesit të pensionit ose përderisa ka mjete në llogarinë e anëtarit të pensionuar të fondit pensional. Në rast të vdekjes së shfrytëzuesit, shoqëria pensionale e paguan shumën e përgjithshme e cila mbetet në llogari individuale pas vdekjes së tij si trashëgimi në pajtim me ligjin. Në rast të harxhohen të gjitha mjetet në llogarinë individuale të shfrytëzuesit të pensionit përmes tërheqjeve të programuara, pagesa e tërheqjeve të programuara ndërpritet. Në këtë rast, pas harxhimit të mjeteve, shfrytëzuesi i pensionit do të jetë i mbrojtur me pension minimal të cilin do ta paguajë FPISMV.

Kur shfrytëzuesi i pensionit zgjedh tërheqje të programuara nga fondi pensional, kjo do të thotë se ai edhe pas pensionimit edhe më tutje mbetet në fondin pensional me cilësi specifike të anëtarit të pensionuar. Ndërkaq, shoqëria pensionale njëkohësisht i paguan një pjesë të mjeteve si tërheqje të programuara dhe vazhdon më tutje me investimin e pjesës tjetër të mjeteve në llogarinë e anëtarit të pensionuar.

Shoqëria pensionale mund t'i ofrojë llojet e tërheqjeve të programuara:

- tërheqje të programuara të përvetshme që mund të jenë produkt të mëvetësishëm dhe
- tërheqje të programuara të përkohshme, që mund të jenë vetëm në kombinim me anuitet të prolonguar nga shoqëria e sigurimit.

Përlllogaritjen e lartësisë së pagesës së tërheqjeve të programuara të përvetshme e bën shoqëria pensionale. Ndërkaq, pensioni përmes tërheqjeve të programuara për herë të parë përlllogaritet në ditën e realizimit të pensionit nga shtylla e dytë, e pastaj përsëri përlllogaritet në çdo 12 muaj varësisht nga shuma e mjeteve dhe kohëzgjatja e pritjes së shfrytëzuesit të pensionit.

Përlllogaritja bëhet në pajtim me formulën e cila është përcaktuar në Ligjin për pagesë të pensioneve dhe kompensimeve pensionale nga sigurimi pensional me financim kapital dhe varet nga mjetet totale të akumuluar në llogarinë individuale dhe faktori i anuitetit për pension të veçantë, që varet nga mosha e

shfrytëzuesit të pensionit dhe tabelat e vdekshmërisë, si dhe shkalla e tregut të të ardhurave. Ndërkaq kur bëhet përllogaritja e parë shoqëria pensionale është e detyruar që t'i përdorë parametrat në vijim: shuma totale e mjeteve në llogarinë individuale, faktori i anuitetit për pension të veçantë, mosha e shfrytëzuesit të pensionit dhe shkalla e tregut të të ardhurave afatgjate. Gjatë çdo ripërllogaritje të tërheqjeve të programuara shoqëria pensionale është e detyruar që t'i shfrytëzojë parametrat në vijim: shuma totale e mjeteve në llogarinë individuale, faktori i anuitetit për pension individual, mosha e shfrytëzuesit të pensionit dhe kushtet e tij për shkallën tregtare të të ardhurave.

Mjetet që i kanë anëtarët e pensionuar në llogaritë e tyre individuale në fondin e detyrueshëm pensional janë pjesë të mjeteve totale të atij fondi të detyrueshëm pensional. Së këndejmi, edhe ato janë pjesë e portofolit të fondit të detyrueshëm pensional dhe shoqëritë pensionale i investojnë ato mjete në pajtim me Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital dhe bëjnë vlerësim të tyre.

Shoqëritë pensionale arkëtojnë kompensim mujor nga vlera e mjeteve neto të fondit të detyrueshëm pensional për mbulimin e shpenzimeve të shoqërive pensionale për menaxhim me fondin e detyrueshëm pensional. Kjo do të thotë se ky kompensim arkëtohet edhe nga llogaritë individuale të anëtarëve të pensionuar. Shoqëritë pensionale mund të arkëtojnë shpenzime transaksionale për pagesë të pensioneve përmes tërheqjeve të programuara.

12.3.2.4. Tërheqjet e programuara në kombinim me anuitetin e prolonguar të përjetshëm.

Tërheqjet e programuara të përkohshme në kombinim me anuitet të përjetshëm të prolonguar është lloji i pagesës së pensionit që fillon me pagesë të tërheqjeve të programuara të numrit të paracaktuar të viteve dhe vazhdon me anuitet të prolonguar të përjetshëm. Periudha e prolongimit të pagesës së mjeteve për anuitet është e barabartë me periudhën e pagesës së tërheqjeve të programuara të përkohshme dhe shprehet si numër i plotë i viteve ose numër që pjesëtohet me 12 muaj. Zgjedhja e tërheqjeve të programuara të përkohshme dhe anuitetit të prolonguar bëhet njëkohësisht.

Kjo do të thotë se shfrytëzuesi i pensionit njëkohësisht bën zgjedhje të tërheqjeve të programuara të përkohshme të cilat i kryen shoqëria pensionale për numër të caktuar të viteve (për shembull 10 vite) dhe anuitet të prolonguar të përjetshëm që do të fillojë ta paguajë shoqëria e sigurimit të jetës pas skadimit të atyre viteve të dakorduara (për shembullin e cekur, menjëherë pas skadimit të 10 viteve pas pensionimit) dhe deri në fund të jetës së shfrytëzuesit të pensionit. Gjatë kësaj zgjedhje, mjetet totale që i posedon anëtari në llogarinë e tij individuale gjatë pensionimit ndahen ndërmjet fondit pensional për pagesë të tërheqjeve të programuara të përkohshme dhe shoqërisë së sigurimit të jetës për pagesë të përjetshëm të prolonguar.

Prandaj, kur shfrytëzuesi i pensionit zgjedh tërheqjet e programuara të përkohshme në kombinim me anuitet të prolonguar të përjetshëm, ai duhet të përcaktojë periudhën e tërheqjeve të programuara të përkohshme, e cila duhet të harmonizohet me periudhën e prolongimit të anuitetit të prolonguar dhe të jetë një numër i plotë vitesh ose një numër i pjesëtueshëm me 12 muaj. Gjithashtu, shfrytëzuesi i pensionit duhet ta përcaktojë raportin fillestar ndërmjet pensionit përmes tërheqjeve të programuara të përkohshme dhe pensionit përmes anuitetit të prolonguar, me ç'rast ky raport nuk mund të jetë më i madh se 1.5/1 dhe nuk mund të jetë më i vogël se 0.65/1 për çdo shfrytëzues të pensionit që ka të drejtë të shumës më të ulët të pensionit.

Ndërkaq, shuma e pensionit nëpërmjet tërheqjeve të programuara të përkohshme dhe pensionit nga shtylla e parë doemos duhet të jetë e barabartë ose më e madhe se shuma më e ulët e pensionit përcaktuar me ligj. Nëse në fund të periudhës së zgjedhur për pagesë të tërheqjeve të programuara të përkohshme, në llogarinë individuale të shfrytëzuesit të pensionit ende ka mjete, ato i paguhen shfrytëzuesit të pensionit si pagesë e fundit nga tërheqjet e programuara të përkohshme. Nëse mjetet në llogari individuale të shfrytëzuesit të

pensionit shpenzohen para skadimit të periudhës së tërheqjes, ndërpritet pagesa e periudhës së tërheqjes, ndërpritet pagesa e tërheqjeve të programuara të përkohshme.

12.3.2.5. Koordinimi ndërmjet MAPAS dhe AMS për harmonizim të standardeve dhe rregullave për përlllogaritje të pensioneve që i kryejnë shoqëritë pensionale dhe shoqëritë e sigurimit

Duke pasur parasysh se në pagesat e pensioneve nga shtylla e dytë mund të marrin pjesë edhe shoqëritë pensionale, të cilat i rregullon, licencon dhe mbikëqyr MAPAS, dhe shoqëritë e sigurimit të jetës, të cilat rregullohen, licencohen dhe mbikëqyren nga AMS, është i rëndësishëm bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet këtyre dy institucioneve me qëllim të punës së harmonizuar, përkatësisht punës me kushte të njëjta të të dyja llojeve që kryejnë pagesa të pensioneve.

Një nevojë veçanërisht e theksuar është nevoja për harmonizimin e standardeve dhe rregullave për përlllogaritjen e pensioneve përmes tërheqjeve të programuara dhe përmes anuiteteve, me ç'rast standardet minimale dhe rregullat për përcaktimin e tabelave të vdekshmërisë dhe shkallëve të kamatës, i caktojnë AMS dhe MAPAS me të njëjtat kushte për shoqëritë e sigurimit dhe shoqëritë pensionale.

Ndërkaq, AMS i përcakton rregullat dhe standardet minimale për llogaritjen e rezervave teknike, ndërsa shoqëria e sigurimit është e detyruar të përdorë tabelat e vdekshmërisë në përputhje me standardet minimale të përcaktuara nga AMS për llogaritjen e rezervave të anuitetit. MAPAS përcakton rregullat dhe standardet minimale për tabelat e vdekshmërisë, ndërsa shoqëria pensionale është e detyruar që për llogaritjen e faktorit të anuitetit për pensionet nga shtylla e dytë përmes të tërheqjeve të programuara të përkohshme dhe të përjetshme, të përdorë tabelat e vdekshmërisë sipas standardeve minimale të përcaktuara nga MAPAS.

Gjithashtu, AMS i përcakton rregullat dhe standardet minimale për përcaktimin e shkallëve të kamatës dhe shoqëria e sigurimit është e detyruar që, për përlllogaritjen e rezervave për anuitetet, të përdorë shkallët e kamatës në përputhje me rregullat dhe standardet minimale të përcaktuara nga AMS. MAPAS i përcakton rregullat dhe standardet minimale për përcaktimin e shkallëve të kamatës dhe shoqëria pensionale është e detyruar që për përlllogaritjen e faktorit të anuitetit për pensionet nga shtylla e dytë përmes tërheqjeve të programuara të përjetshme dhe të përkohshme, të përdorë shkallët e kamatës në përputhje me rregullat dhe standardet minimale të përcaktuara MAPAS.

12.3.2.6. Qendra e sistemit elektronik për kuotim

Për shkak të transparencës së zgjedhjes së pensionit nga shtylla e dytë dhe kompensimi pensional nga shtylla e tretë vendoset Qendra e sistemit elektronik (shkurtuar Qendra e kuotimit) përmes të cilit do të dorëzohet kërkesa e kuotimeve për lloje të ndryshme të pagesave dhe do të merren oferta nga shoqëritë pensionale dhe shoqëritë e sigurimit.

Qendra e kuotimit është person juridik të cilën me marrëveshje e themelojnë shoqëritë e sigurimit dhe shoqëritë pensionale të cilat paguajnë pensione nga shtylla e dytë dhe kompensimet pensionale nga shtylla e tretë. Qendra e kuotimit do të themelohet nga shoqëritë pensionale ekzistuese dhe shoqëritë e sigurimit në afat prej tre muajsh nga dita e lëshimit të lejes së parë për kryerje të punëve të sigurimit në klasën e anuiteteve dhe pagesën e anuiteteve për shfrytëzuesit e pensionit. Çdo shoqëri të ardhshme të sigurimit dhe shoqërisë pensionale që do të paguajë pensione nga shtylla e dytë dhe kompensimet pensionale nga shtylla e tretë do të marrë pjesë në Qendrën e kuotimit.

Si zgjidhje kalimtare, deri në themelimin e Qendrës së kuotimit, mbledhja dhe prezantimi i ofertave për pensionet nga shtylla e dytë do të realizohet nga shoqëria pensionale që menaxhon me fondin pensional ku anëtari ka llogari individuale. Për atë qëllim, shoqëria pensionale është e detyruar që të vendosë mënyrë

elektronike për komunikim me të gjitha shoqëritë pensionale me qëllim të mbledhë oferta dhe të kryejë punë në pajtim me ligjin.

Qendra e kuotimit themelohet si subjekt joprofitabil. Mjetet për kryerjen e punëve të Qendrës së kuotimit i sigurojnë shoqëritë themeluese në bazë proporcionale. Qendra e kuotimit nuk guxon të arkëtojë kompensime nga anëtarët e fondeve pensionale ose shfrytëzuesve të pensionit ose kompensimit pensional nga shtylla e dytë dhe e tretë.

Qendra e kuotimit miraton Statut në të cilin pëlqim jep MAPAS. MAPAS kryen kontroll të Qendrës së kuotimit.

Qendra e kuotimit i kryen punët në vijim:

- a) vendos dhe mirëmban softuer për lidhje elektronike të të gjitha shoqërive të sigurimit dhe shoqërive pensionale të cilët janë themelues të tij;
- b) pranon dhe evidenton kërkesa për kuotim të dorëzuar në formë elektronike nga shoqëritë pensionale;
- c) pranon dhe evidenton oferta për anuitete dhe tërheqje të programuara të dorëzuara nga shoqëritë e sigurimit dhe shoqëritë pensionale;
- d) dorëzon tabela përmbledhëse me të gjitha ofertat e marra për anëtarin që ka dorëzuar kërkesë për kuotim;
- e) kryen punë që janë me interes të përbashkët të shoqërisë për sigurim dhe shoqëri pensionale;
- f) sjell kod të sjelljes të shoqërisë së sigurimit dhe shoqërive pensionale në procesin e kuotimit;
- g) bashkëpunon me MAPAS dhe AMS për çështje nga sfera e sigurimit, realizimit të pensioneve nga shtylla e dytë; dhe
- h) kryen edhe punë tjera në pajtim me ligjin.

12.3.2.7. Mënyra dhe procedura e realizimit të pensionit të pleqërisë nga shtylla e dytë

Kur i siguruari, i cili merr pjesë në sistemin dyshtyllësh, i përmbush kushtet për pension të pleqërisë, ai parashtron kërkesa përkatëse për realizim të të drejtës së pensionit të pleqërisë edhe pas mbarimit të procesit të realizimit të të drejtës, ai do të marrë dy pensione, njëri nga FSPIMV dhe njëri nga shtylla e dytë, që do t'i paguajë shoqërisë pensionale ose shoqërisë së sigurimit, pas zgjedhjes së tij personale.

Procedura e realizimit të të drejtës së pensionit nga shtylla e dytë fillon me parashtrim të kërkesës së anëtarit të fondit pensional për realizim të të drejtës së pensionit të pleqërisë në FSPIMV (*Hapi 1 nga Skema 1 – Mënyra dhe procedura e kërimit të kuotimeve për realizim të të drejtës së pensionit të pleqërisë nga shtylla e dytë*). FSPIMV zbaton procedurë me kërkesë dhe pas procedurës së zbatuar dorëzon kopje nga zgjidhja e miratuar me të cilën pranohet ose nuk pranohet e drejta e pensionit të pleqërisë në shoqërinë pensionale që menaxhon me fondin pensional ku është anëtar parashtruesi i kërkesës (*Hapi 2 nga Skema 1*).

Anëtari i fondit pensional, i cili ka llogari individuale në fondin pensional, parashtron kërkesë në shoqërinë pensionale (*Hapi 3 nga Skema 1*), që në emër të tij fillon me procedurë për kuotim në Qendrën e kuotimit. Në kërkesën, anëtari i fondit pensional cakton se cilat lloje të pagesave të pensionit dëshiron të jenë të përfshira në kuotim. Në afat prej pesë ditësh nga pranimi i kërkesës, shoqëria pensionale është e

detyruar që të parashtrorë kërkesë për kuotim në Qendrën e kuotimit me numër identifikimi të kuotimit dhe të dhënat në vijim: shumta e mjeteve në llogari individuale, gjinia dhe data e lindjes e anëtarit të fondit pensional dhe llojet e pagesës së pensionit (*Hapi 4 nga Skema 1*). Anëtarit i fondit pensional mund të kërkojë disa lloje të ndryshme të anuitetit të kotohen nga ana e shoqërisë së sigurimit. Anëtarit i fondit pensional që është caktuar për kombinim të tërheqjeve të programuara dhe anuitetit të prolonguar të përjetshëm e definon edhe periudhën e prolongimit dhe raportin ndërmjet këtyre dy llojeve të pensioneve.

Pastaj shoqëria e sigurimit dhe shoqëritë pensionale i prezantojnë ofertat e tyre, në afat prej pesë ditësh nga futja e kërkesës për kuotim në Qendrën e kuotimit. Ofertat për anuitete të përjetshme dhe për tërheqje të programuara të përkohshme në kombinim me anuitet të prolonguar të përjetshëm i prezantojnë shoqëritë e sigurimit (*Hapi 5.1 dhe Hapi 5.2. nga Skema 1*), ndërsa ofertat për tërheqje të programuara i prezantojnë shoqëritë pensionale (*Hapi 5.3. nga Skema 1*). Shoqëritë e sigurimit që japin oferta për tërheqje të programuara të përkohshme në kombinim me anuitetin e prolonguar të përjetshëm japin oferta të veçanta për çdo shoqëri pensionale.

Shoqëritë pensionale japin detyrimisht oferta për tërheqje të programuara. Shoqëritë e sigurimit nëse dëshirojnë mund të prezantojnë për një ose më shumë lloje të pagesave të pensionit për të cilat anëtarit ka parashtruar kërkesë. Kuotimi i tyre është vullnetar, kështu që mund edhe të japin ofertë. Por, nëse dëshiron të lidhë policë për anuitet, shoqëria e sigurimit është e detyruar që të prezantojë ofertë përmes Qendrës së kuotimit.


Pas mbarimit të periudhës së kuotimit, Qendra e kuotimit i dorëzon shoqërisë pensionale tabelë përmbledhëse me të gjitha ofertat e fituara për pensionet e ardhshme të projektuara. Shoqëria pensionale, përmes agjentit, i prezanton ofertat nga tabela përmbledhëse në formë të standardizuar, me kërkesë të anëtarit, e më së voni deri në 10 ditë nga arritja e tabelës përmbledhëse (*Hapi 7 nga Skema 1*). Forma e standardizuar me oferta për pensione të ardhshme të projektuara i përmban të gjitha ofertat për të gjitha llojet e pensionit që i ka kërkuar anëtarit në kërkesën e kuotimit, përfshirë emrin e shoqërisë pensionale dhe/ose shoqërisë së sigurimit, shumën bruto mujore të pensionit fillestar, projeksionet për shumë bruto mujore të pensionit pas 10 deri 20 vitesh, si dhe projeksionet e shumës së mjeteve në llogarinë individuale pas 10 dhe 20 vitesh, në rast të tërheqjes së programuar, në rast të tërheqjeve të programuara, bashkë me supozimet e përdorura për inflacion, të ardhura dhe kompensime përkatësisht shpenzime, si dhe përshkrimet e shkurta dhe karakteristikat e çdo lloji të pagesës së pensionit dhe duhet të nënshkruhet nga anëtarit dhe personi i autorizuar dhe të verifikuar nga shoqëria pensionale. Agjenti duhet ta identifikojë anëtarin me dokumente për identifikim personal dhe personalisht t'i prezantojë ofertat për pensione të ardhshme të projektuara të anëtarit që ka parashtruar kërkesë për kuotim. Agjenti është i detyruar që t'ia sqarojë anëtarit në mënyrë të veçantë çdo ofertë nga tabela përmbledhëse, t'ia sqarojë karakteristikat e të gjitha llojeve të pagesave të pensioneve dhe të drejtave që dalin nga çdo lloj të pensionit, ta informojë anëtarin se shumata e pensioneve të ardhshme të projektuara bazohen në supozime dhe hollësisht t'ia sqarojë supozimet e përdorura dhe ta informojë anëtarin se shumata e pensioneve të ardhshme të projektuara dhe gjendja e llogarisë individuale janë shprehur në denarë me fuqinë blerëse konstante të harmonizuar me fuqinë blerëse aktuale të denarin, përkatësisht është përjashtuar ndikimi i inflacionit të ardhshëm. Është e rëndësishme që agjenti t'ia theksojë anëtarit se projeksionet janë parashikime të bëra nën këto supozime të caktuara dhe nuk janë të garantuara, kështu që nuk realizohen supozimet, shumata e pensionit, mund të jenë të ndryshme nga shumata e projektuara. Gjithashtu, agjenti duhet ta informojë anëtarin se ka të drejtë të parashtrorë përsëri kërkesë për kuotim të ofertave. Pas zgjedhjes së kryer, shfrytëzuesi i pensionit lidh marrëveshje për tërheqje të programuara të përjetshme me shoqëri pensionale, policat e anuitetit me shoqëri të sigurimit ose marrëveshje për tërheqje të programuara të përkohshme me shoqëri pensionale dhe policë të anuitetit me shoqëri të sigurimit.

Anëtari i fondit pensional mund që në periudhë prej 30 ditësh të vlefshmërisë së ofertave, të zgjedhë oferta të dhënë në tabelën përmbledhëse (*Hapi 8 nga Skema 1*).

Anëtari i fondit pensional ka të drejtë të përsëritjes së procesit të kuotimit, përkatësisht nuk është i detyruar që të zgjedhë ofertë të marrë përmes Qendrës së kuotimit. Nëse anëtari i fondit pensional nuk bën zgjedhje të shoqëria pensionale që menaxhon me atë fond, do të konsiderohet se nuk ka zgjedhur lloj të pagesës së pensionit nga shtylla e dytë përkatësisht se e ka prolonguar realizimin e pensionit nga shtylla e dytë. Kjo do të thotë se anëtari ka vendosur të bëhet shfrytëzues i pensionit vetëm nga shtylla e parë, dhe përkohësisht ta prolongojë fillimin e pagesës së pensionit nga shtylla e dytë. Ai mund përsëri më shumë herë të kërkojë kuotime të reja përmes Qendrës së kuotimit.

Megjithatë, ky prolongim i realizimit të pensionit nga shtylla e dytë mund të jetë më së shumti deri në tre vite nga dita e fitimit të së drejtës së pensionit të pleqërisë nga shtylla e parë. Pas skadimit të kësaj periudhe, ai detyrimisht doemos duhet të zgjedhë një prej llojeve të përcaktuara të pagesës së pensionit nga shtylla e dytë. Nëse pas skadimit të tre viteve shfrytëzuesi i pensionit nga shtylla e parë nuk zgjedh një prej llojeve të përcaktuara të pagesës së pensionit, atëherë ai bëhet automatikisht shfrytëzues i pensionit nga shtylla e dytë përmes tërheqjeve të programuara nga fondi pensional ku ai ka llogari individuale dhe shoqëri pensionale fillon me pagesë të pensionit si tërheqje të programuara. Më tutje, shfrytëzuesi i pensionit, gjithsesi ka mundësi për vendim të ri dhe ndryshim të plotësues të llojit të pagesës së pensionit, përsëri me shfrytëzim të Qendrës së kuotimit.

Skema 1: Mënyra dhe procedura e kërkesës së kuotimeve për realizim të të drejtës së pensionit të pleqërisë nga shtylla e dytë



Pas zgjedhjes përfundimtare të ofertës anëtari duhet të nënshkruajë marrëveshje përkatëse ose policë varësisht nga mënyra e zgjedhur e pagesës së pensionit nga shtylla e dytë dhe institucioni i zgjedhur i cili do ta kryejë pagesën. Gjegjësisht, nëse anëtari i fondit pensional ka zgjedhur të pranojë pension nga shtylla e dytë përmes tërheqjes së programuar lidh marrëveshje me shoqërinë pensionale ofertën e të cilit e ka pranuar (Hapi 1.2 nga Skema 2 – Procedura pas zgjedhjes së anëtarit për pagesë të pensionit nga shtylla e dytë). Nëse anëtari i fondit pensional ka zgjedhur të pranojë pension nga shtylla e dytë përmes anuitetit nënshkruan policë për anuitet me shoqërinë e sigurimit ofertën e së cilës e ka pranuar (Hapi 1.1 nga Skema 2). Nëse anëtari i fondit pensional e ka zgjedhur opsionin e tretë të mundshme, përkatësisht të pranojë pension nga anuiteti i prolonguar i përjetshëm, atëherë ai lidh edhe marrëveshje me shoqërinë pensionale (Hapi 1.3.2 nga Skema 2) dhe nënshkruan policë për anuitet me shoqëri sigurimi ofertat e të cilave i ka pranuar (Hapi 1.3.1 nga Skema 2). Ndërkaq, shoqëria e sigurimit dhe shoqëria pensionale nuk guxon të


refuzojë të lidhë marrëveshje ose polica për anuitet me anëtarin që e ka zgjedhur ofertën e tij, në afatin e vlefshmërisë së ofertës së dhënë.

Pastaj anëtari i fondit pensional dorëzon kopje nga marrëveshja me shoqëri pensionale dhe/ose polica për anuitet në shoqërinë pensionale që menaxhon me fond pensional ku ai është anëtar me qëllim që ai të mundësojë pagesë të pensionit nga shtylla e dytë.

Gjegjësisht, pas pranimit të policës për anuitet dhe/ose marrëveshjes me shoqërinë pensionale shoqëria pensionale i transferon mjetet nga llogaria individuale të anëtarit të fondit pensional në llogarinë e fondit pensional të menaxhuar nga shoqëria pensionale e zgjedhur nga anëtari (*Hapi 3.2 dhe Hapi 3.3.1 nga Skema 2*). Shoqëria pensionale është e detyruar që ta kryejë transferin e mjeteve në shoqërinë e sigurimit ose fondin pensional në afat prej një muaji nga data e pranimit të policës për anuitet dhe/ose marrëveshjes me shoqërinë pensionale. Për transferim të kryer, shoqëria pensionale nuk guxon të arkëtojë kompensime nga anëtari ose nga shoqëria e sigurimit, ose shoqëria pensionale të zgjedhur nga anëtari, përveç provizioneve transaksionale.

Pastaj shoqëria e zgjedhur pensionale (*Hapi 4.2 dhe Hapi 4.3.1 nga Skema 2*) ose shoqëria e sigurimit (*Hapi 4.1 nga Hapi 4.3.2 nga Skema 2*) fillon që anëtarit t'i paguajë pension nga shtylla e dytë. Nëse mjetet janë transferuar në gjysmë vjetorin e parë të një muaji kalendarik, shoqëria e sigurimit ose shoqëria pensionale është e detyruar që pagesën e parë të pensionit ta kryejë gjatë gjysmës së dytë të atij muaji. Nëse mjetet janë transferuar në gjysmën e dytë të një muaji kalendarik, pagesa e parë e pensionit është në gjysmë vjetorin e parë të muajit të ardhshëm.

Skema 2: Procedura pas zgjedhjes së anëtarit për pagesën e pensionit nga shtylla e dytë



Nëse shfrytëzuesi i pensionit dëshiron të bëjë ndryshim të llojit të pagesës së pensionit duhet që në shoqërinë pensionale që menaxhon me fondin pensional prej ku paguhen tërheqjet e programuara të parashtrorë kërkesë për ndryshim të llojit të pagesës së pensionit nga shtylla e dytë. Kërkesa parashtrohet në formë të standardizuar. Në kërkesën, shfrytëzuesi i pensionit cakton se cilat lloje të pagesave të pensionit dëshiron të jenë të përfshira në kuotim. Pastaj, në afat prej 5 ditësh nga pranimi i kërkesës së rregullt, shoqëria pensionale në emër të anëtarit parashtron kërkesë për kuotim në Qendrën e kuotimit. Pasi shoqëria pensionale do të marrë tabelë përmbljedhëse me oferta për pensionet e ardhshme të projektuara nga Qendra e kuotimit, e njofton anëtarin për pensione të ardhshme të projektuara që ka parashtruar kërkesë për kuotim se janë marrë oferta për pensione të ardhshme të projektuara. Shoqëria pensionale, përmes agjentit i prezanton ofertat nga tabela përmbljedhëse në formë të standardizuar, në afat prej 5 ditësh, me kërkesë të

anëtarit, e më së voni deri në 10 ditë nga arritja e tabelës përmbledhëse. Për prezantimin e ofertave shfrytëzohet mënyra e njëjtë e prezantimit nga ana e agjentit dhe forma e njëjtë e standardizuar. Pas zgjedhjes së kryer, shfrytëzuesi i pensionit lidh marrëveshje të re për tërheqje të programuar të përjetshme me shoqëri tjetër pensionale, policë për anuitet me shoqëri të sigurimit ose marrëveshje për tërheqje të programuara të përkohshme me shoqëri të njëjtë ose tjetër pensionale dhe policë për anuitet me shoqëri sigurimi.

Shoqëria pensionale që ka menaxhuar me fondin pensional ku anëtari ka pasur llogari individuale gjatë realizimit të pensionit nga shtylla e dytë, është e detyruar që ta mbajë dhe ruajë evidencën e plotë me të gjitha të dhënat në lidhje me procesin e zgjedhjes së llojit të pagesës së pensionit nga shtylla e dytë. Evidenca ruhet për periudhë prej 50 vitesh. Evidenca mbahet për çdo anëtar të fondit pensional dhe përfshin: lloji i zgjedhur i pagesës së pensionit nga shtylla e dytë ose kombinimi i tyre; shuma e përgjithshme e mjeteve në llogarinë individuale; emërtimi i shoqërisë/shoqërive të zgjedhur për pagesë të pensionit nga shtylla e dytë; lartësia e pensionit të realizuar nga shtylla e dytë; karakteristikat e anuitetit siç janë periudha e garantuar, periudha e prolongimit, anuiteti fikse ose variabil, shfrytëzuesi/shfrytëzuesit e caktuar për anuitetin e garantuar; karakteristikat themelore të tërheqjeve të programuara të përkohshme në kombinim me anuitetin e prolonguar të përjetshëm; shuma e pensionit që merret nga çdo lloj të pagesës së pensionit dhe raporti i tyre.

12.3.3. Kompensimi pensional nga shtylla e tretë

12.3.3.1. Llojet dhe mënyra e pagesës së kompensimit pensional nga shtylla e tretë

Shtylla e tretë, njëjtë si edhe shtylla e dytë, siguron kompensim pensional sipas parimit të kontributeve të definuara.

Anëtarët e shtyllës së tretë mund sipas zgjedhjes personale ta realizojnë kompensimin pensional përmes njërit prej llojeve të pagesës në vijim:

- anuiteti,
- tërheqjet e programuara
- pagesa e shumës së njehershme totale
- pagesa e shumës së shumëhershme totale ose
- kombinim i alternativave paraprake

Gjatë zgjedhjes së anuitetit anëtari i fondit pensional duhet të zgjedhë anuitet i cili do të përmbajë nga një karakteristikë nga çdo lloj i anuitetit të cekur në pikat në vijim:

- a) anuiteti individuale dhe të përbashkëta;
- b) anuitete të përjetshme dhe të përkohshme;
- c) anuitete të drejtpërdrejta dhe të prolonguara;
- ç) me periudhë të garantuar ose pa periudhë të garantuar dhe
- d) anuitetet fikse, anuitetet variabile ose anuitetet fikse me pjesëmarrje në fitim.

Në rast të kompensimit të kombinuar pensional, anëtari vendos sa lloje të kompensimeve pensionale do të ndahen mjetet nga llogaria vullnetare individuale dhe ose/ llogaria profesionale dhe e cakton pjesën për secilin prej llojeve.

Njëjtë si në shtyllën e dytë, anuitetet i sigurojnë shoqëritë e sigurimit të jetës, ndërsa tërheqjet e programuara, shoqëritë pensionale.

Ndryshimi i llojit të pagesës është i mundshëm vetëm në rast të tërheqjeve të programuara ose pagesave të shumëhershme. Gjegjësisht, polica e anuitetit është marrëveshje që nuk zgjidhet dhe ajo nuk guxon dhe nuk mund të ndërpritet ose blihet. Por, shfrytëzuesi i kompensimit pensional mund në çdo moment t'i zëvendësojë tërheqjet e programuara të siguruara nga një shoqëri pensionale me shfrytëzim të mjeteve tjera të disponueshme nga llogaria vullnetare individuale dhe/ose profesionale për blerje të tërheqjeve të programuara nga shoqëria tjetër pensionale, blerje të anuitetit nga shoqëria e sigurimit, me pagesë të njëhershme nga shoqëria pensionale ose me pagesë të shumëhershme nga shoqëria e njëjtë ose shoqëria tjetër pensionale. Gjithashtu, shfrytëzuesi i kompensimit pensional mund ta zëvendësojë pagesën e shumëhershme me shfrytëzim të mjeteve tjera të disponueshme nga llogaria vullnetare individuale dhe/ose profesionale për blerje të tërheqjeve të programuara nga shoqëria e njëjtë ose shoqëria tjetër pensionale, blerje të anuitetit nga shoqëria e sigurimit, me pagesë të njëhershme nga shoqëria pensionale ose me pagesë të shumëhershme nga shoqëria tjetër pensionale.

112.3.3.2. Anuiteti në shtyllën e tretë

Në shtyllën e tretë, duke pasur parasysh se bëhet fjalë për sigurimin pensional vullnetar, lejohen më shumë lloje të anuiteteve me disa karakteristika të ndryshme të cilat anëtari, gjatë zgjedhjes së pagesës së kompensimit pensional përmes anuitetit, duhet t'i zgjedhë.

Gjegjësisht, ai duhet të zgjedhë nëse anuiteti do të jetë i veçantë ose i përbashkët. *Anuiteti i veçantë* është lloji i anuitetit të cilin shoqëria e sigurimit ia paguan vetëm një shfrytëzuesi të kompensimit pensional. *Anuiteti i përbashkët* është lloji i anuitetit të cilin shoqëria e sigurimit ia paguan shfrytëzuesit të kompensimit pensional, e pas vdekjes së tij nga ai shfrytëzues i caktuar. Nëse vendos për anuitet të përbashkët, atëherë shfrytëzuesi i kompensimit pensional, në policën, cakton një ose më shumë shfrytëzues të cilët në rast të vdekjes së tij e shfrytëzojnë anuitetin. Çdo shfrytëzues fiton një pjesë të kompensimit pensional në lartësi të definuar nga anëtari i fondit pensional në policën, ndërsa shuma e të gjitha pjesëve që i marrin shfrytëzuesit nuk mund të tejkalojë 100% të lartësisë së kompensimit pensional.

Gjithashtu, anëtari duhet të zgjedhë nëse dëshiron anuitet të përjetshëm ose të përkohshëm. *Anuiteti i përjetshëm* është lloji i anuitetit me të cilin shoqëria e sigurimit i garanton shfrytëzuesit të kompensimit pensional pagesë të përjetshme mujore të kompensimit pensional, pa dallim të jetëgjatësisë së tij reale. *Anuiteti i përkohshëm* është lloji i anuitetit me të cilin shoqëria e sigurimit i garanton shfrytëzuesit pagesë të kompensimit pensional për numër të paracaktuar të periudhave.

Karakteristikë tjetër e anuiteteve për të cilën duhet të vendosë anëtari është nëse dëshiron anuitet të drejtpërdrejtë ose të prolonguar. *Anuiteti i drejtpërdrejtë* është lloji i anuitetit të cilin shoqëria e sigurimit fillon ta paguajë pas transferimit të premisë nga shoqëria pensionale në shoqërinë e sigurimit. *Anuiteti i prolonguar* është lloji i anuitetit të cilin shoqëria e sigurimit fillon ta paguajë pas skadimit të periudhës së prolongimit.

Karakteristikë tjetër është nëse anuiteti ka ose nuk ka periudhë të garantuar. *Anuiteti pa periudhë të garantuar* është lloji i anuitetit i cili nuk ka periudhë të paracaktuar të muajve në të cilat paguhet detyrimisht dhe paguhet derisa shfrytëzuesi i pensionit është gjallë. *Anuiteti me periudhë të garantuar* është lloji i anuitetit i cili ka periudhë të paracaktuar të muajve në të cilat detyrimisht do të paguhet pa dallim nëse

shfrytëzuesi i pensionit është gjallë. Nëse shfrytëzuesi i pensionit vdes, shoqëria e sigurimit ia paguan anuitetin shfrytëzuesit të caktuar deri në fund të periudhës së garantuar. Lartësia e anuitetit që e pranon shfrytëzuesi i caktuar është i barabartë me lartësinë e anuitetit që e ka pranuar shfrytëzuesi i pensionit. Nëse anuiteti është *i garantuar*, anëtari në policën e anuitetit cakton një ose më shumë shfrytëzues dhe radhitje të shfrytëzimit, të cilat në rast të vdekjes, do ta shfrytëzojnë anuitetin deri në fund të periudhës së garantuar. Periudha e garantuar e anuitetit është me kohëzgjatje prej më së shumti 240 muajsh.

Nëse anuiteti është *i garantuar bashkërisht*, në rast të vdekjes së anëtarit, shfrytëzuesit e caktuar deri në fund të periudhës së garantuar pranojnë kompensim pensional në lartësi prej 100% që i shpërndahet çdo shfrytëzuesi, në pajtim me lartësitë e pjesëve të kompensimit pensional të përcaktuara nga anëtari i fondit pensional në policën. Pas mbarimit të periudhës së garantuar, çdo shfrytëzues e merr pjesën e kompensimit pensional të përcaktuar nga anëtari i fondit pensional në policën. Nëse anuiteti është *i prolonguar në mënyrë të garantuar*, periudha e garantuar fillon me mbarimin e periudhës së prolongimit.

Në fund, anëtari duhet të zgjedhë karakteristika në lidhje me lartësinë e anuitetit i cili do të paguhet. *Anuiteti fiks me kosto të jetesës* është lloj i anuitetit i harmonizuar me lëvizjen e kostos së jetesës dhe paguhet çdo muaj në denarë ose në euro me kundërvlerë me denarë. *Anuiteti fiks me pjesëmarrje në fitimin* është lloj i anuitetit të cilin shoqëria e sigurimit e paguan çdo muaj dhe që përfshin pagesë të garantuar minimale dhe përqindje nga fitimi i realizuar i shoqërisë së sigurimit. *Anuiteti variabil* është lloj i anuitetit të cilin shoqëria e sigurimit e paguan çdo muaj me lartësi të ndryshueshme të anuitetit varësisht nga vlera e tregut e mjeteve të fondit investues. Anuiteti shprehet në njësi ose pjesëmarrje të fondit investues, ndërsa lartësia e pensionit caktohet si rezultat nga numri i njësive (pjesëmarrjeve) dhe vlera e tregut e njësive (pjesëmarrja).

Gjatë caktimit të lartësisë së kompensimit pensional të paguar përmes anuitetit variabil dhe anuitetit fiks me pjesëmarrje në fitim, shfrytëzohen simulime dhe projeksione me parametra dhe supozime të lejuara. AMS pas pëlqimit paraprak të MAPAS i përcakton parametrat e lejuara të cilat shoqëria e sigurimit dhe personat tjerë të autorizuar mund t'i shfrytëzojnë në materialet e marketingut, simulimet dhe projeksionet për lartësinë e pensionit e cila në të ardhmen do të paguhet përmes anuitetit variabil dhe anuitetit fiks me pjesëmarrje në fitim, si dhe supozimet që duhet të përdoren dhe të cekën nga shoqëria e sigurimit dhe personat tjerë të autorizuar, veçanërisht supozimet në lidhje me të ardhurat e mjeteve të investuara të shfrytëzuara në disa “skenarë” dhe atë: “bazik”, “optimist” dhe “pesimist”.

Shumën e anuitetit e cakton shoqëria e sigurimit, në bazë të mjeteve të akumuluar që transferohen si premi në shoqërinë, karakteristikat e anuitetit të zgjedhur dhe faktorët tjerë (tabelat e vdekshmërisë, supozimet e shkallëve të kamatës, shpenzimet për menaxhim dhe supozime tjera që shfrytëzohen si caktim i lartësisë së anuitetit të ofruar).

Policat e anuiteteve për shtyllën e tretë i shesin shoqëritë e sigurimit përmes përfaqësuesit në sigurimin, shoqëritë e sigurimit në sigurim dhe shoqëri brokere sigurimi që është themeluar dhe punon në pajtim me Ligjin për mbikëqyrje të sigurimit. Ndërkaq ato gjatë shitjes së anuiteteve nuk guxojnë të ofrojnë zbritje, refundim të mjeteve në para ose volitshmëri tjera të anëtarit të fondit pensional.

Shoqëria e sigurimit nuk guxon të arkëtojë kompensime gjatë pagesës së anuiteteve nga shtylla e tretë, përveç shpenzimeve transaksionale.

Në rast të falimentimit ose likuidimit të shoqërisë së sigurimit që siguron kompensim pensional nga shtylla e tretë zbatohen në mënyrë adekuate dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje të sigurimit që kanë të bëjnë me falimentimin dhe likuidimin e shoqërisë së sigurimit. Ndërkaq, kërkesat e shfrytëzuesve të kompensimit pensional nga shtylla e tretë dhe prej tyre personat e caktuar kanë të drejtë të shlyerjes prioritare në krahasim me kreditorët tjerë të shoqërisë së sigurimit.

12.3.3.3. Tërheqjet e programuara në shtyllën e tretë

Në kuadër të shtyllës së tretë të shoqërive pensionale mund të ofrojnë:

- a) tërheqje të programuara të përhershme dhe
- b) tërheqje të programuara të përhershme

Do të thotë se anëtari mund të caktohet për pagesë të përhershme të tërheqjeve të programuara ose për pagesë në periudhë të caktuar.

Gjatë përlllogaritjes fillestare dhe vjetore të lartësisë së kompensimit pensional nga tërheqja e programuar, shoqëritë pensionale i shfrytëzojnë formulat e njëjtë që përdoren gjatë përlllogaritjes së lartësisë së pensionit nga tërheqjet e programuara nga shtylla e dytë. Shoqëria pensionale e paguan kompensimin pensional përmes tërheqjeve të programuara çdo muaj, me transferim të mjeteve në llogarinë transaksionale të caktuar nga shfrytëzuesi i kompensimit pensional.

Edhe në këtë rast shfrytëzuesi i kompensimit pensional ka cilësi specifike të anëtarit të pensionuar. Pjesa e mjeteve që mbeten në llogari përsëri riinvestohet dhe është pjesë e mjeteve të përgjithshme të fondit vullnetar pensional. Shoqëritë pensionale i investojnë mjetet që i menaxhojnë për llojet e tërheqjeve të programuara nga shtylla e tretë në pajtim me Ligjin për sigurim pensional vullnetar me financim kapital.

Shoqëritë pensionale arkëtojnë kompensim nga mjetet për tërheqje të programuara nga shtylla e tretë në lloj të kompensimit mujor si përqindje të vlerës së mjeteve neto të fondit vullnetar pensional për mbulim të shpenzimeve të shoqërisë. Shoqëritë pensionale mund të arkëtojnë shpenzime transaksionale për pagesë të kompensimeve pensionale përmes tërheqjeve të programuara.

12.3.3.4. Pagesa të njëhershme dhe të shumëhershme në shtyllën e tretë

Në shtyllën e tretë lejohet edhe pagesa e njëhershme ose e shumëhershme e mjeteve nga llogaria vullnetare dhe/ose profesionale. *Pagesa e njëhershme* është tërheqje e njëhershme e të gjitha mjeteve nga llogaria vullnetare individuale ose profesionale e anëtarit të fondit pensional. *Pagesa e shumëhershme* është tërheqja e mjeteve nga llogaria vullnetare individuale ose profesionale e anëtarit të fondit pensional në disa këste të barabarta ose të ndryshme në periudha të barabarta ose të ndryshme, derisa mjetet në llogarinë nuk harxhohen. Me këstin e fundit paguhen të gjitha mjetet nga llogaria. Gjatë përcaktimit të shumave, numrit dhe periudhave të pagesave nuk përdoren tabelat e vdekshmërisë.

Pagesa e njëhershme dhe të shumëhershme të kompensimit pensional mund të bëjnë vetëm shoqëritë e menaxhimit me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale ose shoqëri për menaxhim me fonde vullnetare pensionale.

Shoqëritë pensionale i investojnë mjetet që i menaxhojnë për shkal të pagesave të njëhershme ose të shumëhershme në pajtim me Ligjin për sigurim vullnetar pensional me financim kapital.

Shoqëritë pensionale arkëtojnë kompensime nga mjetet për pagesa të njëhershme dhe të shumëhershme në lloj të kompensimit mujor si përqindje e vlerës së mjeteve neto të fondit pensional vullnetar, për mbulim të shpenzimeve të shoqërisë. Shoqëritë pensionale mund të arkëtojnë shpenzime transaksionale për pagesë të kompensimeve pensionale përmes pagesave të njëhershme ose të shumëhershme.

12.3.3.5. Koordinimi ndërmjet MAPAS dhe AMS për shkak të harmonizimit të standardeve dhe rregullave për përlogaritje të kompensimeve pensionale që i kryejnë shoqëritë pensionale dhe shoqëritë e sigurimit.

Njëjtë si për shtyllën e dytë, duke pasur parasysh se në pagesat e kompensimeve pensionale nga shtylla e tretë mund të marrin pjesë shoqëritë pensionale, të cilat i rregullon, i licencon dhe i mbikëqyr MAPAS dhe shoqëritë e sigurimit të jetës të cilat i rregullon, i licencon dhe i mbikëqyr AMS, është i rëndësishëm bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet këtyre dy institucioneve me qëllim të punës së harmonizuar, përkatësisht punës në të njëjtat kushte të dy llojeve të shoqërive që do të kryejnë pagesat e kompensimeve pensionale.

Prandaj, AMS dhe MAPAS përcaktojnë standardet dhe rregullat minimale për përcaktimin e tabelave të vdekshmërisë dhe shkallëve të kamatës, në të njëjtat kushte për shoqëritë e sigurimit dhe shoqëritë pensionale. Ndërkaq, AMS përcakton rregullat dhe standardet minimale për përlogaritjen e rezervave teknike ndërsa shoqëria e sigurimit është e detyruar të përdorë tabelat e vdekshmërisë në përputhje me standardet minimale të përcaktuara nga AMS për llogaritjen e rezervave për anuitetet. MAPAS përcakton rregullat dhe standardet minimale për tabelat e vdekshmërisë, ndërsa shoqëria pensionale është e detyruar që për llogaritjen e faktorit të anuitetit të pensioneve nga shtylla e dytë përmes tërheqjeve të programuara të përjetshme dhe të përkohshme, të përdorë tabelat e vdekshmërisë sipas standardeve minimale të përcaktuara nga MAPAS.

Gjithashtu, AMS i përcakton rregullat dhe standardet minimale për përcaktimin e shkallëve të interesit, ndërsa shoqëria e sigurimit është e detyruar që për llogaritjen e rezervave për anuitete, të përdorë shkallët e kamatës sipas rregullave dhe standardeve minimale të përcaktuara nga AMS. MAPAS përcakton rregullat dhe standardet minimale për përcaktimin e normave të interesit, ndërsa shoqëria e pensioneve është e detyruar që për përlogaritjen e faktorit të anuitetit për pensionet nga shtylla e tretë përmes tërheqjeve të programuara të përjetshme dhe të përkohshme, të përdorë shkallët e kamatës në përputhje me rregullat dhe standardet minimale të përcaktuara nga MAPAS.

12.3.3.6. Mënyra dhe procedura e fitimit të së drejtës pensionale në rast të realizimit të viteve ligjore për moshë

Pas arritjes së moshës së caktuar ligjore, anëtari i fondit pensional ka të drejtë të kompensimit pensional nga shtylla e tretë. Do të thotë, anëtari mund që në këtë moshë, por nuk është e domosdoshme që t'i tërheqë menjëherë mjetet si kompensim pensional. Këtë të drejtë mund ta realizojë edhe në ndonjë prej viteve të ardhshme të jetës së tij, por më së voni deri në moshën 70 vjeçare.


Për realizim të kësaj të drejte të kompensimit pensional nga shtylla e tretë, anëtari i fondit pensional i dorëzon kërkesë për fitimin e të drejtës së kompensimit pensional shoqërisë pensionale që menaxhon me fondin pensional ku ai ka llogari vullnetare individuale ose profesionale (*Hapi 1 në Skemën 3 – Mënyra dhe procedura e kërkesës së kuotimeve për realizim të të drejtës së kompensimit pensional nga shtylla e tretë*).

Nëse anëtari ka edhe llogari vullnetare individuale dhe profesionale mund të kërkojë bashkim të mjeteve nga të dyja llogaritë. Nëse llogaritë janë në dy shoqëri pensionale, kërkesa dorëzohet në njërin prej shoqërive pensionale.

Nëse janë përmbushur kushtet për të drejtën e kompensimit pensional shoqëria pensionale lëshon vërtetim për shumën e mjeteve në llogarinë e saj vullnetare individuale dhe/ose profesionale dhe cakton numër identifikimi të kuotimit (*Hapi 2 në Skemën 3*). Anëtari mund të vendosë të kërkojë kuotim në

Qendrën e kuotimit për zgjedhje të llojit të kompensimit pensional, personalisht (Hapi 3.2. në Skemën 3) ose përmes shoqërisë pensionale dhe të kërkojë nga shoqëria pensionale numër identifikimi të kuotimit. Nëse anëtari vendos që të kërkojë personalisht kuotim në Qendrën e kuotimit për zgjedhje të llojit të kompensimit pensional e shfrytëzon vërtetimin të cilin e ka lëshuar shoqëria pensionale.

Skema 3: Mënyra dhe procedura e kërkesës së kuotimeve për realizim të të drejtës së kompensimit pensional nga shtylla e tretë




Nëse anëtari vendos të kërkojë kuotim përmes shoqërisë pensionale, e autorizon me shkrim shoqërinë për të kërkuar kuotim (Hapi 3.1 në Skemën 3) në të cilën i cek llojet e kompensimeve pensionale dhe e cakton pjesën e mjeteve në llogarinë vullnetare individuale dhe/ose profesionale për secilin prej llojeve. Në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, shoqëria pensionale është e detyruar të

parashtrojë kërkesë për kuotim në Qendrën e kuotimit me numër identifikimi të kuotimit dhe të dhënat në vijim: shuma e mjeteve në llogarinë individuale, gjinia dhe datëlindja e anëtarit, lloji i kompensimit pensional ose kombinimi i tyre të përcaktuara nga anëtari i fondit pensional (*Hapi 4 në Skemën 3*). Nëse anëtari i fondit pensional vendos të mos kërkojë kuotim në Qendrën e kuotimit parashtron kërkesë në shoqërinë pensionale për pagesë të mjeteve përmes tërheqjeve të programuara në mënyrë të njehershme ose të shumëhershme (*Hapi 3.3. në Skemën 3*).

Shoqëritë e sigurimit dhe shoqëritë pensionale në afat prej pesë ditësh nga dita e kërkesës duhet t'ia prezantojnë ofertat e tyre përmes Qendrës së kuotimit ose shoqërisë pensionale ose personalisht anëtarit (*Hapi 5.1. Hapi 5.2. dhe Hapi 5.3. në Skemën 3*). Shoqëritë pensionale detyrimisht prezantojnë oferta, ndërsa ofrimi i ofertave për shoqërinë e sigurimit është në bazë vullnetare. Shoqëritë e sigurimit mund të prezantojnë oferta të një ose më shumë llojeve të kompensimit pensional të kërkuara nga anëtari i fondit pensional. Nëse dëshiron të lidhë policë për anuitet, shoqëria e sigurimit është e detyruar që të japë ofertë përmes Qendrës së kuotimit. Pas përfundimit të periudhës së kuotimit shoqëria pensionale nga Qendra e kuotimit merr tabelë përmbledhëse me të gjitha ofertat e marra për anëtarin (*Hapi 6.1. në Skemën 3*). Nëse anëtari ka kërkuar kuotim personalisht, atëherë nga Qendra e kuotimit merr drejtpërdrejt tabelë përmbledhëse me të gjitha ofertat e marra (*Hapi 6.2. në Skemën 3*). *Shoqëria pensionale është e detyruar që ta prezantojë tabelën përmbledhëse të anëtarit dhe i dorëzon kopje nga tabela përmbledhëse, të verifikuar dhe të nënshkruar nga shoqëria pensionale (Hapi 7 në Skemën 3)*. Pastaj anëtari i fondit pensional mund të zgjedhë ofertë të cekur në tabelën përmbledhëse (Hapi 8 nga Skema 4).

Nëse anëtari ka zgjedhur që të pranojë kompensim pensional si tërheqje të programuara lidh marrëveshje me shoqërinë pensionale ofertën e të cilit e ka pranuar (*Hapi 1.2 në Skemën 4 – Procedura pas zgjedhjes së anëtarit për pagesë të kompensimit pensional nga shtylla e tretë*). Nëse anëtari i fondit pensional ka zgjedhur të pranojë kompensim pensional si anuitet nënshkruan policë për anuitet me shoqërinë e sigurimit ofertën e të cilin e ka pranuar (*Hapi 1.1. në Skemën 4*). Nëse anëtari i fondit pensional ka zgjedhur të pranojë kompensim pensional si kombinim nga tërheqjet e programuara dhe anuiteti lidh marrëveshje me shoqërinë pensionale dhe nënshkruan policë për anuitet me shoqërinë e sigurimit ofertat e të cilëve i ka pranuar. Ndërkaq, shoqëria e sigurimit dhe shoqëria pensionale nuk guxojnë të lidhin marrëveshje për policë për anuitet me anëtarin i cili e ka zgjedhur ofertën e tij. Anëtari dorëzon kopje të marrëveshjes dhe/ose policë për anuitet në shoqërinë pensionale që menaxhon me fondin pensional ku është ai anëtar (*Hapi 2 në Skemën 4*).

Skema 4: Procedura pas zgjedhjes së anëtarit për pagesë të kompensimit pensional nga shtylla e tretë



Nëse anëtari i fondit pensional ka zgjedhur të marrë kompensim pensional si pagesë të njëhershme ose të shumëhershme nga shoqëria pensionale, ai lidh marrëveshje me shoqërinë pensionale ofertën e së cilës e ka pranuar (Hapi 1.3 dhe Hapi 1.4. në Skemën 4). Pastaj shoqëria e përzgjedhur pensionale bën pagesën e njëhershme ose të shumëhershme të kompensimit pensional (Hapi 4.3 dhe Hapi 4.4 i Skemës 4). Pas pagesës së kryer, shoqëria pensionale lëshon vërtetim se të gjitha mjetet nga llogaria vullnetare individuale dhe/ose profesionale janë paguar. Shoqëria pensionale i dorëzon kopje të vërtetimit MAPAS-it.

Anëtari i fondit pensional nuk është i detyruar që të zgjedhë ofertë të fituar përmes Qendrës së kuotimit dhe nuk mund të kërkojë kuotim përmes Qendrës së kuotimit në numër të pakufizuar. Megjithatë, anëtari i fondit pensional realizon detyrimisht të drejtën e kompensimit pensional kur do t'i mbushë 70 vjet. Shoqëria pensionale është e detyruar të kontaktojë anëtarin që ka mbushur moshën 70 vjeçare për të realizuar të drejtën e kompensimit pensional. Nëse anëtari zgjedh një lloj të kompensimit pensional, anëtari nënshkruan marrëveshje në pajtim me zgjedhjen e tij. Nëse anëtari nuk zgjedh llojin e kompensimit pensional, konsiderohet se ka zgjedhur pagesë të njëhershme nga shoqëria pensionale që menaxhon me

fondin pensional ku anëtari ka llogari vullnetare individuale dhe/ose profesionale dhe pagesa bëhet në llogarinë e tij transaksionale. Nëse anëtari nuk e njofton shoqërinë pensionale për llogarinë transaksionale, shoqëria pensionale i ruan mjetet në llogarinë vullnetare individuale dhe/ose profesionale të anëtarit.

Pas marrjes së policës së anuitetit dhe/ose kontratës me shoqërinë pensionale, shoqëria pensionale i transferon mjetet nga llogaria vullnetare individuale dhe/ose profesionale e anëtarit të fondit pensional në llogarinë transaksionale të shoqërisë së sigurimit (Hapi 3.1 në Skemën 4) dhe/ose në llogarinë e fondit pensional të menaxhuar nga shoqëria pensionale e zgjedhur nga anëtari (Hapi 3.2 në Skemën 4). Për transferimin e kryer, shoqëria pensionale nuk guxon të arkëtojë kompensime nga anëtari ose shoqëria e sigurimit, ose shoqëria pensionale e përzgjedhur nga anëtari, përveç provizioneve transaksionale. Shoqëria pensionale është e detyruar t'i transferojë mjetet shoqërisë së sigurimit ose fondit pensional brenda një muaji nga dita e marrjes së policës për anuitet dhe/ose marrëveshjes me shoqërinë pensionale.

Pastaj shoqëria e përzgjedhur pensionale (Hapi 4.2 i Skemës 4) ose shoqëria e sigurimit (Hapi 4.1 i Skemës 4) fillon t'i paguajë anëtarit kompensim pensional nga shtylla e tretë. Nëse mjetet transferohen në gjysmën e parë të muajit kalendarik, shoqëria e sigurimit është e detyruar të bëjë pagesën e parë të anuitetit, ndërsa shoqëria pensionale është e detyruar të bëjë pagesën e parë të tërheqjeve të programuara, gjatë gjysmës së dytë të atij muaji. Nëse mjetet fondet transferohen në gjysmën e dytë të muajit kalendarik, shoqëritë janë të detyruara të bëjnë pagesën e parë nga anuiteti, përkatësisht tërheqjet e programuara, t'i bëjnë në gjysmën e parë të muajit të ardhshëm.

Nëse shfrytëzuesi i kompensimit pensional dëshiron të bëjë ndryshim të kompensimit pensional ai mund të kërkojë kuotim përmes shoqërisë pensionale ose personalisht në Qendrën e Kuotimit ose të mos kërkojë fare kuotim.

Nëse shfrytëzuesi i kompensimit pensional vendos të kërkojë kuotim përmes shoqërisë pensionale, duhet të paraqesë kërkesë për ndryshimin e llojit të pagesës së kompensimit pensional me kuotim. Kërkesa paraqitet në një formë të standardizuar. Në kërkesën, shfrytëzuesi i kompensimit pensional cakton se cilat lloje të pagesave të kompensimit pensional dëshiron të përfshihen në kuotim. Pastaj, në afat prej 5 ditësh nga marrja e kërkesës formale, shoqëria pensionale në emër të anëtarit i paraqet një kërkesë për kuotim Qendrës së Kuotimit, e cila përfshin shumën e llogarisë individuale të anëtarit. Pasi shoqëria pensionale merr tabelën përmbledhëse me ofertat nga Qendra e Kuotimit, ajo i paraqet ofertat shfrytëzuesit të kompensimit pensional.

Nëse shfrytëzuesi i kompensimit pensional dëshiron të bëjë ndryshim të kompensimit pensional ai mund të kërkojë kuotim përmes shoqërisë pensionale ose personalisht në Qendrën e Kuotimit ose të mos kërkojë fare kuotim.

Nëse shfrytëzuesi i kompensimit pensional vendos të kërkojë kuotim përmes shoqërisë pensionale, duhet të paraqesë kërkesë për ndryshimin e llojit të pagesës së kompensimit pensional me kuotim. Kërkesa paraqitet në një formë të standardizuar. Në kërkesën, shfrytëzuesi i kompensimit pensional cakton se cilat lloje të pagesave të kompensimit pensional dëshiron të përfshihen në kuotim. Pastaj, në afat prej 5 ditësh nga marrja e kërkesës formale, shoqëria pensionale në emër të anëtarit i paraqet një kërkesë për kuotim Qendrës së Kuotimit, e cila përfshin shumën e llogarisë individuale të anëtarit. Pasi shoqëria pensionale merr tabelën përmbledhëse me ofertat nga Qendra e Kuotimit, ajo i paraqet ofertat shfrytëzuesit të kompensimit pensional.

Nëse shfrytëzuesi i kompensimit pensional vendos të kërkojë personalisht kuotim gjatë ndryshimit të llojit të pagesës së kompensimit pensional në Qendrën e Kuotimit, ai personalisht duhet të paraqesë një kërkesë për ndryshimin e llojit të pagesës së kompensimit pensional me kuotim në formë të standardizuar dhe vërtetim të shumës së mjeteve në llogarinë vullnetare individuale dhe/ose profesionale në momentin e lëshimit të vërtetimit të siguruar nga shoqëria pensionale, e cila nuk është më e vjetër se një muaj. Në afat prej 5 ditësh nga kryerja e kuotimit Qendra e Kuotimit siguron oferta të cilat shfrytëzuesi i kompensimit pensional i cili ka parashtruar kërkesë personalisht i merr nga Qendra e Kuotimit.

Nëse shfrytëzuesi i kompensimit pensional vendos të mos kërkojë kuotim, gjatë ndryshimit të llojit të pagesës së kompensimit pensional, ai i paraqet kërkesë shoqërisë pensionale për pagesën e mjeteve të mbetura nëpërmjet tërheqjeve të programuara në mënyrë të njehershme ose të shumëhershme.

Pas përzgjedhjes, shfrytëzuesi i pensionit lidh marrëveshje të re për llojin e përzgjedhur të pagesës pensionale.

Shoqëria pensionale e cila ka menaxhuar me fondin pensional ku anëtari ka pasur llogari vullnetare individuale dhe/ose profesionale gjatë realizimit të kompensimit pensional, është e detyruar të mbajë dhe ruajë të gjithë evidencën me të gjitha të dhënat që lidhen me procesin e përzgjedhjes së kompensimit pensional. Evidenca mbahet për çdo anëtar të fondit pensional dhe përfshin: llojin e përzgjedhur të kompensimit pensional ose kombinimin e tyre; shumën totale të mjeteve në llogarinë vullnetare individuale dhe/ose profesionale; emrin e shoqërisë ose shoqërive të përzgjedhura për pagesën e kompensimit pensional; shumën e kompensimit të realizuar pensional; karakteristikat e anuitetit siç janë periudha e garantuar, periudha e prolongimit, anuiteti fiks ose variabil, shfrytëzuesi ose shfrytëzuesit e caktuar për anuitetin e garantuar dhe llojet e tjera të anuiteteve; karakteristikat themelore të tërheqjeve të programuara të përkohshme të kombinuara me anuitet të prolonguar; shuma e pensionit që merret nga çdo lloj të pagesës së pensionit dhe raporti i tyre. Evidenca ruhet edhe në rast të pagesës së njehershme ose të shumëhershme të mjeteve nga llogaria vullnetare individuale dhe/ose profesionale e anëtarit të fondit pensional.

12.4. KUSHTET PËR FITIMIN DHE REALIZIMIN E TË DREJTËS SË PENSIONIT INVALIDOR DHE KOMPENSIMIT PENSIONAL NË RAST TË INVALIDITETIT

12.4.1. Pensioni invalidor nga shtylla e parë

I siguruari të cilin do të ndodhë humbja e aftësisë së punës, si dhe i siguruari me aftësi tjetër të punës i cili për shkak të mbushjes së viteve të caktuara të jetës me rikualifikim ose kualifikim plotësues të aftësohet për kryerje të punës tjetër përkatëse, fiton të drejtën e pensionit invalidor nëse:

1. Invaliditeti është shkaktuar nga lëndimi në punë ose sëmundja profesionale – pa dallim të gjatësisë së stazhit pensional

Pensionin invalidor në këtë rast caktohet nga baza pensionale me përqindje maksimale (për pensionin të realizuar deri në vitin 2015 80%, ndërsa për pensionin e realizuar pas vitit 2015 përqindja maksimale zvogëlohet gradualisht dhe në vitin 2040 është 72%),

ose

2. Invaliditeti është shkaktuar nga lëndimi jashtë punës ose nga sëmundja, me kusht që para ndodhjes së invaliditetit të ketë pasur stazh të mbushur pensional në pajtim me nenin 50 të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor.

Pensionin invalidor në këtë rast caktohet nga baza pensionale varësisht nga gjatësia e stazhit pensional dhe vitet e mbushura të jetës, në mënyrë adekuate me mënyrën e përlllogaritjes së pensionit të pleqërisë. Në këto pensione sigurohet përqindja minimale, e nëse humbja e aftësisë së punës ka ndodhur para mbushjes së kushteve për pensionin të pleqërisë sigurohet edhe shtesa e invaliditetit, nëse pensioni është më i ulët të cilin e përdorin pensionistët invalidorë nga lëndimi në punë ose sëmundja profesionale.

12.4.2. Pensioni invalidor nga shtylla e dytë

I siguruari i cili është anëtar i sistemit pensional dyshtyllësh dhe ka fituar të drejtën e pensionit invalidor nga shtylla e parë, realizon pension invalidor ashtu që shuma totale e mjeteve në llogarinë e atij anëtari transferohet në FSPIMV dhe pagesa e plotë e pensionit invalidor e përlogaritur në mënyrën e lartpërmendur paguhet nga FSPIMV ose merr pension invalidor vetëm nga shtylla e dytë nëse mjetet e akumuluaru janë mjaft të mëdha për t'i siguruar pension më të madh ose të barabartë me pensionin invalidor nga FSPIMV.

Me përjashtim, për anëtarin ose të siguruarin e shpërndarë përkohësisht i cili ka fituar të drejtën e pensionit të përkohshëm invalidor në pajtim me nenin 130 të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, pensionin e përkohshëm invalidor e paguan FSPIMV, ndërsa mjetet nga llogaria individuale të anëtarit mbeten në fondin e detyrueshëm pensional derisa anëtari nuk realizon të drejtën e pensionit të pleqërisë, invalidor ose familjar.

Edhe kërkesa për pension invalidor, si dhe kërkesa për pension të pleqërisë, fillon me dorëzim të kërkesës në FSPIMV, anëtari i fondit pensional i cili kërkon pension e dorëzon edhe emërtimin e shoqërisë pensionale që menaxhon me fondin pensional në të cilin është llogaria e tij individuale. Pastaj, FSPIMV në shoqërinë pensionale përkatëse dorëzon të dhëna për shumën e pensionit që do të paguhet nga shtylla e parë dhe adresa e anëtarit.

Më tutje, për shkak të krahasimit, shoqëria pensionale e përlogarit pensionin invalidor për anëtarin si pension i përjetshëm individual përmes tërheqjeve të programuara. Gjatë përlogaritjes shfrytëzohen formulat e njëjta që shfrytëzohen gjatë përlogaritjes së tërheqjeve të programuara. Shoqëria pensionale e njofton anëtarin e fondit pensional që kërkon të realizojë të drejtën e pensionit invalidor për përlogaritjet e kryera.

Nëse konstatohet nga përlogaritjet se pensioni i përlogaritur nga shtylla e dytë është më e madhe se pensioni nga shtylla e parë, anëtari i fondit pensional i cili kërkon të realizojë të drejtën e pensionit invalidor ka të drejtë të zgjedhë nëse:

- a) Mjetet nga llogaria invalidor do t'i mbajë dhe do të heqë dorë nga pensioni invalidor nga shtylla e parë, me ç'rast shoqëria pensionale fillon me pagesën e tërheqjeve të programuara ose
- b) Mjetet nga llogaria invalidore do të transferohen në FSPIMV me ç'rast FSPIMV fillon me pagesën e pensionit invalidor.

Anëtari e bën zgjedhjen e tij në shoqërinë pensionale përmes deklaratës, ndërsa shoqëria pensionale dorëzon kopje nga deklarata në FSPIMV dhe në MAPAS.

12.4.3. Kompensimi pensional në rast të invaliditetit nga shtylla e tretë

Nëse te anëtari i fondit pensional vullnetar është konstatuar aftësi e përgjithshme për punë nga Komisioni i Vlerësimit të aftësisë së punës të Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut ai ka të drejtë, pa dallim moshe, të zgjedhë një prej mundësive për kompensim pensional të lejuara si lloj të pagesës nga shtylla e tretë.

Gjegjësisht, shuma e plotë e mjeteve të akumuluaru në llogarinë e tij do të përdoret, me të drejtë të zgjedhjes personale të anëtarit, për:

- a) ndërsa pagesë të shumës së plotë në llogari të tij, në mënyrë të njëhershme ose të shumëhershme
- b) anuitet pensional

- c) tërheqje të programuara dhe
- d) kombinim të opsioneve të lartpërmendura.

12.5. REALIZIMI I TË DREJTËS SË PENSIONIT FAMILJAR

12.5.1. Pensioni familjar nga shtylla e parë

Pension familjar mund të realizojnë anëtarët e familjes së të siguruarit të ndjerë: bashkëshorti, fëmijët dhe prindërit që i ka mbajtur i siguruari në kushte të përcaktuara me ligj.

Anëtarët e familjes fitojnë të drejtën e pensionit familjar nëse i siguruari i ndjerë:

- ka mbushur së paku 5 vite stazh të sigurimit ose së paku 10 vite stazh pensioni, ose
- i ka mbushur kushtet e pensionit të pleqërisë ose invaliditetit, ose
- ka qenë shfrytëzues i pensionit të pleqërisë ose invaliditetit.

Shuma e pensionit familjar caktohet në përqindje nga pensioni të cilin i siguruari do ta ketë gjatë kohës kur ka vdekur dhe atë 70% për një anëtar të familjes, e për çdo anëtar të ardhshëm edhe nga 10%, por jo më shumë se 100%.

12.5.2. Pensioni familjar nga shtylla e dytë

Në rast të vdekjes së anëtarit të fondit të detyrueshëm pensional nga shtylla e dytë, i cili ka anëtar të familjes që kanë të drejtën e pensionit familjar, bartësi i të drejtës së pensionit familjar realizon pensionin familjar kështu që shuma totale e mjeteve në llogarinë e anëtarit të ndjerë transferohet në FSPIMV dhe pagesa e plotë e pensionit familjar të përlllogaritur në mënyrë të lartpërmendur paguhet nga FSPIMV ose fiton pension familjar vetëm nga shtylla e dytë nëse mjetet e akumuluar janë mjaft të mëdha për t'i siguruar pension më të madh ose të barabartë me pensionin familjar të FSPIMV.

Edhe realizimi i kësaj të drejte fillon përmes FSPIMV. Gjegjësisht kur personi i cili kërkon të realizoj pension familjar nga anëtari i fondit të detyrueshëm pensional, ai parashton kërkesë për pension familjar në FSPIMV dhe e dorëzon emrin e shoqërisë pensionale që menaxhon me fondin pensional në të cilin është llogaria individuale e anëtarit. Pastaj FSPIMV në shoqërinë pensionale përkatëse dorëzon të dhëna për shumën e pensionit familjar e cila do të paguhet nga shtylla e parë, adresën e personit i cili kërkon të realizojë të drejtën e pensionit familjar dhe datëlindjen, gjininë dhe periudhën e shfrytëzimit të pensionit për çdo shfrytëzues. Periudha e shfrytëzimit të pensionit familjar mund të jetë e përkohshme nëse pensionin e shfrytëzojnë fëmijët gjatë shkollimit ose e përjetshme për anëtarët tjerë të familjes.

Për shkak të krahasimit, në pajtim me këto të dhëna shoqëria pensionale e përlllogarit pensionin familjar përmes tërheqjeve të programuara si pension i përjetshëm individual ose pension i përkohshëm individual (varësisht nëse bëhet fjalë për fëmijë të cilët janë në shkollim ose anëtarë tjerë të familjes) nga mjetet e llogarisë individuale të anëtarit të ndjerë në shtyllën e dytë, sipas rregullave të përcaktuara. Gjatë përlllogaritjes formulat e njëjtë që shfrytëzohen gjatë përlllogaritjes së tërheqjeve të programuara. Shoqëria pensionale e njofton personin i cili kërkon të realizojë pension familjar nga anëtari i fondit pensional për përlllogaritjet e kryera.

Nëse nga përlllogaritjet konstatohet se pensioni i përlllogaritur në këtë mënyrë nga shtylla e dytë është më i vogël se shuma e pensionit familjar nga shtylla e parë, atëherë mjetet e anëtarit të fondit pensional transferohen në FSIPMV me ç'rast FSIPMV fillon me pagesën e pensionit familjar.

Nëse nga përlllogaritjet konstatohet se pensioni i përlllogaritur nga shtylla e dytë është më e i madh ose i barabartë me pensionin nga shtylla e parë e të drejtës së pensionit familjar ka të drejtë të zgjedhë nëse:

- a) mjetet nga llogaria individuale e anëtarit do t'i mbajë dhe do të heqë dorë nga pensioni familjar nga shtylla e parë, me ç'rast shoqëria pensionale fillon me pagesën e tërheqjeve të programuara ose
- b) mjetet nga llogaria individuale do të transferohen në FSIPMV me ç'rast FSIPMV fillon me pagesën e pensionit familjar

Personi i cili kërkon të realizojë pension familjar nga anëtari i fondit pensional zgjedhjen e bën në shoqërinë pensionale përmes deklaratës, ndërsa shoqëria dorëzon kopje nga deklarata në FSIPMV dhe në MAPAS.

12.6. E DREJTA E TRASHËGIMISË

Në rast kur anëtari i ndjerë i fondit të detyrueshëm nuk ka anëtarë të familjes që kanë të drejtën e pensionit familjar, atëherë mjetet në llogarinë e atij anëtari bëhen pjesë e masës së trashëgimisë së trashëgimlënësit dhe me to veprohet në pajtim me Ligjin për trashëgimi.

Në rast të vdekjes së anëtarit të fondit vullnetar pensional mjetet në llogarinë trashëgohen përkatësisht bëhen pjesë e masës së trashëgimlënësit të personit që ka vdekur dhe me to veprohet në pajtim me Ligjin për trashëgimi.

12.7. TË DREJTAT TJERA TË PAGESËS NGA SHTYLLA E DYTË

Kur anëtari i fondit të detyrueshëm pensional nuk do të fitojë të drejtën e pensionit të pleqërisë sipas Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, për shkak që nuk ka mbushur stazh pensional së paku 15 vjet, mund të realizojë të drejtën e pensionit vetëm nga shtylla e dytë. Kjo kërkesë parashtrohet pas mbushjes së moshës 65 vjeçare.

Anëtari parashtron kërkesë për realizim të të drejtës së pensionit vetëm nga shtylla e dytë në shoqërinë pensionale që menaxhon me fondin pensional ku është ai anëtar. Kërkesës anëtari i bashkëngjit edhe vërtetimin e lëshuar nga FSPIMV se nuk ka realizuar të drejtën e pensionit për shkak të mospërbushjes së kushteve në lidhje me gjatësinë e stazhit pensional dhe deklaratën e verifikuar në noter se heq dorë nga e drejta e pensionit nga shtylla e parë dhe e drejta e shumës më të ulët të pensionit.

Anëtari i fondit pensional mund të zgjedhë ndërmjet:

- a) pagesës së njëhershme të mjeteve nga shtylla e dytë nga llogaria e tij individuale ose
- b) realizimit të pensionit vetëm nga mjetet nga shtylla e dytë, nëse pensioni është më i madh ose i barabartë me 40% të shumës më të ulët të pensionit në ditën e realizimit të të drejtës së pensionit nga shtylla e dytë.

Pas fillimit të zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative obligimi për dorëzim të vërtetimit nga FSPIMV se anëtari nuk ka realizuar të drejtën e pensionit për shkak të mospërbushjes së kushteve në lidhje me gjatësinë e stazhit pensional transferohet te FSPIMV. Përkatësisht, në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për realizim të të drejtës së pensionit vetëm nga shtylla e dytë, shoqëria

pensionale dorëzon kërkesë në FSPIMV për të dorëzuar vërtetim se anëtari i fondit pensional nuk ka realizuar të drejtën e pensionit për shkak të mospërmbushjes së kushteve në lidhje me gjatësinë e stazhit pensional. Nëpunësi i autorizuar nga FSPIMV është i detyruar që ta dorëzojë vërtetimin në shoqërinë pensionale në afat prej tre ditësh nga pranimi i kërkesës.

12.8. E DREJTA E SHUMËS MË TË ULËT TË PENSIONIT

Të siguruarit në sistemin njëshytlësh dhe anëtarët e sistemit pensional dyshtyllësh kanë të drejtë të mbrojtjes minimale përkatësisht të drejtë të shumës së garantuar minimale të pensionit. Gjegjësisht, nëse pensioni i përlogaritur nga shtylla e parë, i të siguruarit nga sistemi pensional njëshytlësh, ose shuma e pensioneve të përlogaritura nga shtylla e parë dhe e dytë, e anëtarit të sistemit dyshtyllësh, është më e vogël se pensioni i garantuar minimale, FSPIMV e paguan në mënyrë plotësuese dallimin deri në pensionin minimal.

Shuma më e ulët e pensionit të pleqërisë të realizuar si përmbledhje e pensioneve nga shtylla e parë dhe e dytë nuk mund të jetë më pak se përqindja e poshtëshënuar nga rroga mujore e përcaktuar e të gjitha të të punësuarve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2002, dhe atë:

- për shfrytëzuesit të cilët pensionin e kanë realizuar me stazh pensional mbi 35 vjet (meshkuj), përkatësisht mbi 30 vjet (femra), në lartësi prej 41%;
- për shfrytëzuesit të cilët pensionin e kanë realizuar me stazh pensional mbi 25 vjet (meshkuj), përkatësisht mbi 20 vjet (femra), në lartësi prej 38%;
- për shfrytëzuesit të cilët pensionin e kanë realizuar me stazh pensional deri në 25 vjet (meshkuj), përkatësisht deri në 20 vjet (femra), në lartësi prej 35%.

Ky pension harmonizohet me përqindjen me të cilën harmonizohen pensionet tjera.

Për zbatimin e të drejtës së shumës më të ulët të pensionit për anëtarët e sistemit dyshtyllësh është i rëndësishëm roli i shoqërisë të cilat do ta paguajnë pensionin nga shtylla e dytë për shkak të përlogaritjes së nevojës nga pagesa shtesë deri në pensionin minimal dhe komunikimi i tyre me FSPIMV për shkak të realizimit dhe pagesës së pensionit minimal.

Gjegjësisht, shoqëritë e sigurimit dhe shoqëritë pensionale që do të paguajnë pensione nga shtylla e dytë janë të detyruar që të kontrollojnë nëse shfrytëzuesi i pensionit me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor. Ky kontroll bëhet çdo muaj përmes realizimit të shumës mujore të pensionit që paguhet nga shtylla e dytë dhe shuma mujore e pensionit të realizuar nga shtylla e parë, me shumën më të ulët të pensionit, për çdo anëtar që ka realizuar të drejtën e pensionit nga shtylla e dytë. Nëse ekziston dallim deri në shumën më të ulët të pensionit shoqërisë e sigurimit dhe shoqërisë pensionale e njoftojnë FSPIMV për lartësinë mujore të pensionit nga shtylla e dytë dhe lartësinë e pensionit të realizuar nga shtylla e parë për çdo shfrytëzues të pensionit, në afat prej tre ditësh nga përlogaritja e pensionit për shtyllën e dytë. Pas të dhënave të fituara, FSPIMV me shfrytëzim të evidencës personale për pagesë të pensioneve nga shtylla e parë, kryen kontroll të dallimit të përlogaritur deri në shumën më të ulët të pensionit dhe është i detyruar që të kryejë pagesë të dallimit deri në shumën më të ulët të pensionit.

Me ligjin janë rregulluar më hollësisht rregullat për pagesë të dallimeve deri në shumën më të ulët varësisht nëse bëhet fjalë për pension nga shtylla e dytë përmes tërheqjes së programuar ose përmes anuitetit.

Gjegjësisht, nëse shuma e pensionit përmes tërheqjeve të programuara dhe pensionit nga shtylla e parë është më e vogël nga shuma më e ulët e pensionit, shoqëria pensionale është e detyruar ta rrisë pagesën përmes tërheqjeve të programuara me pagesë shtesë kështu që shuma e pensionit përmes tërheqjeve të programuara dhe pensionit nga shtylla e parë të jetë e barabartë me lartësinë e shumës më të ulët të pensionit të përcaktuar me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor. Pagesa e tërheqjeve të programuara me pagesë shtesë deri në lartësinë e shumës më të ulët të pensionit të përcaktuar me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor. Pagesën e tërheqjeve të programuara me pagesë shtesë të shumës më të ulët të pensionit shoqëria pensionale e kryen derisa ka mjete në llogarinë individuale të shfrytëzuesit të pensionit nga shtylla e dytë. Nëse mjetet në llogarinë individuale të shfrytëzuesit të pensionit harxhohen, shoqëria pensionale më tutje nuk paguan pension përmes tërheqjeve të programuara dhe në afat prej tre ditësh e njofton FSIPMV. Shfrytëzuesit të pensionit të FSIPMV është i detyruar që t'i paguajë pension nga shtylla e parë dhe dallim deri në shumën më të ulët të pensionit.

Nëse shuma e pensionit përmes anuiteteve pensionale dhe pensioni nga shtylla e parë është më e vogël se shuma më e ulët e pensionit, FSIPMV është i detyruar që krahas pensionit nga shtylla e parë të paguajë edhe dallim deri në shumën më të ulët të pensionit në bazë të të dhënave të fituara nga shoqëria e sigurimit.

Nëse shfrytëzuesi i pensionit nga shtylla e parë e prolongon realizimin e pensionit nga shtylla e dytë, nuk do të paguhet pagesë shtesë deri në shumën më të ulët të pensionit derisa nuk fillon të paguhet pensioni nga shtylla e dytë.

12.9. PAGESA DHE TATIMIMI I PENSIONEVE NGA SHTYLLA E DYTË DHE KOMPENSIMET PENSIONALE NGA SHTYLLA E TRETË

Të gjitha pensionet nga shtylla e dytë dhe kompensimet pensionale nga shtylla e tretë paguhen në denarë. Policat e anuitetit nga shtylla e dytë dhe policat për anuitet nga shtylla e tretë mund të shprehen në euro, por pensionet dhe kompensimet pensionale paguhen në denarë, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Te anuitetet fikse me pjesëmarrje në fitimin, shuma e pensionit shprehet në “pjesëmarrje” ose “njësi”, por paguhet në denarë, varësisht nga zgjedhja e njësisë në para për konversion të “pjesëmarrjes/njësisë” të bërë nga shfrytëzuesi i pensionit në ditën e blerjes. Te anuitetet variable shuma e pensionit shprehet në “pjesëmarrje” ose “njësi”, por paguhet në denarë, varësisht nga zgjedhja e njësisë në para për konversion të “pjesëmarrjes/njësisë” të bërë nga shfrytëzuesi i pensionit në ditën e blerjes.

Shoqëria pensionale është e detyruar që tërheqjet e programuara t'i paguajë çdo muaj, jo më vonë se data 25 në muajin për muajin paraprak, me transferim të mjeteve në llogarinë transaksionale të shfrytëzuesit të pensionit. Shoqëria e sigurimit është e detyruar që anuitetet t'i paguajë çdo muaj, jo më vonë se data 25 në muajin për muajin paraprak, me transferim elektronik të mjeteve në llogarinë transaksionale të shfrytëzuesit të pensionit, në mënyrë dhe procedurë të përcaktuara nga AMS. Pagesat e njëhershme ose të shumëhershme nga shtylla e tretë mund t'i kryejnë cilëndo ditë në muajin në llogarinë transaksionale të shfrytëzuesit të pensionit.

Pensionet nga shtylla e dytë, përmes anuitetet ose tërheqjet e programuara, nuk mund të jepen me hipotekë, të blihen as të jenë lëndë e përmbarimit. Policat e anuitetit nga shtylla e dytë nuk mund të blihen. Mjetet nga shtylla e dytë, të dedikuara për pensione përmes tërheqjeve të programuara, nuk mund të jepen me hipotekë, të blihen as të jenë lëndë e përmbarimit.

13. GARANCITË

Është tejet i rëndësishëm Ligji për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital të sigurojë garanci të caktuara për punë dhe siguri të fondeve të detyrueshme pensionale. Vendorsja e garancive e rrit besimin e publikut në sistemin dhe ndihmon të ruhen pensionet nga ky sigurim si pjesë integrale e sistemit të sigurimit social.

Për këtë shkak në Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital rregullohet mbrojtja në rast të mashtrimit, vjedhjes ose shpërdorimit, e si pasojë e asaj të harxhohen mjetet e fondit të detyrueshëm pensional, me atë që në rrethana të tilla buxheti shtetëror do të bëjë pagesë në fondin me lartësi prej 80% të shumës së humbjes.

Do të thotë, nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut do të paguhet mjete në fondin e detyrueshëm pensional në kushtet në vijim:

- nëse mjetet e fondit të detyrueshëm pensional janë zvogëluar si rezultat i veprës penale mashtrim, vjedhje ose shpërdorim. Detyrimi nga ky paragraf nuk ka të bëjë me humbjen e vlerës së mjeteve të fondit pensional në rast të investimit në kundërshtim me Ligjin ose humbjen e shkaktuar nga mashtrimi dhe vjedhja në subjektin në letrat me vlerë të të cilit janë investuar mjetet e fondit të detyrueshëm pensional;
- mjetet e shoqërisë që menaxhon me fondin e detyrueshëm pensional nuk janë të mjaftueshëm për mbulim të mjeteve të fondit pensional që janë zvogëluar si rezultat të veprës penale mashtrim, vjedhje ose shpërdorim;
- ky raport i Agjencisë publikohet në publik, në afat prej pesë ditë pune pas dorëzimit të tij te ministri i Financave.

Pagesa e mjeteve buxhetore nuk është kushtëzuar me ngritje të padisë formale kundër personit për veprë penale. Në fondin e detyrueshëm pensional do të paguhet mjetet në lartësi prej 80% të shumës së humbjes në datën ose datat e zvogëlimit, të harmonizuar për rezultatet mujore të të gjitha fondeve të detyrueshme pensionale, të përllogaritura për periudhën nga data e zvogëlimit deri në datën e pagesës së mjeteve.

Në rast kur Agjencia ka propozuar në raportin i cili i dorëzohet ministrit të Financave, të kryhet pagesë e mjeteve në fondin e detyrueshëm pensional, ai fond pensional nuk guxon të pranojë anëtarë të rinj dhe të lidhë marrëveshje të reja për tërheqje të programuara derisa nuk paguhet mjetet buxhetore.

Nëse bëhet pagesa e buxhetit shtetëror, leja për menaxhim me fondin e detyrueshëm pensional të shoqërisë e cila menaxhon me atë fond do të tërhiqet.

14. DISPOZITA NDËSHKIMORE DHE PËR KUNDËRVAJTJE

Duke pasur parasysh që sigurimi pensional me financim kapital rregullon të drejta veçanërisht të rëndësishme si pjesë integrale e sistemit pensional në shtet, e me qëllim të vetëm mbrojtja e interesave të anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale, ekziston nevoja për sanksionim të personave juridikë dhe fizikë të cilët do t'i shkelin dispozitat e Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital dhe/ose Ligjit për sigurim pensional vullnetar me financim kapital, me ç'rast në ligjet janë rregulluar sanksione adekuate ndëshkimore dhe për kundërvajtje.

Për shkak të specifikës së kësaj sfere në Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital dhe në Ligjin për sigurim pensional vullnetar me financim kapital janë vendosur disa vepra penale:

- me dënim me burg nga një deri në pesë vjet ndëshkohet personi përgjegjës në shoqërinë pensionale, i cili me paraqitje ose mbulim të fakteve, duke e mashtruar ose në mënyrë tjetër joligjore, do të ndikojë të miratohet vendim në shoqërinë pensionale për shfrytëzim ose investim joligjor të mjeteve të fondit pensional, dhe si rrjedhojë kjo do të jetë dëm i shkaktuar mbi mjetet nga fondi pensional; nëse për shkak të veprës së cekur më parë është shkaktuar dëm mbi mjetet e fondit pensional me përmasa të mëdha, kryerësi do të dënohet me burg nga një deri në dhjetë vite;
- Me dënim me para ose me burg deri në tre vjet dënohet personi përgjegjës te ruajtësi i pronës i cili me moskryerjen ose kryerjen jo të duhur të detyrimeve ligjore për ruajtje të sigurt të letrave me vlerë që paraqesin mjete të fondit pensional ose nëse lejon të zbatohet marrëveshja e joligjore për marrje investuese ose transfero të atyre mjeteve dhe shkakton dëm të mjeteve të fondit pensional; ato për shkak të veprës së lartpërmendur është shkaktuar dëm mbi mjetet e fondit pensional me përmasa të mëdha, kryerësi do të dënohet me burg nga një deri në pesë vite;
- me dënim me para ose me burg prej tre vitesh dënohet personi përgjegjës në shoqërinë pensionale ose personi tjetër juridik që kryen punë lidhur me sigurimin e detyrueshëm dhe/ose vullnetar me financim kapital, i cili me tejtransferimin ose moskryerjen e autorizimeve të tij, do të shkelë, heqë ose kufizojë të drejtën e anëtarit ose anëtarit të pensionuar të fondit pensional që i përket sipas ligjit.

Për shkak të mundësive të mëdha nga keqpërdorime me të cilat do të shkelen të drejtat veçanërisht të rëndësishme të qytetarëve, përveç veprave penale, me të dyja ligjet e lartpërmendura përcaktohen numër më i madh i kundërvajtjeve për personat juridikë dhe personat përgjegjës në to dhe gjoba përkatëse. Nëse me kryerjen e kundërvajtjes është marrë dobi më e madhe pronësore ose është shkaktuar dëm më i madh pronësor, personi juridik mund të dënohet me gjobë deri në shumën e dhjetëfishtë të dobisë së marrë pronësore ose dëmit të shkaktuar pronësor. Nëse kundërvajtja është kryer për shkak të eksploatimit, personi përgjegjës mund të dënohet me gjobë deri në shumën e dyfishtë të dënimit të përcaktuar maksimal për llojin bazë të kundërvajtjes.

Anëtar i Këshillit të Ekspertëve

Darko Sazdov

15. SHTOJCA

Shtojca 1 – Lista me ligje, rregullore dhe literaturë tjetër të shfrytëzuar

- Ligji për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital
- Ligji për sigurimin pensional vullnetar me financim kapital
- Ligji për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve pensionale nga sigurimi pensional me financim kapital
- Ligji për sigurim pensional dhe invalidor
- Ligji për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social
- Ligji për letrat me vlerë
- Ligji për tatimin mbi fitim
- Rregullore për licencimin e shoqërive pensionale
- Rregullore për kushtet më të afërta për themelimin e shoqërive pensionale
- Rregullore për menaxhim të mirë korporativ të shoqërive pensionale
- Rregullore për mënyrën dhe procedurën e marketingut të fondeve pensionale
- Rregullore për agjentët e shoqërive pensionale
- Rregullore për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional
- Rregullore për transferimin e mjeteve pas ndërprerjes së anëtarësimin në fondin e detyrueshëm pensional
- Rregullore për transferim jo në kohë të kontributeve
- Rregullore për anëtarësim në fondin vullnetar pensional
- Rregullore për mënyrën e pagesës së kontributeve në fondin vullnetar pensional
- Rregullore për kompensimet për fondet e detyrueshme pensionale
- Rregullore për shumën maksimale dhe mënyrën e pagesës së kompensimit monetar për transferimin e anëtarit nga një fond në fond tjetër pensional.
- Rregullore për investimin e mjeteve të fondeve të detyrueshme pensionale
- Rregullore për investimin e mjeteve të fondeve vullnetare pensionale
- Rregullore për përmbajtjen e strategjisë së investimit të fondit pensional
- Rregullore për vlerësimin e mjeteve të fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale
- Rregullore për llogaritë individuale

- Rregullore për llogaritë vullnetare individuale dhe profesionale
- Rregullore për transferimin e mjeteve ndërmjet fondeve të detyrueshme pensionale
- Rregullore për mënyrën e transferimit të mjeteve në Fondin SPIMV
- Rregullore për mënyrën dhe kohën e transferimit të mjeteve në fondet vullnetare pensionale
- Rregullore për mënyrën e raportimit të Agjencisë për Mbikëqyrjen e Financimit Kapital të Sigurimit Pensional.
- Rregullore për procedurën e tërheqjes ose revokimit të lejes për menaxhimin e fondit të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional.
- Rregullore për mënyrën e menaxhimit të fondit të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional pas tërheqjes ose revokimit të lejes për menaxhimin e fondit të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional të shoqërive pensionale.
- Rregullore për vërtetimin me mendimin e aktuarit të autorizuar
- Rregullore për mënyrën e krahasimit të shumave mujore të tërheqjeve të programuara dhe pensionit nga shtylla e parë dhe mënyrën e kontrollit dhe pagesës shtesë të shumës më të ulët të pensionit.
- Rregulloret për projeksionet e pensioneve dhe shumat e llogarive individuale për tërheqjet e programuara
- Rregullore për prezantimin e ofertave për pensionet e ardhshme të projektuara
- Rregullore për mënyrën e ndryshimit të llojit të pagesës së pensionit
- Rregullore për ndryshimin e llojit të pagesës së kompensimit pensional
- “Tregjet dhe institucionet financiare” Prof. dr. Mihaill Petkovski
- “Doracak i bursës”, Bursa e Maqedonisë SHA – Shkup

***Vërejtje: Informacione të dobishme mund të gjenden në ueb faqen e MAPAS: <https://mapas.mk/>**

Shtojca 2 (link) - Rregullore për mënyrën dhe procedurën e marketingut të fondeve pensionale (Gazeta zyrtare e RM-së. 143/2013, 182/2014, 221/2015, 166/2016, 9/2019 dhe 41/2019 dhe Gazeta zyrtare RMV-së. 235/2019, 244/2019, 116/2020 dhe 253/2021))

Shtojca 3 (link) - Rregullore për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 247/2018, 9/2019 dhe Gazeta zyrtare e RMV-së nr. 235/2019 dhe 212/2021)

Shtojca 4 (link) - Rregullore për mënyrën e anëtarësimit në fondin vullnetar pensional (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 138/2008, 74/2010, 134/2010, 26/2011, 155/2013, 134/2014, 110 2016, 188/2017 dhe Gazeta zyrtare e RMV-së nr. 212/2021)


Shtojca 5 (link) - Rregullore për mënyrën e pagesës së kontributeve në fondin vullnetar pensional (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 138/2008 dhe Gazeta zyrtare e RMV-së nr. 27/2022)

Shtojca 6 (link) - Rregullore për shumën maksimale dhe mënyrën e pagesës së kompensimit monetar për transferim të anëtarit nga një fond në fond tjetër pensional (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 93/2008 dhe Gazeta zyrtare e RMV-së nr. 47/2014)


Shtojca 7 – FLUKSI MONETAR (Pasqyra skematike)

Kontribute për shtyllën e parë dhe të dytë


DAP/FSPIMV arkëton kontribute




**Pagesa e kontributeve në sigurimin e detyrueshëm
pensional me financim kapital**



Kontribute për shtyllën e tretë
(sigurimi vullnetar pensional me financim kapital)




Kompensime




Vërejtje: Shoqëria i paguan kompensimet për FSPIMV, MAPAS dhe RUAJTËSIN nga mjetet personale, vetëm përllqaritja bëhet bė bazë të kontributeve të paguara në fondin pensional

Vërejtje: Shoqëria i paguan kompensimet për FSPIMV, MAPAS dhe RUAJTËSIN nga mjetet personale, vetëm përllqaritja bëhet bė bazë të kontributeve të paguara në fondin pensional


Shoqëria pensionale sjell vendime për investim




Ruajtësi mban evidencë për operacionet me mjete të fondit pensional dhe e njofton MAPAS dhe shoqërinë pensionale




Evidenca e shoqërisë pensionale




Pagosa e pensionit të pleqërisë nga shtylla e parë dhe e dytë



Pagosa e kompensimit pensional nga shtylla e tretë



Pagesa e pensionit familjar dhe invalidor nga shtylla e parë dhe e dytë



Vërejtje: Pension invalidor, përkatësisht familjar paguan Fondi i SPIMV. Përjashtim bën vetëm nëse me shumën e mjeteve në llogarinë individuale mund të sigurohet pension më i madh nga ai i përlogaritur nga FSPIM. Atëherë, pensioni invalidor, përkatësisht familjar në tërësi do të paguhet nga shtylla e dytë.

Pagesë të kompensimit pensional në rast të invaliditetit dhe në rast të vdekjes nga shtylla e tretë

Pagesa e kompensimit pensional në rast të invaliditetit dhe në rast të vdekjes nga shtylla e tretë

